

Nasi Lera

354-32

253

SHTETIT

GJIROKASTËR

Nisemi, djema!

NOVELË
E TREGIME

Nasi Lera

Shqipëri

SHIPETI

NISEMI, DJEMA!

Kishim që në mëngjes që ecnim. Ndjaj të ngrysur duhej të ndodheshim te Gryka e Keqe për të sulmuar natën depon e armëve. Shtatori digjte dhe misrat, që mezi ishin mbjellë atë vit, kishin filluar të thaheshin. Edhe shkizat i kishin gjethet në ngjyrë portokalli të ndezur, sikur thithnin vazhdimisht diellin, që ftohej në çdo lindje të tij. Nga larg shkurret e tyre ngjishnin si zjarre. Ishin lajmëtarët e para të vjeshtës në pyll.

Ata nuk ishin akoma çetë, por e dinin se një ditë do të bëheshin çetë. Në krye ecte babë Asimi. Mbiemrin e tij nuk e kujtonte më askush, përveç dosjeve sekrete të kuesturës. Pas tij vinte Marash Gjati, i ndjekur nga pushtuesit, se kishte hedhur në erë një galeri në minierën e bakrit. Dhe pastaj vinin me radhë: Sul Fusha, i arratisur nga kampi i përqëndrimit në Shijak; Ymer Abazi, i cili kishte vrarë me pushkën e tij të vjetër dy ushtarë italianë kur po i merrnin tokën për aerodrom; Sokol Arifi me dy shokë të tjerë, dezertorë nga ushtria gjatë Luftës Italo-Greke; Xhemal Voka, që kishte vrarë tagrambledhësit çakërr të krahinës, dhe disa fshatarë të tjerë që i urrenin pushtuesit. Dikush prej tyre ruante thellë dëshpërimin e 7 Prillit dhe kthimin e tij nga Durrësi me shaminë plot fishekë të pazbrazur, si pikëçuditëse mbi ditët e tradhtisë.

Kishin kohë që i ndiqnin dhe dy herë ishin rrethuar keq. Ata nuk qëndronin në një vend. Ndaj të ngrysur duhej të ndodheshin te Gryka e Keqe me çdo kusht. Baba donte armë. Nuk ishin akoma çetë, por e dinin se një ditë do të bëheshin çetë.

— U dogjëm për ujë!, — tha Marash Gjati.

— Do të pimë në çezmën e Thikasisit, — tha baba pa e kthyer kokën pas.

Atij i ishte rritur mjekra pis e zezë dhe herë pas here hiqte peshqirin nga qafa e fshinte fytyrën. Nëpër pantallonat e shajakta i ishin ngjitur hala dëllinje, që i shponin këmbët me majat e tyre si gjilpëra.

Thikasi, i mbledhur si grusht, ishte i shkretë. Ndonjë zog i shushatur çukiste ngadalë manaferrat e pjekura, të drobitura nga pluhuri dhe vapa. Ata ndaluan te çezma në hyrje të fshatit. Futën kokën në rrjedhën e freskët të ujit dhe zunë të turfullonin si kuaj nga kënaqësia. Uji u hoqi lodhjen. Grykat e maleve po fshiheshin nën mjegullat e para të vjeshtës. Përtej tyre ishte Gryka e Keqe. Larg. Baba shkopsiti këmbësh që të freskonte gjoksin e tij leshtor dhe mati me sy rrugën që duhej të bënin. Ishin pak vonë. Duhej të nxitonin. U nisën. Ai mbeti në fund. Papritur, nga një shteg mes kulprash, po vinte një vajzë me bucelë. E vështroi me bisht të syrit babën e u ul të mbushte ujë. Babën sikur e magjepsi gurgullima e currilit në bucelën e re prej ahu. Iu duk i njohur ai dialog i lashtë i ujit me bucelën. Dhe donte ta ngrinte një herë, siç bënte kur çlodhej pas punës nën tendën e gorricës, atje në arën e tij.

— Oj gocë, a ma jep ta ngre një herë atë bucelë?, — i tha baba vajzës.

— Ç'të të dojë e bardha zemër, or babë!, — tha vajza duke buzëqeshur.

— E ku ma di emrin, oj gocë?

— Unë do të shqyeja sytë nga habia, sikur të gjeja një njeri që të mos njihje babë Asimin, — tha vajza me zgjuarsi dhe i zgjati bucelën.

— Të hëngsha dasmën, oj gocë!

— Pushka top t'u bëftë, or babë!

Baba nuk ia ndante sytë. Nuk e fshehu kënaqësinë që e njihnin. Në njohjen e tij nga kjo vajzë ai ndjeu se së shpejti, me siguri, do të bëheshin çetë. Rrëkëlleu bucelën dhe e la ujin të rridhte gjoksit të tij leshtor. Vajza nuk ngopej së pari. I dukej sikur baba kishte rrëmbyer renë e bardhë që ngrihej mbi kokën e tij dhe po e thithte tërë etje lagështinë e saj. Papritur u dëgjua një e shtënë. Vajza ktheu kokën andej nga erdhi krisma dhe pa një njeri që po vraponte. Pastaj vështrroi babën dhe ngriu nga habia. Bucela ishte shpuar nga të dyja anët dhe prej saj rridhnin dy currila të hollë uji. Baba pinte e pinte, pa e prishur terezinë, dhe nuk kishte të nginjur. Pikat e ujit mbi gjoksin e tij dukeshin si vesë mbi një bar të sapokositur. Si u ngop, hoqi bucelën nga buzët, fshiu me mëngën e këmishës mustaqet, vështrroi nga erdhi e shtëna dhe tha me inat:

— Ç'qe ai që s'donte të pija ujë si njeri?, — dhe i zgjati bucelën vajzës, që nuk po e merrte veten nga hutimi.

Shokët, me të krisur pushka, qenë vënë në ndjekje të njeriut që shtiu pas gardhit të një mezhde aty pranë çezmës. Ishte e treta herë që përpiqeshin të vrisnin babën. Njeriu që shtiu ishte i shpejtë. Sokol Arifi mori shënjë dhe qëlloi, por plumbi i shkoi huq. Baba vuri re që Sokol Arifi u tërbua fare nga inati, ngaqë nuk po i fuste dot fishekun tjetër pushkës. Qeshi. Edhe Xhemali me Marashin nuk po e arrinin dot njeriun që shtiu mbi Babën.

— Ej, ç'na e lagu!, — tha baba.

Njeriu që kishte shtënë i kërceu papritur një kali të fshehur pas një are me fshesa të gjata. Para se të nisej, u kthye për të parë ndjekësit e tij. Ngërdheshi fytyrën dhe çoi dorën për të goditur kalin. Por dora i ngriu në ajër dhe ai u anua nga shala e ra ngadalë nga kali, si një besimtar që i falet perëndimit të diellit. Marash Gjati po fshinte djersët.

— Ç'qe ai ferraxhi?, — tha baba kur u mblodhën të gjithë.

— Nuk e njohëm. Nga veshja ngjante si këtej, por nga lëkura e surratit nuk dukej fare si fshatar.

— Ashtu!? Ngordhi si qen!, — tha baba dhe, si hodhi sytë tej grykave që po i mbulonte terri pak nga pak, shtoi: — Nisemi, djema!

Vajza mbeti me bucelën e shpuar në dorë, që e kishte terur tërë ujin. Ajo shikonte shpatullat e gjera të babës, që lëkundeshin sikur donin të hapnin malet për të çarë sa më parë drejt Grykës së Keqe.

2.

Në dhomë vinte fëshfëritja e fshesave të thata, që ishin bërë për t'u prerë. Frynte era e ftohtë e mëngjesit. Poshtë lumi rridhte i qetë dhe pellgjet e tij ngjisnin si pasqyra të thyera. Dielli ngjitej ngadalë, sikur donte ta sodiste sa më gjatë fshatin që shtrihej poshtë tij. Petriti hodhi poshtë velenxën e leshtë dhe ndjeu si kërcitën lëpushkat e misrit, me të cilat ishte mbushur dysheku. Atë mëngjes do të kosisnin barin e livadhit, që kishte filluar të zverdhej nga bryma. E ëma kishte zier qumështin dhe tërë shtëpia mbante një erë të këndshme, që të guduliste hundët. Petriti piu shpejt e shpejt një gotë, nxori mushkën, hodhi në sup kosën dhe i ra rrugës më të prerë. I pëlqente kositja e barit, sidomos e dehte aroma e lëngut jeshil që dilte si një lot nga fijet e prera. Që kur ishte i vogël, mezi priste të vinte koha e kositjes. Atëherë flinte bashkë me babanë nën gorricën e egër dhe natën shikonte si pikonte drita e yjeve dhe e hënës mbi luginën e ngushtë të lumit. Babai pinte duhan deri vonë dhe i tregonte ndodhira të luftës. Ato ishin të lashta dhe të reja, por në mendjen e tij ato ngatërroheshin duke lënë gjëmimin e tyre si një rrufe e largët. Edhe ai linte diçka nga fëmijëria e tij në ato tregime për luftën, si lënë lejlekët folenë e tyre kur fillojnë ngricat e para të dimrit.

Duke zbritur nëpër rrugën plot gurë të fshatit, i dukej sikur kishte lindur ashtu, si i rritur. Në të hy-

rë të livadhit, mbi një gur të madh, të zi, të rrokullisur nga mali, po mprichte sqepin një skifter. Sa dëgjoi hapat e Petritit, ai ngriti kokën dhe vështoi me mospërfillje. Pastaj përplasi krahët dhe u ngrit lart tërë dembellëk. Petriti u ul mbi gur dhe nisi të mprichte kosën ngadalë, për të shijuar sa më gjatë fillimin e kositjes. Shtatori po mbaronte si një pranverë e vogël. Zilja e mushkës përhapej nëpër livadh e zvargur, si një këngë e vjetër ushtarësh. Nga ajo zile dukej sikur bin-te mbi bar prehja e verës që kaloi. Dhe për një çast Petriti mendoi se mbi ato trualle nuk ishte dëgjuar gjë tjetër, veçse ajo zile dhe gërvishtja e hollë e gurit që mprichte hënën e bardhë të kosës.

Një rrëke e hollë humbiste barit, si një gjarpër që nxiton të fshihet shelgjishteve. Petriti pështyu pëllëmbët e duarve dhe i dha kosës. Bari u fashit si një pël-hurë e gjelbër. Puna e rrëmbeu djalin dhe ai u habit kur u gjend në fund të livadhit. Kositi derisa nuk i ndiente më shpatullat e këputura nga lodhja. I mbeti dhe gjysma. Livadhi ngjiste me një kokë të qethur me gërshërë. Mori pecetën ku e ëma i kishte mbështjellë drekën dhe u ul nën gorricën e egër që e mbanin për hije. Hante i uritur, duke shijuar domatet tërë tul. Një makinë ngrinte një re të dendur pluhuri tej në xhade. Makina ecte me shpejtësi dhe kabina e saj dukej që sipër ferrave si samar breshke. Petriti e ndoqi për një kohë me sy, pastaj u mërzit. Mblodhi thërrimet e bukës që ishin shpërndarë mbi pecetë, i ngjeshi si top me thërrimet e djathit dhe i futi në gojë. Çmpiu shpatullat dhe tha me vete se deri në mbrëmje do ta mbaronte me siguri kositjen e livadhit.

Zhurma e makinës frenoi, duke mbytur fëshfëritjen e kosës mbi bar. Pastaj ajo ndaloi. Drejt livadhit, duke kërcyer mbi vende të thata, po vinin diçka ushtarë italianë dhe dy xhandarë. Pushkët i mbanin në dorë, sikur kishin dalë për gjah, dhe ndiqnin prenë. E rrethuan Petritin dhe i hodhën mbi fytyrë frymën e tyre të rëndë.

— Ti je djali i Asim...

— I babë Asimit!, — i ndërpreu Petriti.

— Ne nuk njohim babë Asim, po Asim Sokoli. Lidheni!

— Mos më nga me dorë! Vij vetë, sa të nis mushkën për në shtëpi.

Ata shtangën përpara burrërisë së parakohshme të djalit dhe e lanë. Petriti zgjidhi mushkën, i hodhi për sipër kosën dhe pecetën e bukës. Pastaj e goditi lehtë me dhembshuri në vithe.

— Nisu, — i tha.

Mushka nuk luajti nga vendi. Vështronte njerëzit e panjohur me sytë e saj të mëdhenj dhe tundi perçen e bukur, sikur kundërshtonte të zotin.

— Nisu, — i tha prapë me të butë Petriti.

Dikush foli në gjuhë të huaj.

— Lidheni!

Atij ia lidhën duart prapa dhe e shtynë drejt makinës, që priste si një skelet breshke. Pas tij u nis dhe mushka. Djalin e hipën në karrocëri. Oficeri dha urdhër dhe makina ulëriu si një kafshë që e kanë trembur në gjumë. Pas makinës, me një revan të bukur, vraponte mushka. Petritin e pushtoi një dashuri e ngrohtë për atë krijesë që nuk kuptonte ç'ndodhte në botë, por që, me nuhatjen e saj të zgjuar, ndiente diçka të keqe. Petriti harroi se ku ishte dhe kishte para syve vetëm revanin e kafshës që aq shumë e lidhte me jetën. Një ushtar hoqi nga supi pushkën dhe mori në shenjë ballin e mushkës.

— Mooos!, — thirri Petriti, por ishte vonë.

Mushka bëri edhe disa hapa, ngriti me zor kokën për të parë për herë të fundit makinën që largohej dhe, si theu dy gjunjët e parë, u rrëzua mes xhadesë.

3.

Kur ra dëbora e parë, ata ishin shtuar akoma më tepër. Babën e thërrisnin komandant. Ai doli nga kassollja dhe pa pllajën e zbardhur gjatë natës. Ishte me-

si i nëntorit. Baba lau sytë me dëborë. Partizanët ishin zgjuar prej kohësh dhe po ndiznin zjarre për t'u ngrohur. Degët e aheve sa nuk thyheshin nga pesha. Ajri ishte i ftohtë dhe të priste fytyrën. Baba kishte vendosur të ngrinte pritë në rrugën e makinave. Aty nga ora tetë, nga udha që të shpie në fshatin Hani i Thattë, u duk një njeri. Dëborë e pashkelur e lodhte.

— Ku është baba?, — pyeti.

— Babë, të kërkojnë.

Baba erdhi drejt njeriut rëndë-rëndë, sikur kishte nuhatur diçka të keqe.

— Ç'e mirë të pruri deri këtu, o Ibish?

— E mbara të priftë përherë, or babë, por nuk kam ardhur për hajër.

— Mos u tut, or Ibish, po fol. Në këtë botë çdo gjë për njeriun është.

— Petritin me gjashtëmbëdhjetë të tjerë i nisën për në Itali.

Baba kërciti dhëmbët, u ra me dorë mustaqeve, nga që nuk dinte ç'të bënte, dhe u hoq mënjanë. Partizanët e lanë të qetë. E ndienin se nuk e ngushëllonin dot dhimbjen e tij. Baba u ul mbi trungun e një ahut të prerë prej kohësh dhe hodhi sytë andej nga duhej të ishte fshati i tij. Kraharori i ngrihej dhe i ulej në një frymëmarrje të egër. Ziente si një vorbull e turbullt uji. Qimet i ishin ngritur si gjemba iriqi. U çua dhe u vërtit disa herë rreth trungut të prerë. Disa filiza të hollë e të brishtë kishin çarë koren e dëborës dhe ishin mbështetur mbi trungun e ahut. Filizat ngjaisnin si gishtërinj të njomë fëmije mbi dërrasat e djepit.

— Xhemal!, — thirri baba.

— Urdhëro, babë.

— Merr sëpatën dhe prijë atë ah.

Xhemali nuk pyeti, po rrembeu sëpatën dhe filloi të priste ahun që i tregoi baba. Goditjet e sëpatës përhapeshi mbi pllajë si një daulle e ngjirur. Baba vuri duart mbi gjoks dhe nuk ia ndante sytë ahut që nisi të anohej. U dëgjua kërcitja e trungut, dhe pema u rrë-

zua përtokë, duke ngritur si pluhur dëborën e ngrirë. Xhemali vështroi babën dhe tha:

— Po tani ç'të bëj, or babë?

— Dërrasa! Thirr dhe tre shokë të prisni aq dërrasa sa duhen për dy tabutë. Kur t'i mbaroni, më bëj zë.

Baba hyri në kasollen e vogël dhe ndezi një cigare të trashë sa gishti. Thifhte cigaren dhe nxirrte tymin e dendur, sikur aty po valonte një kazan me ujë. Dëgjonte shokët që prisnin dërrasa dhe mendonte për luftën që do të vazhdonte gjatë. Në Malin e Thatë kishte ngritur çadrat një batalion alpin. Prej andej ai zbriste fshatrave dhe kryente ekspedita ndëshkimore. Deri në drekë sëpatat nuk pushuan. Atëherë erdhi edhe Arifi dhe i tha se as atë ditë nuk do të kishte lëvizje në xhade. Baba e dëgjoi dhe i tha që të mos largohet nga vendi, por të vëzhgonte vazhdimisht derisa t'i dhembnin sytë. Arifi u largua. Baba mbeti përsëri vetëm. Kur sëpatat heshtën, doli nga kasollja. Xhemalit i lëshonte këmisha avull.

— U lodhe?

— Pak.

— Merr gozhdë dhe mbërtheji tabutet. Kur t'i kesh lyer me të zezë, më bëj zë, — tha baba dhe hyri përsëri në kasolle.

Bojën e gjetën në fshatin Hani i Thatë, prandaj tabutet u bënë gati ndaj të ngrysur. Baba i pa dhe në fillim rrudhi buzët.

— E zeza duhej të ishte më e fortë, por s'ka gjë, prapë ajo është e zezë.

I ngarkoi dy tabutet në mushkë dhe u nis për në qytet së bashku me Xhemalin dhe Ymer Abazin. Nata ishte pis e errët. Edhe dëborë sikur kishte humbur bardhësinë e saj. Mushka ecte me kujdes, duke zgjedhur rrugën. Dëborë kërciste nën peshën e tyre. Baba nuk ndiente të ftohtë. Ishte tërë mllëf. I kujtohej vazhdimisht Petriti dhe sakaq nxehej që e kishte lëshuar veten aq shumë. Kishte pirë më tepër duhan, sesa du-

hej. E donte Petritin. Ndofta, ngaqë ishte më i vogli. Xhemali me Ymerin mezi e ndiqnin nga pas.

Nga larg u dukën shtëpitë e para. Ai ishte fshati më i madh i tërë krahinës dhe, megjithëse nuk kishte asgjë të përbashkët me një qytet, banorëve u pëlqente ta quanin kështu. Ata e quanin kështu me mëndjen e tyre, se në bisedë e thërrisnin thjesht me emrin e tij. Ai bëhej gati treqind shtëpi dhe të gjithë profesion kryesor kishin blegtorinë. Toka ishte e pakët dhe e varfër. Mbi fshat kishte kullota të gjera dhe bar të dendur. Fshati ndahej në tri lagje. Lagjja e sipërme dhe e poshtme i kishte shtëpitë të shpërndara, kurse ajo e mesit i kishte gati njëra mbi tjetrën. Pikërisht aty ishte dyqani, kafja dhe nënprefektura. Dy kilometra në verilindje italianët po ngrinin kazermat e tyre. Dukej që asaj krahine ata i jepnin rëndësi të madhe. Ndofta, ajo ishte një pikë strategjike e tyre. Por, ngaqë nuk donin të tërhiqnin vëmendjen e banorëve, ata e kishin lënë fshatin të bënte jetën e tij normale. Kështu, në fshat rrallë shiheshin ushtarë, përveç disa xhandarëve që vërtiteshin kot për të mbajtur qetësinë apo për të zgjidhur ndonjë ngatërresë ose zënie. Natën para nënprefekturës bënte rojë një xhandar.

Baba përkëdheli qafën e mushkës dhe po mendonte. Fshati dukej i shkretë. Kështu dukej ai gjithmonë në dimër. Frynte një erë e ftohtë që të priste fytyrën.

— Nga t'i biem?, — pyeti Ymer Abazi.

— Përroit të Thatë, — tha baba dhe tërhoqi kapitallin e mushkës.

Ymer Abazi me Xhemalin e ndoqën pas. Ecnin me kujdes. Dëborë kërciste nën hapat e tyre. Kur iu afruan qendrës, ata ndaluan dhe shkarkuan tabutet. Njërin e hodhi në kurriz baba, kurse tjetrin Xhemali. Baba i këshilloi përsëri me zë të ulët dhe u nis i pari. Ymer Abazi shkoi me Xhemalin.

Ata u takuan përsëri pas gjysmë ore. Kishin ngrirë. Dukej që kishin qëndruar gjatë shtrirë mbi dëborë.

— Në rregull?, — tha baba.

— Në rregull, — u përgjigj Ymer Abazi.

— Nuk ju diktoi njeri?, — u sigurua përsëri baba.

— Jo, — tha përsëri Ymer Abazi. — Pritëm sa shkoi të flerë.

— Atëherë nisemi, — tha baba.

Kur u gdhí, banorët që u çuan të parët panë në të dyja anët e shtëpisë së nënprefektit dy tabute të zeza, si dy roje të ballsamosura në hapësirën e ftohtë dimërore. S'kaloi shumë dhe në qiell u ngrit një tym i zi, i dendur. Dukej sikur tabutet rriteshin e rriteshin dhe donin të fusnin brënda tërë shtëpinë e nënprefektit.

4.

Ata çatisën papritur e papandehur. Futën kuajt në oborr dhe i lidhën pas trungut të thanës që sapo kish-te çelur lulet e para. U ranë me kamxhik pantallonave të shajakta për të shkundur pluhurin e një rruge të gjatë e të lodhshme dhe nuk po hynin. Vështronin të hutuar, sikur nuk e prisnin që ajo shtëpi të ishte aq e heshtur.

Nënë Zarifja i pa kur po vinin nga larg, duke ngarë kuajt nëpër mëhallën e poshtme, dhe sillej vërdallë nëpër dhomë, pa ditur ç'të rregullonte më parë. Ajo behje e menjëhershme e shastisi. Edhe Lejlaja, e bija, u step, megjithëse më shumë se askush ajo ardhje kishte lidhje me atë vetë. Lejlaja e dinte se ata do të vinin një ditë. Kishte raste kur i dukej se ata nuk do të vinin dhe se e kishin harruar. Po tani që i pa si hynë në oborr dhe si shkundën pluhurin e rrugës së gjatë dhe të lodhshme, pluhur që do të binte edhe mbi udhëtimin e saj të nusërisë, nuk ndjeu atë që priste. Që përtej perdes së trashë prej basme, të çngjyrosur nga dielli, kuajt dhe krushqit, dita dhe pemët, çatitë dhe rrugët, i ngjanë me një fotografi të vjetër, të zverdhur, të turbullt.

Gratë i shkundi zëri i krushkut që thërriste nga poshtë. Nënë Zarifja zbriti me nxitim shkallët dhe u doli përpara. U dha dorën dhe i përqafoi me radhë. Pa-

staj i futi në konak. Ata u ulën dhe vështruan me vëmendje muret. Nga jashtë vinte poterja e harabelave që meremetonin foletë. Njëri prej krushqve hodhi para këmbëve kutinë e duhanit.

— Të ka mbetur shtëpia pa një burrë, moj krushkë, — tha ai. — S'ka kush të na zgjatë një duhan.

— Shtëpia që i ka burrat në luftë, nuk është kurrë bosh. Po kush je zotrote, se nuk ta kam dëgjuar ndonjëherë zërin?

— Është komshiu im, — tha krushku, — kurse ky vëllai i graas.

— Dridheni nga kutia ime, se u lodhët, burra, — tha komshiu.

— Jo, — e ndërpreu nënë Zarifja, — në shtëpinë e babë Asimit mysafirët s'kanë pirë kurrë duhan nga kutia e tyre.

— Epo, tani ne jemi si një shtëpi, — u përpoq të zbuste atmosferën krushku.

— Jo, — tha nënë Zarifja ashpër. — Në shtëpinë e babë Asimit pihet duhan nga duhani i tij dhe raki nga rakia e tij.

Ajo shkoi në dhomën ngjitur dhe solli një qese të qëndisur. Pastaj vuri xhevzen me kafe në zjarr. Kutia e komshiut mbeti e mbyllur. Lumi i madh kishte zgjeruar shtratin dhe deri në dhomë vinte zhurma e tij e mbytur nëpër bërrylat e shumtë. Malet derdhnin dëborën e tyre fushave. Kafja zjeu dhe nënë Zarifja e shtiu nëpër filxhanë. Nuk i kishte pyetur ende përse ishin munduar deri aty. Askush nuk po fliste. E kishte fejuar vajzën para dy vjetësh, në krahinën përtej malit. Sapo nisi lufta, hyrjet dhe daljet u rralluan. Baba shkelte zakonisht nëpër krahinën e tij. Dhe, kur një ditë u takua me komandantin e çetës fqinjë, e pyeti për krushkun. Ai i tha se krushku ishte burrë i mirë. Baba e kishte ndërprerë dhe i kishte thënë se burrat e mirë i njëj vetëm lufta. Komandanti i çetës fqinjë i kishte thënë përsëri se krushkun e kishte të mirë. Po dhëndri? Edhe dhëndri. Atëherë baba që nxehur e i kishte thënë se në atë krahinë të gjithë burrat na qenka-

shin të mirë. Komandanti i çetës fqinjë kishte qeshur me babën. Kur u ndanë, ai i dërgoi të fala krushkut.

Në dhomë dëgjohej se si rufisnin kafen krushqit.

— Epo, ç'e mirë ju solli?, — pyeti nënë Zarifja.

— Dasma, krushkë, dasma. Dua ta marr Lejlanë pas dy javësh.

— E përse nxitohesh kaq tepër?

— Gruaja më ra uloke.

— Dy javë janë pak. Vajza e ka babanë në luftë. Edhe vëllanë ia syrgjynosi dushmani.

— Nuk bëhet qameti sikur ta lërë për dy ditë luftën baba, — tha komshiu. — E ka dhe vajzë të vetme. Sa për djalin, kështu ishte e shkruar. Ai të na kthehet shëndoshë.

Nënë Zarifja e dëgjoi si me mospërfillje dhe u kthye përsëri nga krushku:

— Babës do t'i pëlqente që kjo dasmë të bëhej si të ketë mbaruar kjo luftë.

— Luftës i dihet vetëm fillimi, kurse fundi...

— Nuk e di ç'do të thotë baba me të vëllanë.

— Edhe ai në luftë është?, — pyeti komshiu.

— Po.

— Le ta lërë dhe ai një ditë luftën, — tha përsëri komshiu.

— Nuk do të bëjmë dasmë të madhe, — tha krushku.

Nënë Zarifja u mendua. Ajo ishte e sigurtë se baba nuk do ta kundërshtonte vendimin e saj. Në ato vite bashkëjetese ata kishin marrë shumë nga njëri-tjetri.

— Do të më bëhej shumë qejfi sikur në dasmë të vinte dhe baba. Kam kohë pa e parë, — tha krushku.

— Atë e ka ai vetë në dorë, — tha prerë nënë Zarifja.

— Gjynah mos vijë në gëzimin e parë, — tha komshiu.

Krushku tjetër heshte. Dukej sikur dremiste.

— Gëzimin e parë e pati kur lindi burra, — tha nënë Zarifja.

— Ashtu është, krushkë, ashtu.

Krushqit qëndruan edhe për drekë. Nënë Zarifja i shoqëroi edhe në pije. Ajo nuk e pranonte që në shtëpi nuk kishte burra. Si u ngopën dhe panë diellin që po rrëshqiste drejt perëndimit, krushqit u çuan të iknin. Mbi leshin e bardhë të postiqeve mbeti pluhuri i rrugës së gjatë dhe të lodhshme, si një brengë e çuditshme. Nënë Zarifja i përcolli deri te dera.

— Kështu, moj krushkë, javën e parë të muajit po vij të marr Lejlanë. I thuaj dhe babës se kështu e kam hallin. Po erdhi në dasmë, do të më bëhet shumë qejfi.

— Mirë, o krushkë, mirë. Si të jetë e thënë. Bëji të fala krushkës.

Ajo u dha të treve dorën me radhë dhe u uroi udhë të mbarë. Ata u larguan dhe humbën në mëhallën e poshtme. Lejlaja kishte mbështetur ballin mbi xham dhe vështronte rrugën që gjarpëronte në kodër. Nuk kishte lëvizur fare nga vendi. Sesi i dukej që do të martohej.

— I dëgjove?

— Po.

— S'kemi ç'bëjmë.

— Sesi më duket kjo dasmë, moj nënë. Unë nuk e mendoja kështu.

— Dasmat kështu kanë qenë, moj bijë, ndryshe nga se i mendojnë vajzëzemat!

Lejlaja u kthye përsëri nga dritarja.

— Po sikur të mos vijë baba?

— Edhe bën vaki.

— Unë nuk dua që të martohej pa qenë dhe baba.

— Mos u bëj çilimi. Nesër do të rritësh fëmijë.

— Ti nuk e di, po baba mezi e ka pritur këtë ditë.

Nënë Zarifja nuk foli. Të dyja ia ngulën sytë rrugës që gjarpëronte mbi kodër. Pas pak aty u dukën tri hije të zeza dhe një re pluhuri. Ishin krushqit. Ata i ngisnin kuajt revan. Dhe Lejlaja ndiente sikur thundrat e tyre shkelnin mbi gëzimin që po çonin në fshatin e largët përtej maleve.

Nën një kumbull të mbushur plot lule të bardha, si një shkumë deti, rrinte babë Asimi dhe mendohej. Kishte mall për shtëpinë, për gruan, për ahurin dhe erën karakteristike të dhomës. Ky mall iu shtua akoma më tepër, kur e lajmëruan për dasmën e vajzës. Gëzimi e preku zemrën e tij prej babai dhe nuk gjente rehat. Lëvizte andej-këndej, si një kalë i shqetësuar dhe s'dinte ç'të bënte. Ai i kishte pritur me qetësi ngjarjet e luftës, por kjo dasmë kaq e çuditshme sikur ishte futur vjedhurazi në tërë atë tym lufte, si diçka e huaj, e hutuar, si një njeri që humbet rrugën dhe bie papritur nga dielli në mjegull të dëndur. Ai nuk e priste nga vetja tërë atë zjarrllëk që i la lajmi i dasmës. E bisedoi me komisarin, por ishin në prag të operacionit armik dhe çeta ia kishte nevojën. Babë Asimi s'mund ta braktiste çetën. Ai duronte dhimbjen dhe pinte duhan nën kumbullën e lulëzuar. Ndonjë petal shkëputej nga lulja dhe rrëzohej plot naze rreth e rrotull kurores së pemës. Edhe tërfili çeli. Binte erë gjelbërim dhe ditët e netët ishin të pastra, të kthjellëta, tamam ditë dasme. Babë Asimi pa komisarin që po afrohej.

— Kohë e bukur, — tha komisari duke tundur kokën në drejtim të majave të maleve.

— Eh, o komisar, ty çdo gjë të lë tragë.

Komisari vuri buzën në gaz dhe nuk foli.

— Epo, kështu është njeriu, mish e kockë ka, ama, zemra e urdhëron, — vazhdoi baba. — Zemra e hedh në luftë, zemra e bën zap, zemra i sfilitet dhe zemra e bën të kërcejë nga gëzimi. Po s'pati njeriu zemër, qoftë edhe një kuintal, s'është njeri, por bishë. Bishë e shkuar bishës. Ja, si thua ti, komisar, që je dhe me shkollë e ia thua lapsit?

— Ke të drejtë, babë. Ja dhe ne prandaj luftojmë, rropatemi, derdhim gjakun, që zemra të na bëhet e bukur, e madhe. Ti le dasmën e vajzës sot, se s'mund të braktisje luftën.

Babë Asimi tundi dorën, sikur t'i thoshte mos e ngiste më atë muhabet.

— Kisha qejf ta bëja ndryshe dasmën. Të vinjt ju të gjithë. Ta dridhnim vallen sa të shëmbej dyshemeja dhe të kërcisnin trarët si kocka. Sot aty, me siguri, nuk ka këtë hare. Gruas i vjen keq që nuk ka burrin me djem-të; vajzës i vjen keq që nuk ka babanë dhe vëllezërit. Ja, sikur i kam përpara, si rrinë të mpira, sikur u ka ikur gjaku. E di, komisar, sa më ka vrarë kjo dasmë, nuk më ka vrarë as internimi i djalit. E përse të ngjashë kështu?

Komisari ngriti kokën dhe i nguli sytë Babës. «Këtë njeri, po të duash ta vrasësh, vetëm me gëzim e vret», — mendoi.

— Jo, se nuk më sëmbon zëmra për djalin, por vajzën sikur e rrit vetëm për t'i gëzuar ditën e dasmës. Dhe në këtë ditë të mos i gjendet prindi, është sikur të pushkatosh dhe babanë, dhe vajzën.

Komisari nuk dinte ç'ti thoshte. E ndiente veten të pafuqishëm dhe sikur për herë të parë po rrinte pranë këtij njeriu të thjeshtë me fytyrë të ashpër, si një copë tokë e bërë gur nga dielli, me sy të thellë e pak të lëngshëm, si dy yje, që e zbutin shkëlqimin e tyre nga ndonjë tyl i hollë reje, me flokë të thinjur dhe mustaqe të gjata. «Nuk mjafton vetëm dhimbja në luftë, për të zbuluar shpirtin e një njeriu, por edhe gëzimi», — mendonte komisar, pa ia ndarë sytë Babë Asimit, që tani heshte dhe vështronte i menduar majat e maleve, mbi të cilat po binin rrezet e fundit të diellit. Poshtë këmbëve të tyre disa bredha të zinj dukeshin si hardhuca të gjelbra. Kumbulla rrëzoi një dorë petalesh mbi shpatullat e komandantit dhe të komisarit. Kumbulla u lëkund, lehtë, sikur u drodh nga një këngë partizane. Disa re u skuqën dhe qëndruan mbi majat e dy maleve, si zjarre çobanësh. Si topa dëbore lëviznin disa dele me qingjat e vegjël, që i gëzoheshin barit dhe ditës që po perëndonte. Nga shelgjishtet e dëndura të përroit të fshatit buçitën ciçërimat e zogjve, si një dialog i gjatë, i pandërprerë, i

1940

8025



gjetheve të vogla ngjyrë ulliri me rrezet e diellit. Një flutur e madhe vërtitej mbi tërfil, duke tundur krahët e bardhë me pika të zeza, ngadalë e tërë naze. Pylli papritur u skuq, sikur mori flakë, dhe bredhat e rinj tani ngjanin me një tufë peshqish të kuq, që po nise-shin për të shtegtuar. Baba heshte dhe nuk ua ndante sytë deleve që kullosnin.

— Kështu, o komisar, me demek, italiani është si i sëkëlldisur dhe po bëhet gati për operacion?

Komisari qeshi.

— Armiku kërkon që ta ketë vetë inisiativën, por ajo s'duhet të na shpëtojë kurrë nga duart.

— Shokët u çlodhën ca, — tha Baba.

— U çlodhën. Ishte marshim i gjatë.

— Tani këndojnë. Ju këndoftë gjithmonë zemra, o djema, ju këndoftë! Apo jo, o komisar, në dasma do t'ia themi, që ç'ke me të!

Dhe papritur Babë Asimi zuri të këndonte një këngë të vjetër dasme. Komisar, që nuk ishte nga ajo anë dhe nuk e dinte atë këngë, mbante iso me zë të ulët. Kënga fliste për nusen, që do ta merrnin krushqit të dielën që në sabah. Babë Asimi filloi pak nga pak ta ngrinte zërin. Nja dy partizanë, që e dëgjuan dhe që e kishin kënduar atë këngë në sa e sa dasma para luftës, u afruan ngadalë, u ulën përtokë dhe, si ngri-në në pozicionin e zakonshëm të atyre që këndojnë, filluan t'i mbanin ison. Kënga rritej e rritej. Poshtë kumbullës u mblodhën gati shumica e partizanëve. Babë Asimi, kur i pa ashtu kokë më kokë që këndonin me aq zjarr, u prek dhe gati sa nuk qau. Dikush ia nisi një kënge tjetër. Ishte e lashtë ajo këngë. Vajza i thoshte nënës se do të shkonte në luftë kundër hasmit. Moti kishte erë dhe shi. Shiu do t'ia kalbte rrëpin e pushkës. Me gërshetin tim të prerë do ta lidh pushkën, o nënë. Po, kur të më marrë malli, moj bijë si do t'ia bëj? Dil dëgjo krismat nga mali.

Komisari brofi i pari. Rrëmbeu komandantin dhe zunë të kërcenin një valle burrash. Partizanët formuan një rreth dhe përplasnin shuplakat nën ritmin e këm-

bëve. Baba kërcente lehtë, si pendë, dhe i dukej sikur ishte në dasmën e vajzës.

— Shenjën!, — thirrën partizanët.

Baba, po të ishte në shtëpi, do të kishte kërcyer aq lart, sa të bënte një shenjë në suvanë e tavanit. Por aty nuk kishte tavan.

— Shenjën!, — thirrën përsëri partizanët.

Baba ngriti kokën lart dhe pa një re të hollë...

— Hopa, komisar!, — thirri ai dhe, duke u dhënë forcë këmbëve e duke mbajtur frymën, brofi përpjetë. Gishti i tij i madh, si një turjelë shpoi drejt resë. Kur mbaroi së kërcyeri, u përplas përtokë dhe, duke marrë frymë me zor, i binte komisarit në kurriz.

— Më rrofsh, o komisar, më rrofsh! Dhe juve ju hëngsha dasmën, o djema!

Babë Asimi uronte tamam si zot shtëpie. Komisari nuk ia ndante sytë. Baba qeshte e gëzohej dhe harroi se, përveç komisarit, asnjë prej partizanëve nuk e dinte se ai atë ditë martonte vajzën dhe kishte gëzimin e parë të shtëpisë.

6:

Asnjëherë nuk i ishin dukur orët aq të gjata sa natën kur u martua. Gratë e pakta që erdhën, të gjitha të panjohura për Lejlanë, pëshpërisnin vazhdimisht me njëra-tjetrën dhe, si e kishin plotësuar kureshtjen e parë, u zhytën në mendime për jetën e tyre të zakonshme, të cilën e kishte prishur për pak çaste kjo dasmë e papritur. Nga kjo Lejlasë iu krijua përshtypja se ishte e vetmuar dhe larg njerëzve, sikur qenia e saj në atë dhomë ishte e huaj dhe krejt e padukshme. Dhoma ishte e madhe dhe e zhveshur. Ndofta, i dukej asaj kështu, sepse aty asgjë nuk i ngjallte atë dridhje që të jep dhoma ku je rritur.

Ajo rrinte në këmbë, në qoshe. Herë pas herë kthehte me kujdes kokën nga dritarja aty pranë dhe hidhte sytë jashtë. Dhe vuri re si u shua dita, si humbën

në fillim konturet e maleve, pastaj konturet e kodrave, pastaj çatia e shtëpisë në fund të fshatit dhe vonë çatia e shtëpisë fqinjë. Pastaj ndodhi përsëri e kundërta. Malet fituan masivin e tyre të errët, kodrat hijen e tyre të butë, çatitë ftohtësinë bojë hiri të rrasave dhe bajamja ngjyrën rozë e ktheu në të verdhë me të bardhë. Kishte dalë hëna.

Në katrorin e derës kalonin fytyra të ndryshme. Ndalonin për një çast, e vështronin me kujdes dhe iknin në dhomën e burrave. Më gjatë qëndronte i vjehri. Lejlaja shikonte në fytyrën e tij një trishtim që vinte duke u rritur. Ai ishte matur disa herë të futej në dhomën e grave, por sikur e mbante mbërthyer diçka mos kalonte pragun e derës. Lejlaja nuk e kuptonte përse po ndiente dashuri për atë njeri. Ndofta sepse që sot ajo do t'i thërriste atij baba, ndofta sepse edhe ai, ashtu si Lejlaja, mbante akoma shpresën se në dasmë mund të vinte nga çasti në çast edhe Baba.

Elmaz Suku nuk i bënte zëmra të fillonte dasmën. Ai mbushi gotën dhe e la ashtu të patrazuar, në krye të sofrës, ku ishin shtruar burrat. Dërgoi nipërit e tij në të katër anët e fshatit, deri aty ku fillonte mali, por ata u kthyen të heshtur. Baba nuk dukej kurrkundë të vinte. Elmaz Suku priti. Në fillim edhe mysafirëve nuk u bënte zëmra të ngrinin dollinë e parë. Elmaz Suku i dërgoi prapë nipërit në të katër anët e fshatit, dhe ata u kthyen të heshtur, si nata që kaloi orët e para. Pastaj ai ia mori një kënge. Mysafirët ia pasuan. Por kënga ishte si një curril i çuditshëm uji që del papritur e pakujtuar nga një e çarë dhe zhduket po aq papritur e pakujtuar. Atë e thithi atmosfera e thatë e dasmës që nuk po fillonte akoma. Njerëzit nuk ishin mësuar të këndonin pa e lagur gurmazin. Megjithatë, për t'ia bërë qejfin të zotit të shtëpisë, dikush ia nisi një kënge tjetër. Elmaz Suku i nisi për të fundit herë nipërit në të katër anët e fshatit. Ata u kthyen të lodhur dhe të rraskapitur, sikur kishin lënë tërë gjallërinë e dasmës shtigjeve nga nuk dukej të vinte Baba. Mysafirët u mërzitën. Elmaz Suku ngriti gotën. Dhe pastaj të gjithë

zunë të pinin si të babëzitur, sikur donin të fitonin orët e humbura. Elmaz Suku nuk e vuri më gotën në buzë. Qëndroi dhe pak në dhomën e burrave dhe u ngrit. Kaloi para dhomës së grave. Ndaloi. Nusja nuk ishte ulur fare. Rrinte në këmbë. Ia nguli sytë. Ai e kuptoi se edhe ajo priste. Dhe Elmaz Suku mendoi me vete se ajo nuk ishte dasmë, por pritje.

Aty kur nata po thyhej, mysafirët filluan të ngriheshin njëri pas tjetrit. Lejlaja dëgjonte trokëllimën e potkonjve pas pllloçave të oborrit, pastaj mbi gurët e rrugës, pastaj larg, gjersa ajo shuhej, si kënga e një zog-u në fluturim. Pas trokëllimës së parë, në një interval të shkurtër, dëgjohej e dyta. «Iku dhe një», — mendonte Lejlaja.

Në dhomë kishin mbetur disa plaka të rrudhosura, sikur kishin palosur vitet, të cilat dremisnin ndenjurr. Aty nga fundi i dasmës hyri fshehurazi një vajzë e re. Lejlasë iu duk sikur e pa në ëndërr. Vajza kishte një fytyrë të freskët, të bukur, lëkurë të lëmuar dhe dy sy të kaltër. Ngaqë ishte e lodhur, vajza i ngjau me një mjegull të bardhë.

— U lodhe?, — pyeti Mjegulla e Bardhë.

Si nëpër gjumë Lejlaja u përgjigj:

— Pak.

— Më mirë mos kishte fare dasma, — tha me një keqardhje tepër serioze për moshën e saj Mjegulla e Bardhë.

— Përse?

— Sepse ka aq shumë zhurmë, sa nuk gëzohet askush. Kur të martohem unë, do t'u them prindërve mos bëjnë fare dasmë.

— Ç'illmotit ashtu?, — tha një plakë që thithte me shije lëngun e një cope mishi.

Mjegulla e Bardhë u tret. Plaka u qetësua. Vazhdoi të thithte lëngun e mishit. Thithja e gëzimit të natës së parë të martesës. Lejlaja çuditej si e kishte mbajtur aq shumë veten, sa mos qante. Ajo tha se, me siguri, nuk e linte gjaku krenar i babës. Plakat fjetën, ashtu ndenjurr, si statuja të ftohta, që gabimisht i kishin

sjellë aty. U dëgjua trokitja e kalit të fundit, që largohet nëpër natë. Elmaz Suku hyri në dhomë.

— Nuk na erdhi Baba, moj bijë, — tha ai.

Lejlaja nuk foli. Elmaz Suku, kundër viteve dhe kundër vetvetes, i mori kokën dhe e puthi në ballë. Lejlaja u mbështet në supin e të vjerrit. Lodhja e natës i iku pak.

— Mos u mërzit, kështu e kanë dasmat që bëhen në luftë, — tha Elmaz Suku. — Shko merr një sy gjumë, se pas pak gdhiet dhe do të kesh punë.

Ai thirri vajzën e madhe, e cila e çoi në dhomë.

— Tani vjen dhe Samiu, — tha ajo dhe doli.

Lejlaja mbeti vetëm në dhomë. Poshtë, pranë dritares kishin shtruar dyshekun. Jorgani i kuq dukej si prushi i një zjarri të madh që po shuhej ngadalë. Ajo hapi dritaren. Era e natës e freskoi dhe për herë të parë ajo mbushi mushkëritë. Shikoi qiellin plot yje dhe se pse e ndjeu veten më të lehtësuar. Jashtë, pranë dritares rritej një bajame. Lejlaja nuk ia dallonte ngjyrën e luleve, por do t'i pëlqente që ato të ishin rozë. Bajamja lëshonte një erë të lehtë, të pakapshme. Mbi një petal, që e kishte gati te dora, pa disa pika vese dhe dritën e yjeve të mëdha. Kishin zbritur yjet për të thithur nektarin e luleve. Poshtë dritares shtrihej fshati i errët, me çatitë e mbuluara me rrasa guri. Çdo mëngjes do të shikonte të njëjtën pamje e pak nga pak do t'i dukej se ishte rritur aty, dhe shtëpia e nënës do të zhytej në mjegullën e fëmijnisë. Pastaj në oborr do të ecnin fëmijët e saj. Kur mendoi për fëmijët, i erdhi keq dhe u skuq, sikur dikush e kuptoi se ç'po ëndërronte atë çast. Ajo u kthye e trembur si të kishte hyrë gabimisht në një dhomë të huaj. Samiu po hiqte opingat. Lejlaja hodhi sytë jashtë. Para gardhit lëvizën dy njerëz me pushkë. Ajo u drodh, sikur për herë të parë po shikonte pushkë. Ata u larguan prapa shtëpisë, duke lënë hijen e tyre aty pas gardhit.

— S'na erdhi Baba, Lejla, — tha Samiu.

Sa dëgjoi zërin e tij të ngrohtë, ajo e ndjeu se Samiu duhej të ishte njeri i mirë. Me instinktin e gruas e njo-

hu. Dhe i iku turpi. Samiu ishte më i lodhur dhe u shtri.

— Na lodhi dasma. Edhe ti duhet të jesh këputur. Nuk u ule fare tërë kohën. Të flihet?

— Jo, po ti fli.

— Po rri edhe unë zgjuar. Akoma ke shpresë mos vijë Baba?

Lejlaja mblodhi supet. Prapa derës u dëgjuan pëshpëritje. Lejlaja shkoi të shikonte kush ishte.

— Mos e hap, — tha Samiu.

Lejlaja ngriu në vend. Pëshpëritjet u fashitën.

— Ikni që këtej!, — dëgjoji zërin e të vjehrrit.

Në shtëpi nuk pipëtinte njeri. Lejlasë po i mbylleshin sytë. Nuk donte të flinte. I dukej sikur Baba do të vinte vetëm sa për ta parë dhe, kur t'i thoshin se ajo po flinte, atij do t'i vinte keq dhe nuk do ta zgjonte. Lejlaja shkoi përsëri në dritare dhe përsëri kaluan poshtë gardhit dy njerëz të armatosur.

— Sec janë nja dy njerëz me pushkë që shkojnë e vijnë rrotull shtëpisë, — tha ajo.

— Janë njerëzit e Nexhip Bajraktarit. Kanë që në sabah që sillen kështu.

— Ç'duan?

— Nuk e di, — tha Samiu i këputur për gjumë.

— Fli, — tha Lejlaja. — Po të mbuloj.

— Po ti?

— Do të rri edhe pak.

Samiu e zuri menjëherë gjumi. Lejlaja u mbështet në dritare. Në dhomë u dëgjua frymëmarrja e Samiut. Lejlaja ktheu kokën. Ai njeri nuk ishte më i huaj për të.

Agimi po trokiste në dritare me degët e bajames së çelur. Lejlaja nuk kishte lëvizur fare nga vendi. Aty dhe kishte dremitur pak. Para se të gdhihej mirë, poshtë dritares kaluan përsëri njerëzit e armatosur dhe të pagjumë. Dita e djeshme i dukej nuses si një ëndërr e lodhshme. Sot po niste jetën e saj të re. Oxhaqet po nxirrnin tym. Po zihej qumështi. Ai ishte një fshat i bukur, tërë bajame dhe kumbulla të çelura. Në rru-

gë dikush po vinte përpara me të bërtitura bagëtinë. Në qymez kakarisën pulat. Nga çatia përballë fluturuan duke përplasur krahët një tufë pëllumbash. Lejlaja ndoqi fluturimin e tyre dhe u bë gati të dilte nga dhoma. Samiu flinte akoma. Pëllumbat u ngritën aq lart, sa u bënë njësh me qiellin. Në oborrin fqinj kërciti çikriku i pusit. Dikush trokiti në derë. Hyri i vjehrrri. Edhe ai nuk kishte fjetur fare atë natë. Vështroi Samiun që flinte dhe tha:

— Përse nuk ke fjetur fare, moj bijë?

— Fjeta, baba.

Samiu u çua si i turpëruar.

— Bëhu gati, se do të nisesh për te Baba, — i tha Elmaz Suku të birit.

Lejlaja e vështroi me dhembshuri të vjehrrin. Samiu po vishej.

— Shko më mbush pak ujë, moj bijë, — tha Elmaz Suku. — Shtjeri dhe Samiut të lajë sytë.

— Shkoj vetë te pusi, — tha Samiu.

— Dua të të jap disa këshilla para se të ikësh.

Lejlaja mori shtambat dhe i zbriti shkallët gati duke fluturuar. Mëngjesi ia hoqi lodhjen e natës. Dhe për herë të parë ajo ndjeu gëzimin e martesës dhe dashurinë për të shoqin. Ishte e lumtur që kishte rënë në njerëz të mirë. Në oborr vërtiteshin pulat. Ajo i trembi. Pulat dolën jashtë në rrugë nga një e çarë e derës. Mbi kokë zhuzhitnin bletët, duke thithur lulet e bajames. Lejlaja vështroi shtëpinë. Dhe iu duk e njohur dhe e dashur. Pastaj lëshoi kovën në pus. Kova theu pasqyrën e ujit. Kur po e ngrinte, dëgjonte si pikonte uji me zhurmën aq të njohur dhe aq të afërme. Kështu binin pikat edhe kur mbushte ujë në shtëpinë e saj. Mblidhte ngadalë litarin dhe i dukej sikur nga pusi po nxirrte diellin e atij mëngjesi aq të freskët. Papritur u dëgjua një e shtënë dhe asaj i theri shpatulla e majtë. U mbështet në murin e pusit dhe pa si dielli lëkundej në kovë dhe pastaj fundosej e fundosej, duke u copëtuar në mijëra pika.

Nga ferrat e gardhit u tërhoq gryka e një pushke

të trembur si koka e një gjarpri kur tërhiqet në vrimën e folesë së vet. Çikriku i lëshuar u rrotullua me shpejtësi dhe kova u përplas në ujë tërë zhurmë, si një rënkim i thellë. Disa bletë që ishin mbledhur në një lule të bajames rrëzuan mbi trupin pa jetë të Lejlasë disa petale të vogla ngjyrë rozë.

7:

Forcat e pushtesve u mblodhën te fusha e avionit, që shtrihej në lindje të qytetit, e shkretë, shterpë, ngaqë bari nuk lihej të rritej asnjëherë. Më shumë ajo shkelej nga ushtarët, që bënin stërvitje dhe nga fshatarët, që ditën e premte bënin aty pazarin. Aeroplanët uleshin aty më të rrallë. Ushtarët u shpërndanë dhe ndezën zjarre. Nga kodra, zjarret dukeshin si ca sy që hapeshin e mbylleshin dhe nuk i zinte gjumi. Italianët po bëheshin gati për të filluar ndonjë ekspeditë të re ndëshkimore. Pritej të vinin edhe përforcime të reja, prandaj në sjelljet e tyre ndihej një siguri e madhe. Disa kishin filluar të nervozoheshin nga vonesa.

Çeta kishte zënë vend në kodrat e perëndimit dhe Baba me komisarin shikonin zjarret dhe s'flisnin. Shikonin hijet që lëviznin dhe prisnin të fillonin sulmin. Ato ditë Baba kishte qenë i helmuar nga vrasja e së bijës. Komisari i rrinte pranë mos kushedi i shkrepse në kokë ndonjë marrëzi. Por Baba e mposhte dhimbjen me një durim të çuditshëm. Të dukej sikur tek ai ishin dy njerëz që luftonin e luftonin vazhdimisht dhe nuk reshtnin asnjëherë. Dhe nuk lodheshin asnjëherë. Kjo përlëshje ishte diçka e ngjashme me përlëshjet e ~~kreshnikëve me bajlozat e eposeve~~. Ishte e ashpër dhe e pamëshirshme. Dhe, sado që Baba mendohej të mos e jepte veten, komisar i dinte ç'hiqte ai burrë, sidomos kur mbetej vetëm, në errësirën e netëve të pranverës. Dy njerëzit sikur rrëmbenin rrufetë dhe ia hidhnin njëri-tjetrit. Dhe Babës i merrej fryma dhe nuk i mjaftonte ajri e hapësira. Vërtitej rreth partizanëve dhe heshtja, me të cilën e shoqë-

ronin ata, ia rëndonte më shumë mendimet. Njëherë u inatos me dy partizanë, të cilët, sa panë nga larg Babën, që po afrohej, u ngritën në këmbë dhe i bënë vend.

— Ç'janë tërë këto temenara, ë?, — u thirri ai. — Jemi në luftë apo në dasmë, ta marrë dreqi!

Dhe, kur kishte parë partizanët e hutuar, ishte penduar dhe kishte ikur me hapa të ngadaltë, pak i kërrusur e me duar prapa. Por atë natë Baba ishte i qetë. Komisarit i dukej sikur atij nuk i kishin ngjarë tërë ato fatkeqësira. «Ky njeri është si stralli», — tha komisarit me vete.

— Sa vajti ora, komisar?

— Katër.

— Domethënë, duhet edhe ndonjë orë.

Zjarret në fushën e aviacionit ishin zvogëluar, sikur mbi to po peshonte, duke i shtypur, mëngjesi që duhej të fekste. Akoma nuk dalloheshin mirë konturet e maleve përballë. Ishte aq qetë, siç bën ndonjëherë në pranverë, kur mund të kapësh me vesh edhe zhurmën më të vogël, edhe lëvizjen e rrënjëve nën tokë, edhe këngën e përgjumur të ndonjë zogu të trembur larg, larg. Baba ishte thinjur në luftë. Komisarit nuk ia ndante sytë.

— Ç'më shikon ashtu, o komisar?

— Kot, — tha komisarit i zënë ngushtë.

Ai nuk tha ato që mendonte. Për ta hequr nga lufta, ç'nuk i kishin punuar Babës.

— Shiko, o komisar, shiko! Luftë është dhe s'dihet.

— E paske zemrën të sflitur, or Babë!

— Jo, o komisar, jo. Por dhe unë prej mishi dhe gjaku jam. Vrasja e Lejlasë është e pabesë, si gjarpri, e poshtë, si ujku, dhe e ndyrë, si çakalli. Prandaj dhe dëshpërohem, nganjëherë, o komisar. Më vjen... — Nuk e mbaroi mendimin gjer në fund e, si heshti pak, vazhdoi: — Edhe unë prej mishi e gjaku jam... Por do të kalojë, do të kalojë...

Poshtë këmbëve të tyre filloi të zbardhte. Ishte një dritë e turbullt, sikur sytë e atij mëngjesi kishin zë-

në perde dhe një dorë e padukshme përpiquej me durim për t'ia hequr. Edhe zhurmat nisën të dëgjoheshin të shpërndara, të mbjella pa kujdes në horizontet e asaj dite që po lindte.

— Po bëhen gati të hapin plagë të reja, qenat!, — tha Baba duke shikuar fushën e aviacionit. — Por, kush mbjell vdekjen, vdekjen korr, — vazhdoi ai me mllef.

Partizanët ishin çuar dhe prisnin të niseshin nëpër përroit e thellë, që, i ngjeshur me shelgje, ishte si një tunel i sigurtë. Lëvizja filloi me kujdes. Baba ecte përpara, i futur në ujë deri afër gjunjëve. Komisari, me pjesën tjetër, do t'i qëllonte armiqtë nga kodra, kur t'i jepte shenjë Baba. Partizanët zunë pozicion. Të gjithë donin të hakmerreshin edhe për Babën. Syrit të Babës nuk i shpëtoi kjo gjë, prandaj thirri komandantët e dy kompanive. Ata erdhën menjëherë.

— Shikoni, — tha Baba, — më zënë veshi se nuk ju durohet sa të më merrni hakun për vajzën. Kjo gjë s'më pëlqen hiç fare, se s'kemi dalë në mal për hatrin tim. Se, po të qe kështu, shkoja vetë dhe ia nxirrja guxhumanin, me këto duar. Ashtu! Dhe çfarë doja t'ju thosha tjetër? Hë! Të mos vritet asnjëri, dëgjuat, asnjëri. Tani shkoni dhe mos ju ndizet gjaku dhe pastaj harroni ç'ju thashë! Hajde, djema, kujdes.

Baba pa komandantët që u larguan dhe se pse donte t'i kthente dhe t'i puthte. «Të qenka zbutur zemra, o Asim Sokoli», — tha me vete dhe dha shenjën e sulmit.

Mitralozat e kodrës krijuan panik në fushën e aviacionit, dhe ushtarët italianë lëvizën në rrëmujë drejt përroit. Atëherë filloi Baba. Lufta u ndez e tani edhe ushtarët armiq qëllonin me tërbim. Por rezistenca e tyre nuk vazhdoi gjatë. Komisari u hodh në sulm. Ushtarët lëshuan armët dhe u dorëzuan. Ata u mblodhën në mes, si ato bagëtitë që i tremben stuhisë. U morën armët. Midis tyre dallohej koka e Nexhip Bajraktarit. Ai vërtitej i egërsuar nëpër vathën që krijuan ushtarët e huaj.

— Ja ku u takuam, or Nexhip Bajraktari.

Nexhipi ulëriu si ndonjë derr i plagosur dhe çori këmishën e bardhë e të qëndisur.

— Ç'të bëj që nuk të kapa dot, or Asim Sokoli, pa ta tregoja unë!, — tha Nexhip Bajraktari.

— E ç'do të më bëje?

— Do të të rripja të gjallë.

Baba qeshi me përcmim.

— Edhe sikur të më vrisje, unë do të të fanepsesha natën dhe s'do të të lija rehat. Do të ta merrja edhe atë pak shpirt, që mund të të kishte mbetur. Do të ta nxirra pak nga pak.

Nexhip Bajraktari doli përpara dhe i tha:

— Atëherë vritmë, ç'pret. Apo të dridhet dora?

Baba rregulloi pushkën dhe pa komisarin.

— Nexhip Bajraktari, ty të ka dënuar populli me vdekje, — tha komisari.

Atëherë Baba hoqi me rrëmbim pushkën nga supi dhe e qëlloi Nexhip Bajraktarin. Nexhipi ra përtokë, çori dheun dhe u përpëlit për një kohë të gjatë, duke u mbledhur kruspull. Ashtu ngriu. Ushtarët e huaj u tron-ditën dhe hapën sytë të çakërdisur.

Ishte gdhirë dhe mëngjesi mbante erë barut të djegur. Mbas tërë asaj potereje kudo mbretëroi një qetësi e pabesueshme. Luftëtarëve u buçisnin veshët. Flladi që nisi të frynte më me forcë nga mali po e shpërndante tymin e luftës. Ata ishin çetë. Çeta ishte rreshtuar dhe priste urdhrin e komandantit. Baba pa njëherë fushën e aviacionit, malet dhe mëngjesin e asaj dite dhe tha ngadalë, por fort:

— Nisemi, djema!



UNË, DJALI YT. . .

Aty nga mesdita mjeku mbaroi operacionin e tij të fundit. I preu këmbën partizanit Gani Elezi. Si zakonisht pas operacioneve të vështira, ai dilte në hajatin e vogël të shtëpisë, të kthyer në spital, dhe shikonte malet. Janari i vitit dyzet e katër kishte ardhur i ashpër në atë fshat të thellë. Dëbora binte mbi dëborë dhe dukej sikur kështu do të vazhdonte gjithmonë. Mjeku shikonte fjollat e tymit, që e bënë akoma më të largët atë fshat, akoma më të largët luftën dhe sillte ndër mend operacionet dhe tërë atë përvojë të madhe që i kishte dhënë spitali partizan. Operacioni e kishte lodhur dhe zhurma e dëborës po i mbyllte sytë. Për një çast e pa veten të shkëputur nga atmosfera e luftës dhe tha se pylli në dimër është një mrekulli e vërtetë. Ishte nga një qytet bregdetar dhe, derisa që bëri 23 vjeç, s'kishte parë pyll në dimër. Po të mos ishte operacioni dhe njollat e gjakut mbi bluzën e tij, do të mendonte se ishte diku larg, mes botës së çuditshme të dimrit. Por ai e ndiente luftën fort dhe kusheqi sa herë e kishte ndier veten të plagosur. Çdo plagë e shokëve linte mbresë në kujtimin e tij. Ai i njihte gati të gjithë pacientët e spitalit. Bile, ua dinte edhe emrat dhe mjaft intimitete. Partizanin Gani Elezi nuk e njihte akoma. E operoi menjëherë sapo ia sollën. Ai ishte, ndofta, nga mjekët e rrallë që nuk do t'i harronte kurrë pacientët



e vet, që nga i pari deri tek i fundit. Cigarja iu fik në dorë. Pylli me pisha ishte i heshtur. Nga larg erdhi e thirrura e një njeriu. Kushedi se ç'kërkonte në një mesditë të tillë, që më shumë i ngjiste muzgut. Mjeku u përpoq të përfytyronte njeriun që do të lajmëronte fundin e luftës në atë fshat të thellë malor. Atëherë nuk do të ishte dimër. Ky ishte dimri i fundit i luftës. Mjeku ishte i bindur për këtë. Dhe dëbora do të ishte shkrirë, dhe pylli do të gjallërohej nga gjelbërimi. As vetë nuk e kuptonte pse e bashkonte çlirimin me pranverën. Ai hodhi cigaren dhe ndjeu një boshllëk. Nuk kishte punë në spital. Partizani Gani Elezi do të kishte dhembje, por ai nuk do ta qetësonte dot. Ai s'kishte fare mjete. Po të kishte, nuk do ta ndiente atë boshllëk që të lë mungesa e punës. Ai pa Saliun që mori sëpatën për të prerë dru. Goditja e sëpatës e zhyti akoma më thellë në mendime. Qoftë dëbora që binte shtruar, qoftë pylli i heshtur, qoftë goditja ritmike e sëpatës, ishin aq paqësore, sa kushdo kishte të drejtë të mendonte se lufta kishte mbaruar, dhe vetëm ai, mjeku i spitalit partizan, nuk e kishte këtë të drejtë. Këmba e prerë e partizanit Gani Elezi ishte lufta. Ai mendoi dëshpërimin e Gani Elezit dhe u çua menjëherë, sikur t'i ishte kujtuar diçka e rëndësishme. Hyri në dhomën e Ganiut dhe iu afrua shtratit. Shokët e tij, që e kishin sjellë, rrinin të heshtur. Njëri i fërkonte dorën me një dhembshuri nëne. Mjeku e kishte parë shumë herë këtë veprim aq të thjeshtë dhe gjithmonë i dukej sikur zbulonte diçka të re në shpirtin e njerëzve. Ai stepej dhe vetëm shikonte ato dy duar që shtrëngohëshin aq natyrisht me njëra-tjetrën. Ata kthyen kokën sapo hyri ai dhe u çuan në këmbë. Partizani që i kishte kapur dorën Gani Elezit, u çua i fundit dhe i lëshoi vendin. Mjeku ua bëri me dorë të mos lëviznin, por ata nuk u bindën. Ishte respekti për atë si partizan dhe mjek. Mjeku i kapi dorën Ganiut. Ishte e ngrohtë. Edhe në ballë ndjeu temperaturën e zakonshme pas operacionit. Po s'kishte asgjë shqetësuese. Askush nuk po fliste. Mjeku e kuptoi se ai duhej ta thyente heshtjen, por nuk din-

te ç'të thoshte. Në dritare dëborë bënte zhurmën e saj të zakonshme, të butë, sikur aty ishin mbledhur përrallat e fëmijnisë dhe pëshpërisnin me njëra-tjetrën. Dhe tha:

— Mos u mërzit, or Gani Elezi.

Partizani qeshi. Dikujt mund t'i dukej e çuditshme ajo buzëqeshje, por mjeku i njëjtte mirë partizanët.

— Të vura ty dhe shokët në zamat, o doktor, — tha Gani Elezi.

Ai foli sikur mjeku të mos ishte njeriu që i hoqi njëren këmbë, por sikur t'i kishte bërë një shërbim të zakonshëm.

— Mos e thuaj atë fjalë, Gani. E përse jemi shokë?

— Ashtu është, ashtu, po ca ky dimër i egër, edhe plaga ime duhej.

Partizani që i mbante dorën, i fshiu ballin.

— Mjaft, or Servet, se më je gjendur nënë e shkuar nënës. Nuk e di në do të ta shpërblej ndonjëherë për të mirë.

— Patjetër, Gani, — tha mjeku.

— Ta dish ç'ka bërë Serveti për mua, doktor, do të të mbetej edhe ty peng, po të mos ia shpërbleje me të mira. Edhe qelbin e plagës ma ka thithur.

— Mjaft, Gani, se lodhesh, — tha Serveti. — Po të flerë, i bën mirë, doktor?

— Po.

— E dëgjon, Gani? Edhe doktori thotë që të flesh.

— Kam kohë për të fjetur, Servet, kam. Dhe për ju do të fle. Po do të mërzitem. Dreqi e mori, mirë do të ishte të mos plagosesha, por, ama, dikush do të plagoset, dikush edhe do të vritet...

«Po ky a e di që i është prerë këmba?», — u shqetësua mjeku dhe pa fytyrën e qetë të Gani Elezit.

Jashtë po errej. Pishat tani nuk dukeshin të veçuara, por si një masë e tërë. Mbi to binte e binte pareshtur dëborë e vitit dyzet e katër. Dy partizanët që kishin sjellë Gani Elezin, pëshpëritën diçka.

— Do të shkoni?, — i pyeti Ganiu.

Ata ngrinë të pavendosur dhe vështruan mjekun. Ky e dinte se nga ai çast për pacientët fillonte gjendja e vështirë. Pacienti fillonte të ndiente plagën dhe kishte raste kur kjo gjendje e rëndë vazhdonte me ditë. Pacienti mbyllej në vetvete dhe i nënshtrohej në heshtje çdo veprimi. Dukej sikur për të s'kishte më rëndësi asgjë... Edhe për mjekun nuk ishte lehtë kjo gjendje shpirtërore e pacientit dhe përpiqej që ta nxirrte me çdo kusht. Partizanët nuk dinin ç'të bënin. Serveti i shtrëngoi dorën Gani Elezit dhe e puthi.

— Po të duash ti, ne rrimë, — tha ai.

— Jo, — tha Gani Elezi. — Gjer në batalion është gjithë ajo rrugë. Pushoi dëborë?

— Jo.

— Të ishit ngritur më parë, or burra.

— S'ka gjë, edhe tani nuk është vonë.

— Ashtu është. Të më ndjeni dhe jua shpërblefsha për të mirë. Vdekje fashizmit!

Dy partizanët u puthën përsëri me Gani Elezin. Mjekut përsëri iu duk sikur Ganiu nuk e dinte që ishte me një këmbë. Ky mendim i ishte ngulur në kokë dhe e godiste si çekan, duke e larguar nga ajo ngjarje. Po të mos e dinte, do të ishte më mirë t'ia thoshin dy partizanët. Partizanët i shtrënguan dorën dhe hodhën në sup pushkët.

— Mos u mërzit, — tha Serveti dhe doli me nxitim nga dhoma. Edhe ai nuk e duronte dot ndarjen. Partizani tjetër, që s'kishte folur asnjë fjalë, u kthye duke zënë gjithë derën e dhomës. U mat të hapte gojën, por s'nxori asnjë tingull. Ngriti grushtin lart dhe mjeku dëgjoi hapat e tyre të rëndë mbi shkallët e drunjta. Si mjeku dhe Gani Elezi heshtnin, sikur përpiqeshin mos humbisnin së dëgjuari ata hapa që largoheshin. Me mendje ndiqnin rrugën e tyre nëpër atë muzg dimri, thellë maleve, ndërsa dëborë do të bënte mbi gjurmët e tyre butë, sikur t'i përkëdhelte.

— Ikën, doktor, ë? Ikën. Janë shokë të mirë.

Mjeku tundi kokën.

— Dhe ti, doktor, je shok i mirë. Mos mendo se të

kam inat që më preve këmbën. Ama, po të më prisje dorën e djathtë, nuk do të të shikoja dot me sy, për kokë të nënës.

Mjeku qeshi. Në atë atmosferë lufte dhe dimri, ai shqiptim gati fëmijor i fjalës «nënës», ishte gjëja më e ngrohtë. Ajo fjalë ishte e madhe si pylli me pisha, që, i rënduar nga dëbora, dukej si një dekor i lashtë, hijerëndë.

— E përse do të më mbaje inat, po të të prisja dorën e djathtë?, — pyeti mjeku duke qeshur.

— Sepse mësova të shkruaj. Më mësoi Zymrytja. E kujt i them dhe unë? Ndoshta, për ty do të ishte më mirë të prisje dorën, se këmbën. Ju nga qyteti s'ju bën përshtypje të shkruarit. Kurse unë... E di, doktor, një ditë, para se të plagosesh, i shkrova letër nënës. Më ngjau sikur e kisha para syve. Ju nga qyteti nuk ia dini së shkruarës.

— Ia çove nënës letrën?, — pyeti mjeku.

— Jo, s'pata kohë.

— Pse nuk ia dhe Servetit t'ia çonte?

— Më vinte rëndë ta s'këlldisja. Mjaft kanë bërë për mua. E mbaj këtu, — dhe Gani Elezi vuri dorën pranë zemrës. — E mbaj këtu dhe më duket sikur kam nënën, — tha dhe ktheu kokën i turpëruar. — E dua shumë, doktor, prandaj mos ma vër re.

— Jo, Gani, jo. Po të duash, ma jep ta lexoj dhe unë.

— Kam bërë gabime, doktor.

— Punë e madhe!

— Jo, doktor, jo. Sikur s'ka lezet njeriu në moshën time të bëjë gabime.

Mjeku donte t'i thoshte se ai s'kishte bërë kurrë gabime në jetë dhe nuk do të bënte kurrë, por nuk foli. Edhe letrën nuk ia kërkoi më. Letra e parë... Nënës... Dimri i fundit i luftës... Dëbora mbi dëborë... Saliu po i fut dru sobës... Dru pishe... Mbrëmja e qetë thellë maleve...

Mjeku u çua të vizitonte të plagosurit e tjerë.

— Doktor!, — tha Gani Elezi.

— Urdhëro!, — u kthye mjeku.
— Mos u mërzite që s'ta dhashë letrën?
— Jo, Gani, jo, — qeshi mjeku. — Kur të duash, të mësoj unë.

— Mirë, doktor. Po e di pse s'ta dhashë? E ç'të duhej ty letra ime dhe misri që do të mbjellë nënia në behar? Se për misrin dhe dimrin i shkruaja.

Mjeku u prek dhe donte t'i hidhej në qafë Gani Elezit. Ai ndjeu t'i njomeshin sytë. Dhe ai misër iu duk misri më i ëmbël dhe ajo nëna iu duk si nëna e tij.

— Po të duash, ta jap ta lexosh, — tha Gani Elezi.

— Jo, tha mjeku, — e lexova.

Gani Elezi u habit dhe vuri dorën atje ku ishte letra. E preku disa herë dhe, kur u sigurua se ajo ishte në vend, iu shtua më tepër habia.

Mjeku qeshi dhe doli nga dhoma. Gani Elezi hodhi sytë nga dritarja. Ishte herët dhe nuk dukej gjë prej gjëje. Dëgjohej vetëm dëbora që binte dhe zjarri që bubullonte, duke mbushur dhomën me erën e këndshme të pishës.

* * *

Gani Elezi i duronte dhimbjet me një sedër karakteristike për fshatarët. Pyetjeve të mjekut u përgjigjej shkurt, sikur bezdisej dhe e kalonte bisedën te lufta, dimri dhe liria. Pastaj fliste për fshatin. Gani Elezi e donte fshatin e tij dhe tregonte aq bukur për shtëpitë, mullirin, livadhet, sa mjekut i dukej sikur edhe ai ishte po nga ai fshat.

Janari kaloi me dëborë. Në spital vinin të plagosur që sillnin lajmet e luftës. Lufta ishte e ashpër dhe dimri sa vinte egërsohej. Ganiu pyeste për brigadën e tij. Ajo kishte nisur një marshim të madh. Në ato çaste ai ndiente humbjen e këmbës, hidhte sytë në dritare dhe përpiquej të ndodhej pranë shokëve. Por ishte e pamundur. Dhe mërzitej. Mjeku nuk e shikonte dot të mërzi-

tur Gani Elezin. Dhe fillonte t'i jepte mësim. Letrën e parë Gani Elezi e mbante pranë zemrës dhe nuk po ia niste nënës. Priste të fillonte shkrija e dëborës, kur nëna të bëhej gati për të mbjellë misrin.

Ditët rridhnin ngadalë, megjithëse ishin të shkurttra. Netët shtyheshin akoma më me vështirësi. Pacientët dëgjonin si fërshëllente era e pyllit të pishave dhe si përplasej dëborë mbi xham. Dhe një ditë, në të aguar, erdhi urdhri që spitali të shpërngulej menjëherë. Mjeku u shqetësua për Gani Elezin. Ai do ta kishte gati të pamundur udhëtimin në një kohë të tillë. Mjeku urdhëroi një partizan që do t'i shoqëronte të rrinte pranë Ganiut.

— Doktor, mos u mërzit për mua, po shiko të tjerët, — i tha Gani Elezi. — Ky le të shikojë të tjerët. Po të kem nevojë, e thërres vetë, nuk më vjen rëndë, jo.

— Kemi rrugë të gjatë dhe moti është i keq.

— Kështu bën gjithmonë në dimër, doktor.

Mjekun e thirri Saliu. Spitali ishte ngritur. Gani Elezin e hipën mbi një mushkë dhe ia lidhën këmbën e shëndoshë pas barkut të mushkës. Kur hipi mbi mushkë, harroi se ishte me një këmbë dhe u bë gati ta godiste me të dyja këmbët në bark, siç bënte në fshat kur shkonte për dru, dhe gati sa nuk u rrëzua, se humbi ekuilibrin, por e mbajtën.

Fshati po boshatisej. Ishte diçka e trishtuar për Gani Elezin, tek shikonte si boshatisej ai fshat që, ndofta, pas disa orësh, do të kthehej në gërmadhë. Automatikun ia kishin hedhur mbi qafë dhe, sa herë që e prekte, i dukej vetja më i fortë.

Mjeku lëvizte sa në krye të kolonës, në fund. Dëborë po i merrte frymën. Po ai nuk qëndronte dot në një vend. Dhe Gani Elezin e pushtoi një dashuri e madhe për mjekun, sa donte t'i hidhej në qafë. Po e njëjta gjë ndodhte edhe me mjekun. Ai, kur shikonte qëndrimin e qetë të Ganiut, e harronte lodhjen.

Kolona hyri në pyll dhe mjeku tha të pushonin një çerek ore. Ai mjekoi disa të plagosur dhe iu afrua Ganiut. Dhe u ndodh para një befasië. Atij i qe hapur plaga dhe i rridhte gjak.

— Përse s'më thirre që kur filloi të të rrjedhë?, — i tha me inat.

— E ç't'ju bëja kot në qafë. Ja, edhe nja pesë orë rrugë kemi. Kur të shkojmë në spital, mjekohem.

— Po a e di ti se, po vazhdoi kështu, mund të vdesësh?, — tha mjeku dhe u trondit. Për herë të parë i thoshte të vërtetën një pacienti. Priti si do të reagon-te Ganiu, por nuk dalloj ndonjë ndryshim. Ganiu i hodhi një sy gjakut që i rridhte dhe lëvizi dorën sikur t'i thoshte mjekut: «E lëmë më mirë këtë muhabet». Plaga ishte hapur keq dhe mjeku e ndjeu se nuk mund të bënte të pamundurën. Dha urdhër që të niseshin për udhë. Mushka ecte e qetë, duke nxjerrë avull nga goja. Ganiu i përkëdheli qafën dhe i pëshpëriti fjalë të ëmbla. Ishte një dialog i ngadalshëm dhe i zakonshëm. Në të dalë të pyllit, në rrëpirën e parë, mushka rrëshqiti dhe u rëzua.

— E prishe këtë radhë, — i tha Gani Elezi dhe u përpoq të çohet. Mushka i rëndonte mbi këmbën e shëndoshë. Erdhën dhe e ngritën. Kur mushka filloi të ecte përsëri, Gani Elezi i foli me qortim: — Mos e bëj më këtë gjë, se na turpëron veten dhe mua. Unë, që i njoh malet, dhe ti, që i ke shkelur pëllëmbë më pëllëmbë, s'ka lezet të rrëzohemi. Mirë?

Mushka tundte kokën, sikur kërkonte falje.

— Hajde, hajde, dhe mund të rrëzohemi ndonjëherë, por, ama, jo për të mbetur përtokë. Ashtu, de! Kujdes, xhan, se ka akull. Ashtu, de! Ne i njohim me pëllëmbë këto vende. Gjermani do të thyejë kokën. Dhe do ta thyejë, sepse nuk e duron dot as dheu, kurse ne dheu na e forcon kockën. Apo e kam gabim? Jo.

Mjeku tani i rrinte pranë. Kjo ia bënte të gjatë rrugën Gani Elezit. Disa herë e largoi, por mjeku nuk e dëgjonte.

— Edhe sa rrugë kemi, Gani?

— Edhe nja dy orë të mira.

— Qenkan shumë, ta marrë dreqi!

— Pak janë. Është dimër, doktor, pa të qe behar, nuk e ndieje fare. Kur të mbarojë lufta, mos e lër pa ardhur këtej.

— Mirë, Gani, mirë. A ke dhimbje?

— Jo.

— Mos më gënjen.

— Po edhe kam pak. Po dhimbja e plagëve për burrat është, për kë tjetër?

Mjeku vështroi një copë herë fytyrën e zbehtë të Ganiut dhe nuk dinte si ta shpjegonte atë qëndrim. Ai priste që Gani Elezi të rrëzohej nga mushka. Por kjo nuk po ndodhte.

Majat e maleve vinin varg, si karvan i bardhë. Retë po uleshin. Partizanët që shoqëronin kolonën shkollnin sa te një i plagosur, te tjetri. Dukej sikur atë ditë ata nuk ndienin lodhje.

— Do të nisë prapë dëbora, doktor.

— Ku, djallin, nuk priti dhe pak!

Gani Elezi qeshi. Mjeku e humbi durimin. Fshati nuk bëhej kurrkund i gjallë. Dëbora nisi e qetë, me flokë të mëdhenj. Ishte një dëborë e bukur që zmadhonte akoma më tepër rrugën dhe karvanin e bënte më të gjatë. Dëbora binte dhe zinte vend me atë fëshfëritjen e saj karakteristike. Anët e zhveshura ngjishnin si mullarë. Dëbora u jepte forma nga më të çuditshme pemëve e gurëve. Dhe Gani Elezi u zbardh. Mjekut i ngjau si një legjendë e lashtë, që sillte mesazhin e madh të fitores. Sado e habitshme të dukej kjo gjë, mjeku nuk ngopej së pari Gani Elezin e zbardhur që lëvizte. Atëherë dhe majat e pishave nisën rrugën e tyre në rojë të karvanit. Dhe mjeku nisi një këngë të re partizane. Dhe kënga nisi udhën. Dhe tani çdo gjë dukej sikur udhëtonte dhe lëvizte drejt fshatit, ku ishte ngritur spitali i ri. Rruga ishte e sheshtë, mes pyllit me ah. Në fund të tij ishte fshati.

— Mos u sëkëlldis, doktor, se mbërritëm.

— Jemi të fortë, doktor.

— Jemi, jemi, jemi...

Dhe mjeku gati sa nuk fluturonte nga gëzimi. Ajo shpërngulje ishte provimi i tij i fundit. Dhe ai e kishte përballuar. Gani Elezi qëndronte mbi mushkë si legjendë e bardhë e maleve, megjithëse kishte humbur

tërë atë gjak. Dhe si legjendë ai e merrte gjakun nga burime të padukshme. «Ku janë burimet e legjendave?», — mendoi mjeku.

Ganiu ecte në krye të kolonës. Ai tërhoqi frerin e mushkës dhe vështroi fshatin. Ishin në hyrje të lagjes së sipërme. Për habinë e tij, jo të gjitha shtëpitë lëshonin tym. Ai nuk e kuptoi dot këtë gjë. Zakonisht, në shtëpi do të mbetej dikush për të mos u shuar zjarrri. Edhe në rrugët e pjerrëta nuk lëvizte kush. Ganiu nuk i pëlqeu kjo qetësi. Dhe iu duk si diçka e keqe. Ai lëmoi këmbën e plagosur dhe nuk i bëhej t'i binte mushkës të nisej. Në lagjen e poshtme para sheshit të xhamisë vrapuan dy njerëz. Ata u futën aq shpejt në xhami, sa ai nuk i dalloj dot.

— Përse qëndrove?, — e pyeti mjeku.

— S'më pëlqen kjo heshtje, — tha Ganiu.

Mjeku hodhi sytë mbi fshat.

— Ndofta, ngaqë nuk je mësuar akoma, — tha.

— Jo, — tha Ganiu, — nuk para më gënjen syri.

— Ç'të bëjmë atëherë?

— Të dërgojmë dikë të shikojë.

— Mirë, — tha mjeku dhe u largua.

Tymi ngjitej lart, duke u shkrirë me qiellin e hirtë e duke të shtënë në shpirt një trishtim dimëror. Fshati ishte thellë maleve, po heshtja e zyrtë e oxhaqeve e bënte akoma edhe më të largët. Ai u mat të kthente mushkën që të shikonte shokët që vinin pas, kur nga qoshja e një kasolleje doli një automatikas gjerman. Ai dha alarm. Ganiu shkundi dëborën nga supet dhe thirri:

— Në pyll! Gjermanët!

Rreshtat e kolonës u kthyen pas. Nga gardhet e mbuluara me dëborë kërcyen gjermanë të tjerë. Ganiu shtrëngoi frerin e mushkës, pa shokët që futeshin në pyll duke shkundur degët dhe hoqi automatikun. Pastaj përkëdheli në qafë mushkën.

— Mos u trëmb, xhanel!, — dhe u sul përpara. Plumbat i fishkëllyen mbi kokë.

Një skuadër ecte në formacion luftimi drejt tij.

Ai dalloi mirë fytyrat e tyre. Tërhoqi mengadalë si-
guresën dhe, duke rënduar mbi këmbën e shëndoshë,
qëlloi. Gjermanët e dinin se ai ishte i plagosur dhe
shtangën në vend. Disa ranë mbi dëborë, duke u për-
dredhur. Dhe nuk lëvizën. Dëbora lëshoi flokët e saj
mbi trupat e tyre pa jetë. Pastaj dikush lëshoi një breshë-
ri drejt mushkës. Ajo theu këmbët tërë dhimbje dhe e
zuri nën vete Gani Elezin. Ai u lirua pak, sa nxori au-
tomatikun, dhe përsëri nisi të qëllonte. Mushka pesho-
nte mbi plagën e tij, por ai nuk ndiente dhimbje. Gjër-
manët tentuan disa herë të afroheshin, por nuk u avi-
tën as disa metra. Automatiku i Gani Elezit qëllonte
e qëllonte.

Mjeku nuk e mbante mend sa vazhdoi përleshja.
Kur erdhën forcat e brigadës partizane, ai e kishte hu-
mbur nocionin e kohës dhe mendjen e kishte te Gani
Elezi. Sapo heshtën pushkët e automatikët dhe në qe-
tësinë e nderë u dëgjua dëbora që shtrohej në tokë bu-
të-butë, ai vrapoi drejt Gani Elezit. Së bashku me di-
sa partizanë largoi mushkën dhe i mori kokën në du-
ar Gani Elezit. Ai dukej sikur flinte. Mjeku filloi t'i
kontrollonte plagët. Kur i zbërthyen xhaketën, pa le-
trën e gjakosur. E mori dhe e lexoi me një frymë.

*Nëne, ky është dimri i fundit. Misrin do ta mbje-
llim së bashku. Pa ç'misër i mbarë do të jetë! Naa, do
ta bëjë kallirin. Si asnjë mot tjetër. Tani u bëj të fala
kush të pyesë për mua. Unë, djali yt, Gani Elezi të
shkruaj. Fund.*

Mjeku palosi me kujdes letrën dhe vështroi malet.
Në kokë i ushtonin fjalët: «Unë, djali yt...».

DHORI, BURRI IM

Dielli donte edhe një pëllëmbë që të zhdukej pas maleve. Mbylla bagëtinë në ahur dhe mbeta me fshesë në dorë, duke parë si po ikte edhe një ditë. Ishte te- tor dhe arrat pikonin kokrra të pjekura, kurse mollët skuqnin si hëna kur prishet moti. Rrezet e fundit binin mbi kashtën e re të kasolles së Thomaidhës, sikur do- nin t'i vinin flakën. Shyqyr që ishte bërë mbarë djali i Mevlanit, se do t'ia ngordhte dëbora edhe ato dy kë- kë bagëti që kishte e shkreta. Kishte mbetur qyqe në shtëpi. I shoqi po mbushte gati katër vjet që kish shku- ar në kurbet dhe nuk kishte dërguar fare haber në ish- te gjallë apo jo. I biri thoshin se kishte dalë partizan, se, kur pat qënë në qytet, kishte vrarë një spiun të italianëve. Kështu i kishte thënë një burrë i panjohur që pat ardhur para disa muajve. Thomaidha vetëm mua ma kishte treguar këtë gjë. Kështu e kishte porositur edhe ai burri i panjohur. Isha rritur në shtëpinë e saj dhe më dukej çudi që Fani, aq i vogël, të vriste njeri. Nuk e di, po më kapi një dëshirë e madhe që ta shih- ja. Por ai nuk duhej të vinte në fshatin tonë. Kur e pyeta një ditë nënë Thomaidhën se ku mund të ndo- dhej, ajo mblodhi supet. Unë bëra dy palë çorape dhe ia dhashë djalit të Mevlanit t'i çonte në mal. Ndofta një palë i vishte dhe i biri i Thomaidhës.

Në këmbë m'u mblodhën pulat. I trëmba dhe ato,

duke kakarisur tërë zhurmë, fluturuan mbi plevicë. Më-halla jonë është në mes të malit, me shtëpitë njëra ngjitur me tjetrën. Kur babai më la të ngjitesha për herë të parë majë malit, çatitë me ploça m'u dukën si shkallë të gurta bojë hiri. Në gjoks m'u bë një gjë e ëm-bël për fshatin ku kisha lindur dhe do të martohesha.

Zhurmat kur kthehen bagëtitë nga kullota dhe mbushin rrugët e oborret me blegërimat e tyre, u fashitën. Mua m'u duk sikur një dorë e madhe i bëri shuk dhe i hodhi përtej nga Përroi i Mushkës. Më zunë të dridhura, se isha veshur hollë. Në fshatin tonë, po ra mbrëmja, duhet të veshës triko leshi. E, kur gjithçka po humbiste në mugëtitë, m'u duk sikur isha diku larg, vetëm. Ndofta kjo ndjenjë më ka lindur që atëherë kur gratë përcillnin burrat në mërgim e zinin qanin pa zë. Fshati im është i varfër. Nuk i bën katër muaj misër çdo shtëpi. Nga kjo gjë dhe shumë burra nuk i kanë varret këtu, po diku larg, sa nuk e merr dot as me mend.

Një ditë dëgjova Thomaidhën që mallkonte dhe më kapi një ngashërim që nuk e mbajë dot përbrenda. Shkova në dhomën lart dhe qava. Pas pak aty u ngjit nëna me gjyshen. Më erdhi turp që më gjetën duke qarë.

— Do burrë, — tha gjyshja pa turp, me atë zërin e thatë, si kërcitja e lëpushkave të misrit. — Lëre të gajë, se i hiqet dhembka.

Mua sikur më ra tavani në kokë. Po mbushej gati një vit e gjysmë që në fshatin tonë nuk ishin bërë dasma. Edhe ne, vajzat, sikur i harruam. Isha në atë moshë kur fejesën e mendon edhe me një farë ngazëllimi, edhe me një farë frike. Nëna më përkëdhelte dhe mua më vinte mirë të rrija ashtu, me kokën ngjeshur në jastëk.

Pas një jave më fejuan me të vërtetë me një djallë nga fshati fqinj, po që punonte në qytet. Ai erdhi dhe u shtrua këmbëkryq me babanë pa pikë druajtje. Nga kjo arsye më ngjau sikur e njihja prej kohësh. Gjyshes nuk i pëlqeu fare. Ajo tha se po prishej dy-

njaja. Unë, sa i qerasa krushqit, u mbylla lart në dhomë. Ata hëngrën dhe drekë e ikën kur po perëndonte dielli. Ai ecte mes krushqve, kështu që nuk e pashë mirë. Flokët i kishte të verdhë, si kashtë. Tani ai njeri nuk ishte më i huaj për mua. Më shfaqej në ëndërr dhe zgjohesha e trëmbur, qull në djersë. Kur kishte hënë, shikoja fshatin që flinte e më sëmbonte zemra që do ta lija. Kjo më habiste dhe nuk mësohesha dot. Kur erdhi një muaj pasi ishim fejuar, diç do nte të më thoshte, po ku na u nda gjyshja! Dhe ne më shumë heshtëm, se folëm. Edhe kur u largua, ai sesi më vështroi. Më la në merak. Ç'kishte ndër mend të bente? Mos do të merrte edhe ai rrugët? E humba fare toruan. Edhe nëna s'më ndahej. Ajo e kuptoi se diçka më brente dhe nuk më shqitej derisa t'i tregoja. Po ç'ti thosha unë, e shkreta! Më mbetën sytë nga rruga. Rrezet e diellit shuheshin mbi rrugë, si gjuhëza qiriri në një dhomë të madhe, të zhveshur. Por ai nuk po vinte.

Një ditë ia behu papritur me një shokun e tij. Mua as ma vari fare. Kishte hallin e shokut të tij, që ishte plagosur në dorë. Gjyshja u bë tjetër njeri. Ajo ia mjekoi dorën shokut me një shkathtësi që nuk e kisha parë prej kohësh. Vetëm se nuk më linte edhe mua të rrija pranë tyre. Sa i çoja ujë të valuar, më zbonde. Ai qeshte bashkë me shokun. Kur po kalonte mesi i natës, u bë gati të ikte.

— Pse nuk fle këtu sonte?, — i tha babai.

— Duhet të jem patjetër që në sabah në punë, — u përgjigj.

— Mos e mbani, — tha dhe shoku i tij.

Ai më kërkoi me sy. Babai e kapi këtë gjë dhe më tha ta përcillja.

— Po sikur të vij e të të them hajde me mua në mal, do të vish me mua?

Ula kokën. Ai më rrahu lehtë shpatullat.

— Përse nuk flet?

— Po pa bërë dasmë do të më marrësh?

— E bëjmë atje ku do të shkojmë, — qeshi ai.

— Liljana, — më thirri nëna.

— Shko, pa kur të vij herën tjetër, e bisedojmë shtruar.

Kur hyra në dhomë, fjala e parë që më kapi veshi ishte një fjalë e panjohur. Ilegal! Dhori, i fejuari im, ishte ilegal. Nuk e di përse, kuptimin e kësaj fjale e lidha me kuptimin e fjalës «kaçak», që ma kishte thënë shpesh gjyshja.

Shoku i Dhorit iku që pa gdhirë. Ai më shtrëngoi fort dorën, sikur të më kishte motër. E përçolla me sy derisa humbi, përtej, nga Përroi i Mushkës. Dorën e kishte të lidhur dhe gjyshja i dha me vete një shishe me lëng lule basani që të ndërronte plagën. Unë prisja të vinte Dhori. Tani që mora vesh se ishte ilegal, sesë më dukej, si tjetër njeri.

Edhe ajo ditë mbaroi si përherë. Në arrën e madhe të Kënos krakaritën serrat dhe laraskat. Drita po fikej ngadalë. Dyert po mbylleshin. Asgjë nuk pipëtin-te. Rruga nga mund të vinte Dhori nuk shihej më. «Nuk erdhi edhe sot! Korba, sa e rëndë qënka ndarja!», — thashë me vete dhe hyra brenda.

Babai kishte vënë përpara sofrën dhe pinte raki kumbulle. Ishte i lodhur. Vetëm gjyshja nuk donte t'ia dinte. Ajo sikur jetonte më vete. Ia kisha frikën mos këpuste ndonjë fjalë, prandaj para saj sillesha sikur nuk isha në merak.

— Po të mblidhet lëmshi, çupë e babait. Dhori më dërgoi haber se do të të marrë. Mjaft u sfilite në këtë shtëpi.

— E ku gjen rehat gruaja, or Loni!, — u ankua gjyshja.

Kishte parë shumë në jetë dhe asgjë nuk i bënte përshtypje gjyshes. Kisha vënë re se ajo i priste me gjakftohtësi vdekjen e moshatarëve të saj.

— Mirë do të bëjë ta marrë një orë e më parë, se edhe kjo po thahet nga dita në ditë.

Në një këngë për kaçakët kisha dëgjuar se ata kanë për nuse pushkën, se edhe plumbat u shponin gjoksin, si pajë e luftës. Po unë do t'ia shëroja se s'bën pla-

gët. Tani nuk ndahesha dot nga ai. Doja vetëm që ai të ishte djalë i mirë dhe të më donte si e doja.

— Përse nuk ha?, — më tha nëna.

— Nuk më hahet.

— Ha me zor.

— Më mirë po ngjitem të fle.

Babai nuk foli. Gjyshja tundi kokën, duke përtypur me zor një kore të njomur me ujë.

— Baba, — i thashë me turp, — a martohen ilegalët?

Babai qeshi dhe tundi kokën.

— Ç'janë këta, o Loni?, — pyeti gjyshja.

— Partizanë, nënë. Luftojnë dushmanin.

— Epo, është burrë ai, nuk i ka lezet dysheku. Se mos ia prish mëndjen, moj ditëzezë!

— Jo, — i thashë.

— Po mos të të hahet, shko e shtrihu.

U ngjita në dhomën time. Ishte herët për gjumë. Nga dritarja shikoja yjet e rralla. «Po sikur të vijë nesër?!», — thashë me vete dhe, nuk e di përse, u futa me nxitim në krevat dhe mbulova kokën me velenxë, si atëherë kur isha fëmijë dhe më shqetësonin hijet e degëve të pemëve.

2.

Ai nuk erdhi të nesërmen. Një natë në fshat kaluan partizanët. Dola me Thomaidhën. Ajo pyeti për të birin, por ata nuk e njihnin. Ata nuk ndenjën fare. Iknin për në luftë. Thomaidha më mori me zor në shtëpinë e saj të pinim bashkë një kafe elbi. Më pyeti për Dhorin. I thashë se kishte dërguar haber se do të më merrte së shpejti. Nuk kisha bërë hazër asgjë. Thomaidha më tha se kështu ishin martuar të gjitha.

Kur u ktheva, nëna më ndali në prag të derës dhe më pëshpëriti:

— Ka ardhur Dhorin me dy shokë.

Unë u drodha e tëra.

— Ku është?

— Po bisedon me babanë.

— Mos ka ardhur?...

Kërciti dera dhe në prag doli babai.

— Hyni të dyja, — tha ai.

Gjyshja ishte e nxehur. Fliste vazhdimisht me veten e saj. Nëna u përpoq ta qetësonte. Mua më vinte rëndë nga shokët e Dhorit.

— Epo, kështu është kur plakesh!... Si puna e atyre cironkave që, kur i than në diell, i pështyjnë edhe mizat. Dëgjo, o dhëndër, më ka mbetur edhe një kokërr lajthi mënd. Posi...

Dhe gjyshja nuk shikonte njeri me sy dhe nuk kuptohej me kë fliste e me kë ishte nxehur.

— Agathi, — i tha babai nënës, — Dhori me këta partizanët ka ardhur të marrë Liljanën. Po mirë, le ta marrë, se e tija është, po do që edhe ajo të dalë malit.

Nëna nuk dinte ç'të thoshte. M'i nguli sytë dhe nuk m'i shqiste. Mua m'u dhimbs dhe isha gati t'i thosha Dhorit të largohej së bashku me të dy shokët. Po nëna e mblodhi veten shpejt.

— Po si kështu, mor Dhori! Mezi e kam rritur dhe kjo e zezë nuk ka parë me sy një ditë të bardhë. Të paktën, sa të vishej një herë nuse.

— Edhe dasmën do ta bëjmë më vonë, mama.

Kur i tha «mama», m'u zhduk tërë inati që më ka-pi kur pashë nënën të turbulluar. Edhe asaj i bënë për-shtypje fjalët e tij.

— Në mal do ta kem si shok, ja, si kam Xhemalin,
— dhe tregoi me kokë partizanin që rrinte pranë.

— Mysliman qënke, zotrote?, — pyeti gjyshja.

— Po, — qeshi Xhemali.

— Ç'pret atëherë nga një dhëndër që i ka shokët
myslimanë! S'thonë kot që fikun e mirë e ha breshka.

— Edhe mua nëna më ka pjellë, moj gjyshe, — u gajas së qeshuri Xhemali.

Po gjyshja e kishte tërë inatin me Dhorin.

— Zotrote, s'berkërke dot pa femër në mal, si gjithë shokët?

— Mjaft tani, — tha babai i mërzitur.

— Pusho!, — tha gjyshja. — Nuk kam vdekur akoma. Le të bëjmë një darkë, sa për adet, dhe le të ikin ku të duan. Edhe kaçakë...

— Po ti, moj çupë e babait, si mendon, se, në fund të fundit, ti martohesh?

— Sikterise, se nuk u shojt dynjaja për burrë, — tha gjyshja duke më ngulur sytë.

Po fjalët e saj nuk bënë njeri të qeshte. Të gjithë më vështronin mua. Nga fshati ynë kishin dalë malit edhe nja dy shoqe të miat. Djali i Mevlanit më kishte folur gjatë. Çorapet e mia kushedi kush i mbante tani veshur. Megjithatë vështrova babanë dhe thashë:

— Si të duash ti, baba.

— Jo, xhani i babait, jo. Nuk dua pengje tani që të rrita. Kaq të them: fati i burrit tënd është edhe yti këtej e tutje.

Sesi m'u mblodh një lëmsh në gjoks. Nuk durova dot dhe iu hodha në qafë. E ndjeva që m'u mbushën sytë me lot. Ashtu mbështetur në supin e babait, e përfytyrova veten të veshur me të bardha. Njerëzit gëzoheshin rreth meje dhe pëshpërisnin me zë të lartë që t'i dëgjoja dhe unë: «Sa e bukur ka dalë kallogrejja!». Fëmijët më ngatërroheshin nëpër këmbë, kurse pak më tutje më prisnin dasmorët. Ja, kali im është ai që e mban kokën lart dhe që i kanë hedhur një velenxë të kuqe. Edhe atij mezi i durohet sa të nisemi. Babai më përkëdhelte dhe seç më pëshpëriste në vesh. Nëna qante pa zë. Kur u shkëputa nga babai, edhe të dy partizanët ishin të prekur. Me siguri që u kujtova motrat. Babai i tha nënës:

— Shko bëje gati. Hajde ta kthejmë edhe nga një gotë, — iu drejtua pastaj të dy shokëve të Dhorit.

Unë nuk u habita që babai pranoi menjëherë. Tani po e kuptoja përse ndodhte që ai largohej shpesh natën për javë të tëra. Nëna nuk më tregonte ku shkonte babai. Dhe unë nuk e pyesja. Vetëm një natë, kur

shtëpia mbante erë ilaçe, u habita, mbasi nuk kishim ndonjë të sëmurë. Nëna më tha atëherë se babai do të çonte te shpella e Gollamicës dy partizanë të plagosur.

Tek po ngjisja shkallët, unë dëgjova tringëllimën e gotave. Ishte dollia e dasmës sime të varfër dhe pa zhurmë. U veshja trashë, se po fillonte dimri. Isha si në ëndërr. Se pse nxitoja që t'i mbaroja punët shpejt e shpejt. Dhori nuk ishte më i fejuari im, po im shoq. Me të do të luftoja.

Jashtë gjethet e mollëve kishin nisur, të thara nga bryma, të binin me shumicë. Lajthitë kishin bërë plot. Do të kishim dimër të ashpër. Ngricat e para të tetorit, që çatisën papritur, tregonin se edhe dëborra nuk do të vonohej. Thomaidha mbylli kotecin e pulave, duke folur me zë të lartë me vete. E kisha dëgjuar gati përnatë, por sonte më dukej krejt ndryshe. Dhe thashë me vete se a do të mësohesha pa zërin e saj? Gjyshja e humbi toruan dhe nuk e hapi më gojën. E' putha në ballë. S'më ikej pa marrë bekimin e saj. I fërkova duart.

— Gjyshe, po iki unë.

— Shko, kurban gjyshja, shko dhe të priftë e mbara! Dëgjo, kaçak, ta duash më tepër se veten.

— Mos ki fare merak, gjyshe, — tha Dhori.

Gjyshja e kapi edhe atë për qafe dhe e puthi në ballë.

Na përcollën deri në të dalë të fshatit. Ecnim pa folur. Gurët kërcisnin nën këmbët tona. U ndava nga prindërit dhe shokët e Dhorit më vunë në mes. Doja të mos e ktheja kokën pas, por nuk munda. Ndalova. Nuk i pashë më. Ishte natë.

— Eja, — tha Dhori, — nuk bën kështu. Tani je partizane.

U nisëm. Si ecëm ndonja një çerek ore, dolëm në një majë, nga dukej fshati. Ndalova prapë, po dritat e zbehta të kandilëve nuk shquheshin që andej.

Fshatin e parë e hasëm pas një ore. Isha e lodhur shumë nga ndarja sesa nga rruga. Dy shokët e Dhorit bënë çmos të ma lehtësonin brengën. Nata ishte pa hënë dhe ata nuk ma shihnin fytyrën. Dhori hiqte rrugën dhe më shumë fola me Xhemalin, sesa me të. Ajo ishte nata jonë e parë. Vetëm kur kapërcyem një përrua, më dha dorën. Nga larg u dëgjuan të lehurat e qenve. Fshati ishte i vogël dhe i mbledhur si grusht. Dy-tri shtëpi kishin dritë.

— Ajo e madhja, — tha Dhori duke treguar me sy shtëpinë që kishte dritë, — është e Kozma Papallazos. Më shpëtoi, pushti, në qytet.

— Kush është ky, o Dhori?, — e pyeta më shumë nga dëshira për të shqiptuar me zë të lartë emrin e tij.

— Mos e ngacmo dhe ti tani, — qeshi Xhemali.

— Që ta marrësh vesh ti, moj Liljanë, Kozmai ta turpëroi tët shoq. Qarkori ngarkoi Dhorin që të vriste Kozmanë, por ai e nuhati dhe desh të lanë pa burrë.

— Tallu, Xhemal, tallu, — tha Dhori qejfprishur.

— Nuk po tallem.

— Megjithatë, unë nuk do ta lë me kaq.

— Ç'ka bërë ky Kozmai?, — pyeta prapë.

— Na ka futur shokët në burg dhe ka vrarë, — tha partizani tjetër që nuk ia kisha mësuar akoma emrin.

— Sonte nuk është çudi të jetë këtu, — tha Xhemali.

— Ashtu qoftë, — tha Dhori.

— Do të shkojmë njëherë nga shtëpia e Dhosit, — tha partizani tjetër. — E kam mik dhe është me Lëvizjen.

Shtëpia e Dhosit ishte në mes të fshatit, pranë çezmave. I bëmë zë. Doli një djalë i vogël, i cili dëboi qentë.

— Kush është?

— Jam Gaqoja. Dhosi në shtëpi është?

— Po.

Hymë brënda. Dhosi ishte një burrë rreth të dyze-

tave. Na përqafoi të gjithë me radhë. U ula si mbi gjëmba dhe nuk dija ç'muhabet të hapja me vajzat e Dhosit.

— Partizane je?, — më pyeti vajza e madhe.

Mbeta një çast e hutuar dhe, kur pashë Gaqon që qeshi, thashë:

— Partizane.

— Po pushkën ku e ke?

— S'ka akoma, po do t'ia gjejmë së shpejti, — tha Xhemali.

E shoqja e Dhosit u nxori burrave piperka të mbushura me gjizë dhe një shishe raki.

— Uroji këta të dy, o Dhosi, se sonte na u martuan, — tha Gaqoja.

— Ashtu? Epo, të trashëgoheni!

Vajzat e Dhosit më puthën në faqe. Edhe e shoqja më puthi. Isha aq e prekur, sa nuk dija si t'i falënderoja. Në atë shtëpi ndjeva sikur dasma ime vazhdonte akoma. Dhe, megjithëse nuk isha martuar ashtu siç e kisha menduar, ajo po më dukej me të vërtetë e bukur. Ata dollinë e parë e ngritën për dasmën time. Vajza e vogël e Dhosit më përkëdheli flokët dhe më tha se i kisha të butë, si kadife. Kështu i kam thënë dhe unë një nuseje në fshatin tonë. Sepse ne vajzave na pëlqen të përkëdhelim flokët e nuseve të reja. Atëherë, kur të gjithë po gëzonin dasmën tonë, u dëgjua një krimë.

— Kush të jetë?, — pyeti Gaqoja.

— Kozma Papallazoja, — tha ftohtë Dhosi.

Dhori kërceu menjëherë nga shiltja dhe rrëmbeu pushkën.

— Këtë herë nuk më shpëton dot, — tha.

— Ç'ke ndër mend të bësh?, — e pyeti Xhemali.

— Atë që nuk bëra katër muaj më parë.

— Po vijnë dhe ne, — tha Gaqoja.

E shoqja e Dhosit hyri me një tenxhere që lëshonte avull. Kishte zier fasule të reja.

— Kozmai vaftë shëndoshë. Korr të misërta, po ha

të grunjta. Ka që në orën pesë që ia ka shtruar dhe bën ç'bën dhe e shkreh nganjëherë.

Dhorit, dora që kishte pushkën, iu zbardh nga shtrëngimi. U çova dhe unë me ta në këmbë. Të tre më panë me mëdyshje.

— Le të vijë, — tha Dhori.

U nisëm të katër dhe për dy minuta u gjendëm te shtëpia e Kozma Papallazos.

— Ju fshihuni këtu, kurse unë po shkoj ta nxjerr jashtë, — tha Dhori.

Ai eci drejt portës së madhe. Unë me Xhemalin dhe Gaqon u fshehëm pas një muri të rrëzuar. Xhemali bëri gati pushkën. Edhe Gaqoja. Unë shikoja Dhorin që ecte drejt derës dhe zemra më rrihte me forcë. Pritëm.

Konaku i shtëpisë së Kozmait kishte dritë. Në oborr lëvizte një hije. Përsëri m'u kujtua dasma ime. Edhe në oborrin e shtëpisë sime sonte do të kishte njerëz. Dhori vuri dorën mbi gardhin e kopshtit dhe i thirri njeriut që lëvizte nëpër oborr. Ai u afrua ngadalë dhe kuptohej se nuk shihte mirë nga sytë. Tërë qenia e tij tregonte një njeri të shtypur e të munduar gjithë jetën.

— Bujrum, — tha burri.

— Kështu e kemi punën, prandaj bëji pak zë Kozmait.

— Po ti hyr, or burrë, se në gëzim dhe në hidhërim nuk merret lejë.

— S'kemi kohë.

— E si t'i them?

— Ka ardhur trimi i Xhemilit, kaq i thuaj.

— Si të duash.

Dhe burri eci duke e gjetur rrugën me tahmin. Pas pak u hap dera e madhe. I pari u duk burri me të cilin foli Dhori pak më parë. Ecte duke hequr këmbët zvarrë e duke tundur llambën me vajguri. Pas tij vinte një njeri tjetër. Ai duhej të ishte Kozma Papallazoja.

— Kush më kërkoi?, — tha ai.

— Afrohu, afrohu, — tha Dhori me një zë që nuk e njoha fare.

— S'e paska zënë gjumi për mua sonte Xhemil aganë?, — tha Kozma.

Që aty, rrëzë murit ku kishim zënë vend, vura re se ai ishte i hequr, me ca sy si të nuselalës.

— Nuk po më njeh?, — tha Dhori.

— Afroje pak llambën, or Taço.

— S'ka nevojë, të bëj dritë unë!

Atë çast dëgjova pushkën e Dhorit. Plumbi e mori Kozma Papallazon në gjoks. Ai qëndroi më këmbë të hapura dhe u bë gati të nxirrte revolen nga brezi. Dhori shtiu përsëri. Nuk e hiqte gishtin nga këmbëza e pushkës. Dukej që vlonte nga urrejtja. Ai ishte burri im. Gajoja më hodhi dorën në sup.

— Shkojmë, — tha ai.

Dhori qëndroi dhe pak, si të sigurohej që Kozma Papallazoja kishte mbaruar me të vërtetë, dhe u nis pas nesh. Kur kaluam qoshen, dëgjova kujen e një gruaje që mallkonte me zë të lartë. Pastaj krisën pushkë. Fshati u zgjua. Ne hymë në një korije me dushk. Mbajtëm vesh mos na ndiqte kush, por degët nuk lëviznin fare. Unë u mbështeta në krah të Dhorit.

— Duhet të mësohesh, Liljana, — më tha. — Luftë!

Nuk fola. Nën hapat tanë dëgjoja se si kërcisnin gjethet e thata dhe se si pikonte lagështia e korijes nga degët e vjeshtës. U shtrëngova fort pas krahut të Dhorit. Gajoja me Xhemalin ecnin para nesh dhe unë nuk i dëgjoja se ç'flisnin. Nata ishte e ftohtë, por në qiell yjet shtoheshin sikur dikush shkoqte e shkoqte pa pushim misra të verdhë, plot bukë.

DITËN E TRETË TË LUFTIMIT

Mujo Halili u plagos në kokë ditën e tretë të luftimit. Nuk i vuri rëndësi plagës, por e lidhi shpejt e shpejt me mëngën e këmishës. Në pjesën lindore të atij qyteti të vogël, në veri, pushtuesit gjermanë dhe reaksionarët rezistonin me një kokëfortësi të pashpresë. Frëngjitë e shtëpive të rënda, si kulla, ngjanin me disa sy të mavijosur nga lodhja e pagjumësia. Dhe villnin zjarr nga errësira e tyre, si qëniet e legjendave. Aty nga dreka skuadra e Mujos mori urdhër të sulmonte rrugën kryesore. Luftuan për dy orë në çdo portë e dhomë e, më në fund, edhe mbi atë rrugë ra qetësia e parë, pas tri ditësh e netësh luftë. Atëherë Mujo Halili ndjeu dhimbjen e kokës dhe iu errën sytë. Shkoi duke iu marrë këmbët deri te një pus, lëshoi kovën e shpuar nga plumbat dhe piu e piu si i babëzitur. Digjej i tëri dhe uji sikur ia shtonte akoma më tepër etjen. Veshët i buçisnin dhe nuk ambientehej dot me qetësinë e papritur. Gjaku i piksur dhe i përzier me pluhurin e rrugës dhe me tymin e barutit të djegur, dukej si plis i tharë e i plasaritur nga vapa. U hodhi ujë syve, por koka nuk po i lehtësohej. Ishin ditët e para të nëntorit dhe Mujos i dukej sikur mbante mbi kokë diellin, që, për çudi, kishte akoma nxehtësi.

Në këmbët e tij u afrua një pulë e trembur. Ajo, si pa rreth e rrotull, futi sqepin në një gropë me ujë

dhe piu. Pastaj, si ngriti sytë indiferentë mbi Mujon, u largua rëndë-rëndë, duke çukitur barin e rrallë që kishte mbirë në të çarat e ploçave. Një dhimbje e mprehtë i përshkoi trupin Mujos. U çua me zor dhe, duke u mbajtur pas murit, doli në rrugë. Shikonte turbull, sikur sytë t'i kishin zënë perde. Aty pranë kërciti hekuri i një porte dhe Mujoja ndjeu dorën e dikujt. Pastaj erdhi dhe një i dytë. Rrobat u mbanin erë barut e pluhur. E kuptoi se ishin partizanë. Njëri prej tyre e thirri me emër, por Mujoja nuk e njohu dot nga zëri. Ndaloi dhe tha:

— Turp, nder, por nuk të njoh.

— Jam Sadiku!, — tha partizani.

— Sadik Çobani?

— Po. Ti si ndihesh?

— Më janë errur sytë dhe nuk shoh dot.

— E ke nga plaga. Sa të ta pastrojë mjeku, dhe do të bëhesh qiqër.

Mujoja nuk foli më. E çuan në spitalin civil të qytetit. Mjeku i zgjidhi plagën dhe ia pastroi. Mujoja u lehtësua menjëherë dhe u bë gati të ikte.

— Mos lëvizni, ju lutem!, — i tha mjeku.

Ai kishte një zë të butë e të hollë, gati si zë femre. «Një zë të tillë mund të ketë vetëm një njeri që i trembet luftës dhe do të rrijë larg saj», — mendoi Mujoja. Dhe ai i urrente njerëzit që donin të rrinin larg luftës.

— Ju lutem, mos lëvizni, — tha mjeku me një zë akoma edhe më të mekur, mbasi e hutoi vështrimi i ashpër i Mujos.

«Ai e ka vështirë të sillet me mua si me një pacient tjetër, — mendoi përsëri Mujoja. — Sepse unë jam një pacient që-i sjell pranë luftën dhe ai do të rrijë larg saj».

— E si të rri, si mumje?, — tha Mujoja me inat.

— Jo, po... Mund t'ju infektohet plaga.

Mujoja ishte nga partizanët e parë, që kishin sjellë në spitalin civil të qytetit të vogël. Mjekut i kishte mbetur në buzë, si një gëzhojë e plasur, buzëqeshja

e trëmbur. Mujoja u bind. Kur ia lidhën plagën, kërkoi pushkën.

— Ju duhet të rrini shtrirë, të paktën tri ditë, — tha mjeku me një zë më të sigurtë. Tek ai tani fliste guximi i profesionit, por Mujoja ia bëri me dorë, se nuk ia kishte ngenë të bindej.

— Kështu ka urdhëruar komandanti. Të gjithë të plagosurit të shtrohen në spital, — tha Sadiku.

— Por nuk ka thënë edhe për gërvishtjet e lehta.

— E keni gabim, — ndërhyri mjeku. — Ju keni pasur fat që nuk ju është prekur sistemi nervor. Prapëseprapë plaga ka nevojë për kurim. Dhomën e keni gati. Shkojmë.

Mujoja qëndroi në mëdyshje.

— Mos u bëj çilimi, — tha Sadiku dhe doli pas mjekut.

Korridorin ishte i ngushtë. Dritaret shikonin nga përrëndimi. Dita po thyhej ngadalë, sikur i vinte keq që po ikte. Vargmalet dukeshin të hirta, të largëta e të lehta. Mbi majat e tyre rriteshin retë si kërpudha gjigande. Mbi ato maja gjithmonë kishte re. Mujoja kështu i mbante mend. Poshtë, nën një arrë të madhe me degë si flokë të shpupurisura nga era, kishin hapur një varr të ri. Mujoja zgjati kokën nga dritarja. Mbi dheun e freskët dikush kishte shkruar me gëzhajat e pushkës: «Partizani Kreshnik Korabi». Dielli reflektohej mbi bakrin e ndritshëm të gëzhjave sikur donte të copëtohej në mijëra diej të tjerë të vegjël. Mujoja kapërceu përshtymën.

— Pse nuk e shërove Kreshnikun, doktor?, — tha tërë inat. Mjeku u drodh dhe nuk dante si t'i përgjigjej. Kur e pa ashtu të trëmbur, Mujos iu shtua neveria.

— Cila është dhoma ime?

— Kjo përballë, — tha mjeku.

— Mirë, do të shtrihem, pasi të shikoj shokët. Ai çeli derën fqinjë. Në shtrat rrinin shtrirë dy partizanë. Njëri ishte plagosur në këmbë, kurse i dyti në kraharor. Përshëndetën Mujon.

— Për sa shërohen?

— Varet nga...

— S'ka varet në luftë! Për një javë t'i shërosh.

Mjeku s'foli. Sadiku vuri buzën në gaz. Në dhomën ngjitur mjeku nuk i la të hynin.

— Është rëndë dhe duhet të flejë?

— Si quhet?

— Dale, se nuk e kam regjistruar. Shko merre të lutem, — i tha infermieres. — Deri më sot nuk më ka zënë syri burrë më të fortë se ky!

— Ç'ky, mor!, — tha Mujoja tërë inat. — Ai ka emër! Zotëria jote futeshe vrimave, kur ai luftonte, dhe ti nuk i mbajtkë mend as emrin! A, po e di unë se ç'doni ju, por nuk e kam në dorë.

Infermierja erdhi me një frymë. Mjeku shfletoi regjistrin me duart që i dridheshin dhe tha:

— Pacienti e ka emrin Latif Dibra.

— Latifi?! Dëgjo, doktor! Latifin o ta shërosh, o gjej vrimë ku të futesh! Mbaji vëth në vesh dhe mos i harro!, — tha Mujoja dhe eci përpara. Hapi me forcë derën e fundit dhe mbeti në vend, si i ngrirë. U nxi në fytyrë dhe tundi kokën, si një kalë që nuk e duron dot zgjedhën. Përballë, në krevatin e vetëm të dhomës, ngjitur pas murit, ishte shtrirë një i plagosur, me këmishën tërë gjak. Edhe i plagosuri mbeti i habitur dhe nuk dinte ku t'i fuste duart. Por pastaj, sikur t'i vinte rëndë që e gjetën shtrirë, hovi përpjetë duke ngërdheshur fytyrën nga dhimbja. Sadiku u bë gati ta ndihmonte, por Mujoja e kapoi për krahu dhe nuk e la t'i afrohej të plagosurit.

— Vetë u rrëzua dhe, po t'i ketë mbetur ndonjë fije burrërie, le të ngrihet vetë.

Këto fjalë duket që e prekën të plagosurin atje ku duhej, dhe ai, me një kokëfortësi karakteristike prej malësori, shtrëngoi nofullat, aq sa u dëgjua kërcitja e dhëmbëve. U mbështet pas murit dhe u çua në gjunjë. Mbi këmishë i doli një njollë e re gjaku. Qëndroi për një çast, ashtu i zbehtë, duke marrë frymë me vështirësi dhe, me një vrull të dëshpëruar, hovi përpjetë

në këmbë. Mujoja e kishte ndjekur tërë këtë skenë me një gjakftohtësi të çuditshme për ata që e njihnin.

— Omer Halili i lau gjynahet, vëlla, — tha i plagosuri dhe uli kokën, sikur ia preu njeri me sëpatë.

Mujoja ndjeu dorën e Sadikut që u drodh dhe bëri një hap përpara. Dërrasat e vjetra të dyshemesë kërcitën tërë rënkim. Në dhomë po fikej drita e asaj dite, që dukej aq e qetë, aq e pafajshme. Mbi degët e arrës së madhe qëndroi një skifter, të cilin për tri ditë rresht e kishin zbuar nga foleja krismat e armëve. Ai mbërtheu thonjtë mbi një degë të hollë dhe përgjonte tërë frikë çatitë e shtëpive dhe dritaret e spitalit. I plagosuri çoi kokën dhe vështroi jashtë.

— Pse nuk më vështroi në sy, Omer Halili? Dikur, kur bëja faj, unë t'i mbërtheja sytë, ashtu siç na mësonte babai.

I plagosuri ktheu kokën nga Mujoja dhe tërë trupi iu drodh, sikur t'ia kishte zënë korenti. Sytë iu çakërritën. S'duroi dot dhe ra mbi krevat. Sustat klithën çjerrë. Infermierja mori një kanë me ujë dhe ia hodhi në fytyrë.

— Bëji një gjilpërë për t'i forcuar zemrën, — tha mjeku.

I plagosuri erdhi në vete pas pak. Sytë i ishin shuar, pa jetë. Mujoja u trondit. Sa shumë i ngjau në atë çast i vëllai me të atin. Dhe iu kujtua ajo ditë që i lidhi më shumë. Ishte palca e dimrit dhe babai që nisi për në prefekturë për pak misër. Ata e pritën në shtëpi tërë ditën, derisa u err dhe rreth kullës u dëgjua ulërима e ujqve të uritur. Atë dimër ujqit u dobësuan, aq sa iu ngjit lëkura pas trupit, si t'i kishte zënë zgjebja. Mujoja me Omerin nuk vunë gjumë në sy. I hidhnin kërcunj zjarrit dhe shikonin përjashta, mos dëgjohej zilja e mushkës. Por jashtë dëgjohej zhurma e dëborës, që binte e binte pa pushim, e ngrirë, e ftohtë, e padukshme. Në mëngjes i pari u çua Mujoja. Ai hapi portën e rëndë prej ahu dhe zbardhëllimi i dëborës i vrau sytë e mësuar me errësirën e kullës. Kur iu mësuan sytë, dalloj përtej gardhit diçka të zezë. Njohu mu-

shkën e tyre dhe vrapoi drejt saj me zemër të ngrirë. Rreth mushkës dëborë skuqte. Në sytë e saj të qelqtë pasqyroheshin retë e bardha që iknin drejt perëndimit. Në bark i nxinin plagët që kishte marrë. La mushkën dhe zuri të kërkonte të atin, i bindur se duhej të ishte diku aty pranë. E gjeti të mbështetur pas trungut të trashë të lisit. Dukej sikur ishte ulur aty për të pirë një cigare, siç bënte zakonisht, kur kthehej nga pazari. Mujoja i mori kokën në duar dhe gati sa nuk ia dha të qarit. Mbi dëborë ishin përhapur kokrrat e misrit si yje të këputura.

— S'erdha deri këtu të shikoj lotë!, — tha i ati me një zë të mekur. Në fytyrë nuk i kishte mbetur pikë gjaku. Mujoja ia lau sytë me dëborë, e cila zuri të avullonte menjëherë. Zemra i rrihte dobët, tamam si ajo gjuha e zbehtë e kandilit, kur do të fiket, se i ka mbaruar vaji. — Mjaft, më lër tani dhe më thirr Omerin!, — tha i ati.

— Omeer! Omeer!, — thirrri me sa fuqi që kishte Mujoja.

Omeri doli nga kulla si i çmendur dhe u afrua duke e çarë dëborën me gjoks si ndonjë dem i tërbuar. E kapi të atin për këmbësh e shpatullash dhe u bë gati ta fuste brenda në kullë.

— Mos më lëviz, se nuk dua të më dalë xhani, pa t'i thënë dy fjalë. Kam një plagë në bark, — dhe u mblodh kruspull.

— Kush të qëlloi?, — e pyeti të atin Omeri.

— Isuf Mejdani, te Kroj i Bardhë. Ta kesh kujdes Mujon dhe nënën.

Dha shpirt në dorë të Omerit. Kishte rrojtur për të lënë amanetin. E varrosën që atë ditë. Toka e ngrohë të nën dëborë i mbeti në mendje Mujos për një kohë të gjatë. Dhe u rrit duke pasur si baba të vëllanë, Omerin. Nuk ia ktheu asnjëherë fjalën. Grindja e parë ngjau kur nisi lufta. Mujoja donte të dilte partizan, por nuk e linte Omeri. Omeri i urrente partizanët, vetëm e vetëm se me ta ishin edhe djemtë e Isuf Mejdanit. Dhe të dy vëllezërit u ndanë. Mujoja u hodh me par-

tizanët, kurse Omeri u bashkua me forcat e bajraktarët. Njëherë i dërgoi haber se, po ta kapte të gjallë, do t'ia rripte lëkurën si të shelegut. Mujoja ia ktheu përgjigjen se një plumb e mbante përherë me vete, për të mos rënë i gjallë. Para një viti, në përleshjen e Bridashit, gati sa nuk u kacafytën, por bajraktari dha shenjën për t'u tërhequr dhe Omeri i humbi nga sytë hipur mbi makinat gjermane. Tani ishin përballë njëri-tjetrit, të dy të plagosur.

— Plumbi më fali, gjersa nuk më mori në të majtë, — tha Omeri.

— Ai që shtiu mbi ty, duket që nuk ka nishan, — tha Mujoja dhe shtoi: — Unë nuk do të gaboja!

— Mos harro se kush të ka mësuar, Mujo Halili!

— Për të zezën e tij, më ka mësuar Omer Halili!

— Mos harro se ai është yt vëlla!

— Ka qenë!, — tha prerë Mujoja.

Omer Halili nuk e priste këtë përgjigje nga i vëllai, prandaj nxori një rënkim të mbytur.

— Ai është keq, mos e shqetësoni, — tha infermierja. Edhe ajo deri atëherë mendonte si mjeku, se ishin larg luftës. Infermierja u bë gati ta ndihmonte Omerin, por ai u tërhoq pas murit.

— Je bërë për të qarë hallin, Omer Halili, gjersa po të mëshirojnë edhe gratë, — tha Mujoja. — S'ma merrte mendja se do të katandiseshe deri këtu.

Kur dëgjoi këto fjalë, Omeri përplasi kokën pas hekurit të krevatit dhe hungëroi si një derr i plagosur.

— Jo, — tha dhe u çua në këmbë, — po dua të bisedojmë si burrat! Gjersa më fali plumbi, duhet të më falësh edhe ti.

Mujoja ziente përbrënda.

— Edhe sikur të të fal unë, nuk të fal ai që qëndron mbi mua, gjyqi partizan. — Dhe, si u mendua pak, pyeti: — A ke vrarë partizanë me duart e tua?

Omeri hezitoi në fillim. Ajo pyetje e vriste më shumë se plaga.

— Kjo pyetje nuk bëhet në luftë,

— Ti a ke vrarë?

— Kam luftuar.

— Ç'të bëj që je i plagosur, pa flisnim ndryshe. .

Omeri shqeu këmishën dhe tregoi plagët e hapura në gjoksin leshtor. Pastaj iu prenë këmbët dhe u shkreh në ngashërim. Ishte një ngashërim i rëndë, sikur aty po shëmbej një kullë e lashtë dhe e pamposhtur.

— Të paktën më rri te koka kur të më dalë xhani, — tha me një zë të këputur dhe lutës Omer Halili.

Atyre që ishin në atë dhomë iu duk sikur foli një i huaj që kishte hyrë pa u parë. Të gjithë ia mbërthyen sytë Mujos. Flokët i ishin ngritur përpjetë dhe trupi i lëkundej si një lis, kur e fryn era. Omeri nuk ia ndante sytë dhe i lutej pa zë. Mjeku ishte bërë meit nga fytyra. Lufta kishte hyrë në atë spital të vogël, të qetë deri atëherë, me tërë ashpërsinë e saj. Ai u bë gati t'i lutej Mujos, që të paktën, të mos tregohej aq i rreptë me të vëllanë tani që ai po vdiste, por nuk e hapte dot gojën. Nofullat i ishin mbërthyer tamam si një njeriu që e ka zënë rrufeja. Infermierja nuk dinte ç'të bënte. Sadiku vështronte Omerin me neveri. Ishte ndodhur kushedi sa herë pranë rasteve të tilla. Në duart e tij kishin dhënë jetën disa shokë. Dhe kishin mbyllur sytë të qetë, sikur po binin të flinin.

Omeri mblodhi forcat e fundit që i kishin mbetur dhe u lut për herë të fundit:

— Eja!

Atëherë Mujo Halili gati sa nuk iu hodh përsipër:

— Omer Halili, linde si njeri, por po vdes më keq se një qen!

Dhe doli nga dhoma pa e kthyer kokën pas. Në dhomë mbeti mjeku, që çdo gjë i dukej si ëndërr, infermierja që zuri të pëshpëriste diçka të errët, ogurzezë, dhe Omer Halili që përpëlitej e përpëlitej vazhdimisht.

I PAPERKULURI

Skuadra u duk nga kafja e Qazimit, mbasi kaloi vreshtat e sipërme. Gjermanët dhe ballistët ishin të lodhur dhe tërë pluhur. Mbas atij dimri të ashpër dhe të egër maji nuk po lëshonte pikë shiu. Toka, e ngopur me ujin e dëborës së shkrirë, ishte gjallëruar, por fshatarët thoshin se duhej edhe një shi i mbarë. Atyre pak njerëzve që rrinin në kafe, u shkoi menjëherë mendja te shiu, sapo panë gjermanët e ballistët tërë pluhur e të heshtur. Këta kaluan përpara kafes duke përplasur këmbët dhe u drejtuan për në qendër të nënprefekturës. Në mes kishin vënë një partizan të ri, rreth të gjashtëmbëdhjetave. Ai ecte i qetë dhe ata që e panë, e kuptuan se partizani nuk duhej të kishte zbritur ndonjëherë deri këtu. Ishte një djalë flokëverdhë dhe me sy të kaltër. Mes ballistëve, ai ngjante tamam fëmijë. Plagët e fytyrës së partizanit tregonin se armiqtë gjermanë e ballistë e kishin torturuar me egërsi.

— Përsëri po merren me fëmijët, — tha burri që pinte kafe më shumë për veten e tij, sesa për të tjerët.

— Çfarë the, zoti mësues?, — tha Qazimi, i zoti i kafes.

— Asgjë, asgjë, — tha tërë shqetësim mësuesi dhe u çua me të shpejtë. Pagoi dhe u largua nga kafja.

— S'u bë një herë burrë dhe ky mësuesi ynë, — tha një klient tjetër. — I ka hyrë lepuri në bark.

Qazimi, që kishte qejf të filozofonte dhe të hiqej si i gjezdisur, tha:

— Kështu e ka jeta. Megjithatë, në jetë nuk fiton gjithmonë ai që është më i fortë. Kam njohur një njeri në Follorinë, që kishte frikë nga hija e tij dhe përsëri i ecte.

Ai hodhi peshqirin në sup, mori filxhanin e mësuesit dhe u fut në banak.

Vapa po shtrëngonte dhe rrapet e mëdha, të pagjethëzuara mirë, nuk lëshonin dot hije mbi tavolinat. Poshtë kafes rridhte lumi. Ai zbriste nga malet dhe aty e zbuste zhurmën e tij. Lumi i dukej Qazimit si një qenie që ndante dy botë krejt të kundërta, sikur ndante luftën nga paqja. Në njëërën anë ishin zyrat e nënprefekturës, bodrumi i së cilës shërbente si burg, ndërsa në këtë anë ishte kafja, që, siç i dukej atij, habitej me marrëzinë e njerëzve për të vrarë njëri-tjetrin. Për të theksuar këtë marrëzi, Qazimi kishte varur në mur një tablo me pamje idilike, të blerë në Follorinë. Po, për habinë e vetë Qazimit dhe të vajzave të veshura me një tyl të hollë, nga dukej tërë trupi i tyre, lufta zbriste nga malet dhe futej në nënprefekturën përballë, ashtu e gjakosur, tërë pluhur dhe e ashpër. Pastaj ulej në tavolinat shumëngjyrëshe, si mozaikë, për të zhdukur çdo shenjë qetësie dhe për t'i dhënë atij ambienti ngjyrën e luftës. Dhe tablotë me ngjyrat joshëse ishin gjërat më absurde në këtë ambient. Nga malet nuk frynte pikë erë. Gjethi kishte nevojë për erë që të shpërthente.

Tavolinat mbetën bosh. Qazimin e vriste më tepër se çdo gjë trishtimi i tavolinave bosh. I fundit mbeti Asllani. Qazimi e shikonte me bisht të syrit Asllanin, i cili tërë vëmendjen e kishte përqëndruar te nënprefektura. Kur torturonin njeri dhe lumi rridhte i qetë, zhurmat e torturave vinin deri në kafene. Edhe sot u dëgjuan për dy orë rresht thirrjet e Xhaferr Myrtos, komandantit të «Ballit». Ai thërriste si i tërbuar dhe Qazimi dridhej sikur po e torturonin atë vetë. Asllani nuk lëvizte. Dukej qartë se nuk i interesonin të thirrurat e

Xhaferr Myrtos, por diçka tjetër, që ai nuk e dëgjonte dot. Vetëm kur në nënprefekturë ra heshtja, Asllani u çua dhe iku. Qazimit iu duk akoma më i çuditshëm ky Asllani. Seç kishte diçka të thellë ky Asllani, që e trembte të zotin e kafes dhe e bënte t'i nënshtrohej. Asllani u zhdruk përtej vreshtave, andej nga u dukën në mëngjes ballistët.

Si zakonisht, në orën dy kaloi lumin mbi gurët e mëdhenj Xhaferr Myrtoja. Ai ishte i ngrysur dhe sytë i kishte flakë të kuq, sikur tërë gjaku i kishte vajtur aty e vërtitej e vërtitej për të dalë jashtë. Ai u përplas mbi karrige dhe fshiu zverkun me pëllëmbën e dorës leshtore.

— Sillmë të ha!, — tha Xhaferr Myrtoja me sytë të mbërthyer në bodrumet e nënprefekturës. Zëri i dridhej nga një mllaf i brendshëm, që nuk e shuante dot.

Qazimi i solli gjellën dhe u largua menjëherë prej tij, sikur t'i shërbente një të vdekuri. Xhaferr Myrtoja e kuptoi këtë dhe i thirri:

— Eja rri dhe. ti në tavolinë. Nuk më shkon të ha vetëm.

Qazimi iu bind, po pikërisht kjo bindje pa asnjë kundërshtim e nxehi akoma më tepër Xhaferr Myrton. Atij nuk i pëlqente të ishte kaq shpejt pranë dy natyrave të kundërta. Ky ndryshim i krijonte një gjendje të rëndë, që e mundonte. Dhe përsëri vështroi bodrumet e nënprefekturës. Dielli digjte dhe kishte një dritë verbuese. Lumi rridhte poshtë, indiferent, pavarësisht se i kishin atribuar ndarjen e botës.

Xhaferr Myrtoja hëngri shpejt e shpejt dhe iku pa paguar. Qazimi nuk guxoi t'i kërkonte lekët. Ai e kishte pikasur tërbimin e komandantit të «Ballit» dhe u lehtësua kur ai humbi në portën ogurzezë të nënprefekturës. Ajo nxinte si një grykë, ku futeshin e dilnin shpirtrat e këqija. Qazimi ishte supersticioz. Edhe vapa, jo karakteristike për ato vise në atë muaj, kishte diçka të keqe. Aty nga ora katër, i pari që erdhi në kafe ishte Asllani. Ai duhej të kishte bërë rrugë të gjatë, sepse dukej i lodhur e tërë pluhur.

- Ke ngrënë?, — pyeti Qazimi.
- Jo.
- Ç'do të hash?
- Asgjë. Më bëj një kafe pa sheqer.
- Ti sikur e pi me sheqer, — tha me djallëzi Qazimi.

Asllani ia nguli sytë me dyshim Qazimit, i cili u tremb më tepër, sesa kur hasi vështrimin e Xhaferr Myrtos. Rrotulloi peshqirin në dorë dhe u fut në banak. U dëgjua kërcitja e xhezves dhe e filxhanëve. Nga bodrumi i nënprefekturës u dëgjuan të thirrurat e Xhaferr Myrtos. Zëri vinte i ngjirur dhe kishte humbur sigurinë e parë. Qazimi ia mbërtheu sytë Asllanit. Sa herë që dëgjohej fërshëllima e kamxhikut, Asllani shtrëngonte nofullat dhe i dridhej dora që mbante filxhanin e kafes. Qazimi donte të mos i shikonte këto reagime, sepse i ngjante sikur bëhej pjesëmarrës në një komplot të rrezikshëm. Ai asnjëherë nuk i quante gjërat me emrin e tyre të vërtetë. Ky do të ishte një guxim i tepruar. Dhe u qetësua kur deri në banak erdhi e mbretëroi rrjedhja e qetë e indiferente e lumit.

— Sot nuk zure punë me dorë, mor Asllan, — i tha me intimitet Qazimi.

— Epo s'do vdesim në punë, si zotrote, — ia ktheu Asllani pa ia ndarë sytë nënprefekturës.

— Ashtu është, ashtu. Njeri nevojtar unë.

Asllani u përpoq të vinte buzën në gaz, por u ngrys. Nga nënprefektura po dilte duke qeshur Xhaferr Myrtoja. Ai fliste me këmbë e me duar dhe e qeshura e tij e ngjirur dukej si një klithmë e trembur sorrash, kur fillon shiu. Ai po vinte drejt kafes. Kur po kalonte lumën, i rrëshqiti këmba mbi një gur dhe për pak u rrëzua. Qazimit i ngriu zemra. Xhaferr Myrtoja mund të bënte namin. Por jo. Komandanti i «Ballit» ishte më qejf dhe këtë qejf nuk mund t'ia prishte asgjë. Ai u ul në tavolinë së bashku me një civil të paparë ndonjëherë atyre anëve dhe kërkoi raki. Bile ai e qetësoi Qazimin duke i thënë se do t'i paguante dhe drekën.

Nga malet zuri të frynte fresk. Ishte ora më e për-shtatshme për të pirë raki në kafën e Qazimit. Asllani sa vinte dhe ndiente dhimbje. Ai kishte ngrirë me sytë nga bodrumi i nënprefekturës. Fytyra iu zbeh dhe një dobësi po i ndizte gjymtyrët. Tani e kuptoi se ishte lodhur dhe duhej të pushonte. Por nuk mund të shkë-putej nga tavolina. Xhaferr Myrtoja fliste me civilin dhe bënte shaka. Kujtonte jetën në Itali, kur bënte a-kademinë. Edhe civili kishte qënë në Itali. Ata nisën një këngë të trishtuar italiane për një dashuri të brak-tisur. Asllani nuk merrte vesh asnjë fjalë nga ajo kë-ngë e huaj dhe e largët, që deformohej nga zëri i ngjirur i Xhaferr Myrtos dhe zëri i hollë i civilit. Era e freskët e malit u theksua më tepër dhe dielli humbi përtej maleve duke skuqur qiellin. Muzgu ra papritur.

— Çohemi, — dëgjoi Asllani civilin. — Nuk më pëlqen të më zërë errësira këtu.

— Si të duash, por tani është më bukur se kurrë, — tha Xhaferr Myrtoja.

— S'është koha për të shijuar muzgun. Pastaj ti ke punë me atë.

— Po, ta marrë dreqi. Sa e kujtoj, më prishet hu-mori. Ku dreqin vajtën dhe e kapën sot.

— Ti duhet të gëzohesh, Xhaferr. Ai më shumë se-sa sot nuk na është dashur kurrë.

— Ashtu, ashtu, ke të drejtë, por jam aq i shka-tërruar nga nervat, sa doja ta harroja.

Civili qeshi nën buzë.

— Nuk ke se ç'bën, — dhe vazhdoi me një shpreh-je italiane që Asllani nuk e mori vesh.

Xhaferr Myrtoja u tregua shumë i sjellshëm me Qazimin, bile i kërkoi të falur për mospagimin e drekës dhe u largua pas civilit.

Mbi qëndrën e nënprefekturës ra nata. Qazimi ndezi llambat me vajguri. Ajo natë do të ishte e qetë. Sjellja e Xhaferr Myrtos e preku Qazimin. Ai mori dy gota dhe iu afrua Asllanit.

— Hajde ta ngremë njëherë bashkë.

— S'më pihet.

— Mos ma prish sonte, se nuk më shkon mbarë nesër. Hajt gëzuar!, — dhe e çoku gotën e tij me gotën që kishte sjellë për Asllanin.

Asllani nuk e preku me dorë gotën. Ajo mbeti në tavolinë, si një trishtim. Edhe në disa dhoma të nënprefekturës u ndezën llambat me vajguri. Pastaj njëra prej tyre lëvizi dhe u zhduk. U pa në bodrum. Aty u vendos mbi një gozhdë dhe nga dritarja e vogël, si një frëngji, dukeshin si lëviznin disa hije. Ishte si një shfaqje me hije, pa zhurmë. Xhaferrri nuk thërriste si ditën. Asllani e kuptoi se tani po fillonte tortura më e tmerrshme për partizanin e njomë që sollën në mëngjes ballistët. Qazimi pa hijet dhe u çua i trëmbur. Mblodhi karriget dhe iu afrua Asllanit.

— Do ta mbyll, do ta mbyll, prandaj, o burra, se më presin. Bobo, sa u vonova sot! Me siguri gruaja ka luajtur nga mendtë. Çohu, Asllan vëllai, çohu!

Asllani u gritic dhe doli jashtë. Qazimi kyçi derën dhe humbi në errësirë, gati duke vrapuar. Asllani u mbështet pas një rrapit dhe priti aty. Drita dhe hija vazhduan për një kohë të gjatë në dritaren e bodrumit. Vonë fare ajo humbi në errësirë.

Të nesërmen në mëngjes Qazimi u habit kur gjeti Asllanin mbështetur pas rrapit. Sytë i ishin buhavitur. Asllani kishte qenë ndër klientët e rrallë të kafes së Qazimit.

— Po ty s'të paska zënë gjumi?, — tha Qazimi.

— Thuaj njëherë si u gdhive, a derëbardhë, — ia ktheu Asllani dhe mori vetë një karrige dhe u ul pranë derës.

Mëngjesi ishte i kthjellët dhe ditën do të bënte përsëri nxehtë.

— As sot nuk do të kemi shi, — tha Qazimi duke rregulluar zjarrin për të zier kafet.

— Ty nuk të prish ndonjë punë në bie apo nuk bie shi, — tha Asllani.

— Si nuk më prish punë? Pse nuk më dhimbset mua fukarai? Pastaj, edhe unë nga fukarai anoj.

Por Asllani nuk po e dëgjonte më. Para nënprefe-

kturës filloi një gjallëri e paparë. Në shesh doli Xhaferr Myrtoja dhe seç dha disa urdhra. Pas pak filluan të fshinin sheshin.

— Siç duket, presin ndonjë të madh, — tha Qazimi.

— Bëmë kafën, — tha Asllani, — dhe mos i hidh sheqer.

Aty nga ora nëntë u dukën dy triçiklë gjermane dhe pas tyre ca makina me ushtarë. Ata zbritën dhe çmpinë këmbët. Dikush dha një urdhër gjermanisht. Asllani la lekët mbi tavolinë dhe u largua. Qazimi bëri sikur nuk e pa dhe pritë me zemër të ngrirë se ç'do të ndodhte.

Nga bodrumi u dëgjuan përsëri të thirrurat e Xhaferr Myrtos. Ato ishin më të egra dhe në egërsinë e tyre ndihej një siguri më e madhe, bile një mospërfillje. Të bërtiturat shqip gërshetoheshin me ato gjermanisht dhe atëherë dukej sikur ishte krijuar një gjuhë e re, e përbindshme, e ftohtë, një gjuhë që s'mund ta flisje si të tjerat, një gjuhë që vetëm kërcënonte. Qazimi u rrëqeth e u mblodh grusht. Nuk do ta duronte dot atë gjuhë, vetëm se, kur ajo heshti, atij i buçisnin veshët. Edhe kur hyri Xhaferr Myrtoja me oficerin gjerman në kafe, atij i buçisnin veshët dhe nuk e kuptoi ç'porositën. Xhaferr Myrtoja me oficerin gjerman i dukeshin si një qenie. Kjo vinte nga gjuha që kishte dëgjuar pak më parë. Ai ndjeu kërcënimin e saj si një sëpatë.

— Mos u huto, o Qazim, po na bëj ndonjë gjë për të ngrënë, — tha Xhaferr Myrtoja.

Ai ishte i sjellshëm dhe tërë delikatesë. Siç dukej, tani ishin vitet e akademisë që mbizotëronin në qenien e tij.

— Ai duhet të dijë shumë, — tha oficeri gjerman.

— Si çdo korrier, — tha Xhaferr.

— Dhe është kokëshkëmb, si çdo korrier. Partizanët dinë t'i zgjedhin kornierët.

— Mua më duket se, që të flasë, duhet t'i heqim idenë e moshës.

— Nuk ju kuptoj.

— Ai është gjashtëmbëdhjetë vjeç. Idetë e tij janë gërshetuar me romantikën e moshës.

— Cila është më e rrezikshme: idetë apo mosha e tij?, — tha oficeri gjerman.

— Nuk e di mirë, por unë them mosha.

— A nuk ju duken më të rrezikshme idetë që nuk kanë moshë? Unë atyre u trembem shumë.

— Atëherë duhet të luftojmë me idetë, — tha i habitur Xhaferr Myrtoja.

— Po, — tha oficeri gjerman, — sepse mosha e tij, pa ide, është e dobët dhe e përkulshme.

Qazimi u afrua tërë frikë dhe u shërbeu. Sa la gotën e fundit, u largua shpejt e shpejt drejt banakut. Atje e ndiente veten më të sigurtë. Ishte i rrethuar nga shishet dhe tablotë idilike.

— Mundohu që ai të flasë sa më parë, — tha oficeri gjerman dhe nuk foli më derisa mbaroi së ngrëni. Kërkoji me sy ku të lante duart. Çezmë s'kishte. Poshtë ishte lumi. Ai rrudhi buzët dhe u çua. Xhaferr Myrtoja e ndoqi pas.

Tërë atë ditë nuk hyri njeri në kafe. Edhe nga dritarja e bodrumit qetësia me të bërtiturit dilnin si copëza të një filmi herë me zë e herë pa zë. Qazimi e përfytyronte skenën, por nuk e përfytyronte dot partizanin e ri. Ai donte që atë ditë të mos e shqetësonte njeri. Në kohë të tilla, kur gërshetohen gjuhët, si diçka ogurzezë, është më mirë të jesh vetëm. Dhe Qazimi ishte i kënaqur. Nuk dinte kujt t'ia kushtonte këtë qetësi. Dhe si përgjigje të kësaj pyetjeje, dëgjoi zhurmën e lumit që rridhte i qetë, i kthjellët dhe indiferent. Lumi nuk donte të dinte se rrjedhja e tij ndante dy botë. Gjethet e rrepeve u zmadhuan edhe pak. Pas ndonjë jave kafja do të mbulohej nga gjelbërimi dhe do të dukej si një ishull i veçuar nga telashet e kësaj jete.

Aty nga mesi i ditës nga dyert e nënprefekturës nxorën partizanin e ri. Ai nuk njihej. Mezi qëndronte në këmbë. Qazimi u drodh. Atë po e sillnin drejt kafes së

tij. Partizani përpiquej të shikonte malet, por ia vriste sytë dielli që kishte një shkëlqim të fortë. Sheshi zbardhte. Nga malet filloi të ndihej freskia e parë. Era ia lëkundte lehtë djaloshtit flokët e verdhë, si grurë i pjekur. Sytë nuk i dukeshin. Ishte enjtur nga fytyra. Nuk njihej. Ai nuk kishte më moshë. Po ashtu dukej më i papërkulur. Në anë të lumit qëndroi. Ndoqi rrjedhën e tij me sy. Dhe aty Qazimiu duk sikur dalloi dhe ngjyrën e syve. Ata ishin të kaltër dhe të njomë. Ata ishin si qielli. Qielli nuk ka moshë. Partizanin e shtynë nga pas. Atë nuk e mbajtën dot këmbët dhe u rrëzua mbi ujë. Vuri buzët dhe piu, piu tërë etje.

— Shtyjeni midis atyre dy gurëve të zinjl!, — tha njëri prej ballistëve, që mbante një palë mustaqe të gjata pis të zeza.

Dy ballistë e kapën njëri nga koka e tjetri nga këmbët dhe e hodhën atje ku i urdhëruan.

— Provojeni njëherë!, — tha përsëri ballisti mustaqelli.

Njëri prej ballistëve u hodh nëpër gurë, pastaj shke li mbi trupin e partizanit dhe kërceu në kafe.

— S'ka ku të vejë më mirë!, — thirri.

— Mos mbytet?

— Jo, jo, është cekët.

— Mirë. Ti qëndro aty, kurse ti këtu. Shiko se mos jua rrëmbejnë. Natën do të shtojmë rojet, — tha ballisti mustaqelli dhe u largua për nga nënprefektura.

Rojet zunë vend dhe ndezën nga një cigare. Qazimi u struk brenda banakut. Kur e thirri roja, u rrëqeth. Por e mori veten shpejt. Në zërin e rojës ai dalloi klientin që porosiste...

— Aty do ta lini?, — pyeti.

— (Po. Gjersa t'i mbushet mëndja të tregojë.

— Qënka i fortë!, — tha padashur Qazimi dhe, kur pa se kishte shprehur atë që nuk duhej t'ia pohonte as vetes, u zmbraps. Por roja nuk e dëgjo. Ai porositi kafe dhe thithi cigaren e sapodredhur.

Partizani zuri vend mirë dhe qëndronte atje pa lëvizur. Dukej si një njeri që ka vënë veshin dhe dëgjon

zhurmat e tokës, të ujit, të stinëve e të vitevë. Zhurma e ujit i sillte në përfytyrim malet. Ai dëgjonte çapet e maleve. Ato afroheshin dhe përkuleshin mbi flokët e verdhë: Partizani ndjeu frymën e tyre dhe mbylli sytë. Nuk kishte gjë më ngacmuese se zhurma e ujit që zbriste nga malet. Ajo sillte shkrirjen e dëborës së fundit, që mbushte shtratin e lumit.

Që në mëngjez Xhaferr Myrtoja doli si i tërbuar nga nënprefektura. Ai eci drejt partizanit. E kapë për flokësh, ia pënplasi disa herë kokën dhe u përpoq ta mbyste. Pastaj, si e pa që ishte e kotë, hoqi dorë. E ndiente veten të dërrmuar.

— Do të të lë këtu të kalbesh, — tha ai dhe shkoi të piqte një kafe.

Zëri i tij nuk e kishte forcën e ditës së parë. Ai i vinte si i mekur. Edhe vetë Xhaferr Myrtoja u habit me këtë transformim e nuk donte ta besonte. Dhe për të provuar që s'e kishte humbur forcën e zërit, u bërtiti rojëve dhe kafexhiut të shërbente shpejt.

Qazimi nuk dinte ku të futej. Sytë i kishte të fryrë. Nuk kishte fjetur fare. Tërë natën i ishte shfaqur partizani i hedhur në lumë. Ai shikonte me keqardhje lumin, që e kishte humbur neutralitetin e vet. Na ishte njëherë një lumë që humbi neutralitetin e vet dhe nuk ndante më dy botë.

«Duhet ta mbyll kafen për pak kohë», — mendoi Qazimi dhe sikur u lehtësua.

Në kafe nuk po hynte asnjë klient. Vonë erdhi një fshatar që po kthehej nga qyteti për në fshatin e tij. Ai donte të shikonte kush ishte partizani, prandaj u përkul. Por rojet u hodhën dhe e shtynë. Fshatari i moshuar pështyu dhe u çua. Shau rojet dhe u largua për në fshat pa pirë kafen. Qazimit iu duk sikur dëgjoi mallkimin e fshatarit edhe për kafen. Pastaj, nga ora dy-mbëdhjetë deri në dy, Xhaferr Myrtoja filloi torturat, por partizani nuk foli. Qazimi shikonte nga banaku si humbiste forca e Xhaferr Myrtos dhe si shuhej në sytë e tij tërë ajo siguri. Qazimi kishte çaste që aty, brenda banakut, ndiente se nuk ia kishte frikën Xhaferr

Myrtoş. Por, sapo i vinte kjo gjë në mendje, e shuan-
te me frikën që kishte guxuar të shkonte aq larg.

I pari banor që piu kafe ishte Asllani. Ai nuk e
kaloi lumin mbi gurë, por i ra mes për mes. Para parti-
zanit ndaloi. Partizani kishte rënë në agoni dhe nuk
ndiente asgjë. Asllani qëndroi aty i pikëlluar. Ai nuk
e shihte dot dhimbjen. Qazimi kishte frikë mos i shkrep-
te ndonjë gjë në kokë Asllanit, prandaj nuk ia ndante sy-
të. Asllani qëndroi gjatë aty, në mes të lumit, që kishte
humbur neutralitetin. Pastaj, duke mposhtur veten, eci
drejt kafes. Qazimi e kishte pjekur kafën dhe ia
kishte bërë gatë.

— Ky qenka luan, — tha me zë të ulët Qazimi.

Asllani pohoi me kokë.

— Unë nuk do të duroja dot as edhe një orë. Kë-
të po bëhen dy ditë që po e torturojnë, — vazhdoi Qa-
zimi.

— Ç'dërdëllisni ju aty?, — tha roja.

— Asgjë, zotëri, asgjë, — tha Qazimi dhe zuri vendin
e zakonshëm pranë banakut.

Asllani qëndroi derisa u err. Kur kaloi pranë parti-
zanit, i foli diçka. Rojet e ndaluan.

— Çfarë i the?

— Asgjë.

— Pse, bar hamë ne? Ti diçka i fole.

— Po, — tha Asllani, — i urova natën e mirë.

Rojeve iu duk zbavitës ky urim dhe zunë të qesh-
nin. Asllani i la dhe iku i menduar drejt shtëpisë. Fres-
kia e majit po zbriste nga malet. Partizani po i dhim-
bin plagët. Ndonjëra ishte gangrenizuar. Gjumë nuk do
të vinte në sy. Nuk ishte hera e parë që e priste mën-
gjesin zgjuar. Dhe partizani nisi të kujtonte. Megjithëse
ishte i ri, ai kishte shumë kujtime. Tërë vitet mblidhe-
shin në natën e sotme. Dhe partizani tha se, edhe në një
natë si kjo e sotmja, ai vlente të përmblichte tërë jetën
e tij. Aty nga mesi i natës erdhi Xhaferr Myrtoja. As
ai nuk kishte gjumë atë natë. Xhaferr Myrtoja ishte më
i egër se kurrë. Sikur i kishin hequr ndonjë gjymtyrë.
Cilën gjymtyrë i kishin hequr Xhaferr Myrtoş? Ai filloi

torturat dhe nuk dinte ku e godiste. Plagët e vjetra i dhembën aq shumë partizanit, sa në fillim i ra të fikët. Por uji e solli në vete. Yjet reflekttoheshin në lumë. Sa ishin? Partizani i shikonte turbull. Xhaferr Myrtoja e torturoi deri vonë, kur filloi të shpërndahej errësira e natës. Kur humbi çdo shpresë, e qëlloi me revolver në kokë. Rrjedha mori me vete gjakun. Partizani ndiente se i rridhte gjaku dhe e dinte se ai ishte mëngjesi i fundit.

Deri në mëngjes ai humbi shumë gjak. Edhe mëngjesin e pa turbull. Por ai nuk kishte nevojë ta shihte qartë. Mëngjeset ishin fotografuar në kujtesën e tij fort dhe qartë. Ai dinte çdo hollësi të tyre me sy mbyllur, shikonte zbardhjen e maleve dhe pishat që përthyenin rrezet e diellit. Ai ndiente aromën e pishave në maj. Mezi merrte frymë. Në gjoks i shtrëngohej dhimbja e plagëve. Kishte jetuar një natë të jashtëzakonshme. Gjakun i kishte pushuar. S'kishte më gjak. Lumi e shpërndaui arave. Po vaditej misri. Aroma e tokës në mal... E rrëmbyen për krahësh dhe e çuan buzë lumit. Nuk shikonte. Dëgjoi vetëm zërin e Xhaferr Myrtos. Ky thirri e thirri, sa u lodh. Pastaj nxori revolen dhe e qëlloi. Partizani ra. Gjakun e pakët që i kishte mbetur ia thithi toka e etur. Xhafer Myrtos iu duk sikur qëlloi në erë. Kur pa partizanin pa jetë, e ndjeu veten të lodhur dhe të dërrmuar. Rojet prisnin urdhër. Ai nuk dinte çfarë urdhri të jepte. I shkrepri të urdhëronte ta ngjallnin përsëri partizanin që ta ripushkatonte. Përsëri! Ta ngjallnin që ta ripushkatonte! Ky mendim po e çmendte.

Hidheni në lumë, atje ku rryma është më e rrëmbyer!

Rojet, si genie të kurdisura, e zbatuan menjëherë urdhrin. Xhaferr Myrtoja pa se si e hodhën partizanin dhe u pendua. Donte që ta kishte pranë. Donte të ndiente pushtetin e tij. Por tani kjo ishte... e pamundur.

— Shkoni ma gjeni!, — thirri.

Rojet nuk dinin ç'të bënin.

— Shkoni! Ç'prisni?

— E mori rryma.

— Ndiqeni! Ndiqeni dhe kapeni!
Rojet u larguan. Xhafer Myrtoja priti. Priti gjatë.
Kë priste? Rojet u kthyen duarbosh.
— Ku e keni?
— Nuk e gjetëm. Një fshatar na tha se e mori Asllan Ostrovica me dy të tjerë.
— Cilët ishin?
— Nuk i njihim.

Tani ishte kot çdo urdhër. Partizanin nuk do ta gjenin dot. Hyri në kafe Qazimi u tremb. «Vetëm një-réz si ky ma kanë frikën», — mendoi Xhafer Myrtoja dhe i erdhin at me veten. Piu me një frymë një gotë raki. Pastaj piu një të dytë. Vajzat e veshura me tyl sikur talleshin dhe e joshnin. Xhaferr Myrtoja e pa se çdo gjë ishte e kotë. Ishte i dërrmuar dhe pa pikë fuqie. Nga nënprefektuara po vinte me vrap trimi i tij.

— Ç'ke?
— Do të nisemi!

Dhe vërtet; para nënprefekturës po rreshtoheshin ushtarët gjermanë dhe ballistët. Xhaferr Myrtoja qeshi. Po fillonte Operacioni i Qershorit, por ai e ndiente dis-fatën e tij të pashmangshme pa shkrehur as edhe një pu-shkë.

STAZHIERI

Që ata e vunë re mërzinë time, jam i sigurtë, por që askush nuk e kuptoi shkakun e saj, për këtë nuk kam as dyshimin më të vogël. Në dolëm nga bari në hollin e gjerë të hotel «Tiranës» dhe po rregullonim shallet. Jashtë frynte erë dhe binte një shi i padukshëm. Të nesërmen, kur të gdhihej, mali i Dajtit do të zbardhte nga dëbora. Dhjetori po mbante ftohtë dhe makinat e druve punonin deri vonë. Të nesërmen do të nisesha me shërbim për në Përmet. Ishte muaji i tretë që dilja vetëm për vetëm me shoferin me shërbim. Nuk e di, po shërbimet më kishin hyrë në zemër, sidomos më pëlqente kur shikoja respektin e të tjerëve sa merrnin vesh se punoja në Radiotelevizion. Të them të drejtën, këtë respekt sikur po e kërkoja edhe nga e fejuara ime, edhe nga shokët. E kërkoja si diçka të natyrshme dhe, kur ma jepnin, isha në humor. Edhe atë natë dy shokët e mi dhe Entela, e fejuara, sesi më vështruan, kur u thashë të çoheshim, se të nesërmen, që në mëngjes, do të nisesha për në Përmet. Fillova t'u tregoja qyfyre të gazetarëve të vjetër. Disa i tregova sikur më kishin ndodhur mua, dhe ata qeshën. Bota e gazetarëve ka gjithmonë diçka tërheqëse për ata që nuk i njohin. Para sportelit kishte njerëz.

— Nuk ka, mor shok. (Pse s'dua unë të të jap!, — thoshte sportelisti.

— Kemi ardhur nga larg, për hall, — i lutej një burrë.

— Si ia bëni për hotel?, — më pyeti Kujtimi.

— Nuk e kemi problem fare. Sa marrin vesh se jemi të Radiotelevizionit, na regjistrojnë menjëherë.

Gjysma e asaj që thashë ishte e vërtetë. Para dy muajve në Shkodër ne e gdhimë në makinë, sepse ishin zënë të gjitha hotelet. Por këtë nuk ia tregova as Entelës.

— S'ka kuptim, — tha Entela. — Gazetarë këta dhe të flenë jashtë!

— Ikim, se, sa të përcjell Entelën dhe të kthehem në shtëpi, vete vonë. Nesër jam për në Përmet, — thashë kushedi për të satën herë atë natë.

Ata i hapën rrugën Entelës dhe po bëheshim gati të dilnim, kur pashë se drejt hotelit po vinte një grua me të zeza me një djalë.

— Harrova të ble cigare, — thashë dhe hyra menjëherë në bar.

Të tre më vështruan me habi, por unë nuk u lashë kohë të flisnin. Dhe, sapo hyra në bar, filloi dhe mërzia ime, apo nuk di si ta quaj atë ndjenjë që më pushtoi. Ishte diçka midis mërzisë dhe keqardhjes, kur ti e kupton se të mungon diçka që, duke e vlerësuar te të tjerët, mendon se e ke edhe vetë. Në bar kishte tym. Në tavolinën tonë nuk ishte ulur kush. Kamerierja po mbledhte pjatat e ëmbëlsirave që kishin ngrënë shokët e mi dhe gotën time të konjakut. M'u duk sikur isha kthyer aty prej vitesh për të ringjallur diçka të braktisur dhe të harruar prej vitesh njëherë e përgjithmonë. Kamerierja i hoqi një leckë tavolinës dhe u largua indiferente. Me siguri që ajo i kishte harruar tani fytyrat e klientëve që ishin ulur aty pak më parë. Kjo ishte e natyrshme, por mua nuk më kishte rënë në sy herët e tjera. Qëndrova disa minuta sikur po kërkoja njeri dhe hapja derën për të dalë jashtë. Gruaja kishte ulur trastat për tokë dhe vështronte e shqetësuar djalin që bisedonte i dëshpëruar me sportelistin.

— Të kuptoj fare mirë, po ja më thuaj ti ç'të të bëj?

Të gjitha vendet i ka zënë Ministria e Shëndetësisë. Sec kanë një mbledhje.

— Mos kushedi nuk vjen ndonjëri.

— Po s'erdhi njeri, ju do t'ju regjistroj të parët, por mos mbani shumë shpresë. Shkoni në ndonjë hotel tjetër.

— Kemi dy orë që vërtitemi, — tha djali.

— Ç't'ju bëj unë i shkreti! Keni ardhur në kohë ters, fund viti...

Gruaja e shikonte në gojë sportelistin. Ishte e lodhur. Me siguri që nuk i kishte rënë rasti të dilte shpesh nga shtëpia dhe nuk ishte mësuar me telashet e hoteleve kur shkon vonë. Kur djali po kthehej nga gruaja, unë dola jashtë. «Më mirë mos e kisha dëgjuar bisedën e djalit me sportelistin», — mendova.

— Ç'u vonove kaq shumë?, — më pyeti Entela.

Nuk iu përgjigja. Edhe ai shqetësim që vura re në zërin e saj, më nervozoi.

— Ç'ke kështu?, — më pyeti Kujtimi.

— Asgjë.

— Sikur je zbehur.

— Mos nuk je mirë?, — tha Entela dhe më hodhi dorën. — Nesër je dhe për rrugë.

— As vetë nuk e di se si m'u morën pak mendtë, — thashë.

— Ruhë, është gripi nëpër këmbë, — tha Bashkimi, që ishte në vitin e katërt të Fakultetit të Mjekësisë.

Pranë Monumentit të Skënderbeut, u ndava me të dy shokët. Mbeta me Entelën. Ajo m'u var në krah. Më pëlqente kur më varej kështu dhe kur ecte duke i hequr me përtim këmbët. Në atë ecje të plogët të fejuarit shprehin zakonisht lumturinë e tyre. Këtë e kisha kuptuar para se të fejojehsha dhe vetë. Por atë natë Entela, që herët e tjera më dukej pa peshë, më rëndonte dhe më bezdiste.

— Ec si njeri, — i thashë me inat.

— Ç'ke kështu!, — më tha më shumë e habitur, se e fyer. — Në «Tirana» ishe mirë.

— Tani nuk jam.

Ajo ndaloi dhe m'i nguli sytë.

— Ç'më shikon kështu, sikur nuk më ke parë kurrë?

Entela nuk foli. Hoqi krahun dhe ngriu në vend. Na kaluan pranë disa studentë që diç pëshpëritën mes tyre dhe pastaj qeshën. Unë u nervozova.

— Ç'rri si e shastisur? Hajde!, — dhe u nisa.

Ajo nuk luajti nga vendi.

— Do të vish apo të të lë vetëm?

Ajo u afrua dhe ne ecëm pa folur. Shelgjet buzë Lanës lëkundeshin sikur përzierin retë e shiut. Bulevardi ishte i shkretë. Neonet hidhnin dritën e tyre mbi asfaltin e qullur. Në stacionin e autobuzit të Unazës nuk kishte njeri.

— Ta marrë dreqi, kushedi kur vjen!, — thashë.

Entela u tërhoq mënjanë, u mbështoll mirë me pardsynë e saj dhe lidhi në kokë shallin.

— Hiqe!, — i thashë. — Ke parë dhe ti që lidhin shall dhe hop, si majmun!

— Më laget koka, — tha ajo.

— Punë e madhe! Se nga ti u vonuam dhe sonte. Kishë qejf për te «Tirana»!

— Ti vetë më premtove para se të shkoje në Kukës së, sa të ktheheshe, do të më çoje te bar «Tirana». Vetëm për të mos ta prishur, erdha.

— Qëkur kështu ti?

Nuk dija se ç'flisja. E dija se Entela nuk kishte asnjë faj, po ja që desha të shfryja diku. Dhe iu derdha asaj. Ajo, e urtë, por edhe e shastisur, m'i mbërthen-te sytë dhe me siguri që nuk merrte vesh asgjë. Atë natë ajo nuk kishte asnjë faj. Unaza ishte e përgjumur. Edhe autobuzi as që dukej të vinte.

— Në fund të dynjasë e kenë shtëpinë! Yt atë, për të rregulluar të tjerët, është i zoti, kurse për vete nuk e nxjerr dot qimen nga qulli, — thashë.

— Ç'flet kështu!

— Pse, u preke, a?

Në këtë kohë nga kthesa e urës së fundit u dukën dritat e autobusit urban.

— Nuk ka nevojë të më përcjellësh, — tha Entela kur ai ndaloi para nesh.

Vetëm kur autobusi më humbi nga sytë, u pendova që i kisha folur ashtu. Nuk dija nga të shkoja. Isha qullur. Në shtëpi nuk më vihej. Dhe, pa e kuptuar, u nisa, për në hotel «Tirana». Nxitoja. Në kokë nuk kisha asnjë mendim të qartë. Hyra në holl, po para sportelit nuk kishte njeri. Sportelisti po bënte llogaritë i përkulur mbi disa regjistra të mëdhenj.

— Më falni, — i thashë.

Sportelisti nuk e ngriti kokën menjëherë. Vazhdoi të bënte llogaritë. Pastaj hoqi një vizë poshtë shifrave pa e prishur gjakun dhe shënoi shumën. Bëri dhe provën. Kur u siguria që ishte në rregull, ngriti kokën dhe më tha:

— Urdhëroni!

— Mos kanë zënë vend këtu një grua me të birin, nga Dhërmiu?

— Nga Dhërmiu? Një grua me të birin? Jo. Të gjitha dhomat i kemi pasur të zëna që dje.

— Domethënë nuk mbeti ndonjë dhomë bosh?

— Jo.

— Natën e mirë.

— Natën e mirë.

Dola jashtë. Të katra orët e sahatit dukeshin nga larg si katër të pagjumë. Shiu ishte rralluar, por era ishte bërë më e ftohtë. Në shtëpi nuk më vihej. Sikur më vriste rehatia e shtratit që nëna ma rregullonte me aq kujdes. Shkova në hotel «Peza», po edhe aty më thanë se nuk kishte pasur vend.

— Ku mund të kenë shkuar?, — pyeta sportelistin.

— Ku ta di unë?

— Nga më thua të shkoj të pyes njëherë?

— Ec njëherë nga hotel «Drini».

Tirana po bëhej gati të flinte. Në shtëpi e dinin që isha me Entelën dhe nuk më prisnin të kthehesha shpejt. Ecja drejt hotel «Drini» dhe më iku çdo dëshirë që të nisesha nesër me shërbim për në Përmet. Kisha para syve gruan që vështronte e shqetësuar sportelistin tek

bisedonte me të birin. Isha i sigurtë se ajo nuk kishte dalë shpesh nga fshati dhe nuk ishte mësuar të flinte hoteleve. Që ishte një grua e padalë, këtë përshtypje e krijova që atë natë kur fjeta në shtëpinë e saj. Kjo kishte ndodhur para dy javësh. Në Vlorë më thanë të shkoja në Dhërmi dhe të bëja një emision për të rinjtë nga qyteti që kishin shkuar aty vullnetarë.

— Po për të fjetur si do t'ia bëni?, — më pyeti instruktori i rinisë.

— Mos flemë në kamp.

— A do t'ju lënë... Të më kishe thënë më parë, e kisha marrë në telefon drejtorin, — tha instruktori.

— Do ta rregullojmë në një farë mënyre, — e qetësova.

— As mos ju vejë në mendje se do të flini jashtë.

Kur dolëm nga Vlora, ora ishte dy e gjysmë. Dëfi ishte i shqetësuar dhe përplaste dallgët pas shkëmbinjve tek Uji i Ftohtë. Kur është kohë e keqe, udhëtimi më duket mjaft tërheqës. Në Dhërmi po shkoja për herë të parë. Shoferi, që donte të qëndronim atë natë në Vlorë, ishte i mërzitur.

— Mbaje!, — i thashë.

— Pse?

— Seç ishte një grua me një djalë që na zgjatën dorën.

Shoferi frenoi. Djali erdhi me vrap.

— Në Dhërmi, — tha ai.

— Hipni.

Gruaja mezi merrte frymë. Sa zuri vend, nuk la urim pa na dhënë. Më preku gëzimi i saj i çiltër dhe m'u kujtua nëna. Ngaqë nuk kisha dalë shpesh nga shtëpia, nëna më kujtohej shpesh.

— Na iku autobusi dhe mbetëm për pikë të zezë. I thashë djalit: «Hajde të dalim nga Ujëti e Ftohtë, se do të ketë ndonjë njeri të mirë që të na marrë deri në fshat». Dhe ja ku erdhët ju. — Djalit sikur i vinte turp që e ëma nuk e fshihte gëzimin e saj dhe nuk fliste. Në kokë kishte kapele dhe flokët i kishte të qethur. Do të shkonte ushtar. I urova shërbim të mbarë. — Të

falem nderit, biro, dhe të të rrojnë gjithë ç'ke për zemër. Këtë që na bëtë ju sot, m'u dhëntë rasti t'ju shpërblej si ma do zemra.

Sapo kaluam Dukatin dhe filluam të ngjitem Llogoranë, u prish koha dhe nga deti nisi të ngrihej mjegull. Pishat u mbuluan sakaq dhe rruga mezi dukej. Vetëm zhurma e motorit tregonte se po ngjiteshim në mal. Era kishte vende që frynte si e tërbuar, aq sa makina tundej. Pishat gati sa nuk thyheshin. Afër majës ranë pikat e para. Rruga ishte e shkretë.

— Kush udhëton tani!, — tha me inat shoferi.

Nuk bëra zë. Ndofta, ai kishte të drejtë. Rruga ishte e rrezikshme dhe mjegulla sa vinte e dendësohej.

— Kështu është këtej, biro. Edhe në verë Llogoraja ka mjegull.

Më kishin thënë se nga maja e Llogorasë deti Jon duket si një mrekulli, kur është kohë e kthjellët. Atë ditë unë nuk do ta shihja detin, por kjo nuk më mërziste. Udhëtimi po më pëlqente. Sidomos pishat e deformuara nga era dukeshin edhe më të bukura ashtu mes mjegullës që rrëshqiste drejt maleve. Kur zbritëm Llogoranë, ishte errur dhe nuk e pashë përsëri detin.

— A do të na lënë të flemë në kamp?, — pyeta djalin.

— Nuk e di, sepse e kanë të ndaluar, por..., — tha djali.

— Ç'është ajo! Të na urdhëroni në shtëpi, — e ndërpreu me qortim e ëma.

— Do të vonohemi, — i thashë.

— Kur të doni të vini. Portën hapur e keni, mos shkoni fare nga kampi.

— Mirë, — i thashë.

— Dëgjon, Jorgji, mos i lër të shkojnë gjëkund, — i tha të birit.

Ndaluam para klubit. Gruaja nuk na e dha dorën dhe na tha se na priste. Djali qëndroi me ne. Na ndihmoi për të mbledhur vullnetarët.

— Shko, — i thashë, — je i lodhur.

Ai qeshi, por nuk u largua. Bisedën me të rinjtë e

inçizova në një nga dhomat e tyre. Në fillim më shqetësoi era e fortë që frynte nga jashtë dhe bubullimat e shpeshta që thithte mikrofoni, por pastaj i lashë. Ato ilustronin fare mirë ato që thoshin vullnetarët. Në emision futa edhe një vendës, një djalë zeshkan, me tipare të trasha. Ai doli nga dhoma sa mbarova punë me të. Në fillim kjo më bëri përshtypje, por thashë se kishte ndonjë hall dhe vazhdova inçizimin. Ai erdhi pas gjysmë ore. Ishte i lagur. Mbarova nga ora nëntë e gjysmë. Isha i lodhur dhe më flihej. Mbylla magnetofonin dhe vështrova shoferin. Ai ia kishte shtruar muhabetit dhe nuk kishte asnjë shënjë mërzie.

— E, si të doli biseda?, — më pyeti.

— Mirë.

Në këtë kohë më zuri syri Jorgjin. Ai nuk ishte larguar fare nga ne.

— Po ti, pse nuk ke ikur?

Jorgji buzëqeshi me një fare turpi.

— Po ju pres.

— Pse?, — pyeti vendësi që kisha inçizuar.

— Do të vijnë nga ne sonte, — tha Jorgji. — Nëna po i pret.

— E rregulluam atë punë. Njëherë tjetër..., — tha zeshkani me një ton paqtues.

Jorgji u prek.

— E kushedi kur takohemi prapë, — tha ai.

— Sonte do të vijnë nga unë, ik tani.

Jorgji më vështroi i sigurtë se do të shkoja nga ai.

— Ndonjëherë tjetër, — i thashë.

— Si të doni, po nëna me babanë po ju presin.

— Falemnderit, po do të vijmë përsëri. Kështu e ka zanati ynë.

— Ju të urdhëroni kur të doni, por është puna për sonte. Ju i premtuat edhe nënës, — tha Jorgji.

— Shko tani, pa herë tjetër do t'jua sjell vetë. I thua Jetterit që i mori Fotoja.

— Mirë, — tha Jorgji dhe na dha dorën. Më erdhi keq që nuk shkova nga ai. Shiu përplasej me forcë mbi

xham dhe shkrepimat çanin errësirën. U ndava nga vullnetarët dhe ndoqa Foton. Ai ndezi elektrikun e dorës. Shiu na qulli menjëherë. Era e vërtiste nga të katër anët.

— Ku e ke shtëpinë?

— Në lagjen «Gjilekë», — tha Fotoja.

Tërë rrugës vetëm zbrisnim. Nën dritën e shkrep-timave dallova dallgët që përplaseshin në breg. Pastaj përshtypjen se isha në një fshat bregdetar ta forconte dhe prania e portokajve. Fotoja bënte ç'bënte dhe më hidhte dritën përpara të shihja rrugën.

— E paske larg, — i thashë, — të kishim marrë makinën.

Gurët e bardhë ishin rrëshqitës. Pata idenë se Dhërmiu ishte gurë dhe det. U futëm në një rrugicë. Aty era gati sa nuk na rrëzoi. Megjithatë ajo natë më dukej interesante. Pa e kuptuar, po e futja në kujtimet e mia. Po e filloja jetën e gazetarit duke takuar njerëz të mirë. Ata, pa e ditur, linin tek unë diçka të mirë, të bukur. Duke iu afruar shtëpisë së Fotos, m'u kujtua Entela dhe shokët. Ata, me siguri, ma kishin zili këtë natë joniane. Qesha me vete. Nëna donte të bëhesha mjek. Tani do të isha në kuzhinë, pranë sobës. Por shiun, erën dhe zhurmën e dallgëve të padukshme të asaj nate nuk i ndërroja me asgjë.

— Erdhëm, — tha Fotoja.

Hymë në një korridor të ngushtë dhe të çuditshëm. Si mur i djathtë shërbente shkëmbi i malit.

— E keni si kështjellë shtëpinë.

— Ta shikosh nesër në mëngjes, thua si nuk merr të tatëpjetën. E kemi ngritur mbi gur. S'ka tokë të butë këtu.

Sa dëgjuan zërat tanë, na doli përpara një burrë i thinjur dhe një djalë.

— Babai, vëllai, — na njohu Fotoja.

— Po ju qenkeni bërë ujë! Ndërrohuni menjëherë, — tha babai i Fotos.

— S'ka gjë, thahen.

— Ç'është ajo fjalë, biro, — ndërhyri një grua ve-

shur me të zeza që ishte pas tyre. — Foto, jepu pantallonat e tua.

«O»-ja e theksuar, e ngrohtë e asaj gruaje m'u duk e njohur.

— Bashkë paskemi një trup, prandaj vish të miat, — më tha i vëllai i Fotos.

U ndërruam në dhomën lart. Kur zbritëm, u thashë të zotërve të shtëpisë:

— Ju shtrënguam, të na falni.

— Me se të na ndodhet, — tha babai.

U ulëm pranë vatrës, mbi disa postiqe me lëkurë delesh. U mbështetëm mbi jastëkë.

— Rrini si t'ju vijë më mbarë. Foto, na sill edhe ca dru.

Ajo që më shqetësonte filloi pas pak. Nëna dhe vëllai i Fotos po pregatisnin darkën. U mata t'u thosha mos bënin gjë, por kjo mund t'i fyente. Dhe nisëm bisedën. Ishin njerëz të thjeshtë dhe të dashur. Druajtja ime, si djalë i padalë që isha, u zhduk pa lënë gjurmë. Nëna e Fotos na shikonte me një dhembshuri prekëse. Dhe thashë se nënat janë të gjitha njëjloj. Qëndruam deri vonë. Na shtruan për të fjetur lart, në katin e dytë.

— Sa dhoma këni?, — pyeta Foton kur po binim të flinim.

— Dy. Kjo është e vëllait. Është i martuar.

— Po e shoqja ku është?, — pyeta menjëherë.

Fotoja u pendua dhe nuk m'u përgjigj aty për aty. E pyeta përsëri.

— Ka shkuar tek e ëma, sepse sapo ka lindur. Do të rrijë disa ditë. Kështu e kemi zakon ne këtej.

Por ai nuk dinte të gënjente. E pa se po e vështroja në sy dhe tha:

— Flemë, se dhe ju jeni të lodhur.

Fikëm dritën. Unë rashë pranë dritares. Shkrepimat ishin rralluar. Në mendje më silleshin tërë mbresat e ditës. Biseda me të atin e Fotos, që ishte martuar me dashuri, origjina krutane e lagjes «Gjileka», çlirimi i Sarandës e të tjera e të tjera. Gjumi nuk më zinte. Hapa pak perden, por nuk dallova gjë. Natë e errët jo-

niane. Zhurma e detit dhe një shtëpi ngritur majë shkëmbi. Dhe përsëri m'u duk sikur në atë shtëpi isha rritur, sikur kjo dhomë nuk kishte asgjë të panjohur për mua. Më pushtoi një mall, si malli që na zë kur shkojmë në shtëpi të re, ndërsa shtëpia e fëmijnisë mbetet larg, e turbullt, si një vatër që djeg dhe ngroh me ditët e bukura. Dhe kjo ndjenjë më pushtoi më fort, se të nesërmen në mëngjes do të largoheshim dhe, ndof-ta, nuk do të më jepej rasti ta përsëritja atë natë.

Nuk mbaj mend kur më zuri gjumi. Në mëngjes gjëja e parë që më ra në sy ishte drita e mugët e agimit dhe e detit të qetësuar, të lodhur. Në katin poshtë ishin zgjuar prej kohësh. Edhe Fotoja nuk ishte në dhomë. Ai u ngjiti pas pak.

— Si fjete?, — më tha.

— Mrekulli.

— Pate ftohtë?

— Hiç fare.

— Zbritëm. Pantallonat na i kishin hekurosur. Nëna e Fotos po tiganiste petulla.

— Mirëmëngjes, biro, si fjetët?

— Mirë.

Hyri dhe i ati, i Fotos.

— Qenke zgjuar herët, — i thashë.

— Kështu e kemi zakon ne nga fshati, — qeshi ai. — Domethënë, sot do të ikni?

— Që tani, bile.

— Pa pirë kafen dhe pa vënë diçka në gojë, s'keni nga të shkoni.

— Keni tërë atë rrugë, biro.

— Ishalla nuk ka mjegull Llogoraja, — tha shoferi.

— Sot kthjellët është, po maja e Llogorasë ka qelleshe.

— Mos kushëdi nuk ju hahet që tani, biro, — tha nëna e Fotos.

— Mbështillua në letër, — tha vëllai i Fotos.

Na mbushën një letër të madhe me petulla që lë-

shonin një erë të mirë. Të gjithë na përcollën deri poshtë, në xhade.

— Dhe të na vini gjithmonë, se bëjmë edhe muhabet, edhe njihemi, — tha i ati i Fotos kur u ndamë.

— E keni ju radhën, — u thashë.

Jo vetëm atë ditë, por edhe më vonë e kujtoja atë natë me një mall të veçantë. Dhe doja t'ua shpërbleja sa më parë atyre njerëzve të mirë, por ja ku erdhi kjo natë që unë të kuptoja se më mungonte diçka. Gruaja që vështronte tërë ankth sportelistin dhe djali ishin Fotoja me t'ëmën.

Ora po vinte njëmbëdhjetë. Tani hotelet mbylleshin. Hyra në hotel «Drini». Dhe aty më thanë se nuk kishin pasur vende.

— Nga t'i kërkoj?, — pyeta sportelistin.

— Kot që të lodhesh, tani nuk gjen hotel hapur, — tha sportelisti.

Dola nga hotel «Drini» dhe nuk më bënë këmbët të shkoja diku. Mbi sheshin qendror frynte erë. Akrepat e orëve të Sahatit më dukeshin si pasagjerë të pagjumë që presin mes rrugës mos kalojë ndonjë makinë t'i marrë. Fillova të qetësoja veten duke thënë se Fotoja me t'ëmën tani flinin. Më kishin mbetur edhe dy hotele pa shkuar, por nuk guxoja të veja. Më trembte përgjigjja e sportelistëve. Përse u tregova aq i vogël, kur i pashë ata të dy që po vinin drejt hotel «Tiranës»? Në kokë kisha vetëm këtë pyetje. Përpiqesha të justifikoja veten, duke thënë se ajo ishte një dobësi e çastit, por ishte e kotë. U nisë për në shtëpi. S'kisha ku t'i kërkoja më. Ora po i afrohej dymbëdhjetës. Isha i sigurtë se ata të dy tani po flinin në të ngruhtë, por kjo nuk ma zbuste brëngën.

NGA SELCA NË TAMARË

Ndofta, rruga më e mërzitshme dhe më monotone kur zbret nga Vermoshi është ajo nga Selca në Tamarë. Menjëherë pas gjelbërimit të bjeshkëve hyn në një grykë shkëmbore, të egër dhe të thatë. Gryka është e heshtur dhe ti ke gjithmonë përshtypjen sikur aty sapo ka mbarruar një përlëshje kreshnikësh, të dalë çuditërisht nga guvat e lahutave. Ndryshë nuk ke si ta shpjegosh rrëmujën e shkëmbinjve dhe përplasjen e çrregullt të lumit Cem pas bërrylave të shumtë, si një rapsod i verbër që shtegton për të mbledhur fragmentet e eposit të vet. Gjelbërimi është ngjitur lart mbi bedenat shkëmborë, poshtë të cilëve dredhon rruga këmbësore.

Atë vit shkova me shërbim për të piketuar rrugën e Malësisë së Madhe. Ishte pranverë dhe gjatë grykës së lumit frynin erëra të forta. Po mbushja muajin që punoja dhe e njihja gati me pëllëmbë gjithë vendin, nga Leqet e Hotit deri në Vermosh. Isha i mërzitur që më dërguan aq larg. Përgjegjësi më kishte premtuar se do të më dërgonte atë vit buzë detit. Edhe Tiranën e kisha pranë, edhe detin (Pas një muaji fillonte sezoni i plazhit). Kurse këtej as që dukej shenjë për të hequr pelicën. E vetmja kënaqësi ishte kur dilja me Shpend Manin për të kapur trofta me kosh. Zhytesha në ujin e ftohtë të Cemit deri në gjunjë dhe, me një shkop të

gjatë, trembja troftat që fshiheshin nën gurë. Peshkimi me kosh ka diçka nga gjuetia kur shtyn kafshët e egra drejt pritës.

Atë mëngjes përgjegjësi më dërgoi për në Tamarë të merrja disa vegla. Në rrugë nuk kishte njeri. Ishte aq qetë, sa edhe zhurma e ujit që rridhte pranë një shtegu aty afër, dukej sikur vinte nga larg. Kur kalova urën e vogël prej dërrase dhe kapërceva një shkëmb të madh, i cili zgjatej deri te buza e lumit, më zuri syri katër mushka, dy kufitarë, një oficer dhe një grua që ecnin në drejtim të Tamarës. Mbi mushka kishin hipur dy djem të vegjël, flokëverdhtë. Fëmijët shikonin të habitur rreth e rrotull dhe, me siguri, nuk e kuptonin shkakun e atij udhëtimi aq të lodhshëm. Nxitova hapat dhe i arrita.

— Mirëmëngjes, — i thashë kufitarit që ecte me mushkën e fundit.

Ai ma ktheu përshëndetjen krejt ndryshe nga si ishte zakoni i atyre anëve, ku të pyesnin për lodhjen dhe mërzitjen që të jepte rruga, po ta bëje vetëm. Kufitari vetëm sa lëvizi buzët. Dhe nuk e di përse, mendova se ata e kishin bërë rrugën nga Vermoshi deri aty të heshtur. Mushkat ishin ngarkuar me orendi shtëpiake. E mora me mend se oficeri po transferohej. Zilet binin ngadalë dhe tingëllima e tyre e theksonte akoma më tepër heshtjen e grykës dhe të njerëzve. Njëherë mendova të ndaloja, gjoja sikur isha lodhur, dhe t'i lija të largoheshin e pastaj të nisesha edhe unë për në Tamarë, por nuk më bënin këmbët të ndahesha prej tyre. Kufitari që kisha në krah e kuptoi se u mërzita nga heshtja e tyre dhe më zgjati paketën e cigareve. Atëherë nuk e pija duhanin.

— Komandanti?, — i thashë kufitarit, duke bërë me kokë nga oficeri që ecte në krye.

Kufitari tundi kokën.

— Ku e kanë transferuar?

— Në Tiranë.

— Në Tiranë dhe është kaq i mërzitur?! Për veten

time, do të mërzhitesha sikur të më hidhnin nga Tirana këtu. Një muaj kam dhe...

Kufitari ndaloi dhe më pa me inat. E pashë se e kisha shkelur, por, edhe të zbutja përshtypjen që i lashë, nuk guxoja. Sepse vështrimi i tij nuk të linte të flisje duke fshehur diçka.

— Ke të drejtë, se nuk e njeh, — tha kufitari për habinë time me një ton të ngrohtë dhe të butë.

— Sa vjet bëri në Vermosh?, — e pyeta i lehtësuar.

— Dymbëdhjetë. Sot në mëngjes, kur u nda, qau. Babai qëkur isha i vogël më ka mësuar se burrat nuk duhen të qajnë. Dhe kisha menduar se ashtu duhej të ishte. Por sot e pashë se nuk ka pasur të drejtë.

Oficeri u kthye nga ne. Ishte i ri dhe me një fytyrë të njomë. Dhe mua m'u mbush mendja se ai mund të qante me tërë mend dhe të dukej burrë. Oficeri nuk na dëgjoi, por e kuptoi që po flisnim për të. Ndaloi dhe na priti. Në ato çaste nuk doja që të na afrohej, sepse kufitarit po i hapej goja. Për fat, oficerin e thirri njëri prej fëmijëve.

— Çfarë punon?

— Gjeometër.

— Dëgjo, gjeometër, burri në Vermosh njihet në janar. E komandantin e kam njohur në janar, — tha kufitari.

— E përse në janar?, — u habita unë.

— Sepse në Vermosh janari të do të fortë.

— Ju nga jeni?

— Nga Qeparoi.

Dhe tek ai kufitar i ri pashë diçka nga kaltërsia e Jonit të gërshetuar me ashpërsinë e Alpeve në dimër. Ky gërshetim i dha atij një pushtet mbi mua. Kishte atë që unë e doja, por nuk e kisha akoma. Oficeri përkëdheli flokët e djalit. U afrua edhe gruaja. Ne u kaluam pranë. U bëra kureshtar dhe i vështrova. Ata ua kishin ngulur sytë largësivë të mjegullta nga rridhte Cemi e nga duhej të ishte Vermoshi. Pas bërrylit gryka bëhej më e gjerë dhe qielli më i madh. Cemi më i qetë.

— Po çmallet për herë të fundit, — tha kufitari.

— Edhe ty, kur të lirohesh dhe të shkosh në fshatin tënd, ka për të të marrë malli, — i thashë.

— Fjalë është ajo!

Oficeri me gruan dhe djalin e vogël ecnin pas nesh. I kishim lënë ndonja njëzet metra.

— Që ditën e parë Vermoshi na priti me tufan. Ti nuk ke parë se si shfryn ai në Alpet. Lëre unë që vija nga Qeparoi. Të them të drejtën, thashë se a do ta përballoja, dot. Ndodhi që na nxorën me shërbim. Komandanti nuk na u nda tërë ditën e ditës. Lëvizte sa në një vend te tjetri. Dëborë deri në mes. Se si rezistonte, nuk e shpjegoj dot. Na ndërruan natën. Nuk më hahej, vetëm doja të shtrihesha e të flija, megjithëse nuk kisha vënë gjë në gojë. U shtriva. Tufani u tërbua më keq. Përplaste dëborën në xhama dhe tundte tërë kapanonin. Me shërbim do të niseshin kufitarët e vjetër. Kur po më kapllonte gjumi, më shpon në ije Lleshi. Ma bëri me shenjë të shikoja jashtë, nga perdia e hapur. Komandanti po nisej me ndërresën tjetër. Nuk e mbaj mend e sata ndërresë ishte. Sikur ma hoqi njeri me dorë gjumin. Më vinte turp të flija. Pashë se të gjithë nuk po flinin. Tufani shfrynte. Para portës, në oborr, dëborë hidhej e hidhej, si të ishte dallgë deti që thërrmohet pas shkëmbinjve. Mundoshesha të gjeja ku ishte komandanti. Por nuk dukej gjë tjetër përveç vorbullave të dëborës. Era reshti në mëngjes. Dolëm para portës. Kishin ardhur edhe shumë malësorë. Ishim në merak. Ata u kthyen tamam në kohë. Komandanti piu një gotë çaj dhe u nis me ne që merrnim shërbimin. Dhe qëndroi tërë ditën, deri në mesnatë.

Kufitari heshti dhe i ra me pëllëmbë mushkës. M'u duk sikur më harroi. E kuptova se isha njeriu i parë që ia tregonte ditën e tij të parë në kufi. Mund t'u ketë shkruar prindërve, por është ndryshe kur ia tregon dikujt dhe shikon reagimin e tij. Për të vërtetuar këtë, e pyeta:

— Ke shkruar ndonjëherë me lejë në shtëpi?

Nga pöshtë u dukën shtëpitë e Tamarës. Tani po e kuptoja atë që më tregoi im vëlla kur u lirua nga ushtria. Edhe ai e bëri ushtrinë në kufi, por në një pikë tjetër, në Jug. Unë i kërkoja të më tregonte se si kishte kapur shkelës kufiri. Se pse jetën në kufi e përfytyroja me të papritura të çuditshme, me gjurmë në dëborë, me sinjale misterioze, zogj që tremben menjëherë nëpër shkurre të dendura, me qen të stërvitur që të çojnë gjer buzë ndonjë përroi ku zhduken gjurmët, me reflektimin e diellit mbi ndonjë metal të nikeluar, e ku ta di unë. Po im vëlla s'më tregonte gjëra të tilla. Ai më tregoi disa herë për ditën e fundit. Dhe vetëm tani po e kuptoja përse ma tregonte vetëm atë ditë. Dhe ja si kishte ndodhur:

Kufitarët që do të lroheshin atë ditë, ishin grumbulluar në oborrin e bukur të pikës. Makina që do t'i merrte kishte ardhur që pa lindur dielli, sepse pika ishte pak larg. Ata duhej të ishin nisur prej kohësh, por askush nuk luante nga vendi. Komisari përpiqej t'u mbushte mendjen të hipnin në makinë. Kufitarët e liruar e dëgjonin, por nuk i kthenin përgjigje. Shikonin shtigjet nga nisëshin kur merrnin shërbimin dhe heshtnin. Shoqëruesi u shqetësua. Kufitarët po pengonin tërë shokët e tyre që tani duhej të ishin mbledhur në qytetin e vogël kufitar E.

«— Po mirë, edhe sa doni të presim? — u tha shoqëruesi kufitarëve.

— Pa ardhur komandanti, nuk lëvizim nga vendi.

— Po sikur të mos vijë fare sot?

— Nuk do të nisemi.

— Si, o, nuk do të nisemi? Pse, do të thyejmë urdhrin?

Komisari nuk bënte zë.

— Edhe sa do të presim, komisar?, — e pyeti shoqëruesi, i merakosur.

Po ja, presim edhe ndonjë orë. Po erdhi, mirë, në mos, nisuni.»

Dhe ata pritën. Shikonin relievin e dashur të tokës dhe, çuditërisht, tërë kujtimet e tyre atë ditë ishin të lidhura me komandantin. Dikujt i vinte në mendje shtegu i ngushtë i pyllit dhe ketrat që luanin duke kërcyer nga njëra degë te tjetra, kurse ata vëzhgonin. Dikujt i kujtohej e shoqja e komandantit, që u ishte bërë si motër, dikujt fëmijët. Pastaj kujtimet përplaseshin si vorbull dëbore dhe ti humbisje rrugën në bardhësinë e shqetësuar të dashurisë për shokun dhe vëllanë. Kufitarët prisnin. Gjatë viteve të shërbimit ata ishin mësuar me pritjen. Por kjo ishte krejt e ndryshme dhe krejt e paparashikuar. Ishte një pritje ku kufijtë e kohës treshin e nuk kishin relievin e tyre. Ata ishin të sigurtë se do të qëndronin ashtu gjatë dhe nuk kishin për të bërë as edhe një hap nga ai oborr i pastër, rrethuar me disa pisha si çadra me bisht të drejtë. Nën ato pisha kishin kaluar shumë nga ditët e tyre.

Ata panë radistin që po avitej i shqetësuar.

— Ç'është?, — pyeti komisari.

— Urdhërojnë të nisen menjëherë, — tha radisti.

— Shokë, e tepruam, — tha komisari.

— Nuk ka dhe lezet, kështu, mor shokë. Ju sikur keni ardhur sot dhe nuk e dini se shërbimi ka të papriturat e tij. Komandantit kushedi si i ka dalë puna. Pastaj, ju po pengoni tërë shokët që na presin në qytet.

— Ore Prengë, — iu drejtua një kufitar i liruar radistit, — thuaju si është puna.

— S'mund të shkelim urdhrin, o Nikollë, — ia ktheu kufitarit komisari.

— Pa u takuar me komandantin, ne nuk lëvizim, — tha i vendosur Nikolla.

Komisari mblodhi supet. Ai e dinte se ishte e kotë t'u ndërronte mendjen.

— Eja me mua, — iu drejtua komisari pas pak Nikollës.

Dhe bashkë me të u var poshtë pikës, drejt fshatit të vogël me dymbëdhjetë shtëpi. Po afrohej dreka dhe ata tani duhej të ishin duke udhëtuar drejt qyteteve të

tyre. Komisari me Nikollën nxitonin. Kaluan para çezmave të fshatit dhe trokitën në një shtëpi të vogël. Derën ua hapi e shoqja e komandantit.

— Është mbyllur në dhomë dhe nuk dëgjon të dalë, — tha e shoqja.

— O Agim!, — thirri komisari.

Askush nuk iu përgjigj.

— Edhe mua nuk më ka folur tërë mëngjesin. Që në darkë erdhi i mërzitur. As vuri gjë në gojë, po u shtri menjëherë.

— O, Agim! Jam Pandi, — tha përsëri komisari.

— Çfarë ka komandanti?, — pyeti i shqetësuar Nikolla.

— Nuk i bën zemra të ndahet nga kufitarët e li-ruar, — tha e shoqja.

Kur dëgjoji këto fjalë, Nikolla u sul me vrap drejt derës dhe thirri:

— Komandant, jam Nikolla! Kam ardhur të përshëndetemi.

Dhe Nikolla mbeti para derës si i ngrirë, sikur nuk dëgjoji zërin e tij, por heshtjen e pasdrekes. Doreza e derës lëvizi dhe në prag u dha komandanti. Ai përpiquej ta mbante veten, por, kur iu afrua Nikollës, nuk u përmbajti dot dhe iu hodh në qafë.

Kishim hyrë në Tamarë. Ndofta, diçka e tillë mund t'i kishte ndodhur edhe oficerit që transferohej nga Vermoshi.

— Eja të pimë një kafe, — më tha kufitari.

Shkova. Fëmijët e vegjël shkuan menjëherë tek ura. Ne u ulëm në kafën e vogël të Tamarës.

— Kur do të fillojë rruga?, — më pyeti oficeri.

— Këtë muaj.

— Ke punë të bukur, — më tha oficeri. — Si e pi kafën?

— Me sheqer.

— Na bëj pesë kafe, oj Lulë. Dy me sheqer dhe tri të meşme.

Kafet me sheqer ishin njëra për mua dhe tjetra për gruan e oficerit. Kufitarët rrinin të heshtur.

— Pas një muaji do të vij t'ju takoj, — tha oficeri. Kufitarët buzëqeshën si fëmijë të urtë. Lula na solli kafet. Shikoja komandantin, kufitarët, që përsëri nuk e fshihnin mërzinë e tyre, gruan që i mbante sytë nga fëmijët dhe mendoja për veten time.

[Faint, mostly illegible text follows, appearing to be bleed-through from the reverse side of the page.]

NET PRILLI

1.

Nonda nuk dëgjoi fare ç'i tha e shoqja, por, sa pa drejtorin që po zbriste drejt qendrës së sektorit, rrëmbeu sefertasin e torbën dhe u sul përjashta.

— O kryetar, o kryetar! (Edhe pse kishin dy vjet që ishin kthyer në fermë, Nonda i thërriste si atëherë kur ishin kooperativë.)

— Ë, mor Nonda, ç'kemi?

— Lëre, ta tregoj rrugës.

Drejtori e vështroi njëherë i habitur, pastaj hodhi sytë nga malet përballë. Moti po mbante i keq. Mbi fshat po ngjitej nga lugina një mjegull e dendur, e murme. Ajo shpërndahej vonë, duke lënë mbi degët e zhveshura të rrapeve, mbi barin e vogël dhe plisat e tokës lagështinë e saj që pikonte gjatë ditës e trishtuar. Ata zbritën rrugën e ngushtë, shtruar me gurë të bardhë, dhe ndaluan para klubit të mbyllur.

— Paska ardhur Guri, — tha i lehtësuar drejtori, kur pa shoferin që po i hidhte ujë makinës. — Hë, mo Nonda, ç'kishë për të më thënë?

Nonda e pa njëherë në sy, pastaj i largoi sytë sikur i vinte rëndë të fliste, dhe mblodhi kot buzët. Fshati po zgjohej me zor. Po mbante një kohë e tillë, sa nuk dallohej dot agullimi i ditës nga muzgu i

mbrëmjes. Kjo i jepte fshatit një pamje të dremitur. Nonda u vërtit nga u vërtit dhe ia nisi:

— Që thua ti, o kryetar, po bëhesha gati të bija të flija, se helbete lodhemi, kur lehu qeni im. Gjynah që nuk e more atë këlyshin që të dhashë vjet. Por sivjet e kam bërë me mend të të jap një se s'bën. E, pra, kur lehu qeni im, dhe ai nuk leh kot, thashë me vete se ndonjë jabanxhi e ka zënë nata te ne dhe fup, vishem. Fshati i vogël ne, thellë në male dhe, vetëm në pastë hall, vjen njeri. Si erdhi në fund të dhjetorit Kiçoja i Pandorës. Eh, u nis burri i botës nga ana e anës për dy kile arra, sikur u shua qyteti! Ia kishte mbledhur e shoqja. O dua arra nga të fshatit, o rashë e vdiqa! Sikur tonat janë, të rëna nga qielli! Kur ka gjetur, pse mos bëjë. Dhe ai, shushko mbeti derdimeni, pëlltumb, dhe i troket në derë s'ëmës. «Dua arra për Vitin e Ri», — i thotë. Sikur nuk e dinte se arrat nuk zunë fare këtë vit. Po e shkreta Pandorë përmbysi dynjanë dhe ia mbushi torbën plot. Tjetri kaq donte dhe të nesërmen, pa larë mirë sytë, krisi e iku. Vetëm ku ia kanë nevojën, kujtohen për fshatin tonë.

— Mor Nonda, unë e takova vetë Kiçon atë mëngjes dhe ai më tha se kishte ardhur të merrte t'ëmën që ta bënte me ta Vitin e Ri. Por plaka nuk luajti nga vendi, se zuri të qëmtonte dëborë, — tha drejtori i habitur nga ajo bisedë pa kuptim që i kishte hapur Nonda.

— Pse qëmtoi dëborë atë ditë?

— Posi! Dhe plaka kishte frikë se mos ftohej rrugës.

— Domethënë, paska ardhur për të marrë t'ëmën?

— Bile e kishte dërguar vetë e shoqja.

— Bukur ta paska hedhur, qerratai! Mor po janë bërë të zgjuar njerëzit sot! Paska ngulur këmbë e shoqja! Dhe kush pa, ajo që, kur vjen në behar, zë hundët me shami pa hyrë mirë në fshat! Sa shpejt që beson dhe ti, o derëbardhë! Kiçoja erdhi për arra dhe s'ka

burrë nëne të ma ndërrojë mendjen. Qëmtonte dëborë dhe i ftohej e ëma! Je i sigurtë që ra dëborë atë mëngjes, se mua nuk më kujtohet gjë?

Tjetri u mërzit dhe pa orën. Shoferi nuk po e ndizte dot makinën. Drejtori po bëhej nevrík. Pas pak u dëgjua si ulëriti motori. Drejtori la Nondën dhe shkoi drejt saj. Nonda e ndoqi pas.

— E, që thua ti, kryetar, kur lehu qeni im, dola të shikoja se ç'bënte vaki jashtë. Khan-xhin se pipëtitte njeri i gjallë. Mor, po roja, ku të jetë futur? E di se duhet parë në drejtori problemi i rojës.

Drejtori e vështroi me inat.

— Nejse, unë një mendim shpreha. E kam këtë huq, sikur vetëm mua më dhimbset fshati.

Shoferi afroi makinën pranë tyre.

— Ç'pati që nuk u ndez shpejt?

— Ftohtë, shoku drejtor, dhe i ka rënë pak bateria, — tha shoferi.

— Po ti ku i ke pasur sytë që i ke lënë të bien?, — iu hodh Nonda.

Shoferi tundi kokën sikur të thoshte: «Hej, bela!», dhe nuk i foli.

— Do të nisemi tani?

— Po.

Shoferi dhe drejtori hipën në makinë. Hipi dhe Nonda pas tyre.

— Se nuk ta bitisa fjalën, — tha ai me gjysmë zëri. Prania e një të treti sikur e kishte mpirë. — Khan-xhin jashtë. Qeni sa nuk këpuste zinxhirët. Tyt, i thirra, por ai në të tijën. Ham që ham! Zbrita shkallët dhe dola në rrugë. Mbrëmë të thante cikna. Isha veshur hollë. Ku tëk, më zënë sytë një njeri me elektrik dore që shikonte dyert.

Nonda heshti për të parë në po e dëgjonin me vëmendje apo jo. Shoferi ktheu kokën pas. Edhe drejtori lëvizi. Nonda u kënaq.

— I thashë çfarë donte aq vonë. Më tha se kërkonte shtëpinë e Paskal Ndrios. «E ç'e ke Paskal Ndrion?»

— e pyes. «Xhaxha», — më thotë. «Xhaxha dhe nuk ia di shtëpinë!», — i them i habitur. «S'kam ardhur ndonjëherë natën», — më përgjigjet serbes. Mua më kërcëu damari. «Përse nuk prite të gdhihej, pa të vije?». Ai qeshi. «Qenke i lezetshëm, ti xhaxho». «Shiko, — i them, — mos më shpjer në njëqind çezma ti, po më thuaj troç: përse ke ardhur?». Them të rri nja tre vjet në fshatin tuaj. Besoj se do t'ia kaloj mirë». «Pse kamp është fshati ynë?», — i them. «Ka hava të mirë,» — më thotë dhe pastaj shtoi diçka që më vjen rëndë ta mendoj e jo ta them me gojë.

Nonda heshti përsëri, por shoferi e kishte mendjen te gropat e rrugës dhe drejtori te koha që edhe atë ditë nuk dukej e mbarë. Mbi xham ranë dy pika shiu. Nonda u tërhoq në sedilje, si i fyer. Drejtori nxori paketën e cigareve, mori një për vete, i zgjati një dhe shoferit dhe e futi në xhep.

— Na jep dhe neve një, o kryetar, — tha Nonda si i fyer.

— Më fal, nuk e kisha fare mendjen.

— S'ka gjë, o kryetar, ke hallë të mëdha ti.

Në rrugë nuk dukej njeri. Makina hidhej nëpër gropa, duke spërkatur me baltë fierërat e thata dhe dëllinjat. Dushqet e mëdha dukeshin si të mërzitura që dimri po vazhdonte aq gjatë. Megjithatë, në dridhjen e lehtë të barit ndihej diçka e pakapshme nga ngrohja e kohës.

— Ku do të punoni sot?, — pyeti drejtori.

— Te qershitë, — tha i mërzitur Nonda, se e kuptoi që kishte grirë kot deri atëherë.

— I thuaj atij brigadierit t'i luajë pak duart, se jeni prapa.

— Mos ki merak, gjë që bëhet kjo, po asaj që më tha nipi i Paskal Ndrios si i bëhet.

— E, nxirre të shkretën!, — e ndërpreu shoferi.

— Pse, u mërzite, zotërote? Shiko o, timonin mos na hedhësh bashkë me kryetarin në ndonjë hendek, pa ka kush i zgjidh problemet. Oj, u bëmë si këmbët e

dhisë! I nipi i Paskal Ndrios, o kryetar, më tha se pas-kësh dëgjuar se fshati ynë na i paska vajzat e bukura dhe qejflesha. Do të jesh i poshtri i dynjasë, po nuk e caktove në ndonjë punë të rëndë që t'i bjerë bretku tërë ditën e ditës dhe pastaj le t'i shikojë vajzat tona në gjumë. Vjen i bini botës vullnetar dhe nuk e ka mendjen te puna, por...

Shoferi frenoi papritur. Nonda gati sa nuk u përplas pas kurrizit të drejtorit.

— Ku i ke mendtë ti, ore!, — tha ai.

— S'paska ardhur akoma njeri, — tha drejtori.

— Unë vij gjithmonë i pari.

— Po brigadieri?

— Epo është i ri, o kryetar, mos ia vër re aq shumë.

Kur të bëhet sa ne, edhe atë s'do ta mbajë dysheku. Po zbres unë, o kryetar, po shiko, ma thirr në zyrë atë nipin e Paskal Ndrios! Po të ketë ardhur për të punuar, të ulë kokën, në mos, udhë e mbarë i qoftë. O...

— Do të zbresësh tani?, — ia priti shoferi me inat:

Nonda qëndroi edhe pak si për inat të tij dhe zbriti. Makina u largua duke u hedhur nëpër gropa. Drejtori ndezi edhe një cigare.

— Të jenë të vërteta ato që tha Nonda?, — pyeti ai.

Shoferi mblodhi supet.

2.

Rrugët e shtruara me gurë të bardhë heshtnin, si të lodhura nga nata e gjatë e fundit të janarit. Ishte akoma errët dhe frynte një erë e ftohtë që të prishte fytyrën. Oxhaqet e para nisën të nxirrnin tym. Kërciti një derë dhe njeriu i parë që doli atë mëngjes ishte Nonda. Ai zbriti drejt zyrave të sektorit, atje ku drejtori linte makinën. Mibështetur te rrapi rrinte roja dhe ngrohej në prushin e zjarrit të fikur.

— Si u gdhive, Zoi?, — e pyeti Nonda.

Tjetri e përshëndeti duke trazuar hirin për të nxjerrë thëngjijtë e vegjël.

— Kryetari s'paska zbritur akoma?

— Po ty s'të paska zënë gjumi për kryetarin, a si?

— Hallet, Zoi, hallet s'e lënë njeriun e shkretë ta bëjë gjumin rahat.

— Po sikur nuk kam dëgjuar të jetë bërë ndonjë hata, o Nonda.

— Ti e ke mirë, se shikon vetëm punën tënde. Dhe mirë bën... Ore, Zoi, kam dashur të të pyes disa herë, po nuk më ka ardhur ylli. E ke parë ndonjëherë natën të nipin e Paskal Ndrios ti?

— Si nuk e kam parë! S'ka gjumë fare. Para një jave ishte i mërzitur. Erdhi dhe u ul, ja aty ku je ti. E pikasa menjëherë që nuk ishte në të. «Ç'ke»? — i them. «Asgjë», — më thotë. «Lëri ato, diç të ha përbrenda ty». Ai qeshi. Është djalë i urtë. «Kur u dogj shtëpia e nënës?», — më pyeti. «Në dimër të dyzetekatrës». «Më vjen keq që janë gërmadha». «Ç't'i bësh dushmanit?». «Po sikur të ngre një dhomë?», — më pyeti. «Ngrejë, — i them, — e ke shtëpinë e nënës». «Shkova përsëri sot, — më thotë, — dhe më pikoi në zemër. Trëndafilat ishin harbuar dhe do të jenë bërë të egër. Nëna i ka shumë qejf trëndafilat. Në verë le të vijë të rrijë me mua. Kështu që edhe çmallet». I thashë se e kishte menduar mirë atë punë. Ai s'foli më, po ia nguli sytë zjarrit. Seç kishte një brengë që e hante përbrenda. E pyeta mos kishte bërë fjalë me njeri. «Jo», — më tha. «Mos ma fshih mua, se më ke në këmbë të Katerinës», — i thashë. Pa, si u drodh djali kur i zura në gojë emrin e s'emës! Si gjethi i plepit kur çel. E më thotë se na e kishte thirrur drejtori dhe se i kishin rënë në qafë kot së koti. I thashë mos mërzitej, po ku dëgjonte ai! Çdo gjë i lë tragë.

Zoi trazoi përsëri hirin me shkop dhe nuk foli.

— Domethënë, e kishte thirrur kryetari?

— E kishte thirrur, e kishte thirrur, po ma thotë kjo e shkretë se i kanë rënë kot në qafë.

Fshati u zgjua. Në pranverë ai mbytej nga gjelbërimi. Në qershor kundërmonte erë trëndafilash. Ishte djegur disa herë, po gjithmonë mëkëmbej. Së bashku me shtëpitë digjeshin edhe trëndafilat, por ata lëshonin të parët sythat nën hirin e gërmadhëve.

Drejt tyre po vinte Guri, shoferi i drejtorit.

— Pyete Gurin, ai e di kur vjen kryetari.

— Lëre, dreqin. Është dhe nursëz, pa lë të tjerat.

— Si u gdhive, Zoi?

— Mirë. E di kur do të zbresë kryetari?

— Sikur ka zbritur, — tha ai dhe shkoi te makina.

Ata të dy e ndoqën me sy dhe nuk folën për një cast. I pari e theu heshtjen Nonda.

— Kështu, o Zoi, nipi i Paskal Ndrios ishte i mër-zitur, the?

— Do t'i ketë rënë, kot në qafë, se merr ngando-njëherë kryetari.

— Kryetari?!

— E, o, kryetari, po kush, unë?

— Domethënë, edhe kryetari e shkel, ë?, — tha Nonda.

Zoi nuk ia vari dhe në fytyrën e Nondës u end si një merimangë e trembur një buzëqeshje pa kuptim.

— Po lëviz pak, se u mpiva, — tha.

Guri ndezi makinën dhe e la ashtu që të ngrohej motori. Spiroja hapi klubin. Pastaj erdhi Gjergj Dollani të pinte një kafe para se të fillonte punën. Drejtori nuk po zbriste akoma nga shtëpia. Nonda pa orën e xhepit dhe u alarmua. Po i bëhej vonë për në punë, dhe atë ditë do të shkonin larg. E shoqja, me siguri, po e priste me bukën gati. Por atij nuk i bënin këmbët të largohej nga sheshi ku zakonisht drejtori nisej çdo mëngjes për në sektorët e shpërndarë të fermës. Mes mjegullës që po davaritej, bëri ballë dielli si një tepsi e kallaisur rishtazi. Gjallëria e zakonshme e fshatit pas shpërndarjes së njerëzve në punë u fashit. Nonda pa përsëri orën e xhepit. Siç dukeshin bathët, ajo ditë vdiq. Po dhe ky kryetari ç'dreq gjumë që paska! Apo e ka mirë ai!

Se mos i kërkon njeri llogari. Zoi po shkonte në shtëpi për të fjetur.

— Mos është gjë sëmure? — tha Nonda.

— Kush?, — pyeti i përgjumur Zoi, i cili e ndiente erën e shtratit që larg.

— Kryetari, kush tjetër!

— U kthye vonë mbrëmë.

— E në ç'orë u kthye?

— Në orën një, — tha Zoi dhe hyri në një shteg me fiq të egër.

3.

Shpërtheu gjethi i parë. Bari nuk mbulohej më nga bryma e bardhë, e ftohtë, por nga një vesë e hollë, sikur kishte mbledhur dritën e yjeve. Juga frynte në atë fshat dhe bënte gjatë natës një zhurmë të tillë, sikur sillte ison e një kënge të mbushur me lule që do të çelnin papritur, pa aguar mirë. Dhe një mëngjes thanat varën mbi degët e tyre lulet e vogla, të verdha, si zile që paralajmëronin se nata po shkurtohej. Pas tyre e kishin radhën bajamet, vishnjat, mollët. Dielli u shpërngul më në qendër. Në të çarat e mureve zogjtë po mermetonin foletë. Ndaj të gdhirë të një dite, kur ishte ende mugëtirë, u dëgjua një këngë e largët zogjsh shtegtarë. Po iknin patat e egra. Askush nuk i pa, po të gjithë e ndien si u drodh mëngjesi. Dhe ndoqën me mend fluturimin e tyre drejt visesh të panjohura. Dhe thoshin se edhe dëbora po shkrinte majave... Ndofta, patat i pa vetëm Zoi me Nondën. Ndofta, vetëm Nonda, kurse Zoi ka ngritur kokën lart dhe patat kanë shkundur mbi sytë e tij një copëz nga mjeguullat e Marsit. Fluturoi dhe vargu i fundit i patateve... Thonë se kanë rrugë të gjatë...

— Ikën patat, o Nonda, na erdhi behari.

— E përse tharton turinjtë, a derëbardhë? Nuk thua shqyrr që do të ngrohet koha dhe do të të bien kockat rehat.

— Nuk bën dot njeriu dy pare muhabet me ty, se gjithmonë do t'ia prishësh qejfin. Prit kryetarin til, — tha Zoi me inat dhe u bë gati të largohej për në shtëpi.

— Rri të pimë nga një kafe, se edhe Spiroja e hapi klubin.

— Më pret plaka. Pastaj, kam punë me shtëpinë e Katerinës.

— Po i biri nuk shkon në arë?

— Shkon. Kur vjen ai, iki unë.

— E ç'e do shtëpinë ai, për tre vjet ka ardhur?

— Pse flet kështu, bre Nonda? Ti nuk ke mall për shtëpinë e nënës?

— Kam, o, kam, po sesi më duket. Një njeri i vetëm të banojë në atë shtëpi të veçuar. Është beqar, i ri...

— E çfarë se është i ri?

— Kemi çupa, bre Zoi, kemi çupa.

— Ai është i ndershëm, si Katerina, mo Nonda. Gjynah të flasësh keq për të.

— Mund të jetë ashtu si thua zotrote, por kush i mbajti pishën në qytet. Ndofta, andej ka pasur ndonjë dhe nuk i rrihet dot pa femër. Prandaj më tremb ajo shtëpi. Apo nuk di dhe fjalë të bukura, rrufjani. Një natë po i thoshte së bijës së Dhori Veshit: «Shiko sa e bukur është hëna. Sikur ka varur njeri fener mbi degët e kajsisë». Çupa u shastis. «Pse në qytet si duket?», — e pyeti. «Në qytet duket si ndonjë mace kobashe që, pasi ka rrëmbyer ndonjë copë mish, hidhet tërë frikë nga tarraca në tarracë». Të është dukur ty ndonjëherë hëna si mace kobashe, hë, më thuaj?

Plaku mblodhi supet.

— E shikon? U trullose ti që je plak e jò më pastaj një çupë. Prandaj më tremb ajo dhomë.

— E ka shtëpinë e nënës, o Nonda.

— E, ore, se mos iu dogj xhani për shtëpinë e nënës atij!

— Po përse ta ngrejë, kur është për bukuri në shtëpinë e xhaxhait?

— Nuk e di, se është zor t'ia zbulosh njeriut mendimet e liga. Të ligat i fsheh, kurse të mirat i tregon.

— Po ai një natë më tha se sikur ka dëshirë të rrijë përgjithmonë këtu?... Pastaj folëm gjerë e gjatë për fshatin, për malin, për qershitë. E për çfarë nuk folëm atë natë. Apo s'ish tërë yje dhe frynte juga. Ai mbante vesh dhe fap, kërcente përpjetë. «Kështu buçet Kroi i Nuses, — thoshte. — Kjo është Koriya e Lisave».

I njihte sikur të ishte rritur këtu. Vetëm një njeriu që i dhemb ky vend, i njeh kështu. Se dhembka të mpreh veshin. Pastaj kënduam e kënduam me zë të ulët, sa na u mor fryma.

— Pité gjë?

— Jo.

Zoi hodhi pushkën në sup dhe u bë gati të largohej. Bëri dy hapa dhe u kthye.

— Më vrave, bre Nonda, më vrave me ato që më the!

— E çfarë të thashë, o Zoi?

Plaku u largua duke folur me vete. Nondës ai iu duk më i kërrusur se herët e tjera. Dhe thellë gjoksit ai ndjeu një të prerë të hidhur. Nuk e kuptoi se ç'ishte ajo. Kishte filluar ta ndiente se nipi i Paskal Ndrios ishte njeri i mirë. «Gjersa Zoi e do kaq shumë, dhe burrë më të ndershëm se Zoi nuk gjen, mos vallë e kam marrë kot inat. Ptu! Po, ç'e do shtëpinë? Ai beqar është, nga xhaxhai është...».

Dhe Nonda u nis për në punë duke folur me vete.

4.

Dhe atëherë kur nuk e prisnin, nëpër natë u dëgjua një fëshfëritje e lehtë, sikur era po sillte nga larg, në atë fshat, fluturimin e panjohur të patave të egra që shtegtuan javën e kaluar. Disa dolën jashtë, disa zgjatën

kokat në dritare. Dhe panë se po binte dëborë. U zbardhën çatitë dhe rrugët. Të rinjtë lanë provat e teatrit dhe nisën të luanin. Dëborë trëtej në gazin e tyre dhe, kush i shikonte, tundte kokën me një brengë të ëmbël. Seç kishte diçka rinore ajo dëborë, që shqetësoi ardhjen e pranverës! Mes dëborës së rrallë doli hëna. Pastaj fëshfëritja e bardhë pushoi dhe në sheshin para vatrës së kulturës mbretëroi një heshtje e thellë. Dhe një zë tha:

— Futemi, vazhdojmë provat.

Ishte e shtata natë që qëndronin deri vonë, kur të gjithë kishin bërë gjumin e parë. Derën e shtëpisë ua linin hapur. Ata hynin ngadalë dhe binin e flinin. Kishte nga ata që nuk i zinte gjumi dhe vërtiteshin nëpër shtrat, të shqetësuar. Dhe nuk e kuptonin se ç'ishte ai lëmsh që u mblidhej në gjoks, si një folë zogjsh. Dhe thoshin se fajet i kishte koha, që trillet e përkëdheljet i kishte aq të shumta atë vit. Deri vonë rrinte edhe Nonda. Mposhtte me zor gjumin që i rëndonte qepallat dhe priste mos ndalonte njeri sa për të bërë muhabet. Por të tjerët donin të flinin. Nga larg ia bënte me sy zjarri që ndizte Zoi, por bashkë e kishin prishur.

Kaloi dhe një orë. Të rinjtë dalën të gjithë së bashku nga vatra e kulturës. Vetëm një cipë e hollë dëborë kishte mbetur rrasave të çatave dhe gurëve të rrugës.

— Sa mirë që nuk ra shumë, — tha një zë vajze.

— Pse, moj Meropi?

«Ky është nipi i Paskal Ndrios», — mendoi Nonda.

— Se do të na prishte pemët. Kanë çelur.

— Pemët nuk mbajtën fare dëborë.

«Pse, mos doje, zotrote, të mbanin?».

Pikuan strehët pik-pik.

— Sikur ma hoqi njeri me dorë gjumin.

— Kur të vijë vera, ta shohësh gjumin, — tha një zë tjetër vajze.

«Ç'u ka shtënë zekthin të gjithave ky nipi i Paskal Ndrios!».

— Nesër duhet të ngrihemi herët.

— Do të më thërresësh kur të shkosh në punë, Nora?

«Dashke të të zgjojnë çupat, rrufjan! Nuk e ke keq ti, jo».

— Vetëm mos më lër të pres shumë, si e ke zakon.

— Tani u mësova ta kem të lehtë gjumin.

«Mirë ti që u mësove, por a e di kryetari që e bija të thërritka çdo mëngjes?».

Ata ndaluan para një shtylle elektrike.

«Këta s'paskan ndër mend të flenë fare sonte. Ç'dreqin kanë, s'është as behar! Atëherë, po, se të deh tërfili dhe të tërbon trëndafili i egër dhe mali bën një zhurmë, sikur këndon. Kurse sonte është tamam sikur të jetë kthyer moti për së prapi».

Dikush kishte hapur deri në fund radion që po jepte një këngë të vjetër.

— E keni vënë re që Radio-Tirana jep më të rrallë këngë të grupit tonë?

— Kanë dalë grupe më të mira, o Pilo.

— Të ngremë edhe ne një me pleq e të rinj, — tha nipi i Paskal Ndrios.

«Rri, o spurdhjak, rehat! Ti nuk ke mësuar t'i bësh hyzmet tokës, dashke t'i bësh këngës!».

Dhe papritur dikush nga të rinjtë ia mori këngës:

Ç'u mbush mali lule shumë...

Të tjerët zunë të mbanin iso. Kërciti një dritare.

«Ej, ç'do t'ua prishin këngën!», — i erdhi keq Nondës.

— S'paske gjumë, xha Sandri?, — e ngacmoi njëri.

— A po vjen dhe ti t'ia themi njëherë, — e pasoi një tjetër.

— Vij, o, si nuk vij, — tha xha Sandri që nga dritarja.

Dikush e largoi nga dritarja. Ishte e shoqja.

— Ma lini rehat, se kaq do ky. Po ju këndon, këndon.

Ata heshtën.

— Është vonë, — tha nipi i Paskal Ndrios.

«Punë e madhe se është vonë. Këngë paçim përherë», — tha Nonda me vete.

Ç'u mbush mali lule shumë..., — filloi prapë me një zë pak të ndruajtur, por të ngrohtë, nipi i Paskal Ndrios.

«Nuk ia thënka keq këngës, qerrata!».

Dhe papritur Nonda zuri të këndonte: *Mali u mbush lule shumë.../ S'janë lule, por yje.../ Kush i mbolli yjet?.../ Ajo që unë desha aq shumë... Ku e kishte kënduar këtë këngë? Kudo.*

— Kush je ti?, — i thirrën.

Ai u tremb. Jo se këndoi.

— Eja, mo, këtu!, — i thirrën përsëri të rinjtë.

Por Nonda u kthye në qoshen ngjitur dhe u largua. Dëbora e fundit bënte nën këmbët e tij krap-krup.

5.

Fshati mbante erë gjeth dhe jeshillëku të gudulishte. Retë u bënë të bardha, të dendura dhe në mbrëmje skuqeshin sikur merrnin flakë. Njerëzit i dehte era e tokës, kur i binte dielli i mëngjesit. Muzgjet mblidhnin tërë ngjyrat e ditës dhe i hidhnin mbi malet.

— Mirëmbërëma, kryetar. Shpejt u ktheve sonte.

— Epo, nuk do të mbetemi tërë ditën ugareve, o Nonda.

— Pimë nga një teke, se shkrihesh dhe me masën.

— Të ta jap unë, ama.

— Si të duash, nuk ta prish dot.

— Ata u ulën në tavolinat e nxjerra jashtë. Rrapi i lashtë mbulonte me degët e tij klubin e vogël. Frynte një erë e freskët.

— Si venë punët, o kryetar?

— Nuk jemi dhe aq keq.

Drejtori hodhi sytë poshtë, ku ishte blloku i qershive. Ato dukeshin si çadra të bardha. Pranvera kish-

te ngritur fushimin. Në çezmën përballë gratë mbushnin ujë dhe sec flisnin pa pushim. Drejtori humbi në mendime. Nonda mbeti me gotën e rakisë në dorë sikur kishte frikë mos ia prishte çlodhjen që i jepnin drejtorit qershitë e çelura. Nga dritaret e vatrës së kulturës u dëgjua një thirrje e fortë, pastaj pasoi një heshtje e lehtë. Disa fëmijë kishin hipur majë një kumbullë dhe ndiqnin provat e teatrit.

— Nuk e di, o kryetar, po mua nuk më pëlqejnë këto gjëra. Rrinë deri vonë.

— Mirë bëjnë, o Nonda, janë të rinj.

— Dakord, dakord, po sikur t'u vëmë orar. Ngandonjëherë e kalojnë edhe mesin e natës. Mirë djemtë, po çupat?

— Hiç mos ua ki hallin. I kemi të mirë. Hajde gëzuar!

— Gëzuar, kryetar, gëzuar. Po se të thashë një fjalë, nuk u bë gameti.

Nga dritaret e vatrës së kulturës u dëgjua përsëri një thirrje e egër.

— I dëgjon? Është nipi i Paskal Ndrios.

Drejtori qeshi.

— Ashtu e ka rolin, — tha.

— Ç'rol, mo, për kokën tënde! E ka zgjedhur apostafat rolin e gjermanit. Ai çirret sikur të jetë tamam gjerman. Sat bije i çirret. Shiko, kryetar, kur një mashkull i thërret kështu një femrë, ç'ç ka...

— Drejtori i fermës u nxeh, por e mbajti veten. Nonda e ndjeu se e kishte shkelur, por nuk dinte si të dilte nga ajo gjendje. Drejtori futi dorën në xhep.

— Spiro!, — thirri ai. — Hajde të paguajmë.

— Më fal që të lëndova, o kryetar, por për të mirën e fshatit e kam.

Drejtori pagoi dhe u largua. Nonda vërtiti gotën në dorë dhe e shtrëngoi aq fort, sa për pak e theu.

— Ç'pati që iku ashtu?, — e pyeti një burrë.

— Sepse kjo e shkretë nuk është në bina, — tha Nonda duke i rënë kokës me gisht.

Tjetri e pa i habitur.

— Pse, ç'i thua, mör katran?

— Lërmë për kokën tënde, or Gaqo!

— Hajde, ngrihu të shkojmë në shtëpi.

— Jo, po rri edhe pak.

— Mos u mërzit, or burrë, sikur nuk e njeh dhe ti kryetarin tonë! Nuk ta merr për ters ai, jo.

— E di që s'ma merr për ters, po...

— Hajde tani, hajde, se jemi për punë nesër.

— Shko ti, se po qëndroj edhe pak, pastaj do të ngrihem.

Gaqoja i dha dorën dhe i uroi natën e mirë. Pak nga pak klubi i fermës po boshatisej. Nonda mbeti vetëm. E ndiente veten si të dërrmuar. Nga vatra e kulturës u dëgjuan të qeshurat e të rinjve. Nondën e kapi një dëshirë e madhe të shkonte mes tyre dhe të mos u trembej si atë natë kur i ndiqte pas si një hajdut. Atë natë ata kënduan... Por sonte nuk i bënte zemra t'i dilte përpara nipit të Paskal Ndrios. I dukej sikur ai do ta kuptonte se kishte qenë pikërisht ai, Nonda, që i kishte sjellë andralla të kota. Por le ta shante (Nonda ishte i sigurtë se nipi i Paskal Ndrios nuk do ta shante), ai do ta dëgjonte pa e hapur fare gojën.

Papritur dikush nisi t'i binte fyellit mbi fshat. Nonda mbylli sytë dhe zuri e po e dëgjonte dhe iu duk sikur dëgjonte edhe zhurmën e rrëkeve, sikur shikonte thëllëzat që zbrisnin drejt burimeve nën dritën e yjeve...

Ç'u mbush mali lule shumë...

Nonda u përmend. Të rinjtë kishin mbaruar provat dhe po këndonin. Edhe Nonda nisi të këndonte me vete. Një ngazëllim çlodhës po i ngjitej gjymtyrëve. Nata nuk ishte si netët e tjera. Apo nuk ishte ai si netët e tjera. A thua?!

Ai rrinte dhe shikonte yjet. Nuk priste njeri dhe nuk e vinte re si kalonte koha. Të rinjtë dolën nga vatra e kulturës. Nonda nuk i pa. Shikonte yjet. Nata mban-te erë lule. Hëna e ngrënë kërkonte pjesët e humbura

krojeve, ku lëkundej si një petal rozë, bari zgjohej, një zë i largët dikë thërriste. Dhe ajo buisje ndjenjash që provonte Nonda nuk ishte thjesht jehonë e largët e rinisë së tij, por një ngazëllim prindi që solli mbi këtë tokë, në këto vise fëmijë që dinë t'i gëzohen natës dhe qershive të çelura.

— Toka, — tha ai me vete, — toka!

Dhe për herë të parë i erdhi keq sikur nipi i Paskal Ndrios të largohej nga fshati sa të mbushte tre vjet. Ai mendonte, ndërsa hëna kërkonte pjesët e humbura krojeve, luleve të natës, pikave të vesës, dhe ajri dridhej nga kënga e fyellit që binte e binte sipër fshatit.

FËMIJËT E VITEVE TË PARA

Ne u nisëm për në Laprakë kur i humbëm fare shpresat se do të na pranonin vullnetarë për në hekurudhë. Ishte errur dhe koha po prishej. Pas pak mund të niste shiu, sepse mbi Dajt tërë ditën ishin vërtitur retë. Nga deti frynte një erë e ftohtë që tregonte se vera kishte mbaruar. Faslliu veshi kapotën e gjatë që i vinte deri te kyçet e këmbës. Ai nuk kishte për ta hequr derisa të vinte pranvera. Kështu kishte ndodhur dhe vitin e shkuar. Kujdestari kishte dashur t'ia merrte me marifet, sepse ajo ishte shumë e vjetër, por Faslliu se ku e fshehu dhe askush nuk e gjeti. Atë ditë ne u çuditëm kur ia pamë prapë, por nuk i thamë asnjë fjalë.

Shtëpitë e fundit kishin rënë në gjumë. Unë prekesha kur shikoja si flinin shtëpitë e dëmtuara nga lufta. Gjumi i tyre ka diçka të ngrohtë, të afërme, çlodhëse. Ndofta ai është gjumi më i ndershëm. E kam provuar vetë këtë gjë. Ne të gjithë kishim dalë nga lufta dhe, pak a shumë, kishim diçka nga shtëpitë e rrënuara. Por njerëzit po i rindërtonin. I ndihmonim shpesh dhe ata na e dinin për nder. Edhe shtëpinë tonë të fëmijës e rregulluam për bukuri. Por ne nuk e harronim luftën. Ne i kishim inat ata njerëz që e harronin luftën. Pardje disa fëmijë gjetën në gërmadhat e një shtëpie një bombë italiane. Shkuan në Erzen për të vrarë peshq, por bomba i plasi njerit në dorë. Gëzimi, që fle ngjitur me mua,

zgjohet i trembur në gjumë dhe kërkon prindërit. Dje u largua nga shtëpia jonë e fëmijës Petriti. Erdhi e mori gjyshja. E kishte kërkuar plot dy vjet. Ata u larguan të zënë dorë për dore nga rruga e Durrësit dhe neve na u duk sikur u ndamë me një pjesëtar të familjes. U mblodhëm në shesh dhe askush nuk fliste. Por ishim të sigurtë se mendonim për të njëjtën gjë.

Fusha shtrihej para nesh e errët. Tërë rrugën nga qendra në shtëpinë tonë e bëmë pa folur. Ishim të mër-zitur. Gjithë ato ditë kishim jetuar me gëzimin e pranimit si vullnetarë. Nata e sotme do të na dukej e gjatë, sepse do ta kalonim pa gjumë. Në dhomë hymë pa zhurmë dhe u shtrimë pa u zhveshur. Vura duart nën kokë dhe zura të kujtoja fshatin. Ai është larg, mes maleve. Çdo luftë e ka djegur fshatin tim, por ai ka nisur përsëri jetën nga e para. Më pushtoi një mall i madh dhe doja të flisja me Gëzimin. Ai po flinte dhe mua më erdhi keq t'ia prishja gjumin.

— Edhe ti s'paskë gjumë?, — më tha Gëzimi.

— Jo, po ti fli, se ka vajtur vonë.

— Më vjen inat, sidomos me ty që s'më tregove.

— Po të shkoja, nuk të lija pa të marrë, megjithëse je i vogël. Nuk të lë vëllai ty vetëm, nuk të lë. Fli tani, fli, se u bë vonë.

Gëzimi ma dëgjoi fjalën: kishte shumë besim tek unë. E dëgjova që u kthye në krah dhe mbuloi kokën. Zura të mendoja përsëri për gjëra të ndryshme. Kishim shumë gjëra për të menduar. Ndofta ishim nga fëmijët e rrallë, që e kishim këtë të drejtë. Neve kështu na dukej. Nga anë të ndryshme të dhomës vinin pëshpëritje, si ajo gjuha e plepave tani në vjeshtë. Dhe, megjithëse asgjë nuk dëgjoja qartë, e dija përse pëshpërisnin.

— Petraq! O Petraq!, — më thirri Xhevati. — Hajde dhe ti.

Zbrita nga krevati dhe iu afrova. Në fund të dhomës ishin mbledhur Xhevati, Arshiu, Vathi dhe Guri.

— Mos keni vendosur t'ia mbathim fshehurazi!?, — u thashë me inat.

— Jo, mo, dhe ti! Ku të shkon mendja!, — m'u përgjigj Guri.

— Se ti seç lllomotite kur po ktheheshim.

— Kot, mo, kot. Edhe po të ikim fshehurazi, do të na kthejnë përsëri këtu.

— Atëherë ç'keni që nuk flisni?

Vathi lëvizi dhe m'u afrua.

— E di ç'kemi vendosur?

— Jo.

— Meqenëse nuk na pranuan si vullnetarë, të bëjmë diçka dhe ne, sepse s'ka lezet të rrimë duarkryq. Vullnetarët nisen pas një jave. Ne mendojmë që, kur të na japin fruta, të heqim një pjesë të racionit tonë për ata. Nesër bëjmë nja dy arka të mira dhe i mbushim plot.

— Çfarë, o, dy arka!, — tha Guri. — Mos ke ndër mend të na turpërosh!

— Jo, po më vajti gjuha ashtu.

— Unë them të bëjmë njëqind.

— Janë shumë dhe s'i mbushim dot.

— Po sa atëherë?

— Sa të mundim.

— Unë s'kam për të vënë kokërr rrushi në gojë, — tha Arshiu.

— Po e morën vesh vullnetarët se i kemi hequr nga goja, nuk do t'i pranojnë. Prandaj nesër caktojmë sa do të hamë vetë dhe sa do të heqim për vullnetarët. Mirë?

— Mirë!, — thamë të gjithë dhe shtrënguam duart.

— Hej, ju aty në fund, ç'keni që nuk flini?

Ishte Koçoja. Ai ishte një vit më i madh nga ne. Në fillim donte të hiqej si komandant dhe të na urdhëronte, por ne ia mblodhëm. Të gjithë ishim njëlloj. Ai i vari turinjtë nja dy ditë, por e kuptoi se s'kishte asnjë të drejtë të ishte mbi ne. Koçoja ishte i shkathët dhe i fortë. Ndoshta prandaj donte të bëhej dhe komandant. Kur shkua të regjistroheshim për në hekurudhë, ai shtoi nja dy vjet. Neve na erdhi inat që gënjeu, por nuk treguam. Por dhe gënjeshtria s'i piu ujë.

Sot na e prenë shkurt se asnjë prej nesh nuk do të shkonte në hekurudhë. Koçoja na erdhi pranë dhe ne ia treguam vendimin tonë. Ai ishte shumë dakord.

— Nesër që në mëngjes ua themi të gjithëve, — tha Vathi. — Tani hajde të flemë.

U shpërndamë nëpër vendet tona. Unë u futa ngadalë, mos i prishja gjumin Gëzimit. Ai nuk kishte lëvizur fare. Nesër mund të binte shi. Plepat zgjasnin degët e tyre deri në dritare. Mua më pëlqente të rrija kështu pa lëvizur dhe të dëgjoja si trokiste një degë e hollë në xham. Gëzimi lëvizi.

— Petraç, s'më ke më shok, ë?, — tha ai i prekur.

— Si s'të kam shok?

— Po pse s'më tregon se do të shkosh në Durrës?

— Jo, — i thashë, — nuk do të shkoj në Durrës.

— Bëj be!

— Për kokën tënde.

— Po përse të donte Xhevati?

Unë ia tregova dhe vetëm kur iu betova disa herë, ai u qetësua. Duhej të kishte kaluar mesnata. Mua m'u duk sikur retë ishin çarë dhe kishin dalë yjet. Ato më ngjanin edhe si ftonj, edhe si mollë. Dhe sikur kështu më kishte ngjarë përherë. Ftonj, mollë, rrush. Sytë po më mbylleshin dhe, sado që përpiqesha t'i hapja, s'kisha më fuqi. Më dukej sikur yjet po zbrisnin poshtë dhe unë i pandehja si mollë. Zgjatesha t'i këpusja, por ato përsëri ngjiteshin lart. Pastaj dëgjova zhurmën e karrocës që na furnizonte. Ajo ishte mbushur plot. Ne u mblodhëm rreth xha Kostës dhe filluam të shtyeshim kush të shkarkonte arkat. Kur po i gëzohesha ëndrrës, dëgjova Gëzimin. Ai ishte çuar mbi dyshek. U tremba.

— Fli, — i thashë, — fli, është akoma natë.

— Seç pashë një ëndërr, po s'e mbarova dot.

— Fli, — i thashë, — fli. Ndoshta e shikon tani.

Gëzimi u shtri dhe pas pak dëgjova frymëmarrjen e tij të qetë. Mbi xham trokitën pikat e shiut. Ishte shiu i parë i vjeshtës së vitit 1947.

2.

Të nesërmen e gjithë shtëpia jonë e fëmijës ziente nga gëzimi. Mblodhëm dërrasat dhe bëmë arkat. Që ditën e parë mbushëm dy. Bëheshim gati katërqind fëmijë. Tirana ziente. Ne asnjëherë nuk e kishim parë aq të gjallë. Peçit, kur i dha lek një kushëri, shkoi në pazar dhe bleu fiq. I solli dhe i futi në arkë. Prisnim drekën vetëm për të ndarë racionin e frutave. Ne dëgjonim se të gjithë po mblidhnin gjëra për vullnetarët. Kush jepte batanije, kush këpucë, kush brisqe. I thashë Fasliut të jepte kapotën, por atij i vinte keq. Dhe nuk e ngacmuam më. Një ditë ai erdhi vetëm me trikon e leshtë. Ne e kuptuam dhe e lamë të qetë. Unë e dija se kapotën ia kishte falur një partizan kur u çlirua qyteti i tij.

Oborri ushtonte nga zërat e fëmijëve. Era çonte lart gjethet e rëna. Ato shpërndareshin fushës. Dita po zvo-gëlohej, dhe ne mblidheshim herët nëpër dhomat.

Numëronim arkat dhe na dukej sikur s'kishim mbledhur gjë prej gjëje. Arkat i mbanim në fund të dhomës, poshtë dritareve. Gëzimi se ku gjeti pak bojë të bardhë dhe i leu dy prej tyre. Mbas nja tri orësh erdhi Andoni me një kuti tjetër bojë vaji. Atëherë arkat na u dukën më të bukura. Vathi u ngjiti nga një pllakat. Ishim të kënaqur. Të nesërmen niseshin vullnetarët. Ndaj të ngrysur në dhomë hyri Koçoja. Mezi qëndronte në këmbë. Ishte me kanotiere. Xhaketën e kishte mbushur plot me mollë dhe rrush. Ai çau mes nesh dhe lëshoi xhaketën mbi arkën e fundit, që ishte përgjysmë. Mori frymë i lehtësuar dhe u ul buzë krevatit. Atëherë u kujtuam se ai ishte zhdukur tërë ditën nga shtëpia e fëmijës.

— Futini, — tha dhe u shtri.

Ai kishte sjellë aq fruta, sa duhej edhe një arkë tjetër. U bëra gati t'i hidhja në arkën e mbushur përgjysmë, kur më zuri dorën Vathi.

— Prit, — më tha. — Ku i gjete gjithë këto mollë dhe rrush?, — iu drejtua Koços serioz.

Koçoja u çua përgjysmë dhe mbeti si i ngrirë. Edhe ne nuk e prisnim ndërhyrjen e Vathit. Koçoja na pa në sy të gjithë me radhë. Para gjashtë muajve, ja kështu si sonte, në gati sa nuk e përjashtuam nga shtëpia jonë, sepse kishte vjedhur fiq. Ai na dha fjalën se nuk do të vidhte më. Kishte mbetur pa prindër që tre vjeç. Dhe disa njerëz të këqij, e kishin, mësuar të vidhte. Por atë kohë Koçoja na dha fjalën se nuk do të prekte gjë me dorë. Dhe nuk kishte venë më dorë mbi gjërat e huaja. Ne e ruanim. E kishte vështirë të ndahej nga vjedhja, por sa vinte dhe po e harronte zanatin e vjetër. Po të kishte vjedhur edhe sonte, nuk do të kishim mëshirë. Partizanët të pushkatonin, po të prekje një kokërr rrush, e jo të vidhje një kosh. Kështu i kishim thënë përpara gjashtë muajve Koços, megjithëse nuk ishim të sigurtë si do të vepronim. Pandi, një djalë i druajtur dhe i zbehtë, të cilit ne i jepnim nga racioni ynë që të shëndoshej, ishte strukur në një qoshe tërë frikë dhe kishte thënë se lufta pat mbaruar. Atëherë qemë nxehur edhe më tepër me Koçon dhe ia kishim përsëritur se, po të vidhte, do ta pushkatonim.

Në dhomë ra heshtja. Rrinim si të ngrirë. Si do të përgjigjej Koçoja?

Ai mori frymë thellë dhe tha:

— Nuk i vodha, Vath, jo. Kam punuar tërë ditën si kalë duke mbajtur koshat e fshatarëve. Nuk u mora lekë, po fruta.

Ai zbuloi kurrizin dhe ne pamë si i ishte skuqur dhe i ishte rrjepur vende-vende lëkura. Vathi i dha dorën dhe e puthi.

— Nuk të mbetet hatri që të pyeta?

— Jo.

Ne u çliruam nga një ankth i madh dhe i dhamë dorën njëri pas tjetrit Koços. Ai gati sa nuk qante.

— Ti, me siguri, nuk ke ngrënë fare bukë, — tha Faslliu.

— Më ka ikur uria, dua vetëm të fle.

— Petraç, shko në kuzhinë dhe merr pak gjellë.

Unë vrapova. U futa në kuzhinë dhe i tregova xha Ramadanit si qëndronte puna. Ai donte rregull, por, kur dëgjoi për atë që kishte bërë Koçoja, më mbushi pjatën plot. Edhe çajit i hodhi dy kokrra më tepër sheqer. Kur u ktheva në dhomë, aty ishte aq qetësi, sa m'u duk sikur kisha ngatërruar dhomën. U bëra gati të flisja, kur Vathi më bëri me shenjë të rrija urtë. U afrova tek arkat në majat e gishtërinjve. Koçon e kishte zënë gjumi. Shokët ia kishin hequr këpucët dhe e kishin mbuluar me tri batanije. Vura pjatën mbi arkat. Gjella lëshonte avull dhe po ftohej ngadalë. Neve na erdhi keq t'ia prishnim gjumin. Atë natë bëmë një arkë të re. Ndofta gëzimi që provuam me atë arkë ishte më i madhi. E lyem me ngjyrë të kuqe. Për të fjetur, ramë aty nga ora tre, po, kur u gdhi, na u duk sikur s'kishim vënë gjumë në sy. Koçoja flinte dhe ne i morëm arkat pa bërë zhurmë. Mbi Dajt akoma s'kishte dalë dielli. Fusha po zgjohej, duke hequr cipën e hollë të mjegullës nga trupi i saj. Kishim parë shumë herë si zgjohej fusha, por sot ajo na dukej më e bukur dhe më e afërme. Xhadeja ishte e qetë. Ne i vumë arkat buzë xhadesë. Shtëpia jonë e fëmijës flinte. Shokët nuk ishin zgjuar të gjithë. Makinat dhe vullnetarët do të niseshin nga ora tetë.

- Të shkoj të zgjoj Koçon?, — i thashë Faslliut.
- Sa është ora?
- Gjashtë e një çerek.
- Lëre të flejë dhe pak.
- Mos zemërohet?
- Është i lodhur dhe ka nevojë për gjumë. I nxorëm të gjitha?
- Po, s'ka mbetur asnjë.

Dita ishte pak e vrenjtur. Fasliu ishte vetëm me triko. Duhej t'i gjenim një pallto. Mua m'u kujtua kapota. Isha i sigurtë që ai e kishte dhuruar për vullnetarët.

- Ç'më shikon kështu?, — më tha Fasliu.

— Kot, kot, — iu përgjigja shpejt e shpejt dhe, pa e ditur as vetë, e pyeta:

— Mos ke ftohtë?

— Jo. Sot do të më japë kujdestari pallto.

Nuk e di në më gënjente për të më shmangur, por e besova. Ai u largua për nga arkat. Ishte i prekur. I rregullonte dhe përsëri ndërronte mendje. E lashë aty dhe shkova të zgjoja Koçon. Ora po i afrohej shtatës. Ishin zgjuar të gjithë. Atë mëngjes e prishëm orarin e ngrënies. Kur shkuam në xhade me Koçon, të gjithë ishin rreshtuar gjatë saj. Këndonin dhe bënin shaka. Mëngjesi me freskinë e tij kishte hyrë në sytë tanë. Aty nga ora tetë u bëmë pak nërvozë, makinat s'po dukeshin të vinin.

— Mos janë prishur?

— T'u thaftë goja, t'u thaftë!

— Janë të vjetra dhe të dala nga lufta. Nuk u duhet zënë besë makinave të gjermanit.

— Atëherë të nisemi për në Tiranë.

— Ç'flet dhe ti! Ato sikur kanë ardhur. Nuk i dëgjon, apo të kanë lënë veshët?

Në të vërtetë, nga qyteti seç ushtonte, por neve edhe na dukej si zhurmë makine, edhe si zhurmë centrali.

— Po sikur të mos ndalojnë fare, por vetëm të na e bëjnë me dorë?

— Si s'na kishte shkuar kjo në mendje? Të bllokojmë rrugën.

Pastaj filluam të bisedonim se çfarë do t'u thoshim vullnetarëve. Asnjëri nuk ia shkreppte. Rrinim si të ngrirë. Si s'ishim pregatitur më parë? Njëri prej nesh duhej të mbante patjetër një fjalim të shkurtër. Më caktuan mua, sepse lexoja më shumë libra. Unë kundërshtova, por ata thanë se ky ishte urdhër. Nisa të vrisja mendjen, por nuk më mblidheshin dy fjalë bashkë.

— S'ka nevojë për fjalime. U themi punë të mbarë

dhe pikë, — u thashë, mbasi u sigurova se do të mbesha si gugaç para vullnetarëve.

Në këtë kohë u duk makina e parë. Vullnetarët këndonin. Në radhët tona filluan të shtyheshin. Ne dolëm në mes të xhadesë. Sapo makina ndaloi, e rrethuan dhe zumë t'u shtrëngonim duart vullnetarëve. Vathi hapi derën e makinës.

— Kush është komandanti?, — pyeti.

— Unë, — tha një djalë i ri rreth të njëzetave me fytyrë të njomë.

Vathi mbeti i habitur. Me siguri komandantin e përfytyronte më të madh dhe me mustaqe. Komandantët në gjithmonë i përfytyronim me mustaqe.

Vathi u kthye nga unë, si të më pyeste në ma mbushte edhe mua syrin ai djali i njomë për komandant, apo jo. Unë ngrita supet.

— Ç'kishit?, — tha djali.

— Domethënë, ti je komandanti?

— Po.

— Ne jemi të shtëpisë së fëmijëve. Kemi mbledhur disa arka me fruta për ju.

Komandanti u prek. Ai doli jashtë dhe hipi mbi kabinë. Makinat kishin ndaluar njëra pas tjetrës. Komandanti ua bëri me dorë të mbanin qetësi. Heshtën.

— Shokë vullnetarë! Këta fëmijë kanë mbushur disa arka me fruta për ne. I kanë hequr nga goja e tyre. Unë i falënderoj nga ana juaj, por mendoj që ata t'i hanë vetë.

— Po, — thanë vullnetarët.

Atëherë Vathi hipi mbi kabinë dhe thirri që ta dëgjonin të gjithë:

— Mos na i ktheni, se ne nuk i marrim. Do të na mbetet qejfi. Pastaj, po t'i hani ju, sikur i kemi ngrënë ne. Apo jo?

— Po!, — thamë të gjithë dhe, pa pritur urdhër tjetër, filluam t'i ndanim arkat në çdo makinë. Vullnetarët na puthnin dhe na përkëdhelnin flokët me dashuri vëllai.

MPOSHTJA E NJË NATE

Që kur u hap Ploça e Re, nga Ploça e Vjetër nuk kalon më asnjë makinë dhe, ndofta, unë jam shoferi i vetëm që nuk e kam braktisur. Sidomos kur mbaron vera, e kam vështirë të mos i bie nga Ploça e Vjetër. Ajo është prishur mjaft nga ujërat dhe vende-vende ka mbirë bari. Mua më duket sikur asaj i vjen keq që e kanë lënë pa zhurmat e makinave, që i kalojnë përbri. Por unë, gjersa ajo të bëhet e pakalueshme, nuk kam për ta braktisur, sidomos në ditët e fundit të verës. Sepse në ditët e fundit të verës të Ploça e Vjetër mposhta frikën e një nate. Po të më kishte mposhtur nata mua, sot nuk do të isha shofer dhe do të më vinte turp edhe nga ajo copë rrugë. Se njeriut, për të arritur atje ku do, i duhet gjithmonë të mposhtë një copë natë që të ngjitet pa e kuptuar as vetë. Copa e natës që unë theva ishte frika. Dhe frika, më shumë sesa me natën, nuk ngjet me asgjë tjetër.

Ëndrra ime e parë ka qenë të bëhesha shofer. Dhe kjo nuk ishte si ëndrra e çdo fëmije. Isha rritur nën erën e benzinës dhe të naftës. Babai, xhaxhai (që bantonte me ne, se nuk kishte fëmijë) dhe im vëlla ishim shoferë. Edhe unë pasditet e lira dhe tërë pushimet e verës i kaloja nëpër makinat e tyre. Dhe mezi prisja sa të rritesha e të merrja edhe unë makinën time. Por,

po të mos e kisha mposhtur atë natë, sot mund ta kisha humbur përgjithmonë këtë ëndërr.

Po bie mbrëmja. Lashë në të majtë rrugën e asfaltuar dhe ktheva makinën për nga Plloça e Vjetër. Te gështenja e parë ndalova dhe zbrita më shumë për të sjellë ndër mend atë natë, sesa të çlodhesha. Nga liqeni po fryn një fillad i lehtë. Seç ka diçka të pakapshme fillimi i vjeshtës në periferi të Pogradecit. Kushedi sa herë jam përpjekur ta gjej dhe nuk e kam gjetur dot. Ndofta ka pjekjen e mollëve, ndofta ka ja, këtë erë të lehtë që fryn nga liqeni. Ndofta. Por prapë e ndiej se nuk janë këto. Ndofta ka atë natë kur unë mund të kisha humbur ëndrrën për t'u bërë shofer. Kjo ka ndodhur para pesëmbëdhjetë vjetësh, por unë e kujtoj deri në hollësitë më të vogla.

Atë ditë-ishte fundi i gushtit — po ktheheshim nga Elbasani. Ishte udhëtimi i fundit, sepse pas dy ditësh filloja shkollën. Shtatorin e kam pritur me një farë trishtimi, që më është ngjitur edhe tani, sepse ai më hiqte ndjenjën e lëvizjes, pa të cilën mërzitësia. Babai ngiste makinën dhe nuk e kishte mendjen fare nga unë. Bënte zagushi.

— Këtëj qenka tamam sikur po nis vera, — thashë.

Babai qeshi dhe tha:

— Është fushë, prandaj.

— Kaq vapë në qytetin tonë është në korrik.

— E ç'do të thuash me këtë?

— Mos kushedi këtëj shtatori vjen më vonë.

— Njëllor vjen, njëllor.

Ndofta babai më gënjente nga frika se mos kërkoja të iknim nga qyteti ynë malor dhe të vinim këtëj, në fushë, ku, sipas mendjes sime, edhe pushimet duhej të ishin më të gjata.

— Qyteti ynë nuk është hiç i mirë, — thashë i mërzitur.

— Përse?, — u habit babai.

— Se aty, po ra një shi në gusht, vish pallton dhe, o burra, në shkollë!

— Mos, — tha babai, — mos fol kështu për qytetin.
Ai nuk ka të sharë.

— Posi, posi! Aty pasnesër fillon shkolla.

— Kudo pasnesër fillon shkolla.

Nuk fola më. Dhe papritur m'u kujtuan shokët, nëna, lepujt e bardhë dhe sesi më erdhi, sikur i kisha tradhtuar. Kujtova të papriturën e bukur të dimrit, kur zgjohesh në mëngjes dhe shikon çatitë e mbuluara me dëborë. Kurse këtu, në fushë, atëherë ka vetëm shi dhe shi. Sa gjë e mërzitshme duhet të jetë shiu i vazhdueshëm! U mata t'i them babait se e dua pa masë qytetin tonë, aty rrëzë malit, por nuk dija si t'ia nisja. Babai e kishte mendjen te rruga. Për çudi, atë ditë askush nuk po ia zgjaste dorën makinës sonë.

— Ishalla nuk na zë shiu tek e Përpjeta e Madhe!, — tha babai.

— Pse?

— Kam frikë se nuk do ta ngjitim dot.

— Aty nuk ka baltë.

— Prapë xhiron.

Tani kisha para syve vetëm të Përpjetën e Madhe. Kur të bëhesha shofer, nuk do t'ia kisha fare frikën. Kisha dëgjuar se në dimër era hidhte aty shumë dëborë, bile edhe babai kishte ngelur një natë të tërë, por unë do ta çaja se s'bënte dhe do të dilja në majë të qafës. Dhe përfytyroja veten në timon.

— Ç'bën kështu?, — u habit babai.

Siç dukej, po ngisja makinën me mendje, sepse duart më ngrinë sikur kisha përpara timonin.

— Ej, dreq, — tha babai, — edhe ti shofer më ngjan se do të të bëhesh, sikur kemi marrë me tapi këtë zanat. S'ka ç'të duhet timoni ty, shiko librat.

— Jo, — i thashë.

— Nejse, ka kohë. Po qe kësmet, bëhu dhe ti shofer. Tani shiko mos më turpërosh në shkollë.

— Mirë, — i thashë.

Ai u qetësua nga fjalët e mia dhe mua nuk më vinte më turp të ngas makinën time imagjinare, të shkel

gazin, të marr kthesat me shpejtësi dhe të ndërroj marshet me lehtësinë më të madhe. Nuk mjaftonte vetëm zhurma e makinës së vjetër të babait, po bëja dhe unë me gojë. Babai qeshte me lëvizjet e mia. Doja që ai udhëtim të mos mbaronte kurrë. Gati sa nuk fluturoja nga gëzimi. Dhe ja, nga larg pashë të Përpjetën e Madhe. Mbi të kishte re.

— Ej, sikur ta kalojmë pa shi!, — tha babai.

— Në shi nuk dalin thëllëza, — u mërzi ta dhe unë.

— Hallin e thëllëzave kemi mangut tani!

Më kishte rastisur që nja dy herë të shikoja thëllëza, atje ku mbaronte e Përpjeta e Madhe. Dhe më dukej se, sa herë të kaloja andej, patjetër që thëllëzat do t'i binin mes për mes xhadesë e do të futeshin në pyllin me dushqe të shkurtra. S'ka shpendë më të bukura se thëllëzat, sidomos sqepin e kanë flakë të kuq, sikur nxitojnë të ndezin diku zjarrin e fikur. Sikur të na dilnin dhe sot dhe të kapnim ndonjë!

Hijet po ngjiteshin nga fusha. Po kalonim nga vera në vjeshtë. Tani makina ecte nëpër luginën e vogël. Pas pak fillonte ngjytja. Babai ndezi cigaren dhe e vërtiste nëpër gojë. Motori uturinte. Kishim ngarkuar çimento. Xhadeja ishte e thatë. Lagështia e mbrëmjes akoma nuk po ulej.

— Ua kam frikën atyre reve, — tha babai.

Mbi të Përpjetën e Madhe retë ishin ulur akoma më poshtë.

— Shkelja!, — i thashë.

— Kaq ngre virania!

— Ama dhe ti, nuk more që nuk more një makinë të re!

— Nuk e lë dot, bre Niko. Kemi luftuar bashkë!

— Po mirë, o, të gjithë kanë marrë makina të reja. Edhe babai i Llaqit, edhe babai i Kiços, edhe i Dhorit. Pse, më të mirë se ti janë ata?

— Jo, — tha babai, — po ja që nuk më ndahet xhani kollaj nga ajo.

Nuk e kuptoja dot këtë dashuri të babait për ma-

kinën e tij rrangallë, që i kërciste tërë karrocera si një teneqe e ndryshkur, prandaj dhe nuk i jepja të drejtë. Makina ngjitej si breshkë. Kur iu afruam së Përpjetës së Madhe, mbi xham ranë pikat e para. Dhe, kur prisja që babai të shqetësohej, ai zuri të vërshtëllente një këngë që e këndonte nëpër dasma. Bile, kisha dëgjuar kur njerëzit u thoshin sazexhinjve të merrnin njëherë këngën, e Petros (kështu quhej im atë). Babai i futi makinës marshin e parë dhe ndezi dritat. Xhadeja ishte lagur, asaj që ia kishte frikën im atë.

— Më mirë të binte me gjyma, se ta shpëlante kështu asfaltin, — tha ai.

Po ngjitim të Përpjetën e Madhe. Babai gati sa nuk e hëngri bishtin e cigares. Makina u drodh dhe rrëshqiti pak nga e djathta. Babai manevroi shpejt e shpejt dhe përsëri ajo eci shtruar. Mblodha duart grusht e i shtrëngoja. Harrova se aty mund të dilnin thëllëza, harrova gjithçka, përveç metrave që hanin dhëmbët e rrotave të makinës. Ajo ngjitej dhe ngjitej. Babai çlirroi pak nga pak nofullat e shtrënguara dhe pështyu bishtin e cigares. Kur e kaluam të Përpjetën e Madhe, ai nisi të puthte timonin e makinës.

— S'më le dhe këtë radhë në baltë, moj plakë, s'më le!

Babai, që nuk kishte puthur ndonjëherë as vëllanë, as motrën, as mua që isha më i vogli, puthte timonin sikur të ishte njeri.

— S'kisha hallin tim, moj plakë, por hallin tënd. Po të mos e haje këtë radhë të përpjetën, do të të lija, se mjaft u lodhe. Po e shoh se edhe ty nuk të ndahet shpirti nga unë. Sikur dynjaja të përmbysët, tani nuk të lë.

Babai e puthi përsëri timonin dhe qeshi me zë të lartë. Qesha dhe unë. Më erdhi keq që e kisha sharë pak më parë makinën e vjetër që tani zbriste e lehtë si pendë nga maja e qafës. Ajo vërtet ishte e vjetër, po, ama, maloret i përpinte.

— Tani arritëm, — tha babai.

Po nga e Përpjeta e Madhe deri në qytetin tonë duheshin edhe dy orë, në mos më shumë. Rruga ishte fushore dhe përpara kishim vetëm një malorë të vogël. Por atë do ta kalonim me një dorë. Dritat çamin errësirën dhe mua më mbuloi përsëri trishtimi i mbarimit të pushimeve të verës. Kushedi kur do të më merrte me vete përsëri babai!

— Ç'ke që m'i vare turinjtë një pëllëmbë?

— Hiç.

Babai më tha të haja fiq. Largova fierërat që mbulonin shportën dhe nxora dy kokrra. Një ia zgjata babait. Ai u kënaq.

— Përse të mos bëhesh doktor?, — më pyeti.

— Nuk më pëlqen.

— Po mirë, këtij zanatit tonë ç'i pëlqen kaq shumë?

Mblodha supet.

— Kur nuk e di, atëherë kot që të bëhesh shofer. Bëhu më mirë doktor, që, kur të sëmurem, të më shërosh.

— Ti nuk do të sëmuresh.

— Ç'na the! Edhe makina që është hekur e vjen një ditë dhe na lë shëndenë e jo unë që jam njeri.

— Ti je më i fortë, sepse je shofer, — iu përgjigja.

— Po ma bën qejfin, pizeveng!

— Nuk ta bëj qejfin hiç.

Në liqen pasqyrohej hëna, drejt së cilës ecnin disa re të hirta.

— Si thua, do të çlodhemi pak në Pogradec?

— Kot që të vonohemi. Tani as nuk lahesh dot.

— Mirë e ke. Dhe tët ëmë ka filluar tani ta hajë merakun për djalin.

— Ajo bën kot, sikur të jem bebe.

— Mos ia vër re shumë. Kështu e kanë të gjitha gratë. Për hiçgjë lebetiten, sikur është bërë thagma.

— Kushedi, kur të marr makinë, nuk do të flejë fare.

— Do të flejë, se atëherë ti do të jesh bërë burrë.

— Pse tani nuk jam?

— Nuk e di, — tha babai dhe qeshi i kënaqur.

Në qoftë se ai udhëtim do të kishte mbaruar si kishte nisur, tani do ta kisha harruar. Pikërisht sa filluam të ngjithnim Plloçën e Vjetër, ndodhi ajo që as babai, as unë nuk e prisnim. Makina ecte ngadalë. Kur iu afruam Gështenjës së Madhe, tërë makina u drodh dhe shpërtheu uji. Babai tërhoqi menjëherë frenat e dorës dhe zbriti poshtë. Dëgjova që po u vinte rotave gurë. U zgjata nga dera, po nuk e pashë dot. Hënën e kishin mbuluar retë dhe jashtë ishte errësirë e madhe. Gështenja tundte degët me një zhurmë të frikshme. Ngriva në derë. Nuk merrja vesh se ç'bëhej. Gjithçka ndodhi shpejt e shpejt. Babai kontrolloi makinën nga të katër anët dhe erdhi brenda në kabinë.

— Do të nisemi?, — e pyeta.

— Ku?

— Në Korçë.

— Sonte do të flemë këtu. Na u thye semiaksi.

— Po deri në Korçë nuk vemi dot me semiaks të thyer?

— Hajde shofer, hajde. Asnjë centimetër nuk lëvizim dot.

— Po sikur të na rimorkojë ndonjë makinë.

— S'na rimorkon dot. Nesër lajmërojmë oficinën për të na sjellë një semiaks të ri.

U mblodha pas derës dhe se pse më kapi një frikë e pakuptueshme të hidhja sytë jashtë. Degët e gështenjës trokisnin mbi kabinë. Nuk kisha fjetur kurrë jashtë.

— Çohu të të rregulloj vendin për të fjetur, — më tha babai.

U struka akoma më shumë në sedilje. Babai diçka kuptoi, se më futi në gji dhe më përkëdheli flokët.

— S'kemi fjetur kurrë bashkë, — më tha me mall.

Por unë isha nën pushtetin e një frike të papritur dhe nuk dalloja gjë. Errësira — sterrë e zezë. Asnjë dritë shtëpie pranë. Rruga pa lëvizje. Dhe thashë atë që duhej të mposhtja:

— Nesër duhet të jem që në mëngjes në shkollë.

— Mos, more!, — tha babai. — Tani s'para ka makina këtej. Ndofta ke fat. Kështu, nesër duhet me doemos të jesh në shkollë?

— Po.

Për herë të parë po e gënjeja babanë. Dhe ai më besoi. Më përkëdhelte flokët dhe më thoshte me një zë të ëmbël, që s'kam për ta harruar kurrë:

— Ja, ja, sikur ka kaluar ndonjë makinë.

Por rruga ishte e qetë. Gështenja më dukej si një qenie e dalë nga përrallat. Ajo trokiste vazhdimisht mbi llamarinën e kabinës dhe më fuste të ngjethura.

— Përse nuk vjen edhe ti?, — e pyeta babanë me gjysmë zëri, si fajtor.

Babai im i mirë nuk dyshonte për asgjë.

— Nuk e lë dot vetëm makinën. Mos u bëj merak për mua, jam mësuar. Të keqen babai sa m'u rrite!

Nuk e di ç'e shtynte tim atë të më fliste aq ngrohtë atë natë, si s'më kishte folur kurrë. Dukej sikur më kishte takuar pas një kohe të gjatë. Mua më vinte për të qarë. Po e gënjeja dhe po e lija vetëm mes rrugës.

— Kur të vish nesër në shtëpi, do të flemë bashkë, — i thashë, më shumë për të qetësuar veten, se babanë.

— Kësmet, — tha ai. — Kisha qejf sonte, por derisa është puna për shkollë, të ikësh. Si nuk po vjen ndonjë makinë, ta marrë dreqi.

Dhe, kur po matesha t'i thosha të më rregullonte se do të flija me të, u dukën dritat e një makine. Tani, edhe të doja të rrija, nuk më linte babai. Për shkollën ai nuk të faltë. Mua m'u zu fare goja.

— Erdhi!, — tha babai dhe doli jashtë.

Mbeta përsëri vetëm. Errësira dhe gështenja nuk më frikësonin më. Dhe nata po më dukej ndryshe. Po të flija aty, edhe shokëve kisha ç't'u tregoja. Kurse unë po ikja dhe për këtë do të heshtja. Babai bisedoi me shoferin dhe hapi derën e kabinës.

— Eja, — tha. — Mamasë i thuaj se do të fle në Pllaçën e Vjetër.

— I kërceva në qafë dhe qava pa zë.

— Nuk më gjen gjë. Është mësuar yt atë.

Më puthi tërë mall dhe u ndamë. Më humbi nga sytë sa bëmë dy metra më tej. Sa më shumë që largohesha nga ai, aq më e rëndë bëhej për mua ndjenja e braktisjes. Ishte diçka e rëndë që më mpiu. Ishte braktisja ime e parë dhe e fundit. Kur ngjitëm Pllaçën e Vjetër, babai ndezi dhe fiku dritat si të na uronte natën e mirë. Sikur të zbrisja dhe të shkoja drejt tij! Ne ramë në një dishezë dhe nuk i pashë më dritat e makinës së babait. U struka në qoshe dhe nuk flisja. Edhe shoferi rastisi një burrë i heshtur. Nata rëndonte mbi supet e mia të njoma me tërë peshën e saj. Nuk kishim fjetur kurrë bashkë me babanë! Tani ai po shtronte velenxën e kuqë prej leshi dhe para gjumit, me siguri, do ta ndizte një herë. Mua nuk ka për të më ardhur gjumi fare. Po të flija me babanë, ai nuk do ta harronte kurrë këtë natë. Më vinte inat me veten. Nga frika, jo vetëm që po braktisja ëndrrën time më të bukur, por po lija vetëm edhe babanë. Gati sa nuk ia dhashë të qarit, por i mbajta lotët me zor nga turpi.

— Si e ke emrin?, — më pyeti shoferi.

— Niko.

— Në ç'klasë vete ti, Niko?

— Në të shtatën.

— Siç duket, do t'i bëhesh me shkollë Petros. Po ç'të pëlqen të bëhesh?

— Shofer.

— Ashtu? Ama, po u bëre shofer, o ngjaji tyt eti, o mos u bëj fare.

Kaq doja që të mos i mbaja më lotët. Shoferi më vështrroi i habitur.

— Ç'ke që qan?, — më pyeti.

— Nuk po qaj, — i thashë, — por mbaje makinën. Shoferi shkeli menjëherë frenat.

— Ç'ke ndër mend të bësh?, — më pyeti.

- Do të kthehem te babai.
- Po e kemi lënë shumë prapa.
- S'ka gjë, do të shkoj më këmbë.
- Nuk ke frikë?
- Jo, — i thashë.
- Mos më gënje!
- Nuk jam mësuar të gënjej.
- Po përse ndërrove kaq shpejt mendje?

Ula kokën. Por nuk mund ta gënjeja. Dhe i tregova për frikën që më kapi te Gështenja e Madhe, kur babai më tha se do të flinim në makinë atë natë. Kur mbarova së treguari, shoferi nuk më foli fare, por ktheu makinën në një vend të gjerë dhe e nisi andej nga sapo kishim kaluar. Në majë të Plloçës ndaloi.

— Tani shko më këmbë, se s'kam ku ta kthej makinën, — më tha.

Ai donte të më provonte. Por unë kisha kaluar provën më të vështirë, mposhtjen e vetes, dhe asgjë nuk më bënte përshtypje. I dhashë dorën dhe zura të zbrisja poshtë nëpër errësirën e natës, që sa vinte dhe dendësohej. Nga larg pashë dritën e zbehtë të kabinës së babait. Ai nuk kishte fjetur akoma, sikur ta dinte se unë nuk do ta lija kurrë vetëm. Asnjë dritë nuk më është dukur deri më sot më e ngrohtë, më e dashur dhe më e afërme. Ecja drejt saj dhe për herë të parë m'u duk sikur ditët e fundit të verës aty, në periferi të Pogradecit, seç kishin diçka të veçantë. U përpoqa ta gjeja, po nuk e gjeta dot. Ndofta kanë pjekjen e mollëve, ndofta aty më shumë se kudo ndihet fillimi i vjeshtës, që është aq e bukur në periferi të Pogradecit. Ndofta... Ndofta më duket mua kështu, se diku në mes të Plloçës së Vjetër, që tani është e braktisur, filloi burrimi im.

E megjithatë seç kanë diçka të veçantë ditët e fundit të verës në periferi të Pogradecit...

KUR TË KTHEHESHA ME LEJE

Ula me kujdes valixhen, sikur kisha frikë mos prishja qetësinë e atij korridori të heshtur, të thjeshtë, dhe nuk guxoja të trokisja. Lexova kushedi për të satën herë emërtimin e zyrës që disenjatori e kishte punuar më merak të madh, më shpresë se isha gabuar. Gjithçka më dukej si ëndërr, sidomos prania ime në atë kantier të largët. Së bashku me mua sikur kishin ndalur para asaj dere të punuar shpejt e shpejt edhe ditët e viteve të mia. Edhe ato qëndronin të habitura dhe të hutuara dhe nuk e kuptonin ç'kërkonin aq larg shtëpisë ku nisën jetën. Më shumë se kurrë isha në një gjendje të tillë, sa edhe ngacmimi më i vogël mund të më prekte dhe të më shtynte të ndërroja mendje. Bile edhe dërrasat e pastazhionuara mirë të dritareve, që nuk puthiteshin plotësisht, më trishtuan. Dhe vetëtimthi m'u shfaq rruga e mëhallës e shtruar me gurë të zinj, fëmijnia e shkujdesur, zogjtë, dëbora, e parë dhe një shoqe që na u fejua në vitin e tretë të shkollës. Ajo sikur ndau kufijtë e moshës sonë. Nuk ishim më të vegjël. Ndofta, më duket tani kështu. Veçse më është ngulitur thellë vështrimi i saj dy javë para se ta fejonin. Sesi më vështronte, sidomos kur ishim në laboratorin e kimisë dhe rrinim përballë njëri-tjetrit. I fejuari ishte rrobagepësi më i mirë i qytetit tonë. Shoqet pëshpëris-

nin se ai i kishte qepur Vasilikës (kështu quhej shoqja jonë) një fustan që të lije mendtë e kokës. Por unë nuk e pashë kurrë të veshur me atë fustan. Dhe tani e kujtoj vetëm me përparësen e zezë me jakë të bardhë. Edhe kur u fejua dhe uleshim në laboratorin e kimisë, sa haste vështrimin tim të shkujdesur, ajo turbullohej. Më vinte keq, se në trembjen e saj nga unë, më dukej sikur kishte një trishtim të heshtur, të thellë, tamam si muzgu kur bie mbi çatitë e vogla, të kuqe të qytetit tim malor kur mbaron vjeshta dhe oxhaqet lëshojnë tymin e parë të dimrit.

Nga brenda u dëgjua kërcitja e karriges. Ajo më shkëputi nga këto kujtime të çuditshme. Trokita. S'm'u përgjigj njeri. Prita. Pastaj trokita përsëri.

— Epo, hyr, se e morëm vesh, — foli dikush nga brenda.

Nuk dija si të bëja: të hyja me valixhe apo ta lija jashtë. Ngaqë isha i hutuar, ngeca mes derës, sepse nuk më linte valixhja.

— E, o derëbardhë, ç'e ke humbur kështu!, — qeshi burri, që duhej të ishte drejtori i kantierit. — Afrohu, afrohu. Ashtu, de! Ulu tani. Hë, ç'e mirë të pruri?

— Ata të kuadrit më thanë të vij te ju për të filluar punën. Bile ata më thanë se, sa të vija unë këtu, do t'ju kishin marrë në telefon, — fola me gjysmë zëri.

— Për telefon nuk ua kalon njeri atyre të kuadrit. Nuk e marr vesh, xhanëm, ç'e kanë tërë këtë qejf t'ia bëjë telefoni xërr! Nejse. Domethënë, ti do të fillosh punën në kantierin tonë?

— Po.

— Deri këtu bukur. Ku ke punuar më parë?

— S'kam punuar gjëkund. Mbarova shkollën e mesme.

— Këtu e dreqose. Domethënë deri më sot të ka ushqyer yt atë, apo jo?

Mbeta i habitur nga toni i atij burri të ashpër. Ai m'i mbërtheu sytë sikur kishte frikë mos ia hidhja.

— Ke mësuar ndonjë zanat në shkollë?

Kam bërë pak për traktorist.

— Hë, dhe traktoristin kishim mangut! Janë në bina ata të kuadrit apo si? Unë u kërkoj muratorë, ata më dërgojnë traktoristë. Ja, si thua ti, ku t'i fut unë traktoristët? Apo të lërojnë oxhaqet?

Po më dukej çudi që ai ishte drejtor. Kisha një përfytyrim tjetër për drejtorët: sikur ishin të rëndë, që nuk lejonin të diskutonin në sytë e vartësve për shefat e kuadrit. Kështu ishin të paktën drejtorët e shkollave ku kisha mësuar deri atëherë. Kurse ky njëherë e zinte shtruar, më të butë, kur fap, i kërcente një damar dhe shante me zë të lartë. Prisja të më kthehej edhe mua e të më thoshte pse s'kisha vazhduar universitetin, pse nuk isha bërë murator, apo kushedi së çfarë. U çua me rrëmbim dhe shkoi te dritarja.

— Afrohu këtu, — më tha. — E shikon atë oxhakun atje? Hë, e shikon, apo jo? Atje do të punosh. Do të takosh Muço Mollën, brigadierin, dhe do t'i thuash se të dërgova unë. U! kokën dhe bëj ç'të thotë ai. Sakën se dëgjoj ndonjë gjë për ty! Mos më dil fare përpara!

Edhe më vinte për të qeshur, edhe seç ndieja diçka që më trondiste përbrenda. Herë më dukej sikur ai i drejtohej dikujt tjetër, herë mua. Më dha dorën dhe më tha:

— Hajde, mos e merr me frikë!

— Nuk e kam marrë me frikë, — i thashë.

— Lëri, mor, dënglat! Sikur nuk e kemi filluar dhe ne ndonjëherë punën!

Mora valixhen dhe u bëra gati të dilja nga zyra. Drejtori u ul në tavolinë dhe filloi të merrej me një regjistër të madh. Kisha menduar se do të më përcillte deri te dera. I hodha një vështrim, sikur ta kujtoja për këtë, por ai nuk e kishte fare mendjen tek unë. Dola. Dhe m'u duk sikur kisha hyrë gabimisht në atë zyrë. Ecja drejt oxhakut dhe as që shihja përreth. Për herë të parë u inatosa me babanë. Si nuk qe i zoti

të më rregullonte një copë punë në qytetin tonë! Me t'i thënë për në këtë kantier, fap, pranoi menjëherë. Tani do të isha duke u kthyer për në shtëpi. Nëna do të hiqte gjymin nga soba dhe do të më hidhte ujë të lahesha. Pastaj do të ulesha të haja. Nëna do të kënaqej, duke më parë të rritur. Do të rrija pak shtrirë me këmbët nga soba, do të lexoja ndonjë roman të ri dhe do të dilja mos takoja shokët. U pengova pas disa hekurave dhe mend rashë. «Ptu!», shava dhe hodha sytë mos më pa njeri. Po rruga ishte e shkretë. Oxhaku, që nga zyra e drejtorit dukej sikur ishte aty afër, tani sikur largohej. S'kisha ngrënë që në mëngjes. U ula mbi një piring me tulla dhe nxora një biskotë. Nëna... Të ishte për nënën, nuk ndodhesha tani këtu, po ç'ti bëj babait. Një t'i thënë kryetari i lagjes dhe, hop, pranoi. S'ka faj kryetari, jo, kur gjen njerëz si im atë, se për vete i bie gjoksit pastaj: «Kaq kam dërguar në kantierin e...» Hëngra dhe një biskotë dhe nuk më bëhej të ngrihesha.

Ishte fundi i shkurtit dhe koha ishte e paqëndrueshme. Atë ditë frynte një erë e ftohtë dhe retë shtyheshin nga perëndimi drejt lindjes. Në këtë kohë në qytetin tim ato shtyheshin nga veriu drejt jugut dhe mund të lëshonin reshje, dëborë. Këtu kisha dëgjuar se nuk binte fare dëborë. Përsëri m'u kujtuan vitet e shkollës, kur thërrisnim njëri-tjetrin dhe niseshim duke çarë të parët dëborën. Tani u rritëm. Ata shkuan në universitet, kurse unë po filloj punën në këtë kantier. Kisha qenë nxënës i dobët në matematikë dhe fizikë. I mora me mërzi që në klasën e pestë dhe kështu vazhdova deri në fund të shkollës së mesme. Mësuesi i fizikës më quante njeri me vullnet të dobët. Unë nuk e pranoja. Lexoja deri vonë, sa më digjnin sytë, romane. Por edhe këtë ai e merrte si mungesë vullneti. Deri më sot nuk e kuptoj përse mendonte kështu. M'u kujtua përsëri shoqja që më vështronte me trishtim në laboratorin e kimisë dhe që nuk erdhi në maturë, sepse u martua me rrobaqepësin më të mirë të qytetit tonë.

Qëndrova mbi pirgun me tulla gati një gjysmë ore dhe nuk vura re se po errej. Nxitova drejt oxhakut. Kur arrita aty, pashë nja dhjetë burra që po laheshin duke ngacmuar njëri-tjetrin.

— Kush është Muço Molla?, — pyeta njërin që m'u duk si më i riu.

— E ç'e do Muçon?

— Më kanë caktuar të punoj në brigadën e tij.

— Ashtu? Bukuri! O Muço, të kërkon ky djali.

— Po le të vijë.

Muçoja ishte një burrë i gjatë dhe i hequr. Ishte ulur para një barake prej dërrase dhe pinte duhan. I dhashë dorën dhe ai më liroi vend në një stol të mbërthyer pas barakës. I thashë se më kishin caktuar të punoja me të. Më mati me sy dhe pastaj papritur më hodhi dorën në sup. Më pyeti për gjithçka. Iu përgjigja i mërzhitur. Kushedi sa vetë më kishin bërë të njëjtat pyetje të pashmangshme. Punëtorët hynin në barakë me peshqir hedhur kraheve dhe më buzëqeshnin.

— A je rregulluar për të fjetur?, — më pyeti Muçoja.

— Sonte do të shkoj nga vajza e tezes, në qytet.

— Ia di shtëpinë?

— Nuk kam qenë ndonjëherë, por tezia më dha adresën dhe m'u lut t'i shkoj.

— Rri këtu sonte, pa ke kohë për t'i shkuar. Or Gani! Nuk vete të flesh nga pallatet sot?, — i tha Muçoja punëtorit më të ri.

— Përse?

— Të flerë ky në krevatin tënd. Është i lodhur dhe nuk ka njeri në qytet. Ka një vajzë tezeje, por nuk ia di as shtëpinë. Nesër i tërheqim dhe këtij një krevat.

— Mirë, — tha Ganiu. — Hajde të të tregoj ku do të flesh.

— Shko, — më ra në shpatull Muçoja.

Baraka ishte e vogël, me krevate dyshe. Në mes ishte një sobë prej fuçie.

— Këtu, — tha Ganiu. — Çarçafët i ke të pastër. Fli pa merak. Valixhen lëre në dollapin tim.

— Po Muçoja ku fle?, — e pyeta.

— Pse do të flesh pranë Muços?, — qeshi Ganiu.

— Jo, — thashë i habitur edhe unë nga pyetja që bëra.

— Ngjitur e ke. Është burrë i mirë.

— Ej, ju, do të dilni të hamë apo si?, — thirri nga jashtë Muçoja.

— Nuk është shpejt?, — e pyeta Ganiu.

— Kështu hamë, që të flemë herët. Nesër do të çohemi pa gdhirë.

— Po ju zë gjumi?

— Kur jemi të lodhur, na zë, kur nuk na flihet, ia kërcasim muhabetit shtrirë.

Të gjithë po niseshin për në mensë dy e nga dy. Unë u tërhoqa mënjanë. U dëgjoja zërin dhe vetëm nga ai i njihja. Ishin në qejf. Sepse m'u duk sikur isha kthyer aty pas lehtës së zakonshme. Ata ikën. U ula në fronin që kishin bërë para barakës. Korpuset gri humbën siluetat e tyre. Pranë tyre po niste jeta ime e pavarur. Kisha humbur në një topitje të ëmbël, kur shikoj Ganiu, që po vinte me vrap.

— Ç'harrove?, — e pyeta.

— Ty të harrova. Më bëri qepaze Muçoja. Çohu!

— Nuk më hafet.

— Mirë, mirë. Mos, ha, po hajde rri me ne, se kush e dëgjon Muçon pastaj!

— Prit pak, — i thashë dhe hyra brenda. Hapa valixhen dhe nxora qesen prej pëlhure të bardhë, që nëna ma kishte mbushur me biskota dhe mollë dhe që mua më kishte ardhur turp ta merrja.

— Ç'e ke atë?

— Asgjë.

Ata kishin porositur edhe për mua njëloj si për veten e tyre. Në darkë e kisha bërë zakon të pija çaj.

— Bëj naze sot, se nesër ke për t'i përllarë, — më tha një burrë me mustaqe.

Mbarova i fundit. Kur po ngriheshim, u shpërnda-

va nga një biskotë e nga një mollë. Më uruan punë të mbarë. Njëri tha se do të më martonte aty. Qesha. Tjetri më quajti rrufjan që i pëlqen nusja.

Kur dolëm nga mensa, po frynte një erë e ftohtë. Sikur ta kishim bërë me fjalë, të gjithë ngritëm jakat, kush të palltove, kush të pardesyve e kush të peliçeve. Muçoja ndaloi dhe pa qiellin. Ai me siguri që nuk dalloj gjë, por përsëri tha:

— Ku e gjeti të prishej sonte koha. Gano, ke marrë dru?

Ngaqë ishte errësirë, nuk e dallonim mirë njëri-tjetrin. Edhe se ku ishte Ganiu, para apo pas meje, nuk e dija. Ai nuk po përgjigjej.

— Ke marrë dru për sobën apo jo?, — pyeti përsëri Muçoja.

— Jo, usta, — u përgjigj mu pranë meje Ganiu.

— Po pse?

— Mendova se kaq e pati dhe dimri, usta.

— Si, o, kaq e pati! Jemi akoma në shkurt.

— Po ti mos u bëj merak, o usta. Ja, shkoj tani me Neritanin dhe të sjell sa të duash.

— Mirë, po mos u vononi.

U nisa me Ganiun. Unë mbusha krahët me dru, kurse ai mbushi dy kova me qymyr.

— Ky të mban tërë natën ngrohtë, — tha Ganiu për qymyrin.

Shokët po na prisnin para barakës. Dikush pinte duhan, dikush bisedonte, dikush mendohej. Ndezëm me Ganiun zjarrin dhe nuk e vumë re se soba e kthente tymin. Drutë ishin prej pishe dhe të gjithëve na pëlqeu era e tyre. Para se të shtriheshim, Muçoja na ndau secilit punën për nesër. Unë do të rrija pranë tij. Drutë u ndezën mirë dhe Ganiu hodhi qymyrin sipër tij.

— Natën e mirë!, — na tha dhe iku.

— Natën e mirë!, — iu përgjigjëm.

Sapo u shtriva, sikur ma hoqi njeri me dorë gjumin.

— Je rehat?, — më pyeti Muçoja.

— Po.

E pyeta përse flinin në atë barakë. Më tha se e kishin ngritur pranë oxhakut për të mos humbur kohë nga pallatet deri aty. Kishin dhënë fjalën që ta mbaronin oxhakun në mes të tetorit. E kuptova se për të fjala e dhënë ishte diçka më shumë, sesa mund të mendoja unë.

— Se, po të duash të njohësh një njeri se sa është burrë, shikoje sa e mban fjalën e dhënë. S'është puna vetëm te fjala. Kur ke mundësi ta bësh një punë sa më parë, bëje, bre, qerrata!

— Si dukeni deri tani?

— S'ta përcaktoj dot. Para nja dy javësh më erdhi një gazetar me syze. Ishte sa ti. Seç më pyeti, nuk e mora vesh. Ngandonjëherë këta gazetarët nuk merren vesh se ku duan të dalin me pyetjet që të bëjnë.

— Kushedi sa gazetarë ke njohur!

— Edhe ti do të njohësh, mos ki gajle. «Kur të mbarojmë oxhakun, hajde, — i thashë gazetarit. — Po ta kemi mbajtur fjalën, shkruaji nja dy rreshta, në mos, nxije». Se nuk ka lezet, bre, Neritan, të ngrihesh para të gjithëve dhe pastaj të të vijë turp t'i shikosh në sy. Njeri tha se Muçoja e bën për t'u dukur. E kujt do t'i dukem! Asnjërit, bre, asnjërit! Më sëmboi këtu dhe nuk më zuri gjumi. Se e di sa rëndësi ka ky oxhak? Nuk e merr dot me mend. Nejse, nuk e ngava. Ama, kur një pusht po llapte se goja e bëkam për t'u shqepur në lekë, ia ngjesha turinjve. E di, ja, sikur që tani të lë punën, rroj si s'ka më mirë. Edhe një punë sa për t'u eglendisur e gjej në qytetin tim. Po atëherë ç'ke, që i bie tjetrit në qafë kot? Oj, e bën Muçoja për lekë! Sikur do t'i shtrojë kalldrëm Muçoja lekët! Kur ta mbarojmë oxhakun, do ta kuptosh dhe ti se Muçoja me shokë nuk e bën për lekë. Ka dhe që nuk e kuptojnë. Ka, bre, si nuk ka!

Në krevatin poshtë dikush po gërhiste.

— Fle Elmazi, fle, se u këput fare sot. E bën njeri këtë gjumë kur punon vetëm për lekë! Se, që

thua ti, Neritan, edhe se si fle, kuptohet se ç'njeri je. Posi, posi. E, o, edhe nga gjumi. Fle Elmazi, fle. Edhe nja një muaj e kemi pisk, pastaj vjen behari. Dhe ti do t'ia kesh marrë dorën punës. Tani edhe s'të flihet, po nesër ke për të fjetur, ja, si Elmazi.

— Shkon shpesh në shtëpi?

— Rrallë. Do të thuash ti se Muçoja qenka zemërgur. Jo, më merr malli që ç'ke me të për nipërit dhe gruan. Po nuk dua që atyre t'u skuqet faqja. Ore, s'ka gjë më të poshtër sesa kur fëmijëve u skuqet faqja për prindërit e tyre. Vijnë ata ngandonjëherë të shtunave. Çmallemi të diel dhe i përcjell. Unë e kam mendjen atje, ata këtu. Kështu qenka njeriu: gjak e mall. Edhe për këtë oxhak do të kesh mall. Ta them unë e mos shko më tutje. E, o, mall do të kesh. Të duket habi? Puna të bën njeri të mirë. Mos e harro këtë, hë, xhan!

Era frynte lehtë mbi çatinë prej populiti. Qymyri kishte marrë zjarr. Dëgjoja Muçon dhe e ndieja veten më të lehtë. Ai heshti. M'u duk sikur u zhyt në mendime. Nuk e shqetësova. Sonte nënën nuk e zë gjumi. Kot merakoset. Po këtë nuk ia them dot, se është larg. Nëpër rrugët e kantierit shkonin makina. Dritat e tyre hynin midis të çarave të dërrasave të barrakës. Kur u ktheva nga Muçoja, atë e kishte mbërthyer gjumi. Dhe mua, po më mbylleshin sytë.

Nuk më kujtohet sa ishte ora, kur ndjeva të më dhimbe koka dhe të më vinte për të vjellë. Nëpër tym gjeta pantallonat, hodha kraheve xhakëtën dhe, duke u përpjekur mos bëja zhurmë dhe zgjoja shokët, dola jashtë. Ajri i ftohtë më solli në vete dhe për herë të parë m'u duk sikur u mbusha me frymë. U ula te stoli dhe më pëlqente të më rrihte era gjoksin. Kur po çlirohesh, volla. U lehtësova pak, po kokën e kisha përsëri plumb. Qëndrova jashtë nja pesë minuta dhe hyra brenda nga frika se mos ftohesh. Po gdhiej dhe yjet ishin të largëta. Sa hyra brenda, më ra në hundë era e qymyrit dhe atëherë e kuptova përse volla. Më kishte zënë

qymyri. Shkunda të parin që ishte pranë derës! Nuk përmendej. E kapa dhe e nxora jashtë. Zuri të vjellë. Hapa derën dhe dritaren. Tundja shokët. Dikush ngrihej me zor. Ndonjëri jo. As vetë nuk e kuptoja se ç'bëja. Vetëm i hidhja në kurriz dhe ia nxirrja jashtë. I shtrija në batanije dhe hyja përsëri brenda. Të fundin nxora Muçon. Ai ishte më keq. U trëmba. M'u duk sikur kishte vdekur. I hapa gojën dhe fillova t'i thith ajrin. Nuk mbaj mend sa vazhdova kështu. Erdha në vete kur dikush më hodhi dorën në sup dhe më largoi. Atëherë pashë se rrötull barakës kishte tërë atë njerëz dhe dy makina të ndihmës së shpejtë. I futën më barrela. Pastaj makinat u larguan duke u rënë sirenave.

U gdhi. Isha i dërrmuar. Filluan të më pyesnin, por nuk u përgjigjesha dot të gjithëve. Në gojë kisha një shije të keqe. Dikush më zgjati një gotë qumësht. E piva më ndoht. Më dhanë prapë dhe prapë e piva. Më thanë nëse doja të më çonin në spital, por nuk pranova. Kantiëri po niste punën dhe ata më thanë se, po të mos e ndiejë veten mirë, t'i thërrisja. I falënderova. Mbeta vetëm para barakës. Malet po skuqnin majat. Era kishte pushuar. Pas pak erdhi Ganiu.

— E?, — e pyeta.

— I shtruan në spital.

— Po si na ndodhi kështu, o Gani?, — e pyeta.

Ai më vështroi në sy dhe mblodhi supet.

— Menduam se nuk do ta ndiznim më dhe dikush duhet ta ketë lëvizur tubin dhe ka harruar ta çojë në vend.

— Unë dyshova njëherë kur doli tymi i druve, por thashë se mos e kthente era.

— Ku na rastisën dhe dru pishe, dhe ajo e uruar pishë ka erë të këndshme. Për veten time, vdes për erën e pishës. Po ty të pëlqen?

— Po, — u përgjigja. — Me sa vura re, edhe shokëve u pëlqente.

— Po, po. Ata s'të heqin nga goja. U shpëtove jetën, — më tha Ganiu kushedi për të satën herë atë mëngjes.

Dhe as vetë nuk po e kuptoja përse ndieja një gëzim që sa vinte e rritej dhe doja t'i takoja sa më parë shokët e mi të punës. Jo që të më lavdëronin. Kishte diçka tjetër, që nuk e përcaktoja dot ky gëzimi im. Aty ditët e mia po merrnin një kuptim tjetër dhe ndofta që atë ditë po nisja diçka që as më kishte shkuar ndonjëherë në mendje. Rruga me kalldrëm e shtëpisë sime, shokët, shoqja që u martua me rrobaqepësin më të mirë të qytetit tonë, romanet dhe netët mbi to se pse më dukeshin sikur i kisha jetuar prej kohësh, prej vitesh. E ndieja se do të kisha mall për të gjitha këto. E ndieja se, edhe kundër dëshirës sime, ato do të feksnin në kujtesën time, kur të çlodhesha shtrirë në krevat, si feks një agim i purpurt mbi një luginë. Do të jetoja ditët, do të më vinte keq për shoqen time që nuk e mbaroi shkollën me ne, sepse u martua me rrobaqepësin më të mirë të qytetit tonë dhe që me vështrimin e saj në laboratorin e kimisë më qortonte që isha aq i cekët; do të merrja pastaj lejën e zakonshme dhe do të shkoja në shtëpi, kur të kishte rënë dëbora e parë, e cila do të më përshëndeste me zhurmën e saj të butë, sikur habitej që kisha ndryshuar aq shumë.

Dielli kishte dalë dhe Ganiu më tha të bënim gati vendin e punës.

— Ata sikur kanë ardhur, — tha Ganiu.

Ai u ngjit në oxhak. Pas tij u ngjita dhe unë. Kantieri mbante erë mëngjes.

ME SHËRBIM

Ai e kuptoi se nuk po e duroja dot dhe bënte e ç'bënte e kthehej nga unë tërë respekt. I përgjigjesha shkurt, por, sido që të ishte toni im, ai nuk përtonte të më dëgjonte me buzën në gaz duke tundur kokën. E njoha që në fillim nga buzëqeshja. Ishte një buzëqeshje uniforme, si katrorët e guaskës së breshkës. Ma kishte falur para pesë vjetësh. Dhe më ishte ngulitur në kokë si diçka shqetësuese. Jo më kot më kujtonte guaskën e breshkës. Në çdo situatë ai fap, futej brenda saj. Dhe, kur ndiente se rreziku kishte kaluar, dilte prej saj dhe ecte ngadalë, me kujdes, për të mos u ndier. Më zgjati paketën e cigareve.

— Nuk e pi, — i thashë.

— Para pesë vjetësh, bile para pesë vjetësh e katër muajt, ti e pije, — më tha.

— E kam lënë.

— Edhe mua më kanë këshilluar mjekët ta lë, se më bën dëm, por nuk kam mundur. Ti je njëri me vullnet.

— Isha i sigurtë se gënjente për punën e mjekut. I pëlqente që të tjerët ta mëshironin.

— Me siguri keni kaluar mirë, gjersa i mbani mend dhe muajt, Xhemal, — tha Jani, një kolegu im.

Xhemali u kthye nga unë dhe buzëqeshi.

— Për veten time, nuk kam për t'i harruar kurrë

ditët kur u njohëm. Ti të hyn menjëherë në zemër. Edhe babait i erdhi keq kur u largove. Përse nuk e mbajtje fjalën? — Dhe më tundi gishtin sikur më kërcënonte. — Të kemi pritur.

Prindërit e tij, ndofta, më kishin pritur, kurse ai më kishte harruar sapo isha larguar. Po ecnim nga qendra e kooperativës drejt xhadesë së makinave. Koha ishte e butë dhe fshati nuk ndodhej larg Tiranës. Mua më pëlqente ta bënim në këmbë atë copë udhë, po ai nuk na la. Na siguroi se do të na gjente makinë.

— Ej, sa të kemi pritur! Kur vinte ndonjë makinë nga Tirana, dilja me vrap se mos ishte ti. Dhe e di si bëhesha kur nuk ishte ti? Të më zije për hunde, më... «Nuk dimë të paktën si është me shëndet, se për punë ishte çapajev djalë», — thoshte babai. Kur të dëgjoja në radio, ma bënte zemra tak-tak.

Jani nuk po e kuptonte përse sillesha ashtu me atë njeri. Dhe vetë sikur bëhesha pishman, por, sa shihja buzëqeshjen uniforme, nxehesha me të e ziejta përbrenda. Ndalua nën disa plepa. Ai, sa shihte ndonjë makinë, dilte në mes të xhadesë dhe zgjaste dorën. Dhe, kur makinat nuk ndalonin, afrohej drejt nesh i pezmatuar dhe si fajtor.

— Ç'ke që nuk e duroj dot?, — më tha Jani me zë të ulët. — Ai po sillet shumë mirë me ne!

— Prandaj, — i thashë.

Xhemali e nuhati që po flisnim për të dhe na u afrua ngadalë. Jani u skuq, kurse unë heshta. Ai na vështronte me një pamje naive dhe nuk dinte ç'të bënte. Po vinte një makinë. Nga frika se mos flisnim përsëri për të, ai nuk doli më në mes të xhades, po ia zgjati dorën që aty ku ishte.

— Kot që presim, — thashë. — Këtu s'të merr asnjë shofer. Ja ku është Tirana.

— Habitem! Nuk kam pritur kurrë kaq gjatë!

— Nuk ke faj ti, — tha Jani për ta qetësuar.

— Mos ju prisha ndonjë plan dhe më vjen keq që u bëra unë shkaktari.

— Jo, jo, — tha përsëri Jani.

Përtej kodrave të buta të Ndroqit, po perëndonte dielli. Gjithmonë më ka pëlqyer peisazhi i kodrave në periferi të Tiranës. Sidomos më pëlqen kur bie muzgu dhe ullishtat marrin një ngjyrë të hirtë të zbardhur, si merr deti kur është i shqetësuar. Ato më ngjajnë me disa akuarele të thjeshta, të pastra, që poezinë e kanë sapo largohesh prej tyre. Dhe tani dielli i madh, i purpurt, po perëndonte. Po të ngjiteshe majë kodrave, me siguri do të shikoje fundosjen e tij në det, duke ngjyer mbrëmjen me një purpur të lehtë, gati të pakapshëm. Plepat anës xhadesë bënin poteren e zakonshme të kthimit të zogjve në fole. Harrova ku isha dhe as vetë nuk e kuptova si u nisa drejt Tiranës. Vetëm kur lamë pas shtëpitë e fshatit, Jani i tha Xhemalit.

— Kthehu ti, mjaft na përcolle.

Ai qëndroi dhe m'i nguli sytë. Po t'i thosha të na përcillte deri në Tiranë, do të vinte tërë qejf. Më shikonte sikur unë kisha ndër mend ta përzijsa.

— Kthehu, — i thashë. — Ndofta të është kthyer gruaja dhe bëhet merak.

Fjalën «gruaja» e theksova me qëllim dhe ai e kapi këtë. Nuk lëvizi nga vendi. Dhe përsëri në sytë e tij vura re një frikë regëtuese, që lutej të mos e dëboja. As që e kisha ndër mend diçka të tillë.

— Kthehu, — i thashë, — ktheu.

Jani i dha dorën për të dytën herë. Ai mbeti atje. Një copë rrugë ecëm pa folur.

— S'të kuptova, ç'pate?, — më pyeti Jani.

— Ai njeri ma ka frikën dhe ti e di se unë nuk i honeps dot ata njerëz që ma kanë frikën. Sepse s'kanë asnjë arsye, asnjë arsye! Sa e kuptoi që unë e kisha marrë vesh ndarjen e tij nga gruaja e parë, i hyri frika. Ka diçka të pandershme këtu, që ai u tremb aq shumë nga unë. E përse? Ç'jam unë? Një redaktor i zakonshëm i Radios, një redaktor që, si kushdo, përpiket të bëjë me ndershmëri punën. Ty do të

të vinte mirë të ta kishte njeri frikën? Jo. Po unë e di përse trembet ai, e di.

Dhe ktheva kokën për ta parë. Po muzgu ia kishte lënë vendin natës.

— Nuk kuptoj si mund të arrijë deri këtu njeriu! Ai s'ka për të fjetur sonte. Ai për një kohë të gjatë do të presë. Se nuk është i ndershëm. Dhe unë nuk do të jem i ndershëm sikur të hesht. Më kupton?

— Jo, — tha Jani.

— Ke të drejtë, se nuk e njeh.

— Po ti ku e njohë me një takim të bërë këtu e pesë vjet më parë?

— Ashtu është, megjithëse ka raste që mjafton edhe një takim për të njohur një njeri si ai. Po, po, mjafton.

Jani nuk foli, por edhe unë nuk kisha dëshirë ta vazhdoja me atë bisedë. Kur hymë në Tiranë, vendosa të takoja disa njerëz për të më sqaruar disa gjëra. Xhemali e kishte parandier këtë vendim, prandaj dhe u tremb nga unë dhe, ashtu si këtu e pesë vjet më parë, ngjeshi në fytyrë buzëqeshjen që të kujtonte katrorët e zinj në samarin e breshkës.

2.

Para pesë vjetësh, apo, për të qenë më i saktë, para pesë vjetësh e gjysmë shkova me shërbim në qëndrën e krahinës P. Në qytetin e vogël mbërritëm ndaj të ngrysur. Kishim udhëtuar tërë ditën e na ishte mpirë trupi. Në rrugën kryesore nuk kishte lëvizje, përveç disa gjimnazistëve, që, si dukej, po ktheheshin nga ndonjë mbrëmje, sepse qeshnin dhe flisnin duke ndërprerë njëra-tjetrën. Ato panë me vëmendje targën e makinës sonë të bërë tërë pluhur dhe, kur shoferi ynë i ra borisë, ulën kokën të turpëruara dhe të skuqura nga kureshtja e tyre. Ato më kujtuan shoqet e mia të gjimnazit. Dhe nuk e di përse u preka, dhe vitet e shkollës m'u dukën të largëta dhe të jetuara nga dikush tjetër.

Ja hodha fajin lodhjes së rrugës dhe qetësisë që fashitte gjithshka. Ndofta, për gjendjen time shpirtërore ka ndikuar dhe ngjyra e ditëve të para të vjeshtës që ishte aq e bukur në atë qytet.

Zumë hotel, u lamë dhe, si u çlodhëm një copë herë, dolëm së bashku me shoferin. Atëherë pregatisja emisionin për jetën kulturore dhe zakonisht punoja në mbrëmje, kur mbledheshin amatorët. Në qytet ishte ngritur shtëpia e re e kulturës dhe tërë rrugës kisha menduar si do ta ndërtoja emisionin për të dalë sa më i mirë. Krahina kishte tradita. Sidomos, të njohura ishin vallet dhe këngët e saj.

Në qytet frynte një erë e ngrohtë, si të ishte fillimi i pranverës. «Këtëj fillimi i vjeshtës qenka i ngjashëm me fillimin e pranverës», — mendova i kënaqur. Ishte fillimi i jetës sime si gazetar dhe gëzoheja kur gjeja ndonjë detaj që më dukej i goditur. Bile çdo gjë përpiqesha ta konceptoja në mënyrë figurative dhe nuk e kuptoja se kjo më dëmtonte për ta bërë sa më komunikuese emisionin. Shtëpinë e kulturës e gjeta nga tingujt e pasigurtë të një fizarmonike, të shoqëruar nga një klarinetë, që nuk i kapte dot notat e larta. Edhe ky ishte një detaj i ngulitur nga jeta ime e shkurtër si gazetar. Po mësonin një këngë të re të festivalit të Radios që ishte përhapur mjaft. Shtyva derën ku ishte shënuar «Dhoma e muzikës». Ishin dy të rinj që bënin prova. Ata lanë instrumentet dhe menjëherë na njohën që s'ishim vendës.

— Kë kërkoni?

— Është gjë drejtori?

— Po. Xhako, shpjeri pak te Xhemali, — tha ai që i binte klarinetës.

Ndoqëm pas Xhakos.

— Ku punoni?, — na pyeti.

— Në Radio-Tirana.

— Në Radio? Shumë mirë. Do të bëni ndonjë emision, me siguri.

— Po.

— Kur s'erdhët para një jave. Kishim festivalin folkloristik. Na ë mburrën.

— A mund t'i mbledhim dot grupet më të mira?

— Edhe i mbledhim, megjithëse është kohë fushate. Ai ishte një qytet bujqësor.

— Ja, bisedoni me Xhemalin, mund t'jua rregullojë ai.

Xhakoja trokiti dhe hapi derën. Xhemali, drejtori, po lexonte revistën «Hosteni». Çoi kokën sa na pa dhe nuk e ndërpreu leximin.

— Këta shokët e Radios duan të bisedojnë pak me ty, — tha Xhakoja.

Xhemali la revistën dhe u çua duke e larguar karrigen tërë zhurmë.

— Urdhëroni, urdhëroni, falemnderit, — i tha Xhakoja, i cili doli nga zyra.

Si zakonisht në fillim të njohjes shkëmbyem nga një buzëqeshje. Heshtëm disa çastë. Pas pak u dëgjua përsëri fizarmonika dhe klarineta me këngën e re të festivalit.

— Djem me pasion!, — tha Xhemali. — Punojnë tërë ditën në fushë dhe vijnë këtu çdo natë.

— Edhe ju keni ditur t'i tërhiqni, — thashë.

Ai qeshi i kënaqur.

— Punojmë me aq sa kemi mundësi.

— Duam të bëjmë pikërisht një emision për aktivitetet e shtëpisë së kulturës.

Ai në fillim na pa si me habi, rregulloi disa shkresa mbi tavolinë dhe, kur ngriti kokën, na buzëqeshi. Ishte një buzëqeshje pak e çuditshme, e sforcuar dhe pa kuptim.

— Ej, ç'ju shatisëm, — tha. — Pitë kafe? — Jo. Shkojmë pimë nga një, pa rregullohemi.

Dhe, për të mos e kundërshtuar, u çua i pari, mori çelësat, që i kishte lënë mbi tavolinë, dhe dolëm.

— Rrugë e gjatë, ë?

— Ishte kohë e mirë dhe nuk e ndiem rrugën.

— Keni qenë më parë këtej?

— Jo, — tha Xhemali.

— Do të kënaqeni. Vjeshta këtej mban erë mollë. Të vinit pas një muaji, do t'ju mbushja me mollë të atilla që as në ëndërr të mos i kishit parë. Por nuk do t'ju lëmë duarthatë, — tha ai duke na buzëqeshur. Tani filloi vjelja.

Qyteti ishte i qetë. Dëgjohej fëshfëritja e gjetheve të shelgjeve dhe llokoçitja e dobët e një lumi të vogël që rridhte në perëndim të tij. Era e ngrohtë vazhdonte të frynte nëpër luginë. Nata kishte yje dhe hënë e të shtinte në tërë qenien tënde një prehje të këndshme. Vjeshta e ngarkuar me mollë.

— Tani niset urbani për në fshatin tim. Shkojmë me të, — tha Xhemali.

— Kemi zënë hotel, — i thashë.

— E rregulloj unë me xha Zenon.

— Ç't'ju shqetësojmë.

— Kot që diskutoni, — na e ktheu ai dhe, meqë po kalonim pranë hotelit, hyri atje.

Sportelisti po lexonte gazetën.

— Si shpejt u kthyet, — tha ai.

— Do t'i marr unë, — tha Xhemali.

— U dhashë dhomën më të mirë dhe i kam re-gjistruar, — tha i mërzhitur sportelisti.

— E, mo, se e rregullon ti.

— Si të doni.

Shoferi kishte ndezur autobusin urban dhe priste orën për t'u nisur. S'kishte shumë pasagjerë. U ulëm. Rrugës nuk folëm. Seç na kapi një kotje e rehatshme. Kur zbritëm dhe hymë në rrugën e fshatit, mua m'u duk sikur ajri dhe nata mbanin me të vërtetë erë mollë. Atë natë qëndruam vonë. I ati i Xhemalit ishte një plak me humor dhe mikpritës. Më erdhi keq që nuk dija asnjë këngë nga ajo krahinë. Edhe në këngë kishte shumë mollë dhe ujë dëbore. Për të na nderuar, i ati i Xhemalit thirri dy vëllezërit dhe një fqinj. Kur ramë për të fjetur, hëna kishte perënduar dhe yjet ishin rraluar. Në dritare trokiste një degë peme. Kur u zgjova,

pashë se ishte një mollë plot kokrra. Mbi to kishte rënë vesa dhe nga dielli ngjisnin si hënëra të kuqe, rrethuar nga yje të bardha. Njerëzit e shtëpisë ishin zgjuar dhe kishin shkuar në fushë prej kohësh. Në magnetofon kisha incizuar disa këngë të atyre pleqve plot humor. S'kisha për t'i prishur kurrë. Më vinte keq që nuk mund të incizoja mbrëmjen, mëngjesin dhe erën e mullëve.

— Kushedi sa bukur është në pranverë, — i thashë Xhemalit.

— Lëre mos e nga, — tha ai dhe unë nuk e kuptova në e kishte seriozisht apo donte të theksonte se atij nuk i bënte aq shumë përshtypje.

— Edhe sonte do të rrini nga unë.

— Jo, — i thashë i vendosur, — nuk ka lezet.

— E ke kot, — ma preu. — Po, të mos vini vetë, vjen plaku ju merr në mes të natës.

— Mbarojmë njëherë punë, pa shohim e bëjmë, — i thashë.

— Do t'ju shpie në një fshat këtu afër, që ka një grup të mirë artistik dhe një përgjegjës të shkëlqyer.

— Mirë, — i thashë, — bëjmë edhe në fshat, edhe në shtëpinë e kulturës.

— Në qytet e bëjmë njëherë tjetër. Tani s'ka lezet. Edhe ty të vete mirë. Emision nga fshati, nga baza. Shiko, mësoje të flasë bukur Fiqon, përgjegjësin, — dhe Xhemali qeshi.

Se pse nuk më pëlqeu ajo buzëqeshje. Më ngjau me diçka që nuk po e përcaktoja dot. Ishte i pari drejtor shtëpie kulture që nuk donte të pasqyroheshin në Radio aktivitetet artistike që zhvilloheshin aty. M'u duk pak e çuditshme.

— Jo, — ngula këmbë, — do të bëjmë edhe në fshat, edhe në qytet.

— Dëgjomë mua, nuk të del keq në atë fshat. Pastaj, ti do të vish përsëri.

— Nuk e marr vesh përse nuk do, xhanëm!
Ishim njohur aq sa të flisnim në intimitet.

— Ne kemi dalë edhe në Radion lokale, le të dalë edhe fshati.

Dhe përsëri buzëqeshi. U përpoqa t'i ndërroja mendjen, por ai e kalonte me shaka. Nuk ngula më këmbë, megjithëse mbeta në mëdyshje. Atë ditë punuam deri vonë.

— E, je i kënaqur?, — më tha kur po ktheheshim.

— Nuk doli keq, — i thashë.

Ecnim nën mollë. Pritej të dilte hëna, e cila kishte zbardhur majën e malit. Një vijë uji zhdukej nën gardhin e dendur të manaferrave.

— Megjithatë, më vjen keq që nuk bëme diçka edhe në qytet, — i thashë.

— Më mirë kështu edhe për ty, edhe për mua.

— Përse?

— Ka njerëz që këtë presin dhe zënë e flasin pastaj. Ja, do të thonë, Xhemali i mori në shtëpi, ua shtroi me të ngrënë e me të pirë për ta nxjerrë në Radio. Dëgjomë mua ti!

U drodha. Ai nuk e vuri re tronditjen time, se ishte errësirë. Tërë kënaqësia e asaj nate sikur humbi dhe u topit. Po shkoja në shtëpinë e tij si në një vizitë të bezdisshme dhe të pashmangshme. Për herë të parë m'u duk vetja si qylaxhi. Vetëm gëzimi i çiltër i të atit më ndaloi të mos kthehesha dhe të lehtësohesha nga brenga dhe mërzia që më kapi.

— Nesër në mëngjes do të kthehem pak nga magazina, — tha Xhemali.

Nga toni e kutova se atij nuk i kishte bërë përshlyetje ajo që kishte folur pak më parë.

— Jo, — i thashë, — nuk dua mollë.

— Mos u bëj fare...

— Jo, — ia ktheva me inat, — nuk do të shkojmë.

— Kështu thua tani, pa nesër bisedojmë ndryshe.

Nuk shikoja fare se ku shkelja. Ai ndaloi dhe më tha:

— Domethënë, edhe ti je i mendimit se Fiqoja është djalë i zoti?

— Po. Bile, m'u duk djalë i sinqertë.

— Edhe unë i këtij mendimi jam. Ua kam thënë edhe atyre të komitetit ta çojnë në vendin tim. Gjynah të humbë në një vatër kulture, apo jo?

U mundova ta vështroja në fytyrë. Ai sikur u tremb nga kjo dhe zuri të buzëqeshte. Dhe as vetë nuk e di përse ajo buzëqeshje më ngjau me katrorët e zinj në samarin e breshkës.

3.

Që atëherë kishin kaluar pesë vjet dhe Xhemalin nuk e kisha takuar më. Kur e takova dje për herë të dytë në atë fshatin afër Tiranës, gjithçka m'u kujtua deri në hollësitë më të vogla. Të nesërmen e asaj dite, sapo shkova në zyrë, përgjegjësi i redaksisë më nisi urgjentisht për në qytetin ku kishte lindur Xhemali. Krahina festonte formimin e çetës. Ndërsa Janin përgjegjësi e nisi prapë për në fshatin ku ishim një ditë më parë.

Para se të ikja, e tërhoqa mënjanë Janin dhe i thashë:

— Xhemalin mos e intervisto. Intervisto vetëm amatorët.

— Përse?, — tha Jani.

— Ta shpjegoj kur të kthehem.

Në qytetin e vogël të krahinës arrita nga ora katër. Seç më pushton një nostalgji kur shkoj pas vitesh në një qytet dhe në fillim më vjen keq që ato ndryshojnë. Por pas pak nis e qesh më veten time dhe gëzohem për shtëpitë e reja, sheshet, rrugët. Hoteli i vjetër ishte prishur dhe sportelisti kishte dalë në pension. S'kisha nga të veja. Këmbët më çuan në shtëpinë e kulturës. Nuk dëgjohej si atëherë një fizarmonikë dhe një klarinetë e pasigurtë, por një grup i madh folkloristik. Bënin prova për të nesërmen, për festën

e krahinës. Në korridor po kalonte një vajzë me veshjen e nxënësve të shkollës së mesme.

— Kë kërkoni?, — më pyeti tërë druajtje.

— Asnjeri, hyra kot.

Ajo uli kokën dhe u largua. Grupi folkloristik vazhdon të provat. Ishte një këngë e re e padëgjuar deri atëherë. Qëndrova dhe pak e dola jashtë. Ishte akoma herët për të ngrënë darkë. Shëtita derisa u err dhe fshatrat ndezën dritat e para. Njëri prej tyre ishte fshati i Xhemalit. Doja të shkoja t'i takoja pleqtë e tij të urtë dhe të dashur, por nuk më bënë këmbët. Më dukej sikur shkuarja ime do t'i lëndonte. Ky mendim m'u ngulit në kokë në mënyrë të pashqitshme. Ndofta, ngaqë nëna ime preket kur i shkojnë shokët e mi në qytetin ku bëjnë me vëllanë e madh. Malli i prindërve kur i kanë fëmijët larg...

Vështrova për një kohë të gjatë dritat që xixëllonin me intimitet joshës, si joshin lulet e mollës blëtët. Pleqtë janë mbledhur në konak dhe bisedojnë. Ndofta sjellin ndër mend djalin. Si të jetë me shëndet, se edhe letër nuk kemi marrë? Mirë. Pastaj heshtin dhe përgjojnë zhurmat e oborrit. Si hapat e?.. Jo, moj, të bëjnë veshët. Sesi m'u duk. Kështu të duket ty gjithmonë në këtë kohë. Pashë autobusin që ndaloj dhe thashë se mos erdhi... Ka punë tani. Ka. Se do të ishte shkullur të na shihte. U bë gati një vit. Një vit. Më piq një kafe.

U largova dhe shkova në restorant. Të gjitha tavolinat ishin të zëna. Kështu mbushen restorantet kur krahinat kanë festë. Dikush më kapi për krahu. Ishte Fiqoja. I dhashë dorën dhe u përqaftam.

— Kur erdhe?

— Sot, për festën që keni nesër.

Më çoi në tavolinën ku ishte ulur dhe më njohu me shokët e tij. Ishin dy të rinj dhe një plak.

— Po ç'kemi, je martuar, a beqar?, — më pyeti Fiqoja.

I martuar.
— Ku punon, zotrote?, — më pyeti plaku.
— Në Radio-Tirana.
— A, nuk i kemi mirë punët bashkë!
— Përse? — qesha unë.
— Sikur kenë harruar t'i vini këngët e krahinës sonë.

— Se mos e dëgjon tërë ditën radion ti, — tha njëri prej të rinjve.

— Dëgjo ti, spurdhjak, edhe një mijë kilometra larg të jem, kjo e uruar, — dhe plaku i ra me dorë gjoksit në vendin ku ishte zemra, — i kap këngët e krahinës sonë.

Ne qeshëm.

— Po, zotrote, ç'do të pish, se po na bën sehir?

— Një gotë birrë.

— Birra nuk është për të pirë, po për të shpëlarë. Ngrehu, o Demçe, se Sheziut po i vjen festja vërdallë sonte, dhe silli mikut një dopio.

Ishte një plak i gjallë, si gjithë pleqtë e asaj krahine.

— Ku je tani?, — e pyeta Fiqon.

— Atje, në fshat.

— Pse nuk u bërë drejtor i shtëpisë së kulturës?

— Kush të tha?

— Xhemali. Ai bile kishte ngulur këmbë për ty deri në komitet, kështu më tha.

Fiqoja qeshi si të më thoshte ta linim fare atë muhabet.

— Cili është ky Xhemali?, — pyeti plaku.

— Xhemali i Braçes.

— Ëhë! Ai që, kur ishte në shkollë, më shqyentë xhaketën dhe më thosh hajde të të jap një teke dhe, kur hyri në punë, më thosh hajde më jep një dopio.

— Dhe plaku ra në mendime. Asnjë nuk foli për një copë herë. Në restorant hynin dhe dilnin njerëz. Plaku u mërzit dhe rrëmbeu gotën.

— Ç'm'i varni turinjtë, sikur ju ka ngrënë maçoku cironkat. Hajde gëzuar dhe ty të lumshin këmbët,

pa në djall të vejë dhe Xhemali. Më vjen për të shkretin Braçe, se është xhanan burrë, pa...

Plaku e rrëkëlleu me fund.

— Çohemi, se kjo e uruar s'të thotë kurrë ngrihu, — tha plaku.

Fiqoja m'u lut t'i shkoja në shtëpi atë natë, por unë i thashë se duhej të qëndroja patjetër në qytet. Ai nuk kundërshtoi. Mblodhi grupin, se do të niseshin për në fshat. Këtë rrugë kishin më se dy javë që e bënin me makinën e kooperativës. Atë natë ua kishte marrë komiteti për një punë. Do të shkonin në këmbë. Fshati ishte larg ndonjë orë.

— Po të përcjell deri në një farë vendi, — i thashë.

Mbetëm pak mbrapa të tjerëve. Nata ishte e freskët. Të rinjtë e grupit këndonin.

— E takova dje Xhemalin, — i thashë Fiqos. — Është bërë përgjegjës i vatrës së kulturës të një fshati pranë Tiranës.

Fiqoja më pa në sy dhe eci përpara.

— S'është më brenda në Tiranë?

— Jo. Pse ku ka punuar më parë?

— E ku i gjendet nishani atij.

Pastaj u kthye i nxehur nga unë dhe tha:

— Kështu, ë, edhe ty të ka thënë për mua! Ç'pëllivan!

— Pse, më ka gënjyer?

— Jo. Sapo ike ti, e mori vesh i madh dhe i vogël se unë do të flisja në Radio. Nuk la njeri pa zënë. Edhe në komitet bëri të madhen. «Ju kam thënë unë! Fiqoja është burrë i zoti. Ja, edhe Radioja e mori. Kot më mbani mua. Lërmëni të shkoj». Dhe ata më thirrën një ditë. Po unë nuk pranova. Nuk më ndahet shpirti nga fshati. Xhemali nuk m'u nda ditë e natë. Më vinte në shtëpi të më mbushte mendjen të pranoja. Më lëpihej më keq se një buçe, gjersa m'u pështiros dhe e dëbova. Kur ai më vjen të nesërmen, sikur të mos kishte ndodhur gjë prej gjëje. E po të jetë njeriu kaq pa fytyrë! Aman, derman! Mezi u mbusha mendjen atyre të ko-

mitetit. Hajde ti të më zëvendësosh. Gjynah për vjehrrin, pa të jetë për mua, s'largohem kurrë që këtej». Ishte fejuar me një vajzë të vetme dhe do të hynte kollovar. Ama, kishte raste që lëkundesha. Po, sa bëhesha gati të pranoja, më vinte gjynah të lija shokët, fshatin, ore dhe për luadhet më vinte keq, edhe për lisat e lumit më sëmbonte në zemër, edhe për dëborën, sikur ajo nuk është njëlloj si dëbora që bie në qytet. Por ja, sesi më vinte. Dhe nuk pranova. Gjetën më vonë një arsimtar. Xhemali krisi e iku. Kur shkova pas një viti në Tiranë, bëri sikur nuk më pa. Pastaj mora vesh se kishte ndarë të shoqen.

— Është martuar përsëri, — i thashë.

Fiqoja nuk foli, por lëshoi vetëm një «hë!». Ishim larguar mjaft. Ecnim mes një are me thekër. Ajo fëshfërinte. Nga lumi dikush u kishte prishur gjumin zogjve. Lehu një qen. Qielli pa fund. Dikush ia mori një kënge dashurie dhe të tjerët e pasuan. S'kishim ç'të flisnim më.

— Do të vish?, — më tha prerë Fiqoja.

— Ndonjëherë tjetër.

— Si të kesh qëj. Kthehu, se je larguar mjaft.

— E di ku i punonte gruaja e parë?

— Po. Në..., — më dha dorën dhe iku.

Mbeta vetëm mes arës me thekër. Nata ishte e bukur. Fillova të kthehesha për në qytet ngadalë. Diku tremba një zog që fluturoi i përgjumur, sikur përplasej pas diçkaje. Kur hyra në qytet, po mbyllnin restorantin. Dhe padashur më vajtën sytë nga fshati i Xhemalit. Atje, nën një mollë, ai më fali buzëqeshjen e ftohtë, si katrorët e zinj të samarit të breshkës.

4.

— Në qoftë se ti e ndjeve veten të mashtruar një herë, mendo sa të rëndë e kam pasur unë, — tha ajo dhe rregulloi flokët që i binin mbi supet.

Ishte një vajzë e thjeshtë, e urtë dhe mua se pse

më pëlqente ta quaja simpatike. Kishte një trup mesatar, të rregullt, flokë të zinj dhe sy kafe, pak me bisht, sikur pyesnin vazhdimisht për gjërat më të zakonshme. Më dukej sikur edhe ajo do të më pyeste si më pyetë vajza ime: «Përse bien gjethet? Përse nuk bie dëborë në Tiranë, po vetëm në mal? Po dielli ku shkon natën?». U pendova që i kisha lënduar diçka që ajo po përpiqej ta harronte dhe ia hodha fajin inatit tim për Xhemalin. Punoja në Radio dhe më pëlqente të shkruaja ndonjë tregim të shkurtër. Por nuk mund të bëhesha as gazetar, as shkrimtar, në qoftë se heshtja. Në qoftë se heshtja, nuk do të isha i ndershëm as para gruas sime, as para vajzës, që sa ka filluar të interesohet për fenomenet e jetës. Në profesionin tim nuk ka asgjë të privilegjuar. Prandaj më hipi inati me Xhemalin që u tremb prej meje. E njëjta ndjenjë më pushtoi edhe kur isha stazhier dhe revista «Hosteni» më dërgoi për një fejtton. Njeriu për të cilin do të shkruaja fejttonin u tremb dhe filloi të më bënte lajka. Më vonë mora vesh se kishte vjedhur. Gjatë kësaj kohe kam shkruar kudo dhe kudo kam shokë. Edhe ajo po sillej sikur të ishim njohur prej vitesh. Prandaj më pëlqeu më shumë. Po ecnim nëpër shëtitoren «Dëshmorët e Kombit». Ajo kishte zakon të rregullonte kot flokët që i binin mbi supet.

— Isha në vitin e parë të Shkencave të Natyrës. Zakonisht seç pësojmë një farë ndryshimi në vajzat kur kalojmë nga shkolla e mesme në fakultet. Ai më ndaloi një ditë. M'u duk si e çuditshme. Nuk e kisha parë ndonjëherë. Deri atëherë nuk më kishte ndaluar njeri kështu. Në gjimnaz, të them të drejtën, ndieja simpati për një djalë dhe si vajzë e kuptoja se kjo ndjenjë ishte reciproke, por na dukej si çudi. Dhe heshtim.

Ajo qeshi me kujtimin që solli biseda jonë.

— Kështu heshtëm edhe në mbremjen e lamtumirës. Ai mbaroi gjeologjinë dhe është në Fushë-Arrëz. E takoj kur vjen këtu. Është burrëruar tepër dhe përsëri më shumë heshtim, se flasim. E habitshme, ë?

Pastaj u kujtua se unë e kisha kapur për Xhemalin dhe ndërroi tonin e bisedës. Asaj më shumë do t'i

pëlqente të më tregonte për shokun e shkollës, sesa për Xhemalin.

— S'kaluan as dy ditë kur e pashë se po më priste në hyrje të fakultetit. Ishte mbështetur pas kangjellave të lulishtës dhe, sa zbrita shkallët, erdhi drejt meje. Më habiti guximi i tij. Ai sillej sikur të njiheshim prej kohëshi. Bile, kur më foli edhe për fëmijërinë time, mbeta si e ngrirë. Thua se kishte qenë një hije që kishte ndjekur rritjen time. Kur fliste, i jepte fytyrës një pamje të përvuajtur. Se pse më pëlqente të mendoja se më donte. Të lutem, mos më qorto që e besova. Ishte dashuria ime e parë dhe nuk mendoja se mund të kishte njerëz si ai. Por prapë nuk i thashë po. Isha e shqetësuar. Dy ditë nuk shkova fare në fakultet, por u mbylla në shtëpi. Edhe të shikoja jashtë, kisha frikë, se mos kushedi, diku, nën dritare vërtitej ai. Kur u err, hapa pak perden dhe, më të vërtetë dikush ishte te muri përballë. Por unë u përpoqa t'i mbushja mendjen vetes se ishte dikush tjetër. Ditën e tretë, sa dola nga pallati, më kapi. U drodha e tëra. Askush nuk më kishte ndjekur me aq këmbëngulje. Dhe përsëri më tha se më donte.

— Dhe ti e besove?, — e ndërpreva menjëherë.

Ajo ndaloi.

— Po, e besova. Më dukej djalë i pjekur. Ndofta, ngaqë ishte në vitin e fundit. Dhe ne i shikonim me një ndjenjë inferioriteti ata që ishin në vitin e fundit. Kjo ndjenjë kishte lindur te ne që në gjimnaz. Prandaj mos më qorto që e besova. Më qorto për më vonë. Sapo u ktheva nga leksioni, ia tregova të tëra babait. Ai u shqetësua, por më tha se nuk isha më e vogël. Gjithmonë jam kuptuar me babanë. Ndofta, ngaqë isha vajzë e vetme. S'kam as vëlla. Babai më tha se donte të njihej me të.

— Pa e njohur akoma as ti?, — e pyeta i habitur.

— Po, — tha ajo dhe uli kokën.

Dukej që e kishte qortuar gjatë veten për nxitimin e saj.

— Po pastaj?, — e pyeta.

— S'kaloi java dhe ai trokiti në derën tonë. Ia hapi babai. Mua, sapo e pashë, m'u veshën sytë. Asnjëherë nuk isha turbulluar aq shumë. Në shtëpi më kish-te ardhur edhe ai shoku i shkollës, edhe shokë të tjerë, po asnjëherë nuk isha tronditur ashtu. U ul në tavolinë dhe nisi bisedën me babanë sikur të njihej prej kohësh. Babait i pëlqeu. Kurse unë mezi prisja sa të largohej. Kur iku, sikur u lehtësova. Ndofta, më duket tani kështu. Kur largohet shoku i gjimnazit, më ngjan sikur nuk ka qenë fare. Nejse. Ne u fejuam. Po, pa u njohur fare. Shoqet e kursit më uruan dhe sikur më vështruan me një farë zilie. Përpigësja të mendoja se isha e lumtur. Edhe ai shoku i gjimnazit më dërgoi një telegram urimi. Në qoftë se në fillim kisha një farë hutimi apo më mirë një farë mosbesimi të dashuria e tij, tani nxehesha me veten time kur më lindte ndonjëherë në kokë një pikëpyetje e tillë. Përse? Sepse doja që të gjithë të mendonin se isha e lumtur. Sa e marrë, hë!

Ai pak nga pak u bë si njeriu i shtëpisë. Hante te ne dhe jo në menses. Më të shumtën e herës, vonohej duke biseduar me babanë dhe flinte në divanin e dhomës së pritjes. Kur flinte nga ne, mua nuk më zinte fare gjumi. Në mëngjes e kisha kokën të rëndë. Aty nga muaji prill i tha babait të ndërhyntë për emërimin e tij në Tiranë. Babai kishte një shok të ngushtë në Ministrinë e Arsimit. Kurse ai shoku i gjimnazit as që më tha gjë për të ndërhyrë babai. Se pse e krahasoj gjithmonë me të. Përse thua ti?

— Ku ta di unë.

Kishim hyrë në rrugën «Marsel Kashen».

— Po ti ç'bëre, kur ai i tha babait tënd të ndërhynte për ta emëruar në Tiranë?, — e pyeta.

Ajo i ra me këmbë një gjetheje të rrëzuar. Nuk m'u përgjigj në çast.

— Heshta, — tha me dhimbje. — Heshta, sepse edhe mua më pëlqente që ai të emërohej në Tiranë.

Ajo foli sikur po e dënonte veten.

— Që në atë çast që heshta, sikur e humba guximin për të folur. Mua më dukej sikur po humbisja guximin, ndërsa në të vërtetë po humbisja diçka më të madhe.

— Edhe guximi nuk është gjë e vogël, — i thashë.

— E di. Por unë nuk doja të besoja se nuk kisha guxim. Nuk duhej ta kisha lënë babanë të bisedonte me shokun e Ministrisë. Por të thashë se më pëlqente që ai të rrinte në Tiranë.

Nga larg erdhi melodia e një orkestre lulishteje.

— Babai bisedoi me shokun e tij. Xhemali erdhi në mbrëmje i shqetësuar. Sa u ul, e pyeti babanë në kishte bërë gjë apo jo. Babai e qetësoi. Shoku i Ministrisë i kishte thënë që Xhemali të shkonte në rrethin e tij derisa unë të mbaroja fakultetin, pastaj do ta tërhiqnin në Tiranë. Ai u kënaq. Edhe babai dukej i kënaqur.

— Po ti?

— Unë?! Heshta.

— Sepse më bukur sesa i fsheh gabimet heshtja, nuk i fsheh asgjë tjetër, — nuk m'u durua dhe thashë unë.

— Po, — tha ajo. — Kthehemi?

— Mirë.

— Në muajin prill bëmë celebrimin. Në qershor ai iku në fshatin e tij.

— Po ti nuk shkove ndonjëherë?

— Jo, megjithëse kisha shumë dëshirë. Thonë se është fshat i bukur.

— Shumë. Po prindërit e tij a i njohe?

— I njoha. Erdhën për një ditë në Tiranë. Dhe nëna e tij më thirri për herë të parë «nuse». Dhe u preka shumë.

— Po t'i kishe njohur mirë, do të të pëlqenin më shumë.

— E di. Po Xhemali nuk i solli më në Tiranë dhe mua nuk më mori në fshat.

— Sepse i vinte turp për prindërit e tij.

— Ndofta.

— Jo ndofta, po kështu është.

Ajo m'i nguli sytë.

— Sikur të ishim njohur më parë, nuk do të kisha gabuar, — tha.

— Përse mendon kështu?

— Sepse askush, as babai dhe as shoku i Ministrisë nuk u nxeën me të, kur ai i bezdiste për punën e transferimit, por përkundrazi përpiqeshin që ta shpejtonin. Ndërsa unë prisja.

— Dhe kur e kuptove se ai nuk të donte?

— Të thashë se doja të bisedoja se isha e lumtur. Por thyerjen e parë e provova natën e Vitit të Ri. Ai nuk erdhi dot, se kishte punë. Më mori në telefon. Dhe, në vend që të më uronte apo të shprehte keqardhjen që nuk po e bënim bashkë Vitin e Ri, më tha ta uroja patjetër nga ana e tij Seferin, shokun e babait që punonte në Ministri, sepse i kishte rënë telefonit, po nuk i ishte përgjigjur njeri. Unë ula me inat receptorin. Nuk më besohej. Singërisht që nuk më besohej. Por s'kaluan as dhjetë minuta, kur telefoni ra përsëri. Nuk u çova. Shkoi babai. Pas pak më thirri mua. «Kush është?», — e pyeta. «Beni», — më tha. U çova me rrëmbim dhe, kur mora receptorin në dorë, nuk dija ç't'i thosha. Beni quajnë shokun tim të gjimnazit. Më flistë nga Fushë-Arrëzi. Por edhe ai dukej i shqetësuar, sepse i dëgjohej frymëmarrja. «Hë, Beni, gëzuar!» «Gëzuar!» Pastaj heshtëm. «Përse nuk erdhe në shtëpi?», — e pyeta. «Është zënë rruga nga dëborë». «A bie akoma dëborë?». «Bie». «Kur ke ndër mend të vish këtej?». «Nuk e di». «Po ti, përpiqu të vish sa më shpejt». Dhe në atë çast na ndërhyri centralistja. «Gëzuar, Erall!», — më uroi Beni. «Gëzuar!», — e urova edhe unë. Dhe, kur telefoni bëri krak, më erdhi keq që kishim folur aq pak.

Nga ajo natë fillova ta analizoja veten dhe Xhemalin me gjakftohtësi. Por ishte vonë. Atij i kishin ardhur dokumentet në Tiranë dhe pritej që në mars të fillonte punën si mësues. Ata të rrethit e kishin lënë, meqënëse po hynte dhëndër brenda. Por unë kisha ven-

dosur që të bisedoja shtruar me të para se të martohe-
sha. Akoma më gënjente një shpresë e vakur. Edhe më
vinte turp. Nuk e përfytyroja dot veten të ndarë, në gjyq.
Sa e vogël, hë? Por doja që t'i mbushej mendja edhe
babait, edhe shokut të tij se ç'njeri ishte Xhemali.
Dhe, kur e kuptuan, nuk guxonin të më shihnin në sy.
Tërë synimi i Xhemalit nuk ishte dashuria për mua
dhe për prindërit e mi, por për Tiranën. Një javë pasi
kishte filluar punën, tha që të bënim një darkë të vo-
gël. Por unë nuk pranova. Kisha vendosur të mos hesht-
ja më.

Erali mori frymë thellë e lehtësuar dhe më vështroi
sikur të më thoshte: «Ja, kjo është e tëra, të tjerat i
di vetë».

— A të të bëj edhe një pyetje?, — i thashë para
se të ndaheshim.

— Po.

— A e njohe ndonjëherë Xhemalin me atë shokun e
gjimnazit?

— Jo, — tha prerë.

Para pallatit të saj u ndamë. Ajo ngjiti shkallët dhe
unë qëndrova derisa hyri brenda. U nisa për në shtë-
pi. Sapo isha kthyer nga shërbimi e, me siguri, gruaja
dhe fëmijët po më prisnin.

TOKA E GURIT TË MIRË

Novelë

1.

Nga gryka e Fushës së Kalit po hynin përherë e më të dobëta në krahinën e Gurit të Mirë erërat mesdhetare. Labo Çikoja e ndjeu se ato do të ndikonin edhe për pak kohë mbi klimën e theksuar kontinentale dhe pastaj do të fillonte dëbora. Atëherë erërat e ftohta do të zbrisnin poshtë në fushë, nëpër Portën e Madhe, siç e quanin malësorët grykën të Lugina e Kaprollit. Dhe me të vërtetë, ajo ishte një portë që hapej në maj për të hyrë era e ngrohtë dhe e butë e detit dhe në tetor për të dalë era e ftohtë e Alpeve. Gjethet e aheve kishin marrë aty-këtu një ngjyrë të theksuar portokalli në të kuq, sikur ishin vatrat ku dielli digjte fundin e tij veror. Kudo ishte aq qetë, sa Labo i dukej sikur mbi barin e dendur, mbi ujërat e kthjellëta të përrenjve, mbi shtigjet e pyjeve, ecte duke shkelur lehtë vjeshta e druajtur e bjeshkëve. Maja e Drerit po mbulohej nga mjegulla e perëndimit dhe dukej aq e lehtë, sikur tërë ai masiv shkëmbor kishte humbur peshën dhe do të rrokullisej nga çasti në çast tej, në Luadhin e Gjakut. Laboja vështronte fshatrat e vogla, që pak nga pak po treteshin në horizontet e ditëve të fundit të verës, dhe e pushtoi një ndjenjë e ngrohtë për gjithçka që e rre-

thonte. Ishte njëzet e gjashtë vjeç. Para katër vjetësh erdhi këtu si mjek i lokalitetit. Kur ishte i lirë, mblihdite të dhëna mbi kirurgjinë popullore. Nisej fshatrave dhe tani i njihte gati të gjitha shtigjet e pyllit. Kishte grumbulluar aq material sa për ta filluar këtë dimër studimin. Sot po shkonte te Zak Plori, një malësor i vjetër, që ishte marrë me kurimin e plagëve të rënda. Majat e zhveshura të maleve reflektonin diellin si bдена të një kalaje të lashtë. Kur erdhi për herë të parë, malet i ngjanë me një kafshë prehistorike, së cilës shakujt e erërave, të shirave e të dëborave i kishin nxjerrë shtyllën kurrizore. E megjithatë ajo ishte një kafshë e paepur.

Në Luadhin e Kroit të Bardhë muzgu mbante erë bar të kositur. Mullarët dukeshin si dekor naiv i një shfaqjeje për fëmijë. Kositësit po linin punën.

— A u lodhët, burra?, — i përshëndeti.

— Ngapak. Po ti për ku kështu?, — e pyetën.

— Për te Zak Plori. Besoj se në shtëpi do ta gjej.

— Aty e ke. A po rri të dredhim një duhan?

— Po bëhet vonë.

— Si të duash, doktor.

Laboja i ra luadhit mes për mes dhe hyri në një dhiare që ngjitej thikë përpjetë. Aty ku ajo mbaronte, ahet ishin aq të dendura, sa në përpjekjen e tyre, për të parë diellin, kishin shtrembëruar trungjet dhe të krijonin përshtypjen sikur rrënjët i kishin në retë e bardha, që lëviznin drejt jugut. Laboja ecte nën fëshfëritjen e gjetheve. Fshati i doli papritur para syve me çatitë e pjerrëta prej dërrase, që, kur bie dëborë, janë aq poetike, aq të ngrohta në heshtjen e qetë të dimrit. Vendi ishte i ashpër, i egër. Vitin e parë Laboja u habit që jeta ishte kacafytur deri aty, por u habit akoma më tepër me emrin e krahinës: Guri i Mirë. Kishte shumë hipoteza mbi këtë emër. Njëra thoshte se banori i parë, mbasi kishte hequr shumë në jetë, i ndjekur dhe i rraskapitur nga të huajt, e pagëzoi kështu këtë krahinë, sepse deri aty nuk do të ngjitej dot i huaji. Tjetra thoshte se ai ishte një emërtim zbutës drejtuar

maleve dhe klimës. Laboja e ndiente se asnjëra prej tyre nuk ishte e përpiktë, por edhe vetë nuk ishte i zoti të jepte një përgjigje të saktë. Dhe mundohëj të hynte në të fshehtën e ekzistencës, sa me kirurgjinë popullore, aq dhe me toponiminë.

Kush ishte i pari i fisit? Kjo nuk dihej. Ai nuk la pas dokumente, la pas emrat e maleve, të majave, të shtigjeve. Dhe erdhën deri në ditët tona emrat e mirëfilltë: Maja e Drerit, Kaprolli, Lugu i Luleve, Shtegu i Dhenve, Bridashja. Më vonë erdhën emrat e të parëve të fiseve e të perëndive. Edhe ato zunë shtigje, maja, luadhe, por jo ato kyçet, që mbajnë edhe sot e kësaj dite emrat e pafajshëm të kafshëve. Fisi kishte qenë lakonik dhe kishte lënë shumë pak hyrje për në të fshehtën e tij. Edhe në legjendat dhe gojëdhanat e tij kishte copëra mjegullash të shtyra nga erërat që frynë më vonë nga deti. Grykën nga u futën për herë të parë të huajt, fisi e kishte quajtur: Gryka e Zezë. Dukej sikur ai njihte vetëm dy ngjyra: të bardhën dhe të zezën. Dhe fantazia e tij e zhvilluar gjeti për pabesinë vetëm një krahasim, atë të ujkut, kurse për besën, që ishte kulti i tij, thuri epose të papërsëritshme. Dhe mbeti gjithmonë i prerë, si çdo fis që thërret përvojën e vet në bisedën e përditshme me jetën.

Kur vinte vera, Labos i dukej sikur gjendej më afër se kurrë së vërtetës së ekzistencës së fisit. Dëbora kthehej në kroje, pylli lëvrinte nga krijesat e shumta, luadhet çelnin lule me tërë ngjyrat, sikur rrënjët e tyre kishin thithur gjatë dimrit me durim esencën e tokës. Atëherë Laboja kuptonte edhe shpirtin poetik, edhe përse jeta ishte ngjitur deri aty. Po, kur dimrit era dilte nga honet dhe humnerat si një bishë, së cilës i kanë prishur folenë dhe që s'di ku të futet, Laboja mbetej përsëri pranë pikëpyetjes së madhe të zanëfillës së jetës. Përshtypja e parë që të lindte pas stuhisë që vazhdonte me ditë, ishte heshtja e asgjësimit. Por papritur kërciste një pushkë, apo ndizej një zjarr. Ata që kishin humbur rrugën, ecnin drejt zjarrit apo pushkës. Ishte një komunikim i lashtë që asnjëherë nuk të linte të

braktisur mes monotonisë së bardhë të dëborës. Udhëtarët orientoheshin shumë mirë nga këto shenja jete, shkundnin dëborën në prag të kullës për të lënë jashtë pabesinë e saj të ëmbël, si gjumi. Dhe nxori fisë një fjalë: «Mos fli kur ka furtunë», apo «Gjumi nën dëborë, vdekja nën gunë». Dhe brez pas brezi njerëzit e përcollën këtë mesazh.

Zak Plori dinte shumë mesazhe të tilla. Zak Plori ishte ndodhur shumë herë pranë plagëve. Dhe Laboja e dinte se nuk kishte malësor të vjetër pa plagë në trup. Plagët ishin të ndryshme, si një pyll i përzier, sepse ishin marrë nga armë të ndryshme. Megjithatë kishin vetëm një gjuhë, atë të mbërthimit fort pas atyre shkrepave.

Në rrugën e fshatit po ktheheshin malësorët. Mbi majën që ngjiste me mjekrën e thinjur të Ali Pashë Tepelenës doli hëna. Ajo ra mbi ujin e përroit dhe kërcente nëpër rrymë si një peshk i zënë në rrjetën e degëve të zhveshura të shelgjeve. Në klubin e fshatit Laboja bleu një pako me llokume për nipërit dhe mbesat e Zak Plorit.

— Do ta pish se s'bën një gotë me mua!, — i tha një malësor dhe e uli me zor në tavolinë.

— Bëhem vonë për te Zaku, — u përpoq të justifikohet Laboja.

— Miq si ti i vafshin Zaku, pa le t'i trokasin edhe në mes të natës. Luaji duart, or Dedë!

Deda solli raki kumbulle të zier dy herë dhe pak djathë.

— Si je tani me shëndet?, — e pyeti Laboja malësorin.

— Më mirë se kur isha i ri!

— Prapë mos e lodh veten tepër.

— E pse?

Laboja qeshi.

— I thonë zemër.

— Vetëm nga frika mos pushoftë, se të turpëron, — qeshi malësori.

Kur doli nga klubi, ishte errur. Nata ishte plot dri-

të. Përroi bënte zhurmë sikur po binte një shi i ngadalshëm pranverë. Dhe Laboja ecte drejt shtëpisë së Zak Plorit me idenë se me të vërtetë mbi atë fshat të thellë, të largët në gji të Alpeve, po thërrmohej hëna si një shi i bardhë.

2.

Në dhomë mbretëroi një heshtje e ngrirë, sikur aty po kryhej një operacion i gjatë, i vështirë, që nuk i dihej fundi. Të gjithë prisnin të fliste Zak Plori. Burrat përpiqeshin të merrnin frymë pa zhurmë, kurse nusja më e re nuk dinte nga të vente dhe mbeti si e ngrirë në mes të dhomës. Laboja nuk e mendoi se pyetja që bëri krejt natyrshëm të kishte kaq hije të rëndë, si të shkatërronte një rit të lashtë. Vështroi me radhë burrat dhe, kur në fytyrat e tyre nuk lexoi gjë, vendosi të priste. Zak Plori trazoi hirin e vatrës. Në lëvizjet e tij kishte dhimbje. Ai përziente e përziente hirin, sikur kërkonte të gjente aty përgjigjen e pyetjes që i kishte bërë ky djalë i ardhur nga larg. Deri atëherë atë pyetje nuk kishte guxuar ta shkonte ndër mend asnjëri. Zaku ishte një plak i thinjur, me tipare të zakonshme, por Labos se pse iu duk i largët dhe i pakapshëm, kur ndjeu heshtjen e plotpushtetshme që e rrethoi.

— Si i ke mjekuar plagët, Zak?

Zaku ishte akoma i fortë. Ai trazoi përsëri hirin e vatrës dhe i ndritën sytë. Pak nga pak po çlirohej nga ankthi, si nga një magji e gjatë, e lodhshme, shqetësuese, ku e kishin futur njerëzit për mrekullitë që kishte bërë duke shëruar plagët. Ngriti kokën dhe vështroi jashtë. Hëna qëndronte mbi majën e Pishës së Vetmuar si gjuhëza e zbetë e një kandili.

— Babai im Zek Kolë Mjeku më mori me vete kur u bëra dhjetë vjeç. Më thirri pranë dhe më tha prerë se, po të vdiste, unë duhej të vazhdoja mjekimin e plagëve. Unë u tremba kur dëgjova fjalën «vdekje» dhe

gati sa nuk qava. Por babai im, Zek Kolë Mjeku, ishte njeri i ashpër dhe nuk i duronte dot lotët. «M'u hiq nga sytë dhe sikterisu, po të pashë të qash», — më tha. Dhe atë që thoshte një herë, ai nuk e përsëriste për herë të dytë.

«Burri dallohet nga kafsha vetëm se nuk i trembet vdekjes. Po nuk u bëre dot burrë, hiqja vetes!», — tha babai im, Zek Kolë Mjeku.

Isha gjaku i tij e, nëse u tremba, u tremba se s'më shkonte kurrë në mendje se ai do të vdiste, si vdes çdo njeri.

«Që sot ti do të shërosh plagët që fisi do të marrë në luftë! Do t'i shërosh, që ai të mos zhduket!»

Krahina jonë përherë ka jetuar nën plumba. Po të mbledhësh tërë plumbin e derdhur kundër nesh, bën një urë nga Maja e Bridashit deri në Majën e Kaprollit. Bile, që kur kam lindur, vetëm luftën mbaj mend. Dhe nuk thoshin atëherë ka lindur në filan vit, por në filan luftë. Të huajt vinin taborrë-taborrë. Ishin shumë, si halat e pishave, kurse ne një grusht, si boçja e pishës. Ata vinin e iknin. Në mbeteshim. Mbeteshim aq sa ishim në fillim. Sikur nëna na nxirrte nga çarku i puskës.

Dhe u nisa me babanë. Ecëm një natë e një ditë. Kapërcyem male dhe gryka, pyje dhe përrenj, derisa sosëm. Babai nuk foli fare tërë rrugës. Ndiante diçka të keqe. Kudo luftohej. Të shtënat dëgjohehin një orë larg.

Ditën e pestë u plagos Pjetër Vetëtima. Kisha dëgjuar për bëmat e tij, por, për ta parë, nuk e kisha parë ndonjëherë, megjithëse babai i kishte mjekuar aq plagë, sa nuk mbahej mend. Ai që na lajmëroi, tha se Pjetri kishte marrë tri plagë në gjoks. Kur hymë në dhomën e tij, ai po pinte duhan të fortë, sa kutërbonte tërë dhoma.

«— Erdhe, or Zak?»

«— Si gjithmonë, or Pjetër».

«— Më duket se këtë radhë ke ardhur për herë të fundit», — tha Pjetri.

«— Mos më bëjnë veshët, apo të është ligshtuar zemra?».

Pjetri u përpoq të buzëqeshte, por nuk e lanë plagët.

«— Gratë zbukurohen me gjerdanë, burrat me plagë».

Babai i nxori dy plumba me pompa thane. I treti i kishte hyrë keq. Unë shkova e preva degë nga pisha e kuqe. Babai u vuri flakën dhe e la rrëshirën të pikonte në gjoksin e Pjetër Vetëtimës.

«— Të tretin s'ta heq dot. Ka hyrë ters, si je vetë», — tha babai.

«— Lëre, s'ka gjë».

«— Mos fol budallallëqe. Ai ecën».

«— Po shkoi në zemër, ajo nuk do ta mbajë».

«— Mbetë i marrë tërë jetën, or Pjetër».

Plagët nuk mbylleshin. Ditën e dytë pas vajtjes sonë Pjetri u bë më keq. Mezi mbushej me frymë. Ajri i dilte nga vrimat e plagëve. Në mëngjes erdhi një luftëtar. Pjetri e dëgjoi i qetë. I dha disa këshilla dhe luftëtari u nis.

«— Harroje luftën, në do të shpëtosh», — i tha babai.

«— Mos më hap, or Zek, plagën e katërt», — tha Pjetri dhe u zhyt në mendime.

Në mesditë luftëtari tha se hasmi ishte shtyrë pak. Pjetri fjeti. Kur ia ndërruam plagën, babait iu drodhën duart. Trupi i sfilitur, për çudi, kishte akoma gjak. Në darkë u bë fare keq. Babai tha se Pjetrit nuk i kishte mbetur as dhe një ditë jetë. Unë doja të qaja.

«— Ti do të shikosh vdekjen e një trimi, prandaj ngulite mirë në kokë».

Ula sytë.

«— Mos ki frikë. Vdekjet e trimave nuk të trembin».

Në mëngjes Pjetri u gdhi i zbehtë.

«— Sa vaj më ka mbetur?»

«— Fare pak».

«— Ata luftojnë».

«— Luftojnë».

«— Dhe tani, or Zek, më lër të qetë».

«— Dhe të dua, s'kam ç'të të bëj».

Pjetri u mbështet pas jastëkut dhe vështroi jashtë. Nga larg vinin të shurdhëta krismat e pushkëve. I sillte era. Nuk e di në i dëgjonte apo jo Pjetri. Shikoja se si tretej ai njeri dhe nuk më besohej se im atë nuk e shëronte dot. Ndaj të ngrysur humbi gojën. Por nuk po vdiste. Kjo po i çudiste të tërë, por veçanërisht babanë. Në kullë s'pipëtimte as miza. Kishte rënë zia. Pjetri jetoi pa ngrënë tri ditë. Rrinte mbështetur në jastëk dhe priste. Ditë për ditë luftëtarët sillnin lajme nga lufta. Kur ata ishin të dëshpëruar, gjë që nuk i shpëtonte syrit të Pjetrit, mua më dukej sikur ai mernte plagën e katërt. Burrat pyesnin babanë për çudinë që po bënte vaki në atë kullë. Babai nuk dinte ç't'u thoshte. Pjetri dëboi me sy edhe priftin. Nuk kishte ndër mend të vdiste hëpërhë. Nuk ia mbante gjallë shpirtin shejtani, jo, i tha priftit me sy. Ditën e nëntë erdhi me një frymë një luftëtar i ri, tërë pluhur dhe me kokën të lidhur me një shami tërë gjak.

«— I shporrëm edhe këtë herë!», — tha ai.

Pjetri donte të ngrihej. Luftëtari i ra në gjunjë. Pjetri e puthi në ballë. Pastaj luajti me zor gishtin. Luftëtari shkoi në dritare dhe shtiu. Gëzhoja u rrokullis në dysheme, duke lëshuar një tym të lehtë. Pjetri ia mbërtheu sytë gëzhojës. U ula dhe mora gëzhojën. Sytë e mi u takuan me të Pjetrit. Ia çova. Ai mblodhi buzën e sipërme me hundën. Ia vura atje ku më tha. Ai i mori erë me tërë mushkëritë dhe vdiq. Të nesërmen e varrosëm. Dhe ne u nisëm për këtu. Rrugës nuk shkëmbyem asnjë fjalë. Ishim në luftë. Plagët merreshin brenda krahinës dhe vetë krahina nxirrte bar, frashër, pisha, dëllinja; thanat lëshonin degë të forta, bletët thithnin lulet dhe bënin mjaltë. Burrat nuk mungonin në luftë. Që atë ditë nuk u ndava nga im atë. Po i hyja pak nga pak zanatit. Prisja të shëroja dhe unë. Por babait nuk i mbushej kollaj mendja. Edhe plagët ishin të rënda.

Një ditë sollën te ne një të plagosur në pulpë. Plaga i ishte qelbëzuar dhe plumbi i kishte mbetur brenda.

Kishin filluar ngricat e janarit. Dëbora kishte zënë një kore të trashë, sa mbante sipër edhe mushkat. Trokitën dhe na bënë zë afër mesit të natës. Dola u hapa derën. Ata hynë brenda dhe u shtruan pranë vatrës. Më i riu prej tyre ishte i zbehtë dhe nuk dinte ku ta vinte këmbën e djathtë.

«— Ku u plagose?», — e pyeti babai.

«— Në Gurshqipe».

«— Kur?».

«— Para një jave».

Ai ishte i katërti luftëtar që ishte plagosur në Gurshqipe dhe vinte në shtëpinë tonë për t'u shëruar. Luftëtari nuk ma mbushte syrin. Ishte i druajtur, si ndonjë vajzë. Ta kishte bërë ky me shokët tërë atë zullum? Në Gurshqipe nuk u mor vesh ku ishte toka, dëbora dhe qielli. Çdo gjë u bë duman. Hasmi kishte ikur humnerave, si ajo bisha që fshihet skutave për të lëpirë plagët.

«— Ku të ka marrë plumbi, more trim?», — pyeti babai.

«— Në pulpë. Duhet të ketë qenë ndonjë plumb qorr».

«— Pa zbuloje pak ta shoh».

Plaga ishte mahisur keq. Babai ia preku me kujdes. Kur shikonte plagët, nuk donte të pipëtinte as miza. Isha mësuar të mos merrja frymë për një kohë të gjatë. Heshtnim si akulli.

«— Pse nuk erdhe më parë?».

«— Ky nuk donte të vinte as tani, — tha malësori që e shoqëronte.

«— Oul! Qenke trim i madh, zotrote!», — u nxeh babai. Kishte inat kur të tjerët nuk i binin prapa shëndetit.

«— Në këmbë është, or Zek Kolë Mjeku, s'është në gjoks!», — tha luftëtari duke u skuqur në fytyrë si vajzë.

«— Nga këmba vete në gjoks».

«— Kështu i thosha dhe unë, po ku i mbushej koka! E ka si gdhe thanë».

«— Kur s'e le të vdiste!».

I plagosuri heshti. Ai dukej që ia njihte huqet ba-bait, prandaj edhe nuk bëri zë në fillim. Pastaj ngriti kokën dhe tha:

«— Nuk e braktisja dot pozicionin. Kishte me plagë më të rënda se unë».

«— Pse, mor karafil, vetëm për një luftë të kemi? Beteja e Gurshqipes s'është as e para, as e fundit».

«— Kisha një pozicion të volitshëm», — përsëriti luftëtari.

«— Për të luftuar, s'ka të sharë. Dy ditë e dy net nuk lëvizi nga vendi», — tha burri që e shoqëronte.

«— Pusho, mor ti, se nuk të pyeti njeri».

Zura të përgatitja bërërat.

«— Sikur të venim me mendjen tënde, ne duhej të ishim shfarosur prej kohësh. Dhe hasmi mjaftonte të na plagoste».

«— Jo, mor Zek!», — tha duke qeshur luftëtari.

«— Çfarë jo, mor... Pse, ka shqiptar pa plagë? Hë, më thuaj!».

Jashtë frynte erë. Babai i hodhi një kërcu zjarrit. Duke trazuar hirin, po fliste me vete. Vetëm në këto çaste dukej i plakur.

«— Ky dhë është i bekuar. Ai plagoset bashkë me njerëzit e tij. Pastaj shtrydh zemrën dhe shërohet. Ai ndaj nuk vdes».

Dhe papritur iu drejtua luftëtarit:

«— Kurse zotrote nuk doje ta dëgjoje. Edhe ti, — më tha, — vëri vëth në vesh këto që po të them. Kur të vdes, bisedo me dheun! Aty ke ç'të duash. Dhe tani, pa na trego sa je i zoti t'i shërosesh plagët e trimave!».

Pas tërë atij vreri nuk e prisja të më linte mjekimin e këmbës së luftëtarit. Fillova ta pastroja qelbin me ujë frashri, ja nga ai frashri që mbin fare badiava kudo, në pyll apo lirishta. I plagosuri nuk e prishte te-rezinë dhe më vështronte me buzën në gaz. Kur u vrenjt njëherë në fytyrë, m'u drodh zemra.

«— Të dhëmb?», — e pyeta.

Por befaz babai im, Zek Kolë Mjeku, ulëriu:

«— Qen! Zemërlepur! Kush të ka mësuar të pye-

sësh trimat, në i dhemb apo nuk i dhemb plaga? Hë? E di se ta marr shpirtin me këto duar, pa m'u dhimbsur fare!».

«— Mos i fol kaq rëndë djalit, or, Zek! Është akoma i vogël».

«— Këtë duhej ta kishte mësuar që në bark të s'ëmës».

Më erdhi për të qarë. Por, po të më shihte me lot në sy, ai do të zemërohej më tepër.

«— Thithja! Me një të thithur t'ia nxjerrësh!», — më urdhëroi.

I plagosuri më fërkoj flokët. Babai e pa me inat, por nuk i tha gjë.

«— Jepi, kapedan!», — më tha burri që shoqëronte të plagosurin.

Babait i ra inati menjëherë.

«— Nga plagët e trimave, mos ki ndoht, bir!», — më tha me një zë të butë që nuk e kisha dëgjuar kurrrë.

Më erdhi t'i hidhesha në qafë. Po plakej babai im Zek Kolë Mjeku, po plakej.

Vura buzët mbi plagë dhe doja që plumbin ta nxirrja menjëherë, më shumë për tim atë, sesa për vete. Plaga mbante erë dhë. M'u duk sikur puthja tokën. Me të vërtetë, toka merrte plagë së bashku me trimat. Thitha ngadalë dhe plumbi po rrëshqiste lart. E kapa me dhëmbë. Kur e nxora, babai më puthi. Për të parën herë dhe të fundit. Pastaj burrat më shtrënguan dorën.

«— Pregatit melhemin!», — më tha babai.

Mora gjalpë pa kripë, dyll blete, një filxhan kafe me bar pezmi, lëkurën e dytë të shtogut, lëkurën e dytë të frashrit, bluashka nga pisha e madhe e kuqe. Treta gjalpin me dyllin në një zjarr të ngadalshëm, pastaj hodha të tjerat gjersa morën një ngjyrë kafe të hapët. Me këtë melhem e mjekova tri ditë rresht. Ditën e katërt iku. E përcolla deri atje ku duket Gurshqipja. Më puthi fort dhe mori malit përpjetë. U ktheva me një frymë në shtëpi. Babai rrinte i menduar pranë vatrës. Ma bëri me dorë të ulesha pranë tij.

«— E përcolle, bir?».

«— Po».

«— Si ecte?».

«— Shumë mirë, nuk çalonte fare».

«— Domethënë, iku përsëri në luftë!», — tha pa e fshehur kënaqësinë dhe më hodhi në këmbë kutinë e duhanit.

3.

Mëngjesi i së nesërmes ishte i kthjellët, me një ajër të lehtë, sikur dikush kishte thithur peshën e gjithçkaje. Laboja ecte mes pyllit dhe ndiente fëshfëritjen e butë të gjetheve që ndaheshin tërë dhimbje. Nuk e kuptoi përse iu duk sikur në fërkimin e tyre kishte diçka nga ndarja e njerëzve para spitalit infektiv të verdhëzës. Purteka e padukshme e vjeshtës binte pa pushim mbi degët e aheve. Drurët, të qethur vende-vende, ngriheshin të menduar, të heshtur si rekrutë, që ishin thirrur të mbanin mbi shpinë ndërrimin e stinëve. Ndonjë zog që trembej nga hapat e tij, fluturonte e pastaj ulej në ndonjë purtekë të hollë e mezi priste sa të largohej njeriu për të vazhduar çukitjen e dheut tërë vlagë. Nga larg Shkëmbi i Gurshqipes mprihte sqepin e bardhë pas reve.

Labos i vërtitëshin në kokë në një cirkulacion marramendës ato që i tregoi Zak Plori, dhe ato që Zak Plorit ia kishte treguar i ati, Zek Kolë Mjeku, dhe ato që Zek Kolë Mjekut ia kishte treguar i ati, Kolë Suk Voci, dhe ato që Kolë Suk Vocit ia kishte treguar... Dhe krijohej kështu një ujëvarë emrash, e cila përhapte kudo stërkalat e saj. Ato binin dhe toka i thithte për të ushqyer rrënjët dhe rrymat e nëndheshme. Duke ndjekur mendimet e natës, Laboja i afrohej të parit të fisit që kishte ardhur në këtë krahinë dhe kishte hapur shtigje nëpër pyll, luadhe dhe male. Ai kishte gjetur këtu tokë, ujë, zjarr, lule dhe bimë. Banori i parë e kishte ndier veten si në mes të një farmacie gjigante.

«— Por, kur plagët merreshin nga plumba të rinj, që s'i kishit parë ndonjëherë, si i mjekonit?», — kishte pyetur ai Zak Plorin.

Zaku ishte menduar dhe i ishte përgjigjur:

«— Plagët, nga çdo plumb të merren, mbeten plagë. Ato kurrë nuk janë të reja. Pastaj, këtu çdo bimë ka sëmundjen e saj dhe çdo sëmundje ka bimën e saj».

Këtë Zak Plorit ia kishte thënë i ati, të atit gjyshi, të gjyshit stërgjyshi. Dhe mbeti dhe u shtua fisi, se plagët i mori në truallin e vet, se çdo gjë e kërkoi në dheun e vet.

Mbasi kaloi pllajën e vogël, Laboja hyri në rrënojat e një kalaje të lashtë. Arkeologët s'kishin veçse dy javë që ishin larguar që andej. Dielli binte mbi tokën e shkrifët dhe bari po shponte cipën për të nxjerrë syrin e tij të gjelbër. Laboja u ul mbi një gur. Vinte shpesh aty dhe tani i vinte keq për ato rrënoja që kishin rënë në qetësi. Ai u njoh menjëherë me arkeologët. Poshtë mureve ishin varrezat e hapura, të punuara me shumë kujdes. Mbi to binte dielli i fillimit të vjesh-tës. Për herë të parë ato shihnin si ndërroheshin stinët mbi tokë. Varrezat i përkisnin shekullit të pesëmbëdhjetë.

«— Ne jemi nga ata popuj që ballsamosjen e luftëtarëve e kemi pasur si gjë të domosdoshme», — i kishte thënë Laboja një arkeologu.

«Diku kam lexuar se deri në fund të shekullit të pesëmbëdhjetë kisha nuk e ka lejuar autopsinë».

«— Po, — tha Laboja. — Kurse të parët tanë nuk e linin luftëtarin e vrrarë në fushë të betejës, por e çonin në shtëpinë e tij për ta varrosur. Kur fshati ndodhej larg, ata e ballsamosnin luftëtarin. Ballsamosja e tyre është diçka e lashtë».

«— Ky respekt ka qenë i përhershëm».

«— Ai është më i lashtë se këto varreza».

«— Gjithnjë populli ka diçka më të lashtë se atë që ti sheh, se atë që lexon, se atë që di», — i qe përgjigjur arkeologu.

Dhe ata vunë re mbi një gur një gjethë të gdhendur.

«— Ç'bimë t'i përkasë kjo gjethe?»; — e pyeti arkeologu.

Laboja e vështroi me vëmendje dhe njohu gjethedellin.

«— Zakonisht, kjo bimë përdoret për të shëruar plagët. Ndofta ky mund të ketë qenë varri i ndonjë mjeku, që, para se të vdiste, ka kërkuar t'i gdhendnin mbi gur këtë gjethe, me të cilën ka mjekuar luftëtarët».

«— Plini i vjetër përmend se ilirët përdornin mbi një mijë bimë, — tha edhe arkeologu. — Dhe, ndofta, kjo gdhendje e rëndomtë, pa vlera artistike, s'është veçse një mesazh vazhdimësie».

«— Ndofta», — tha Laboja.

Arkeologu mori një furçë dhe filloi të fshinte pluhurin nga e gdhendura. Pluhuri binte përtokë, duke u vërtitur rreth gdhendjes sikur i vinte keq dhe habi që ngjeshja e tyre shekullore po shkundej aq shpejt. Gjethedelli po merrte trajtat e plota, e druajtur, që me sqepin e saj kishte çarë guaskën e vazhdimësisë. Më tej punëtorët po nxirrnin muret e rënda të kalasë që rrëshqitja nuk i kishte prekur fare.

«Fisin e detyruan të ngrinte kala», — mendoi Laboja. Dhe, iu përfytyruan dyndjet. Ato ishin të shpeshta, si shtrëngata dimri. Vinin kur hynte pranvera dhe largoheshin kur dimri lëshonte poshtë ortiqet me dëborë. Fisi nuk u shpërngul asnjëherë. Mbeti aty. Nga mademet nxori gurë të rëndë. Dhe mbeti. Erdhën emisarët e fesë dhe sollën lebrën. Fisi e quajti gërbulë. Emisarët e quanin të dënuar nga zoti tërë fisin kur dikë e zinte lebra. Të huajt sollën sëmundje të panjohura dhe shfarosëse. Fisi e kërkoi ilaçin gërxeve, pllajave, luadheve, drurëve, rrënjëve. Piu sanëz, që të kishte gjak. Dhe sanëza mbinte kudo. Në qershor ajo çelte lulet e verdha. Rrënjët thithnin tokën.

Në lëndinën e vogël kishin mbetur akoma hunjtë e çadrave të arkeologëve. Laboja nisi të ecte nëpër rrënojat e kalasë. Dielli dukej më i nxehtë se kurrë. «Ndofta ftohtësia e shekujve nuk u ka dalë akoma gurëve e mureve», — tha Laboja me vete. Një zog me gjoks të kuq,

sikur kishte vënë përparëse, çukiti vesë. Vështroi Labon me sytë e tij naivë dhe nuk u tremb. Laboja qeshi. «Kush ka dalë nga lashtësia, unë apo ti, që nuk e njohim njëri-tjetrin», — mendoi ai. Atje poshtë lumi, si mbliidhte përrenjtë, rridhte i rëndë drejt detit. Troftat ngjiteshin lart, sa më afër dëborës. Gurët që lidhnin mesjetën me thellësinë ilire heshtnin sikur nuk donin të zbërthenin enigmën që fshihnin. Labos i dukej sikur kishte shkuar deri aty për t'u marrë vesh me heshtjen, që këtë mëngjes të bukur të deshifronte jetën e një qyteti të përënduar. Si fillonte dikur jeta në këtë qytet? Diku brenda këtyre mureve ishin punishtet dhe farkëtarët lodheshin tërë ditën. Krahina donte armë për luftërat që nuk i ndaheshin. Mbi këta gurë asgjësimi hidhte zjarr, fjalë dhe sëmundje. Ato përplaseshin pas tyre e u hapnin plagë. Dhimbja duhej të ishte e madhe, sepse zëri i gurëve dëgjohej deri larg. Koha e plagëve të gurit dhe të burrit! Dyert mbylleshin. «Si çdo kala, edhe kjo duhet të ketë një dalje të fshehtë. Arkeologët nuk e zbuluan dot këtë vit». Laboja u vërtit nëpër rrënojat dhe se pse i erdhi keq që dalja e fshehtë dergjej diku aty. Prej saj dilnin ditë për ditë me trastë në krah mbledhësit e bimëve e të rrënjëve. Rruga e tyre ishte e lodhshme. Në atë trastë të thjeshtë i huaji nuk mendonte se fshihej armiku i tyre. Të huajt lëshonin me kokëfortësi asgjësimin drejt gurëve të mureve. Mjekët ishin kudo ku plagët pikonin ditët e luftës. Nxirrnin nga trasta melhëmet e barërat, si të nxirrnin bukën, susakët me ujë. Dhe iknin. Kur ktheheshin përsëri brenda këtyre mureve? Me siguri natën, kur qetësia binte e lodhur mbi grykat e maleve dhe mbi drurët e zhveshur nga stina e barutit dhe e përleshjeve. Stinët duhej të kishin dhimbje në ngatërresën e tyre. Laboja tha me vete se ndofta ai qytet kishte qenë nga qytetet e rralla ku nuk respektohej ndërrimi i stinëve.

Pylli po shkundej nga dremitja e rëndë. Labos në atë çast iu kujtua diçka që i kishte thënë Zak Plori dhe e shënoi në blok. U hodhi edhe një sy rrënojave dhe u mat të largohej. E ndiente se ai vend kishte hyrë në

mbresat e tij, duke e lidhur akoma më fort me jetën e krahinës. Ato rrënoja ishin tani pranë detit të fëmijnisë, pranë mimozave në rrugën e fakultetit të gjeologjisë, pranë dhomës numër njëmbëdhjetë të konviktit, pranë sallës së operacionit, pranë përroit të vogël, buzë të cilit ngrihej spitali i lokalitetit, pranë...

Deri në lokalitet duheshin edhe tri orë të mira. Nga larg dalloi Shtegun e Dhëndrit të Turpëruar. Labos i kujtohej përherë origjina e këtij toponimi sa origjinal, aq edhe komik. Por atë ditë ky toponim sepse nuk i duk komik. Kjo kishte ndodhur kohë më parë. Në këtë shteg ecnin dasmorët me nusen në mes. Rrëshqiti mushka dhe rrëzoi dhëndrin në greminë. Por, që të vinte deri në ditët tona ky toponim, u desh që dhëndri të mbe tej varur në një nga pishat që kishin mbirë në mes të shkëmbit. Askush nuk guxonte të zbriste deri aty. Ata harruan dasmën, dhe të dehurve u doli pija menjëherë. Në atë shteg kishin thyer kokën edhe dhitë e egra. Atëherë dasmorët panë me sy një çudi. Nusja hoqi rrobat e rënda dhe u kacavir poshtë, duke i mbërthyer gishtërinjtë pas të çarave si ndonjë mace e egër. Dhe e ngjiti lart të shoqin, duke i lënë pas turpin. Kur e dëgjoji për herë të parë këtë histori, Laboja tha se shtegu duhej të mbante emrin e nuses, por malësorët qeshën nën buzë dhe ai nuk e zgjati më. Mbi cilën pishë të kishte rënë dhëndri? Laboja ndjeu një trishtim të lehtë. Dhe mendoi se kështu i ndodhte përherë në vjeshtë, që kur ishte fëmijë e shikonte si binin në rrugicën e oborrit fletët e zverdhura të pemëve. Por, tek po i afrohej lokalitetit, ai e ndiente se nuk ishte ky shkaku i vërtetë i atij trishtimi të lehtë, si krahu i bardhë i reve mbi majat e maleve kur avullonte toka.

4.

Në lokalitet u kthye ndaj të ngrysur, sepse qëndroi në restorantin e Ujit të Ftohtë me disa gjeologë. Para hyrjes së spitalit qëndronte mamia. Ajo kishte filluar

punën para dy muajve dhe Laboja sillej me të si me një gjimnaziste të përkëdhelur. Vera largohet me kokën ulur, si e fyer, kurse sytë i qeshnin tërë dinakëri, si një hardhucë që të vështron nga vrima e folesë. Kur koha ishte e ngrohtë, ajo qëndronte ulur te shkallët e spitalit, me bërrylat mbi gjunjë e fytyrën futur midis pëllëmbëve, dhe vështronte malet me një përhumbje fëmijnore. Laboja ishte kureshtar të dinte se ç'mendonte ajo në ato çaste, por nuk guxonte ta pyeste. Ditët e fundit Vera mezi priste sa të niste dëbora.

Laboja e njohu nga larg dhe u habit me veten. Ndjeu një tronditje të ëmbël kur pa fytyrën e saj të mërzitur, së cilës ia kishte mbërthyer sytë e nuk ia ndante. Iu duk sikur ajo kishte kohë që po e priste dhe ishte mjaft e shqetësuar. Dhe befasi i vezulloi në mendje se, ndofta, shkakun i vërtetë i trishtimit që e kapi kur ishte në Shtegun e Dhëndrit të Turpëruar, ishte ndjenja e mungesës së kësaj pritjeje. Por e largoi menjëherë nga mendja këtë supozim dhe u përpoq të buzëqeshte.

Kaloi urën prej dërrase dhe hyri në oborrin e spitalit me një ndjenjë faji të kotë. Vera nuk ia ndante sytë, sikur ai të vinte nga një skaj i largët dhe i panjohur. Ndofta, ai vinte nga rrënojat dhe nga rrëfenjat e Zak Plorit. Laboja e ndjeu se, në vend të buzëqeshjes, fytyra e tij po përpiquej të imitonte atë më shumë se çdo herë tjetër. Ai mendoi ta thërriste «gjimnaziste», por se pse u step nga fytyra serioze e Verës. Atij i pëlqeu ta quante veten fajtor të trishtimit të Verës dhe eci drejt saj, si drejt një mjegulle delikate dhe vegimtare. Si një mjegull duhet të kishte zbritur edhe nusja te shtegu ku rrëshqiti mushka dhe rrëzoi dhëndrin. «Ajo nuk është aq e vogël, sa duket», — i feksi atij në mendje.

— Ku humbe?, — tha Vera.

— Isha larg. Ç'kemi ndonjë gjë këtej?

— Askush nuk ka pyetur për ty, — tha Vera dhe hyri në spital.

Laboja qëndroi i pavendosur në prag të derës. A thua Vera ishte me të vërtetë një vegim mjegullor, i

shkaktuar nga imagjinata e tij e lodhur? Apo atë ditë më shumë se kurrë kishte nevojë që një vajzë e dashur ta priste e shqetësuar gjersa ai të shfaqej nga dhiaret, ashtu i lodhur e tërë pluhur, dhe ta pyeste si ia kishte kaluar. Laboja nuk ishte i zoti të përgjigjej. Dhe nuk lëvizte nga vendi. Ndërsa muzgu alpin po ia linte vendin errësirës së natës. Mbi majën e malit u dukën si kasnecë të dëborës së parë disa re të rënda, ngjyrë hiri. Vera doli nga spitali dhe i kaloi pranë. Kishte veshur pallton e kuqe. Ajo përpiqej të dukej sikur nuk i bënte gjë përshtypje. Dhe padashur Laboja e thirri:

— Ku shkon kështu, moj gjimnaziste?

— Të shoh televizor.

— Çfarë ka?

— E ç'të duhet ty?

— Kot. Jam kurioz të di se ç'do të shohësh.

Vera qeshi dhe Laboja përsëri mendoi padashur «gjimnaziste».

— Volejbol.

— Po ti me kë je tifoze?

— Paske qejf për muhabet, — tha Vera dhe bëri të largohej. Kur nuk kishte hedhur as dy hapa, ndaloi dhe foli pa e parë në sy: — Dhe tjetër herë, kur të largohesh, u thuaj të tjerëve sa do të vonohesh.

Ajo shpejtoi çapet sikur po e prisnin diku. Laboja u përpoq të vinte buzën në gaz, por nuk mundi. Mbi urë ushtuan hapat e Verës. Ajo sikur bënte kastile aq zhurmë. Vëmendjen e kujt donte të tërhiqte me ankimin e dërrasave të urës? Laboja u mat të hynte në spital me një ndjenjë të tillë, sikur aty përjashta po linte të braktisur diçka. Ndofta vegimin e bardhë mjegullor, që, mbështetur pas murit, kishte pritur një kohë të gjatë e pastaj kishte ikur tutje e ishte tretur.

Në dhomë ishte errët. Atë natë nuk do të punonte. Mbrëmja i shoi të tëra zhurmat, përveç zhurmës së lumit. Laboja mbështeti bërrylat mbi parvazin e dritares dhe u përpoq të gjente nëse do të binte apo jo dëborë atë natë. Se pse po e priste me padurim dëborën e parë të atij viti.

As atë natë, as netëve që pasuan më vonë në qendrën e vogël të lokalitetit nuk ra dëborë. Laboja filloi të shkruante studimin dhe pak nga pak ajo që i ndodhi me Verën, kur u kthye nga Zak Plori, i dukej sikur ia kishte treguar një i huaj, kohë më parë. Veçse, sa herë që kthehej në spital, priste të shikonte përsëri vegimin e bardhë të pritjes. Vegimi herë merrte fytyrën e Verës, herë fytyrën e një të panjohure të çuditshme, që s'dihej përse kishte zbritur deri aty. Midis tij dhe Verës kishte hyrë një farë druajtje që ata nuk e shfaqnin, por e ndienin. I dukej sikur kishte tradhtuar veten në diçka që s'duhej të tradhtohet. Vera filloi të vraponte nëpër korridor, si më parë; të qeshte me gjithë zemër, si më parë. Askush nuk e vinte re ndryshimin e saj, atë vello të hollë trishtimi që mbështillte sytë e saj, sa herë që aty pranë ishte dhe Laboja. Laboja kishte çaste që për çdo gjë ua hidhte fajin mendimeve që e pushtuan kur po kthehej rrugëve të vjeshtës.

Tani mbyllej në dhomë më herët dhe shkruante. Puna e tij ishte më tepër një sistemim i të dhënave, sesa një studim. Ai nuk mërzitej nga kjo gjë. Në ato të dhëna ishte një pjesë e së fshehtës së ekzistencës së jetës në atë krahinë. Të tjerët le të ngrinin studime mbi të dhënat e tij. Ai përpiqej të ishte i saktë në plagët, bimët, lulet dhe drurët. Në krahinë u hap fjala se doktor Laboja mbledhte të dhëna për mjekët popullore. Dhe një ditë erdhën në spital dy malësorë nga një krahinë e largët. Kishin bërë tërë atë rrugë. Laboja u prek. Malësorët i treguan për sëmundje dhe shërime të ndryshme. Sa i mbetej pak kohë, Laboja nisej fshatrave. Kur kthehej, nuk i durohej të shihte nëse po e prisnin, apo jo. Por ajo ditë nuk u përsërit më. Njëherë iu duk sikur lëvizti perdja e dritares në dhomën e Verës, njëherë tjetër perdja e dritares në dhomën e pacientëve, njëherë perdja e korridorit. Nxitonte dhe hynte me një frymë, po korridori dhe dhomat ishin bosh. Dilte në

oborr. Dhe aty era mblidhte trishtimin e gjetheve të fundit të drurëve.

Ditët rridhnin dhe e linin dimrin alpin. Dhe një ditë dikush tha se Fusha e Kalit u bllokua nga dëborra. Laboja mendonte se vetëm Vera nuk interesohej për pasionin e tij.

Edhe atë ditë Vera hyri si zakonisht në dhomën e tij dhe i tregoi për një mjeke popullore. Ajo fliste dhe Laboja nuk ia ndante sytë. Ishte si i dehur, si atëherë kur nxori nga spitali të shëruar pacientin e parë. Vera fliste si me mospërfillje dhe nuk e dinte se ato që i tregonte ajo e fushnin Labon akoma më thellë drejt së fshehtës së ekzistencës së jetës në krahinë.

— Për të pasur qumësht, lehonës i jepnin bukë misri, djathë të njomë dhe qumësht. Kur ishte koha e misrave të njomë, ia piqnin pak apo ia zienin.

— Po tjetër, Vera?

— U kanë dhënë edhe lule shtogu të ziera për një çerek ore, ose... dale, se m'u kujtua, edhe qerbash.

Laboja shkruante shpejt e shpejt.

— Ndërsa një plakë më tha dje se i kishte dhënë nuses dy lugë me fara hithrash dhe me sherbet mjalti.

Laboja la stilografin dhe e vështroi Verën në sy.

— Ç'më shikon kështu?, — tha Vera.

— Pse nuk më thirre edhe mua kur erdhi ajo plakë?

— Kot. Pse nuk të pëlqejnë kështu si po t'i them?

— Jo, por...

— Ti, po të duash, shënoi, po nuk deshe, nuk të detyron njeri.

— Vera, ti prekesh si fëmijë.

— Mirë, mirë, ma ke thënë njëqind herë këtë. Do të dhëna të tjera?

— Ou! Po ti qenke një mbledhëse e shkëlqyer!

— Shënoi! Ehb i shtypur dhe i zier, ftua i pjekur, i lyer me sheqer...

— Më ngadalë se nuk të ndjek dot.

— Ehu, këto janë aq të thjeshta, sa...

Vera nuk vazhdoi, se Laboja i ndërhyri menjëherë,

i trembur se mos i rrëzohej dhe i humbiste kënaqësia që i jepte mendimi se edhe Vera i kishte hyrë mbledhjes së të dhënave më po atë pasion që kishte edhe ai. Ky mendim e afronte akoma më tepër.

— Ti nuk e merr me mend sa të rëndësishme janë këto. Ti, me siguri, ia ke bërë vetes pyetjen, sepse je vajzë e zgjuar, si nuk u zhduk jeta nga këto vise kaq të ashpra. Lufta dhe ashpërsia e natyrës nuk iu ndanë asnjëherë kësaj krahine. Por fisi mbeti. Mbeti, se nuk i mungoi gjaku dhe qumështi. Erërat e kanë ngrënë këtë tokë më shumë se plugu. Dëbora e ka mbuluar më shumë se gjelbërimi. Por thellë saj ajo rriste bimët. Rrënjët nuk iu shfarosën kurrë. Kur vinte pranvera, sanëza shpërndante farërat e saj. Dhe fisi i mbledhte. Ai pinte sanëz dhe nuk e njohu aneminë. Piu fara hithradh dhe pati qumësht. Ai kapte plumbin dhe e nxirrte nga plagët me dhëmbë dhe derdhte mbi to gjakun e pishave. Ajo nuk është e thjeshtë, Vera.

Tëk dëgjonte më sa pasion fliste Laboja, Vera u pendua që i foli pa u menduar. Ndokush, që nuk e njihnte atë krahinë, ndofta do të qeshte më pasionin e Labos, kurse ajo nuk ia lejonte vetes këtë kalamallëk. Po rritej pa e kuptuar edhe vetë. Një mjegull e lehtë po mbulonte vitet e saj pa kokëçarje. Zëri i Labos tani i dukej krejt i ndryshuar, sikur vitet kishin futur aty diçka nga vetja e tyre, diçka të rëndë, tragjike, diçka të butë, të lehtë, si qumështi i lehonave. Ajo dëgjoi përsëri emra bimësh, farërash, rrënjësh. Në to është dashuria për të mbetur përherë pranë pyllit dhe arës, pranë fëmijëve dhe gjyshërve, pranë nina-nanave dhe djepeve. Çfarë the?! Ai tha se asnjëri prej tyre nuk e përfytyronte dot brengën e djepit bosh. Jo, e kishte ndërprerë Vera. Si? Unë e përfytyroj. Më shumë se heshtje, brenga e djepit bosh ishte mbretëria e akullit. Vera u drodh. Në një mbrëmje vallëzimi një djalë, student në filologji, i kishte thënë se ajo ishte si akulli. Vera kishte ngritur supet dhe kishte qeshur. Tani nuk qeshi. Prandaj gjërat nuk janë aq të thjeshta, sa duken. Akulli mbi dashurinë, si një helmetë mbi kokën e

një ushtari të vrarë. Asaj i zuri veshi ca fjalë për pishat te Shkëmbi i Ujit. Përse po flisje? S'po më dëgjon? Të dëgjoj, po sepse m'u kujtua një film për Polin e Veriut. E çfarë, pishat? Ato rriten në shkëmb dhe thithin me rrënjët e tyre gjakun e tij. Nuk të marr vesh fare. Gjaku dhe qumështi është jeta. Më kupton, Vera? Jo dhe aq mirë. Se si e kam kokën. Të lodha dhe unë. Jo, jo, vazhdo të lutem.

Ajo nuk e kishte parë Labon të fliste ndonjëherë me aq pasion. Ai fliste, dhe sytë e tij shihnin si të përhumbur diku larg. Ajo tha me vete se nuk do të mërzitej kurrë së dëgjuari zërin e tij. E ndiente veten të shkëputur nga ajo dhomë. As vetë nuk e dinte se ku ndodhej.

Jashtë muzgu po binte i hirtë. Mbi xham, duke u përdredhur, ra një flok dëborë. Pak nga pak Vera po kthehej në gjendjen reale. Dhe papritur u trondit. Laboja ia kishte ngulur sytë, por nuk vështronte atë, po dikë tjetër, së cilës përpicej t'i thoshte diçka, të bukur, të lumtur. Pas flokut të parë ra i dyti. Vera u mbështet mirë mbi parmakun e dritares, sikur donte me çdo kusht të dallonte atë që kishte përhumbur vështrimin e Labos. Por jashtë, përveç belbëzimit të dëborës së parë, nuk dukej gjë tjetër. Dëbora shtohet përtokë, ndërsa malet dhe pylli u zhdukën përtej perdes së saj të bardhë. Atë po e pushtonte një ngazëllim fëmijnor dhe, pa e kuptuar, nisi një këngë që mendonte se e kishte harruar. Përse fliste ajo këngë? Ndoshta, për trokitjen e parë të dashurisë. Përse fliste ajo këngë? Ndoshta për fëmijët që presin Vitin e Ri, ndërsa jashtë bie dëborë. Përse fliste ajo këngë? Vera u kthye me rrëmbim nga Laboja dhe tha:

— Labo, shiko sa bukur bie dëbora!

6.

Mbas dy ditësh në krahinën e Gurit të Mirë mbretëroi një qetësi e tillë, sikur donte t'u jepte mundësi njerëzve, fshatrave për të pyetur njëri-tjetrin si ishin

me shëndet. Lumi i vogël që ndante lokalitetin u mbulua nga dëborë dhe zhurma e tij vinte si jehonë e largët e diçkaje që po humbiste rebelimin e saj. Pishat, me heshtjen e tyre rapsodike, lëkundeshin më të rrallë, sikur rregullonin gunën e trashë të dëborës mbi shpatullat e tyre të gjera. Vera nuk ngopej së pari peizazhin e bardhë. Dhe i dukej sikur ndodhej papritur në një botë të panjohur, të thinjur nga lashtësia dhe të zbuluar rastësisht, nga një trill i kohës. Dhe gjurmët e kafshëve mbi dëborë ngjisinin me dorëshkrime të vjetra, të padeshifruara. Maja e Kthjellës të verbonte sytë. Pylli i përzier nuk ishte më i tillë. Vera tha se ai tani ishte pylli i përrallavë. Ç'bëjnë banorët e tij? Dhe Vera priste që ata të dilnin një nga një. Por pylli nuk pipëtinte dhe nuk e prishte dremitjen e tij të rëndë. Kush do të zgjohej i pari: ketri apo Borëbardha?

Në oborrin e spitalit, me një çantë marshimi në kurriz, doli Laboja. Vera u drodh. Sesi i ngjau dalja e papritur e Labos mes bardhësisë verbuese të dëborës. Sikur doli nga një botë e stisur nga fantazia e saj në një çast dobësie. Çdo gjë humbi konkretësinë e saj. Vetëm në ëndërr njeriu ecën aq lehtë dhe hapat e tij bëjnë këtë zhurmë ngacmuese që largohet e largohet. Krup-krup. Gjurmët mbi dëborë ngjanin si një varg me pata në shtegtim. Kështu largohemi edhe ne nga ditët e fëmijnisë dhe të rinisë. Kjo gjurmë këtu është ajo kur u shpërua nga shtrati dhe ecte mbi dysheme, kjo kur shkove në klasën e parë, kjo kur mbarove të mesmen, kjo kur... Vera nuk e dinte se ç'gjurmë linte dashuria. Mbështeti ballin mbi xham dhe buzët krijuan një varg të panjohur poezie.

Përse nuk ktheve kokën kur kalove mbi urë?

Laboja mori shtegun që të çonte në Lug-Dardhë. Ai nuk e ktheu kokën asnjëherë pas të shikonte lokalitetin e vogël. Kur u kujtua, kishte hyrë thellë në pyll. Një dushk i mbuluar nga dëborë dukej si kasolle. Pylli ishte i heshtur, po jo aq hijerëndë sa në pranverë. Dë-

bora dhe ajri e bënin gati të pabesueshme moshën e tij shekullore. Një dhelpër e trembur u var poshtë shpatit. Nga thellësia e pyllit u dëgjuan goditjet e një sëpate. Shtegu ishte hapur më parë. «Si lidhet jeta!», — mendoi Laboja. Ai përfytyroi tërë shtigjet që mund të hapte jeta për të arritur te njerëzit. Ato ishin të shumta, sa nuk numëroheshin dot.

Laboja po kalonte në Grykën e Erës. Pishat ishin prirur nga jugu. Në atë grykë frynte vetëm veriu. Ai po u binte zileve të akullta. Halat e pishave kishin ngrirë dhe dukeshin si kristale të një abazhuri të madh. Ndonjërin po e shkrinte dielli. Dukej si një llambushkë e ndezur. Laboja mbajti vesh. Dëgjonte muzikën njënotëshe, naive të halave të pishave. Shshsh! Shshsh! Po vjen Plaku i Vitit të Ril' Ku? Ja, e dëgjoni si bien zilet e karrocës së tij? Jo, janë ditët e fëmijnisë, nga të cilat nuk shkëputemi dot.

Nga larg u duk Lug-Dardha. Kur u afrua, Laboja vuri re se në fshat bashkoreshin tërë ato shtigje. Mbi dëborën e ngrirë ato dukeshin si damarë të mëdhenj që shpërndanin jetën nga zemra e krahinës në periferi të saj dhe nga periferia e krahinës drejt zemrës së saj.

7.

Lug-Dardha është fshati më i thellë i tërë krahinës Guri i Mirë. Ai është ngritur nën hijen e një shkëmbi, që banorët i thërresin me një emër të çuditshëm: Guri i Vjeshtës. Nga të çarat e tij të shumta, shpërthen uji; nga zgavrat, në qershor, kullon mjalti, kurse në guvat e shumta, shtohen dhe ngordhin të plakur pëllumbat.

Kur Laboja hyri në fshat, mbi shkëmb rrëshqisnin retë, kurse pishat grindeshin me erën, duke e kërcënuar me degët e moshave të ndryshme. Retë lëshonin fjalë të ngrira në formë dëbore dhe vazhdonin shtegtimin e tyre dimëror.

Ai trokiti në shtëpinë e bacë Ujkanit me një farë pasigurie. Tërë atë rrugë e kishte marrë për të mësuar

diçka nga tragjedia e epidemive dhe e luftës kundër saj. Kishte kohë që mendonte të gjente si e kishte përballuar fisi luftën me mikrobet e padukshme. Ai e dinte se kjo ishte lufta më e rëndë e fisit. Mikrobi fshihej diku dhe pabesia e tij e ligë të rrëqethte. Ai fshihej me vite të tëra me një durim të përbindshëm. Laboja diçka dinte, por donte të ishte sa më pranë atyre që e kishin jetuar luftën me mikrobin e padukshëm të epidemive. Ai e dinte se kishte dy lloj lebrash: lebra vendëse dhe ajo e importuar. Ai erdhi këtu të mësonte diçka mbi lebrën e importuar. Kush e kishte sjellë atë thellë mikrobin e saj, i cili zgjohej nga gjumi si kalonin vite e vite të tëra, njëzet, tridhjetë vjet? . . . Dhe shfaqej në fytyra me ngjyrën e saj të errët, me kokrrat . . . Deformonte fytyrën dhe të folurin. Shenja ogurzeza, kryqe mbi jetën e të gjallëve. Zgjimi nga gjumi i gjatë e bënte mikrobin hakmarrës për vitet e errësirës nga doli. Lebra! Malësori Fran Rrok Jaku, kur sëmundja ia mblodhi gishtërinjtë e shkurtuar sa nuk mund t'i hapte dot, u hodh në lumin e krahinës. Vdekjen e tij e shpejtoi sidomos lajmi se në kufi të krahinës përsëri po shfaqej i huaji. Krahina kishte pasur disa vjet qetësi. Por tek i huaji ishte zgjuar nga inkubacioni, si lebra, mikrobi i luftës. Askush nuk e dinte me siguri nga kishte ardhur lebra, Laboja ishte takuar me disa nga pleqtë njëqindvjeçarë të krahinës dhe ata nxorën nga rrudhat e kujtesës ato që kishin dëgjuar nga gjyshërit e tyre. Si nëpër mjegull ata riprodhonin të dërguarit e një feje të largët, me fytyra të çuditshme, si nata, dhe me dëshirën po atë të çuditshme për të hyrë nëpër shtëpi e për të ndenjtur sa më gjatë. Ata vinin dhe iknin. Vitin tjetër shfaqeshin fytyra të reja, të errëta, sy të ethshëm. Dikush tha se ata ishin sytë e botës së përtejvarrit. Ata vinin nga një vend i huaj. Ishin të dërrmuar dhe tërë pluhur. Kur iknin, linin diçka. Banorët e fisit nuk e dinin se ç'linin. Vonë e mësuan. Ata linin në gjumë mikrobin, i cili do të zgjohej një ditë e do të niste kërdinë e tij. Kur filloi zgjimi, asnjë nga të huajt e dyshimtë nuk u shfaq në krahinë. Ata ishin transformuar në të padukshëm. Lebra! Fisi i

ngjiti emrin kërbulë, nga fjala «kalb». Nga tërë vdekjet, vdekja prej saj ishte më e urryera. Se kishte pabesinë e gjumit. «Rrënjë e keqe!», — i tha fisi kërbulës. — Rrënjë e keqe ti dhe kush të solli ty!». Dhe nisi lufta e gjatë. Fisi ruante rrënjët e tij të forta. Dhe, kur donte të shtohet, ai pyeste mos kushedi kishte ndonjë rrënjë të keqe në familje. Pyetja prekte deri në brezin e shtatë. Kjo ishte e rëndë, por e domosdoshme. Fisi donte të mbetej përherë i bukur dhe i fortë. Ai filloi izolimin e mikrobrit. Kjo ishte diçka e ngjashme me rrethimin e armikut. Ishte rrethimi më i gjatë dhe më i lodhshëm. Sepse mikrobi mund të zgjohej nga çasti në çast dhe të niste kasaphanën e fytyrave, të duarve, të trupit. Fisi përgjonte. Ai e dinte se harresa ushqente rrënjën e keqe. Dhe nuk e linte të përhapej. Bacë Ujkani dinte diçka nga rasti i fundit i lebrës në Lug-Dardhë.

Laboja trokiti përsëri në derën e rëndë të kullës me një ndjenjë të ndryshme nga herët e tjera. Kjo ndjenjë e kapi që para se të nisej nga spitali i lokalitetit. Prandaj nuk e ktheu kokën pas për të parë në lëvizje ndonjë nga perdet e dritareve apo jo. Ai po trokiste në një nga tragjeditë më të rënda që kishte shkaktuar i huaji.

Derën ia hapi një nga djemtë e bacë Ujkanit. Kur ai hyri brenda, baca u çua tërë respekt për ta takuar dhe i hapi vend pranë vatrës. Laboja e dinte se askush nuk do ta pyeste përse ishte lodhur deri aty. Jashtë era forcohej dhe përplasej pas mureve të kullës me një ulërimë të dëshpëruar. Në vatrë digjej një kërcu i madh pishe, që e kishte mbushur dhomën me një aromë të këndshme pylli.

— Ftohtë, — tha Laboja.

— E ka kohën, — tha baca.

Bacë Ujkani i kishte kaluar të njëqindat. «Ujkan, nga ujk, — tha Laboja me vete. — Përse ia kanë vënë këtë emër?». — Dhe dalloj se nga ujku kishin mbetur vetëm sytë e ndritshëm, të zgjuar dhe të mprehtë. Laboja diçka kishte dëgjuar mbi vështrimin e mprehtë të ujkut thellë errësirës së natës. Dhe, pasi pinë raki,

Laboja nuk pa as shenjën më të vogël të pyetjes: «Përse u lodhe deri këtu, në palcë të dimrit?». Ai duhej të fillonte i pari. Por e dinte se ajo pyetje ishte e rëndë. Një shok i tij, kur ishte student, i kishte treguar për heshtjen fyese, me të cilën i kishte pritur një malësor mirditor kur i kishin vajtur në shtëpi. Atëherë ai shoku ishte në një ekspeditë studimore për lebrën. Për t'i larguar çdo dyshim, ata kishin pirë dhe kishin ngrënë në enët e malësorit. Vetëm atëherë ai kishte treguar;

— Bacë, — tha Laboja, — rruga në dimër të këputka më shumë se kurrë. Mos ma merr për keq, por kam uri.

Baca qeshi, por nuk foli. Laboja nuk pa njeri të ngrihej. Menjëherë u hap dera dhe atij i sollën për të ngrënë mish të pjekur. Laboja kërkoi ujë. Përsëri baca qeshi. Mbi Gurin e Vjeshtës era vazhdonte grindjen e lashtë me pishat. Dëbora përplasej pas mureve të kullës dhe grumbullohej e grumbullohej. Laboja çoi kokën dhe ia nguli bacës. Dhe e pyeti për të kërbulurin e fundit në Lug-Dardhë. Në dhomë u bë një heshtje e tillë, sikur pushoi edhe era dhe të gjithë përgjonin mos dikush dha kushtimin për zgjimin e mikrobit. Bacës i shkrepnin sytë. Ujkan, nga ujk. Ata sy tani po përpiqeshin të shikonin thellë errësirën ku flinte mikrobi që po zgjohej. Ai ishte përpjekur ta harronte. Kush ishte i kërbuluri i fundit? Përse të duhet kjo gjë, doktor? Ne jemi munduar ta harrojmë, doktor? Ti nuk më pyete kot dhe tërë atë udhë nuk e more më kot. E kam vështirë, por ti mos u bëj merak. Më lër sa të marr pak veten dhe pastaj do të të tregoj ç'të më pyesësh. Dhe bacë Ujkani, si heshti pak, tha:

— I kërbuluri i fundit ishte djali i Dodan Markut.

8.

Për herë të parë Dodan Marku ia nguli sytë me aq dhimbje pushkës së varur mbi mur. Atij iu duk e madhe, e rëndë, sa nuk do ta ngrinte dot. Pushka qëndronte varur mënjanë, sikur shikonte poshtë diçka që ishte shkëputur nga syri i saj i verbër. Dodani nuk po lëvizte nga

vendi, megjithëse e dinte se prekja fatale e këmbëzës së shkrepjes, së ngrënë nga fërkimi me gishtërinjtë e trashë dhe të rreshkur, ishte e pashmangshme. Piu kafen që i ishte ftohur dhe dëgjoi qetësinë e kullës. Asnjëherë kulla nuk kishte qenë aq e qetë. Syri i verbër i pushkës u zmadhua akoma më tepër, ngaqë nuk po e gjente atë që po kërkonte. «Ç'lodhesh kot? Ti nuk ke për ta gjetur kurrë! Ai nuk duket. Ai është i padukshëm, si qetësia».

Në dhomë hyri plaka më e moçme. Plaka dhe pushka ishin moshatarë. Kishin harruar kur kishin lindur.

— Çohu, — tha plaka.

Dodanit nuk i bënin këmbët. Ai vështroi plakën më të moçme të kullës. Ajo, si edhe pushka, diçka kërkonin. Në fytyrën e plakës ishin zhdukur rrudhat. Dodani u çua nga lekura e dashit. Plaka ishte gati për sakrificën e fundit që kërkonte jeta prej saj. Ajo do ta kryente me rreptësinë më të madhe këtë sakrificë.

— Mos u ligshito kështu, — tha plaka.

Dodani hoqi pushkën nga muri dhe përsëri vështroi plakën. Ajo ishte gati. Sakrifika e fundit...

Dodani doli si i dehur nga kulla dhe u ngjit në majën më të ulët të fshatit. Maja iu duk si varr. Kishte kohë që askush nuk kishte shtënë nga ajo majë. Pak më lart ishte maja tjetër. Prej andej Dodani kishte qëlluar kushedi sa herë për të lajmëruar se po afrohej armiku. Atëherë nuk i ishte dridhur fare dora. Bile ai kishte qëlluar me një dehje, të brendshme, kur lajmëronte afrimin e pabesë të të huajit. Lug-Dardha ishte fshati i fundit i krahinës dhe gjithmonë kishte dhënë sinjalin i pari për të rrëmbyer armët. Bile, në ngritjen e fshatit aq thellë, fisi kishte pasur parasysh sinjalin e parë. Fshati jetonte për hir të dhënies së sinjalit, që hasmi të mos e zinte në befasi krahinën. Deri atëherë Lug-Dardha e kishte kryer mirë këtë. Ai vritej i pari, digjej i pari dhe ndërtohej përherë i pari. Mbeti gjithmonë pranë sakrificës dhe asnjë banor nuk ishte ankuar për këtë detyrë të vazhdueshme që brezi ia linte brezit. Kur vriteshin në ndonjë rast tërë njerëzit e ndonjë kulle,

zjarri i vatrës, ende pa u fikur, ndizej përsëri. Nga gjiri i një kulle tjetër ishte shkëputur një qelizë e porsafornuar, e cila do të shtohet e shtohet në vatrën që nuk fikej kurrë. Dhe mbetet Lug-Dardha fshati në skaj të krahinës, që ndante kufijtë me të huajin.

Para pesë vjetësh vetë ai, Dodan Marku, dha kushtrimin se në kufi po avitej armiku. Krismën e tij e dëgjoji Trebrinja. Krismën e Trebrinjës e dëgjoji Kthjella. Krismën e Kthjellës e dëgjoji zemra e krahinës. Dhe, pa kaluar as një orë, Dodani shikonte vargun e fisit që ngjitej drejt Lug-Dardhës. Sot ai u ngjiti në majën më të ulët. Krismën e tij nuk do ta dëgjonte as Trebrinja, as Kthjella, as zemra e krahinës. Ajo do të vërtitej brenda kufijve të fshatit, si një fërshëllimë gjarpri ogurzi. Ajo krismë i përkiste shtëpisë së tij, nga gjiri i së cilës ishte shfaqur rrënja e keqe. Ai do të fillonte izolimin e saj. Për një çast Dodan Marku dhe pushka u bënë të huaj për njëri-tjetrin. Atij i ngjau sikur frëngjitë e kullave kishin hapur sytë për të marrë vesh se ç'do të lajmëronte pushka. Ato kishin ngrirë. Pas pak ato do të gjallëroheshin dhe do të pleqëronin gjendjen. Dodan Marku tërhoqi me forcë shulin dhe qëlloi në ajër.

— Tani, dhe të duash, nuk fshihesh dot, e pabesë!, — tha ai.

Iu duk sikur dëgjoji kërcitjen e kockave të kërbulës që digjeshin nën flakën e krismës. Si i hodhi edhe një sy fshatit, zbriti për në kullë. Njeriu i parë që i doli te dera ishte plaka.

— Edhe djali është gati, — tha ajo.

— Mirë, — tha Dodani. — Le të presim ç'do të vendosin, pastaj shkojmë dhe ngremë kasollen.

Kaq tha dhe hyri në dhomë. Ndezi një cigare dhe e mbaroi me dy të thithura.

Të gjithë e kuptuan gjuhën e asaj të shtëne, megjithëse ishte njëlloj si gjithë të shtënat. Në shtëpinë e Dodan Markut kishite rënë kërbula. Ajo ishte shfaqur krejt papritur dhe tani duhej veçuar. Veçimi! Fisi kishte mbetur në këmbë, sepse e urrente këtë fjalë. Ve-

gimi! Fisi habitej se si kishte lindur kjo fjalë. Ai nuk donte të mendonte se ajo ishte gatuar me tingujt e gjuhës së tij. Megjithatë ai e dinte se tani ajo ishte e domosdoshme. Edhe krisma e Dodan Markut mblodhi tingujt e gjuhës dhe hodhi mbi Lug-Dardhë këtë fjalë.

Dodan Marku rrinte në dhomën e madhe të kullës dhe priste. Ai e dinte se tani pleqtë e fshatit ishin mbledhur dhe po vendosnin. Mendimin e tyre do ta zbatonte deri më një. Në shtëpinë e tij nuk do të hynte njeri, gjersa të zhdukej kërbula. Ky sakrifikim ishte i ngjashëm me fshatin e tij, i cili ishte ngritur aq thellë për të ruajtur fisin nga sulmi i pabesë i të huajit. Një dhimbje e mprehtë i përshkoi tërë trupin. Të gjithë burrat e asaj kulle nuk kishin vdekur, po ishin vrrarë.

— Po trokasin në derë, — tha plaka.

— Le të hyjnë, — tha Dodani.

Në dhomë hynë dy nga pleqtë më të mocëm të fshatit.

— Pleqësia vendosi t'i japë djalit tëndë një copë tokë mbi Gurin e Vjeshtës, — tha plaku Kel.

— Mirë, — tha Dodani.

— Për aty u nisën djemtë e fshatit t'i ngrenë kasollen, — tha plaku Kurt.

— Ju falemi nderit.

— Fëmijët dhe të rinjtë nuk duhet të shkojnë për ta parë. Për tët bir do të kujdeset më plaka e shtëpisë. Me shtëpinë tënde nuk do të bëhet krushqi për aq kohë, sa ta shohë pleqësia, — tha plaku Kel.

— Mirë, — tha duke mposhtur dhimbjen Dodani.

— Burimi ku do të pijë ujë yt bir është ngjitur me kasollen.

— Yt bir nuk ka të drejtë të marrë pjesë në dasma, në festa, në gëzime dhe hidhërime.

— Ky është vendimi i pleqësisë.

— Do të bëj si të thotë ajo.

— Nesër në mëngjes yt bir të shkojë në kasollen e tij te Guri i Vjeshtës, — e mbylli bisedën plaku Kurt.

Dodani i njihte mirë të dy pleqtë. Ata nuk ishin aq të ashpër. Ata nuk ishin aq të prerë. Aq të ashpër dhe aq të prerë i bënte misioni që kishin. Aq të ashpër dhe

aq të prerë ishin bërë që kur fisi kuptoi rrezikshmërinë e sëmundjeve infektive, që atëherë kur mbi gadishull ra epidemia për herë të parë.

Të dy pleqtë, megjithëse u çuan, nuk po dilnin nga dhoma. Nga lugina po ngjitej nata. Padashur të treve u shkuan sytë te Guri i Vjeshtës. Nga frëngjia e ngushtë e kullës dukej vetëm një pishë dhe një faje të vogël shkëmbi. Dhe mbi atë faje të vogël u ulën pëllumbat që po ktheheshin nga kullota. Diku atje mbi follenë e tyre po prisnin pyllin e po hapnin një copë tokë të vogël buke dhe po ngrinin një kasolle. Kasollja, derisa të vdiste i zoti i saj, do të mbante erë pishë. Pastaj do ta shembte dëbora e madhe. Edhe ajo copë tokë kishte diçka nga sakrifica e fisit. Që të mbetej i virgjër, i fuqishëm, pylli hapte brenda trupit të vet një copë tokë të gethur, si plagë. Mbi të do të shkelte vetëm një njeri. Ai do ta punonte, do ta mbillte, do ta korrte dhe po aty, në një cep, do të varrosej. Këtu mbaronte dhe sakrifica e pyllit. Pastaj rrënjët e pishave do të lëshonin lastarë të rinj, lastarët do të rriteshin dhe do të mbyllnin plagën e hapur.

— Mos u mërzit, o Dodan Marku, — tha plaku Kel.

— Nuk mërzitem, — tha Dodan Marku. — Mërzitem vetëm se ai nuk la pas asnjë djalë.

— Nuk ke ç'i bën, — ngushëlloi dobët plaku Kurt.

Ata nuk kishin ç'të thoshin më dhe dolën nga kulla. Dodani mbeti përsëri vetëm me qetësinë e kullës. Papritur u dëgjua e qara e fëmijës më të vogël. Dodani mbajti vesh dhe dëgjonte, sikur ajo e qarë ishte diçka e re për atë kullë të madhe me tërë ato kurora. E qara ishte e fortë. Për vite të tëra në atë kullë nuk do të kishte dasma. Atij i lejohej të lidhte krushqi vetëm me familje që kishin hequr kërbulën. Por Dodani nuk do të lidhte kurrë krushqi të tilla. Ai do të priste dhe soji i tij do të mbetej si kishte qenë: i fortë dhe i bukur. Tërë gjymtyrët po ia pushtonte një prehje e tillë që të jep vetëm sakrifica për fisin dhe truallin. Edhe vitet që kishin mbetur tani kishin një kuptim të ri. Ai do të jetonte për të ruajtur gjakun e fisit. Kërciti dera dhe në dhomë hyri i biri.

— Sikur të shkoja që tani, baba, — tha ai.
— Jo, — tha Dodan Marku. — Do të shkosh nesër që në mëngjes.

— Nuk po të lë amanet vajzat, se ti i ke merak vetë, — tha i biri.

Dodan Marku tundi kokën.

— Dua që ato të mos i marrë njeri nëpër këmbë, si pa baba.

— Ato nuk ka kush t'i marrë nëpër këmbë.

— Vajzës së vogël ndërroja emrin dhe vëri timin.

— Mirë.

— Kri me shëndet, baba, dhe më ndje ti e tërë fshati për sèkëlldinë që ju shtiva.

— Mos të t'i dëgjoj më këto fjalë.

Të nesërmen që me mëngjes ai përcolli të birin dhe plakën më të moçme të kullës për te copa e tokës diku mbi Gurin e Vjeshtës. Ishte një përcjellje e rëndë dhe e heshtur. Kishte diçka të ngjashme me ceremoninë e varrimit. Plaka dhe djali u ngarkuan me çka u duhej dhe vunë përpara bagëtinë. Tërë fshati kishte dalë dhe i përcillte, duke i përshëndetur. Kur kaluan edhe shtëpinë e fundit, djali vuri re se bagëtia ishte shtuar. Ai u prek dhe ia bëri me dorë fshatit.

Rapsodi i fshatit ngriti aty për aty një këngë. Kënga ishte e ngjashme me elegjitë dhe baladat. Nga dheu i huaj kishin dalë bajlozët. Ata ishin të padukshëm. Ata ishin të neveritshëm. Ata sulmuan të birin e Dodan Markut; I biri i Dodan Markut i mori me vete dhe do të niste luftën kundër tyre mbi Gurin e Vjeshtës. Rapsodi e këndoi atë këngë tërë ditën, derisa ra nqta dhe mbi Gurin e Vjeshtës u ul Arusha e Madhe.

9.

Ajo që dëgjoi ishte diçka e ashpër dhe e egër. Lajoja nuk po e merrte veten nga tronditja. I dukej sikur padashur ishte futur në një skenë ku luhej tragjedia më e fortë dhe më e kotë njëkohësisht. Ai harroi se nga

ç'kohë hyri në këtë tragjedi. Por e mblodhi veten shumë shpejt. Dhe e pushtoi një dashuri e paprovuar deri atëherë për krahinën, që ekzistencën e saj e kishte paguar aq shtrenjt. Për të nuk kishte më pikëpyetje. Krahina e Gurit të Mirë ishte krahina e jetës.

Lug-Dardha ndezi dritat. Nga dhoma e bacë Ujkanit nuk dukej më Guri i Vjeshtës, ku dëbora rëndonte tani mbi pishat rehat-rehat, sepse era ishte tërhequr thellë kontinentit, e lodhur dhe e dërrmuar. Por edhe nata kishte diçka nga misioni i lashtë, por i pandryshuar i fshatit. Megjithëse dëbora binte pa zhurmë dhe të vinte në gjumë, prapë dikush rrinte zgjuar. Ishte ndër-gjegjja e fisit. Ajo nuk flinte kurrë. Sikur ajo të kishte fjetur për një çast, fisi do ta kishte humbur. Vitet që po bënte aty e kishin mësuar Labon se kjo nuk do të ndodhte kurrë. Ai e ndiente këtë me tërë peshën e saj. Dhe ishte i lumtur që ndodhej përditë e më shumë pranë së vërtetës së ekzistencës së pastër të një fisi. Ai ishte krenar për fisin e tij.

— A është kasollja ku jetoi i biri i Dodan Markut?

— Jo!

— A duket që ajo copë tokë ka qenë tokë buke për dikë?

— Jo. Atë e ka mbuluar pylli prej kohësh.

— Prej sa kohësh?

— Sa nuk mbahen mend.

— Po ti nga e di me kaq hollësi?

— Ma ka treguar im atë, dhe tim eti gjyshi im.

«Ndërgjegjja e fisit», — i shkoi menjëherë në mendje Labos. Bacë Ujkani ngriti gotën e rakisë dhe e përpoqi me mikun. Atë natë ata pinë deri vonë.

Të nesërmen, mbasi mbaroi vizitat, Laboja u nis nga Lug-Dardha. Deri te Gryka e Erës e përcolli djali i vogël i bacë Ujkanit. Sapo pa nga maja dritat e lokalitetit të vogël, Laboja ndjeu përsëri nevojën e pritjes. Spitali kishte vetëm një dritë, atë të dhomës së mjekut. Ai nuk e kuptoi përse kishte nevojë më shumë: për të ndier dashurinë e shokut të jetës, apo për t'i treguar atij ato që i tregoi bacë Ujkani. Shpejtoi hapat dhe diku

rrëshqiti keq. U çua me vështirësi dhe eci duke çaluar. Dëborë kishte ngrirë. Lumi rridhte nën dëborë. Edhe troftat. Apo edhe troftat shtegtonin si zogjtë? Ai e shpërndau mendjen për të mos e ndier mungesën e pritjes.

Kur hyri në dhomën e mjekut, soba skuqte nga zjarri. Dikush sapo i kishte hedhur dru. Laboja la çantën, hoqi pallton dhe afroi karrigen te soba për të ngrohur duart. Ai nuk dëgjoi kur u hap dera dhe hyri Vera. Kur ngriti kokën, iu duk sikur ajo kishte qenë aty.

— Sa mirë që nuk ke fjetur, — tha Laboja.

— Përse?, — u habit Vera nga ky fillim i papritur i bisedës.

— Dua të të tregoj diçka.

Dhe Laboja i tregoi të gjitha ato që kishte dëgjuar nga bacë Ujkani. Mbi fytyrën e Verës koha rrëshqiste ngjarjet e saj. Dhe ajo ndjeu atë që kishte ndier Laboja kur bacë Ujkani kishte mbaruar së treguari. Kur Laboja heshti, qetësia iu duk Verës si perdet e rënda të teatrit që mbyllin skenën ku luhet një tragjedi. Po kalonte mesnata. Mbi lokalitet vareshin yjet. Ata nuk po flisnin. Si dy spektatorë që nuk u besohet se në atë skenë mund të luhen edhe tragjedi të tilla.

— A duhej tërë kjo sakrificë?, — pyeti Vera.

— Duhej, — tha Laboja.

— Nuk më kishte shkuar kurrë ndër mend se jeta e paska çmimin kaq të shtrenjtë.

— Sidomos për krahinën e Gurit të Mirë.

Vera fshiu me pëllëmbë avullin që kishte zënë xhami i dritares. Në dhomë po hynte të ftohtët alpin Laboja u çua dhe shkoi te rafti i librave.

— Shpeshherë ne gabojmë kur e gjykojmë jetën vetëm me përvojën tonë, — tha ai duke kërkuar midis librave. — Ne duhet ta çmojmë jetën me përvojën e fisit. Atëherë do ta zbulojmë tërë madhësinë e saj.

Ai hoqi një libër dhe, si gjeti faqen që i duhej, zuri të lexonte: «Lebra nuk është kaq e rrezikshme sa është menduar më përpara. Ajo është shumë pak ngjithëse, dhjetë herë më pak ngjithëse se tuberkulozi. Shumica

e të sëmurëve janë mjekuar dhe shëruar dhe sot jetojnë në shtëpitë e tyre të sigurtë se janë larg çdo rreziku si për veten e tyre, edhe për shoqërinë, prandaj nuk ka vend të zbatohen ato zakone që janë përdorur deri më sot».

Laboja vuri në raft librin dhe vështroi Verën.

— E megjithatë, — tha ai, — kjo nuk duhet të zbehtë sadopak sakrificën e fisit dhe të njeriut. E megjithatë kjo nuk na jep të drejtën t'i gjejkojmë zakonet që mbajtën në këmbë jetën e kësaj krahine.

Ishte hera e dytë që Vera e dëgjonte Labon të fliste me aq zjarr. Herën e parë e kishte dëgjuar me mendjelehtësinë e një gjimnazisteje, kurse sot, kur nata po thyhej, i bëhej qejfi që ai e konsideronte të pjekur. Mbështolli më mirë shpatullat që po i ngrinin me trikon e leshtë dhe shkoi e hapi derën e sobës. Disa thëngjij ende nuk ishin fikur. Ajo i futi sobës ca dru të holla që morën menjëherë zjarr. Laboja u ul përsëri në karrige dhe po ngrohte duart. Vera ia nguli sytë. Laboja nuk e kishte mendjen aty. Kur e pa të zhytur në mendime, Verës iu ngjiti një afsh i ngrohtë në tërë trupin. Ajo kishte respekt për këtë njeri, që me aq zjarr i ishte futur gjetjes së rrënjëve të jetës në krahinë, e ashpër të Gurit të Mirë. Dhe nuk e përfytyronte dot ndryshe. Si e kishte përfytyruar njeriun që mund të dashuronte kur ishte në shkollën e mesme! Po t'i mungonte Labos ai pasion, Verës do t'i dukej njeriu më i kotë që kishte njohur gjatë jetës së saj të shkurtër njëzetvjeçare. Apo i dukej tani kështu? Ndofta, po të mos kishte njohur Labon, përfytyrimi i saj për njeriun që do të dashuronte një ditë nuk do të kishte ndryshuar.

Mbi xham trokiti dikush. Vera u afrua dhe pa se përsëri kishte nisur të binte dëborë. Laboja po dremiste. Vera nuk dinte ç'të bënte. Se pse i pëlqente që të shikonte edhe si flinte ky njeri. Afroi dorën ta prekte në sup për ta zgjuar dhe nuk e kuptoi se si dora i mbeti mbi flokët e Labos. Ishte një prekje e ëmbël, ku më shumë se gjithçka dukej kujdesi i një njeriu më të madh për një më të vogël. Vera nuk e shpjegonte dot këtë gjë.

Si ishte rritur aq shumë gati brenda një nate! Laboja lëvizi, dhe ajo e largoi dorën menjëherë. Dhe përsëri iu duk vetja e vogël para Labos.

— Çohu të flesh, — tha ajo.

— Dremita?, — tha Laboja.

— Pak.

Ai vështroi orën dhe hapi sytë i habitur.

— Paska kaluar mesnata! Të lashë dhe ty pa gjumë.

— Bjer e fli, — tha Vera. — Sot je lodhur.

Në dritare, bashkë me dëborën, po trokiste i druajtur mbi xham mëngjesi alpin.

10.

Pas asaj nate ata i druheshin qëndrimit vetëm për vetëm. Dhe nuk dinin si ta shpjegonin përse ndodhte kështu. Në sytë e Verës Laboja vuri re një trishtim të lehtë dhe u tremb se mos ai i bëhej natyrë. Vera i buzëqeshte dhe i largohej sapo e haste në korridor apo në rrugë. Në largimin e saj kishte diçka të dhimbshme. Dukej sikur luftonte me moshën e vet dhe me ngacmimet e natyrshme që të jep ajo. Dukej sikur ajo po mendohej të dilte nga mosha. Laboja nuk dinte gjë për mendimet e Verës atë natë që ai i kishte treguar për lebrën. Prandaj i dukej e papritur sjellja e saj. Ndërsa ajo natë e kishte hedhur Verën përtej kufijve të dashurisë. Deri atëherë nuk e merrte dot me mend se edhe përtej kufijve të dashurisë ekzistonte diçka po aq e fuqishme, po aq shqetësuese. Dhe i vinte turp që nuk e kishte ditur këtë gjë. Në sytë e saj ishte trishtimi i pamundësisë për t'u kthyer pas. Dashuria për Labon kishte mbetur pas, vite larg. Dhe kjo kishte ndodhur për një shkak të madh. Nën sytë e saj kishte mbetur ylberi mavi i mendimeve. Ajo po ambientohej përditë me këtë ndjenjë. Ajo, për çudi, po e ushqente vetë me kënaqësinë e një sakrifice këtë ndjenjë. Ndërsa Laboja nuk kuptonte gjë dhe nuk dinte si të vepronte.

Dhe pas asaj nate ata i druheshin qëndrimit vetëm për

vetëm. Vonë Laboja tha se ndodhte kështu dhe jo ndryshe, sepse ajo ishte një natë e rrallë dhe çdo përpjekje për ta përsëritur, do ta cenonte papërsëritshmërinë e saj. I dukej sikur kishte ndikuar më shumë sesa duhej mbi moshën e saj. Gjithashtu e dinte se për moshën e saj melankolia mund të bëhej shpejt natyrë, një natyrë që të pëlqen dhe që i jepesh me kënaqësi. Ai nuk donte që kjo të ndodhte me Verën.

Vera jetonte tani me sakrificën e fisit. Një natë gryka e lumit solli shakullimën e orteqeve. Vera u çua nga shtrati dhe hapi dritaren. Zhurma sa vinte dhe rritej, sikur po çahej diçka nga shkëmbinjtë e zhveshur, diçka nga akujt që mbështillnin zakonisht në këtë stinë lugjet dhe honet. Lumi e përcolli për një kohë të gjatë jehonën e orteqeve, që, më në fund, u qetësuan. Verbëria e tyre e egër ishte zbutur. Pasi qëndroi një copë herë të gjatë në dritare, ajo e mbylli ngadalë. Kur u shtri për të fjetur, nuk e zinte më gjumi. U vërtit disa herë sa në njërin krah në tjetrin, dhe prapë në dhomë erdhi e dobësuar zhurma e një orteku të vonuar. Ajo mbylli sytë, ashtu si bënte kur ishte e vogël dhe jashtë binte shi. Tani donte ta zinte gjumi nën zhurmën e orteqeve që shkëputeshin nga zemra e malit nga ndonjë kafshë e egër apo nga era.

Të nesërmen trokiti në derën e Labos. Ai po shkruante. Sapo e pa, u çua në këmbë sikur në dhomë të kishte hyrë një e panjohur.

— M'i jep të t'i daktilografoj shënimet, — tha Vera.

«Sakrifica e fisit», — mendoi menjëherë Laboja.

— S'ka gjë. Kur të shkoj në Tiranë, gjej ndonjë daktilografiste.

— M'i jep mua, — tha me një zë lutës Vera.

Laboja nuk kishte forcë ta kundërshtonte. Mori fletoren e parë dhe ia dha.

— Puno, — tha Vera dhe doli jashtë.

Ajo eci drejt zyrave të lokalitetit me fletoren shtrënguar nën sqetull, duke çarë dëborën që po ngrinte.

Që nga ajo natë Vera kthehej vonë në spital nga zyra e lokalitetit. Laboja dëgjonte hapat e saj në korri-

dor, pastaj fërkimin e letrave të daktilografuara që futeshin nën derë dhe përpiqej të kuptonte se me çkënaqësi ë dëshifronte ajo shkrimin e tij të keq. Mbasi sigurohej se Vera duhej të ishte shtrirë, ai ndizte dritën dhe mblidhte fletët e daktilografuara që ishin shpërndarë. Në rreshtat e faqeve ai shikonte rrjedhjen e netëve të një vajze që sa po niste jetën pranë një fshati të lashtë dhe një pylli akoma edhe më të lashtë. Faqet shtoheshin nga nata në natë. Laboja habitej sa shpejt po mësonte Vera të daktilografonte. Dhe gjithmonë rrjedha e fjalëve i përngjante si një varg me pata që çajnë qiellin udhëve të pafundme të dimrit, gjersa të arrijnë vendin për ku janë nisur. Në fillim i erdhi keq për netët e Verës, por pastaj u mësua dhe tha se nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Ai nuk ë tha këtë për të ngushëlluar veten, por së, me të vërtetë, nuk kishte si të ndodhte ndryshe.

11.

Në fund të janarit Laboja mori lejën e zakonshme të vitit të kaluar. Prindërve u shkroi se, për arsye pune, nuk do të kishte mundësi të shkonte në fshat. Ai e mori me mend dëshpërimin e nënës, e cila nuk e kishte parë gati prej një viti, por nuk kishte si të vepronte ndryshe. Ishte përgatitur prej kohësh për «ekspeditën e fundit», siç e quante me vete mbledhjen e të dhënave të reja edhe përtej kufijve të krahinës së Gurit të Mirë. Tërë natën përgatiti çantën e shpinës dhe të nesërmen u nis që në mëngjes. Vera e përcolli deri tek ura prej dërrase dhe e porositi të kishte kujdes mos ftohej. Ai do të bënte tërë atë rrugë më këmbë. Koha ishte me diell. Ishte një nga ditët më të bukura që mund të çatisin në Alpe. Dëborë e ngrirë e përthyerë diellin me mijëra kristalet e saj dhe tregonte qartë relievin e tokës. Pishat, me majat ë tyre elegante, dukeshin sikur nuk e ndienin peshën e dëborës. Midis hapësirës së drurëve, gjurmët

e kafshëve të egra dukeshin si shenja pikësimi mbi abetaren e përjetshme të dimrit në pyll.

Laboja ecte gjithmonë drejt jugut. Si kapërcëu edhe një shpat mali, para syve i dolën si në një maket majat e kodrave që vinin duke u ulur. Përtej tyre, atje ku mbaronte ngjyra e bardhë e dëborës, ai dalloi kufirin e fundit të krahinës. Ngjyra e errët e tokës i ngjau gati iluzore, e papritur. Dhe akoma më tej ngjyrës kafe, nën avujt e tokës, ishte deti. Krahina e Gurit të Mirë kishte një lartësi dominuese. Një alpinist i kishte thënë se nga maja më e lartë e Alpeve, në kohë të mirë, dukej Tomori, Olimpi, malet Ballkan. Ai e kishte degjuar alpinistin me një ndjenjë ngazëllimi.

Fshati i parë që hasi ishte i vogël dhe krejt i ri. Kur pyeti për këtë gjë, i thanë se fshati i vjetër ishte kthyer në gërmadhë në luftën e fundit gjatë tërheqjes së forcave gjermane drejt Veriut. Ai ndodhej përtej kodrës. Laboja takoi drejtorin e shkollës fillore dhe, pasi i tha përse kishte shkuar deri aty, iu lut ta çonte të shihte gërmadhat e fshatit të vjetër. Por drejtori i tha se ai duhej të ishte lodhur dhe me siguri që këmbët i kishte të lagura. Veç kësaj, nga Alpet nisi të frynte një erë e ftohtë dhe po ngrysej. E lanë të shkonin të nesërmen që në mëngjes, para se Laboja të vazhdonte udhën për në fshatrat e tjera. Drejtori i tregoi me dorë ku e kishte shtëpinë dhe të dy u nisën për aty. Në dhomë ishte ngrohtë dhe e shoqja e drejtorit po bënte gjellën. Ajo ishte një grua e urtë, që i erdhi turp ngaqë mysafiri ia gjeti shtëpinë pak rrëmujë. Rregulloi menjëherë tavolinën dhe u nxori për të pirë. Drejtori dërgoi djalin e madh të thërriste Isuf Boçën.

— Është një plak i lezetshëm dhe me një kujtesë të habitshme, — tha drejtori.

— Deri para tre vjetësh kam pasur një përshtypje të gabuar për kujtesën e njerëzve, — tha Laboja. — Tani më duket se, po të duash të mësosh se si ka qenë koha e një brezi, shiko sa të fortë e ka kujtesën ai brez.

— Ndofta, ne si komb e kemi kujtesën më të fortë, — tha drejtori duke qeshur, — sepse asnjë brez nuk

ka kaluar pa një provë të madhe.

— Po, — tha Laboja dhe çoku gotën e vet me atë të drejtorit.

— Sa t'u bënë që mbledh të dhëna mbi mjekësinë popullore?

— Gati katër vjet.

— Me siguri ke gjetur gjëra interesante?

— Shumë. Shpesh të pabesueshme.

— Edhe në po mbledhim jetëshkrimin e dëshmorëve të fshatit. Nuk e di në ndodh edhe me të tjerët kjo, po mua më ngjan se, sa më shumë të mbledhësh, aq më pak të duket se di për popullin tënd. Hë?

— Kjo ndodh me të gjithë, — tha Laboja duke qeshur.

Drejtori i shkollës fillore hodhi sytë jashtë, ku tje-gullat e kuqe të shtëpive po humbisnin pak nga pak nën hijet e mbrëmjes.

— Pardje më solli në shkollë ditarin e të vëllait një fshatari ynë, — tha ai. — I vëllai i është vrarë në Jug. Ka diçka që mund të të interesojë edhe ty.

Laboja bëhej i paduruëshëm, bile i bezdisshëm kur dëgjonte se dikush dinte diçka që lidhej me mjekësinë popullore dhe nuk i pritej sa ta mësonte atë. Ai u bë gati t'i lutej drejtorit të shkollës që t'ia jepte që atë çast ditarin e dëshmorit, kur në dhomë hyri Isuf Boçi me djalin e vogël që kishte shkuar ta thërriste. Plaku i dha dorën Labos, sikur njihej me të prej kohësh, dhe u ul në mindër, ngjitur me sobën. Mbas shkëmbyen pyetjet e zakonshme për shëndetin e të dashurve, për motin dhe dimrin, Laboja i tregoi plakut përse e kishte lodhur në atë të ftohtë plot lagështi. Plaku i tha se ai nuk lodhej për të tilla gjëra dhe ra në mendime. Ai zuri të fliste papritur, pas një pauze të gjatë. Plaku fliste ngadalë, sikur ia peshonte çdo fjalë barrën e saj, pastaj e shqiptonte. Laboja shkruante dhe herë pas here e vështronte në sy plakun. Dhe nuk habitej kur dallonte se shikimi i plakut ishte i largët.

Gati të gjithë pleqtë, kur tregonin për diçka të lar-

gët, sikur transformoheshin. Edhe tiparet e fytyrës sikur përpiqeshin të kishin tiparet e viteve, për të cilat ata flisnin. Labos iu duk sikur fytyrën e Isuf Boçit nuk po e shihte për herë të parë. Atë sikur e kishte hasur edhe te dikush tjetër. «Veprimi i kohës», — mendoi ai me vete. Atëherë ata kishin të njëjtën moshë dhe ngjarjet linin të njëjtat mbresa. Edhe mënyra se si flisnin, kishte diçka të përbashkët. Edhe këmbëngulja për të qenë sa më të saktë, ishte e përbashkët. Sidomos në përcaktimin e vitit dhe mundësisht të ditës. Ka qenë seneja katërmëdhjetë, ditë e... martë. Përcaktimi i vitit dhe i ditës shpesh u shkaktonte dhimbje pleqve. Dhe, kur e gjenin me saktësi, ata i gëzoheshin kujtesës së tyre si fëmijë. Vinin buzën në gaz, vështronin rreth e rrotull dhe, si mbusheshin me frymë, zinin të tregonin krejt papritur. Edhe Isuf Boçi zuri të tregonte kur në dhomë ishte fare qetësi dhe kur Laboja me drejtorin e shkollës po shqetësoheshin nëse ai i mbante mend ato që u duheshin apo jo.

— Ka qenë moti 1918. Ti do të thuash: si e mbaj mend? Po ja që e mbaj. Njeriu harron atë që duhet harruar dhe jo atë që s'duhet harruar. Xherah Jemini ndryshonte nga ne, si nga veshja, ashtu edhe nga të folurit. Kjo një. Kur e pyetën sa larg ishte fshati i tij, ai u tha: «Me ditë larg». Kjo dy. Shkonte më këmbë ku ta thërrisnin, pa pyetur për shi apo dëborë, baltë apo vapë. Kjo tre. Që thua ti, xherah Jemini ishte nga Përmeti. Pikë. Përse erdhi në shtëpinë tonë? Sepse tim eti i ishin veshur sytë. Xherah Jemini do ta lindte për së dyti. Dhe e lindi. Nejse. S'është koha të të rrëfej si lindi për së dyti im atë. Është tjetër mesele. Hë, do të të rrëfej për atë natë kur na u hap dhe na tregoi se si ishte bërë xherah.

Ja, si tani, po rrinim pranë zjarrit, veçse jashtë binte një shi i ftohtë dhe shkrepinte. Xherah Jemini e kisha përballë. Shkreptimat i sillnin ndër mend flakën e dyfeqeve. Dhe nisi të flasë. Meselera për luftën kam dëgjuar aq shumë kur isha fëmijë dhe i ri, sa të të mbaj me muhabet jo një natë, por sa të kesh qejf. Tani

ndonjë edhe e kam harruar, po atë që dëgjova nga xherah Jemini vetëm vdekja do të ma marrë me vete. Kur hynë të huajt në fshatin e xherah Jeminit, ai ishte kalama. Të atin ia kishin vrarë tri ditë më parë. Tërë fshati u shkul dhe u nis për t'u fshehur në disa shpella. Jemini i vogël kishte ngelur vetëm me të gjyshin në shtëpi. Ai rrëmbeu për dore të gjyshin e dolën edhe ata të shkonin të fshiheshin. Mos harroj pa të thënë se i gjyshi mori edhe pushkën me vete, megjithëse nuk shikonte fare nga sytë. Të huajt kë zinin, e vrisnin në vend, le të ishte kalama apo plak. Nejse. Dolën dhe nipi me të gjyshin të ngjiteshin në mal, po plaku nuk shihte dhe pengohu aty e pengohu atje, e nipi hiq për dore. S'ecën shumë, kur gjyshi, që i kishte veshët pipëz, e ndjeu se hasmi po afrohej. I thotë të nipit, xherah Jeminit, të fshihej. Po donte të dëgjonte i nipi?! Ja, sa dëgjon tani që po flasim për të. I gjyshi e pa që nipi nuk do ta linte vetëm dhe i tha se nuk do ta treste dheu, po të mos i merrte hakun. Se mos harroj pa të thënë, xherah Jemini ishte mashkulli i fundit në atë shtëpi. Pa ç'pa, djali e dëgjoi. U fut mu në mes të misrave dhe priti. Kur fap, ia behën të huajt. Plaku i verbër zuri mesin e rrugës dhe nuk bënte xhap. Sa i dëgjoi, ngriti pushkën dhe mori shenjë me sytë e verbër. Shtiu. Plumbi iku kot. Kur po e mbushte përsëri pushkën, të huaj e kuptuan se ai ishte i verbër dhe menduan të tallen. I dilnin më të majtë dhe e qëllonin o pranë veshit, o në këmbë. Plaku i shkretë, sa dëgjonte që plumbi i vërshëllente në të majtë, kthehej menjëherë andej. Kur fap, e qëllonin më të djathtë. Nipi i shikonte dhe qante pa zë. Të huajt e kishin vënë plakun në mes dhe nuk ngopeshin së qeshuri. Plaku hapi fort sytë, mallkoi perëndinë që i kishte marrë të parët, sokëlliu si atëherë kur ishte djalë, sa të huajt shtangën, ngjeshi grykën e pushkës në zemër dhe hoqi këmbëzën pa iu dridhur dora. Të nipit iu shterën lotët fare. Të huajt në fillim u çakërdisën, pastaj e mblodhën kallaballëkun dhe nisën të shtien mbi trupin pa jetë të plakut. Pastaj ata ikën. I nipi doli nga misrat, mori të gjyshin dhe e varrosi që atë ditë. Pastaj

shkoi fshat më fshat dhe pyeste njerëzit se ku mund të gjente një njeri që ta mësonte si të shëronte sytë. Disa habiteshin me djalin, po më në fund ai ra në një xherah. Iu vardis xherahut gjersa ky pranoi ta mbante afër. E mësoi zanatin dhe nuk rrinte në një vend, po i binte në të katër anët Shqipërisë. Ja, mendo, deri këtu ka ardhur. Hak? Vetëm sa të mbante gjallë frymën, të merrte. Asnjë grosh më tepër. Hë, se mos harroj. Gjatë një operacioni, në Shijak më ngjan, e panë disa të huaj. Çfarë bënin ata aty? Dreqi e merr vesh, po, me siguri, ndonjë punë të keqe, derisa i thanë edhe xherah Jeminit të linte vendin dhe të shkonte me ta. Po xherahu ua priti: «Jam mirë në vendin tim». Po, kishte një djalë të vogël që i mësonte zanatin. Ku është tani djali, se Jemini vdiq më dyzetën, nuk e di.

Ti i mbajte shënim të gjitha sa dëgjove. Ti edhe mund t'i prishësh, se mund të mos të bëjnë punë, por ma thotë zemra se xherah Jemini nuk ishte nga ata burra që u shuhet emri sapo mbyllin sytë. Apo e kam gabim? Jo, po ta kem gabim, ma thuaj.

12.

— Eh?, — tha drejtori i shkollës i entuziazmuar. — Isha i bindur se Isuf Boçi ka një kujtesë fantastike.

Laboja pohoi me kokë. Sapo e kishin përcjellë Isuf Boçin për në shtëpinë e tij. Kishte kaluar mesnata. Drejtori i shkollës ecte përpara. Ai ndaloi dhe, si e pa në sy Labon, tha me po atë entuziazëm, si pak më parë:

— Interesant, ë? Ai i ka kaluar të tetëdhjetat, kurse ngjarja të gjashtëdhjetat, dhe çdo gjë e sillte në mendje sikur të kishte ndodhur dje. Hajde beso se në këtë botë ka sklerozë!

— Skleroza prek gjërat e parëndësishme, — tha Laboja i qetë.

— Ndofta, — tha drejtori i shkollës, — megjithatë xha Isufi ka parë dhe ka jetuar shumë në këtë botë, por xherah Jemini e veçoi nga gjithë të tjerët. Si

e shpjegon këtë fakt?
— Sepse xherah Jemini ia zgjeroi kufijtë e krahinës së tij.

Drejtori ndaloi përsëri.

— Nuk të kuptoj, — tha ai.

— Si të ta shpjegoj, — tha Laboja. — Kjo ka të bëjë me ndërgjegjen e kombit.

Se misioni i xherah Jeminit kishte diçka nga ndërgjegjja e kombit. Dhe intuita e Isuf Boçit s'kishte si të mos e kapte këtë gjë. Sidomos që ajo ishte kontakti i parë mbas kontaktit me ndërgjegjen e fisit apo të krahinës. Nuk di në u shpreha drejt apo jo?

— Po, — tha drejtori i shkollës, — të kuptova.

Deri në shtëpi nuk shkëmbyen më asnjë fjalë. E shoqja e drejtorit po i priste.

— Përse nuk ke rënë të flesh?

— Sapo vura në gjumë fëmijët.

— Mirë, shko bjer ti, se ne po rrimë edhe pak.

Gruaja u uroi natën e mirë dhe u largua. Zjarri digjej. Ata nuk kishin gjumë. Ndjenja se nesër do të ndaheshin, ua largonte edhe dremitjen më të lehtë. Megjithatë nata ishte akoma e gjatë.

— Vetëm ndërgjegjja e kombit mund t'i japë jetës apo vdekjes një kuptim të madh, — tha Laboja duke vazhduar mendimet e veta. — Prandaj dhe kujtesa e veçon ngjarjen apo njeriun.

— Domethënë, kujtesa e Isuf Boçit nuk është një dhunti natyrore?

— Aspak, — tha Laboja prerë. — Ajo është më shumë një dhunti shpirtërore, se natyrore. Dhe populli vatrën e kujtesës që lidhen me jetën dhe fatin e tij i mban përherë ndezur. Janë vatra që nuk sklerozohen kurrë. Sepse ato nuk lidhen vetëm me të kaluarën, por edhe me të tanishmen, edhe me të ardhshmen.

— Po, — përsëriti drejtori i shkollës, — edhe me të ardhshmen.

Në dhomë u bë përsëri heshtje.

— A mund të ma japësh ta lexoj që tani ditarin e dëshmorit?, — tha Laboja.

Përsëri nuk rri edhe nesër?

— Nuk më premtan fare koha, pa edhe unë kisha qejf.

Drejtori u çua dhe i solli fletoren.

— Ti, po të duash, bjer e fli, — tha Laboja.

— Nuk kam gjunë, — tha drejtori i shkollës.

Laboja hapi fletoren dhe menjëherë harroi se ku ndodhej.

17 shkurt 944

Isha caktuar pararojë. Ndaj të gdhirë arritëm në fshatin Mollas. Dimri kishte zënë i prapë dhe ne ishim të lodhur. Fshati ishte kthyer në gërmadhë. Edhe mollët nga duhet të ketë marrë emrin ky fshat, ishin shkumbosur dhe kushedi se kur do të çelnin prapë e do të lidhnin kokrra. I kishin djegur gjermanët me ballistët dy ditë më parë, se ishte bazë jona. Dëbora pushoi ndaj të gdhirë dhe kishte mbuluar muret e zeza. Ndalua me çezma e fshatit. Uji lëshonte avull. Për herë të parë fshati nuk kishte nevojë për ato çezma. Goja na u mbyll dhe nuk dinim ç'të flisnim për të thyer heshtjen. Fshati na vriste me plagët që i kishte mbuluar me dëborë. Ajo ishte e pashkelur. Sa e rëndë qenka dëbora e pashkelur në rrugët e një fshati! Aty ajo më ngjau me një qefin. Nuk kishte rrugina që i hapin zakonisht fshatarët kur zihen udhët nga dëbora. Ato lidhin shtëpitë me njëra-tjetrën, shtëpitë me çezmën, fshatin me pyllin. Atij fshati ia kishin prerë damarët. Se rruginat e dëborës janë si damarë. Edhe ne nuk po hynim në fshat, por po rrinim në hyrje të tij, te çezma. Pasi të çlodheshim edhe pak, do të iknim. Kushedi kur do të vinte banori i parë. Të gjithë ishin shpërndarë fshatrave, te të njohurit e tyre. Aty-këtu dëbora binte nga degët e shelgjeve. Ne kthenim kokën, se mos kushedi shihnim ndonjë njeri. Po, kur shikonim se dëborën e kishte rrëzuar ndonjë laraskë, mërzitëshim akoma më tepër.

— Nisemi, shokë, mjaft ndenjëm, — tha Kopi.

— Edhe pak, — tha Danili.

— S'kemi ç'presim më, — tha Kopi. — Kjo pamje të këputka shpirtin e udhëzoi në një moment të caktuar.

— Edhe pak, — tha përsëri Danili.

Dhe në qëndruam. Çatitë ishin pa oxhak. Por, edhe po të kishte mbetur ndonjë pa u rrëzuar, atë patjetër do ta kishte mbuluar dëbora. Vetëm një gjysmë oxhaku nuk kishte dëborë. Ia kisha mbërthyer sytë dhe nuk ia ndaja.

— Ç'shikon ashtu?, — më pyeti Danili.

Ia bëra me kokë nga gjysmoxhaku. Ata nuk kuptuan gjë prej gjëje. Ku nuk i shkon mendja njeriut, kur është në luftë! Ata nuk më thanë një fjalë.

— Aty duhet të ketë njerëz, — thashë pas pak.

— Do ti që të ketë, — tha Kopi.

— Të zotët e shtëpisë, kur kanë ikur, kanë lënë ndezur ndonjë kërcu dushku që mezi është djegur, — tha Danili.

— Ai duhej të ishte djegur prej kohësh dhe oxhaku do ta kishte mbuluar dëbora, si gjithë të tjerët. Aty duhet të ketë me siguri njerëz.

— Ta do zemra ty që të ketë, — tha Kopi.

— Megjithatë shkojmë shohim njëherë.

— Bëhemi vonë, — tha Kopi, që ishte dhe komandanti i pararojës. — Bëhemi vonë, dhe batalioni tani duhet të jetë duke ardhur. Dhe kaq dhe e zgjatëm si tepër.

Por unë nuk doja të largohesha. Ndofta, ngaqë mund të pranosh vdekjen e një njeriu, por jo të një fshati. Po të kishte qoftë edhe një njeri gjallë, do të thoshte se ai merrte frymë dhe me siguri që nuk do të shuhej nga faqja e dheut. Ishte një fshat i vogël dhe i bukur. Kopi u çua dhe hodhi automatikun në sup. E pashë se nuk e duronte dot më pamjen e fshatit.

— Shohim njëherë, se nuk bëhet gameti, — thashë unë.

— Kot e ke, brë Malkë, — më tha Danili. — Shiko si ndrin dëbora e pashkelur.

— Megjithatë, po shkoj t'i hedh një sy.

— Si të duash. Ne na ke përpara. Mos u vobno. Dëgjon?, — tha Kopi.

— Mirë, — i thashë dhe u nisa drejt shtëpisë, oxhaku i së cilës nuk kishte mbajtur dëborë.

Kur iu afrova shtëpisë dhe pashë shtegun që kisha hapur, m'u duk sikur në atë fshat u kthyen banorët. Ndjeva një gëzim që nuk e kisha provuar deri atëherë. Nuk hyra menjëherë në shtëpi, po i rashë tërë mëhallës kryq e tërthor. U lodha sikur të kisha çarë dëborën në një marshim të gjatë. Tani rruginat lidhnin shtëpitë. Ato pyesnin njëra-tjetrën si u gdhinë, si i kishin bagëtitë dhe pleqtë. Ja, dikush kishte dalë nga fshati dhe ishte nisur për në pyll të priste dru, dikush kishte shkuar në ahur t'u hidhte pak bar bagëtive... Gjurmët mbi dëborë sikur ma hoqën lodhjen. E prapë s'më bënte zemra të hyja brenda. Dera e shkallmuar mbahej në menteshën e sipërme, si e plagosur në këmbë. Ajo u rrëzua sapo e preka me dorë. Më ra në hundë era e tymit. Mbi kokë kisha skeletin e zi të trarëve. Në korridorin e ngushtë kishte dëborë. Shkova nga vinte tymi. Hapa derën dhe pashë se edhe ajo ishte gjysmë dhome. Se si nuk ishte djegur e gjitha, nuk e mora vesh. Pranë vatrës pashë njerëz. Nuk m'u besua. Kërcuri po lëshonte fjollat e fundit të tymit. Ishte një fjollë që e njihja mirë, sikur kërcuri po jepte shpirt. Tre njerëzit e shtrirë nuk lëvizën nga vendi. Dera që hapa u rrëzua edhe ajo me zhurmë. Ai që ishte shtrirë në mes u çua me zor në bërryl. Nga flokët e kuptova se ishte grua.

— Kush je?, — më pyeti.

— Partizan, — i thashë.

— Partizan?! — tha gruaja dhe u rrëzua. Ndofta, harxhoi forcat e fundit duke më folur.

Nxitova drejt saj dhe i ngrita kokën. Lëkurën e kishte të zbehtë dhe të tejdukshme. Peshë nuk kishte fare. I vura kokën në prehër dhe i dhashë pak ujë. Gruaja erdhë në vete. Më vështronte dhe nuk më gëzohej dot. Unë e përkëdhela mbi flokët e thinjur si të ishte fëmijë. Ajo ma bëri me shenjë nga të tjerët.

— Kjo është ime bijë... Sapo e zuri gjumi. Edhe partizani po fle.

Partizani kishte një plagë në gjoks. Ishte e vetmja fytyrë njerëzore në atë gjysmëdhomë. Plagën duhej t'ia kishin ndërruar atë mëngjes. Nuk e di, por këmisha që lidhte gjoksin e partizanit sikur kishte shenjat e forcave të fundit të gruas.

— Hoqi shumë, i ziu, por tani shyqyr është më mirë. Isha si i shastisur. Më dukej se po ndodhesha për herë të parë aq afër luftës.

— Kush e solli?

— Im vëlla, para një jave.

— Përse nuk ikët?

— Dushmani çatisi papritur e pakujtuar. Zaneli nuk bënte dot as edhe një çap.

Hapa çantën dhe nxora copën e bukës që kisha. Ia zgjata gruas.

— Ha një kafshatë. Zgjoje dhe vajzën.

— Lëre të flerë.

Zgjova vajzën: Ajo hapi sytë dhe vuri buzën në gaz. Dhe përsëri i mbylli. Me siguri që iu duk sikur shihte ëndërr. Por unë e zgjova edhe atë, edhe partizanin.

— Mos lëviz, tani kalon batalioni.

— Si është Zarifeja me Gonxhen?, — pyeti partizani.

— Mirë, janë, mirë, mos ki merak.

Gruaja uli kokën mbi gjunjë. Hoqa rrogosin, me të cilin kishin zënë dritaren. Në dhomë hyri drita e mëngjesit. Bardhësia e saj u vrau sytë. Vajza e vogël kafshoi pak bukë dhe filloi ta mbante në gojë. Nuk kishte forcë të përtypej.

— Ku i ke njerëzit?, — e pyeta gruan.

— S'kam njeri. Burri është në mal. Halit Cangonji i thonë. E njeh?

— Po, — i thashë, megjithëse Halitin nuk e njihja.

Dola jashtë të shihja mos po vinte batalioni. Ishte aq qetë, sikur në atë fshat të mos kishte kaluar kurrë lufta.

Edhe gjurmët që kisha hapur në dëborë m'u dukën si gjurmët më paqësore që mund të ketë.

— Si të thërresin?, — më pyeti gruaja kur hyra prapë brenda.

— Ismail.

— E gëzofsh! Kam një rixha për ty. Të më varrosësh djalin.

— Ku e ke?

Gruaja ma bëri me kokë t'i afrohesha. Pastaj, pak më tej, në gjysmerrësirë ajo zbuloi me kujdes trupin e një djali as tre vjeç. Gruaja e kishte veshur me rrobat më të mira. Fëmija i kishte flokët të verdhë.

— Kur vdiq? — thashë me një zë që nuk ishte imi.

— Sonte në mesnatë.

Mora djalin dhe e shtrëngova në gjoks. E dija se nuk duhej qëndruar gjatë në atë dhomë. Ata të tre, gruaja, vajza, partizani e puthën djalin e vogël në ballë. Unë dola jashtë.

M'u prenë krahët dhe qava. Nuk mund të gërmoja as edhe një grusht dhë. Ai, ashtu i bukur, dukej sikur flinte. Por lutja e gruas ishte urdhri më i rëndë dhe më i vështirë që më kishin dhënë deri atëherë. Dhe ai ishte një urdhër i shenjtë. Fillova të gërmoja tokën me bajonetë. Toka e ngrohtë nën batanijen e dëborës lëshonte një avull dehës. Kur pashë gropën e çelur, u habita dhe vetë. E putha për herë të fundit fëmijën dhe e ula me kujdes përtokë. Në këtë kohë ndjeva dorën e dikujt. Ishte komandanti i batalionit. Iu hodha në qafë dhe, i mbështetur në kraharorin e tij, qava pa zë. Partizanët po nxirrnin gruan nga shtëpia. Ajo u afrua dhe qëndroi mbi varrin e të birit. Komandanti urdhëroi të rresh-tohej skuadra. Shkrehëm një breshëri për djalin e vogël. Partizani i plagosur rrinte pranë gruas.

— E ke vëlla, — i tha gruaja partizanit të plagosur, duke i treguar me kokë varrin e porsambuluar.

— Të gjithë e kemi, — tha komandanti. — Edhe ai ra në luftë.

Djali i vogël kishte vdekur nga uria. Ajo grua e

thinjur para kohe kishte ndarë bukën e fëmijëve me partizanin e plagosur.

— Nisemi, — tha komandanti.

Mbi pirgun me dhe, përzier me dëborë, vura kapelën time. Gruan me gjithë vajzën i hipëm në një mushkë dhe i morëm me vete, derisa të largohej rreziku i gjermanëve. Në mëhallën e fshatit kishte tërë ato rrugina. Ecja pranë gruas.

— Ti je doktori?, — pyeti gruaja mjekun e batalionit.

— Po.

— Na, merre këtë. Lyeja edhe tri herë dhe do të shërohet, — tha gruaja dhe i dha mjekut të batalionit një shishe të madhe me një lëng të errët. Mjeku e mori dhe e futi në çantë. Unë mbeta pak më pas. U ktheva edhe një herë nga oxhaku që nuk kishte dëborë dhe e kuptova se vetëm fshat të vdekur nuk ka dhe nuk do të ketë asnjëherë. Jeta do t'i gjejë shtigjet, qoftë edhe me sakrificë, për t'u futur brenda dhe për ta mbajtur ndezur vatrën.

13.

Laboja e kopjoi ditarin e dëshmorit Ismail Bata dhe bëri vetëm dy orë gjumë. Drejtori i shkollës mendoi se Laboja nuk do të zgjohej shpejt dhe se ndofta atij i ndërrohej mendja e qëndronte aty edhe atë ditë. Sepse i hyri në zemër ky djalë i urtë dhe i turpshëm, gati si vajzë. Por Laboja u çua pa lindur akoma dielli. Dhe ndihej aq i freskët, sikur të kishte fjetur me orë të tëra. Drejtori i shkollës iu lut përsëri që të qëndronte, por Laboja nuk pranoi. Atë ditë duhej të shkonte në Vaun e Dejës. E përse ngutej aq tepër? Donte të takonte një fshatar, të cilit i kishin bërë transplatim kockor para shumë vjetësh, në Luftën e Parë Botërore. Këtë rast ia kishte treguar një kolegu i vet, mjek në Shkodër, dhe Labos nuk i pritej sa ta takonte vetë fshatarin.

Drejtori e kuptoi se e kishte kot, të ngulte këmbë për ta mbajtur dhe e përcolli deri te rruga automobilistike.

— Presim mos kalon ndonjë makinë, — tha ai.

— Jo, tha Laboja, — më pëlqen të eci më këmbë. Nuk kam qenë ndonjëherë në këto anë.

— Si të duash, — tha drejtori me buzën në gaz.

— Sa mban Vau i Dejës që këtej?

— Më këmbë mban nja gjashtë orë të mira.

— S'qenka larg, — tha Laboja.

Ai i premtoi drejtorit të shkollës se, në rastin e parë që t'i jepej, do të kthehej ta takonte dhe u nis për rrugë. Mëngjesi ishte i butë. Laboja nuk i gëzohej dot ajrit të freskët e transparent. Nga larg u dëgjua zhurma e një traktori. «Po përgatiten për mbjelljet e pranverës», — mendoi, dhe kjo shprehje aq e zakonshme e faqeve, të para të gazetave kur fillonin mbjelljet se pse i tingëlloi e bukur, si një poezi. Por, pa e kuptuar edhe vetë, ai po futej pak nga pak në atmosferën e shqetësimeve të zakonshme. Atje ku po ecte tani, ishin zhvilluar beteja të ashpra në luftën e fundit. Lufta e fundit kishte qenë më e ashpra dhe më e madhja. Ajo kishte diçka të papërsëritshme, që nuk e kishin pasur luftërat e tjera. Dëshmori Ismail Bata, një pjesë të ditarit të të cilit Laboja e kishte me vete, ishte vrarë në një fshat të rrethit të Korçës, ndërsa një bashkëfshatar i Labos ishte vrarë në Malësinë e Madhe.

Në ato vise ishin zhvilluar luftime të ashpra... Dhe në shumë prej atyre shtëpive ishin strehuar partizanë të plagosur. Laboja sikur i kishte para syve gratë që mjekonin plagët. Dhe iu kujtua gruaja e ditarit të Ismailit. Ajo ishte një grua e zakonshme. Por sakrificat e saj i kalonte të gjitha përmasat, si dhe vetë lufta. Dhe Laboja tha se vetëm një qëllim i madh i jep sakrificës atë përmasë. Dhe ishte një grua aq e zakonshme... Ai nuk e dinte se ku ndodhej tani ajo grua dhe, sado që kishte dëshirë, nuk kishte për ta takuar ndonjëherë. Vetëm në e ndihmonte rastësia. Por edhe rastësia ishte gati e pamundur. Dhe ai ecte e mendonte për gruan e panjohur me po atë mall, me po atë dashuri, si men-

donte shpesh për mësuesen e tij të parë.

Mbasi kishte bërë katër orë rrugë, ai ndaloi në klubin e një kooperative për të pirë një kafe. Aty takoi një kolegun e vet, mjek në spitalin e Tiranës, i cili kishte shoqëruar deri aty një pacient të shëruar. Ai i tha Labos të shkonte me makinën e tyre deri në Vaun e Dejës. Laboja pranoi dhe në Vaun e Dejës arriti në drekë.

Shtëpinë e fshatarit Frrok Spata e gjeti menjëherë. Frroku po priste dru në kopsht. Ai e priti Labon sikur ta kishte njohur prej kohësh.

— Ku do të rrimë, — tha Frroku, — këtu apo brenda?

Dielli ishte gati pranveror dhe Laboja i tha Frrokut të rrinin aty jashtë. U sollën një tavolinë. Frroku tha të bisedonin duke ngrënë bukë. Laboja mbante shënime herë pas here. Frroku kishte lindur në Pukë në vitin 1893. Në Vaun e Dejës kishte ardhur pas të birit. Si mbaruan së ngrëni drekë, Laboja e pyeti Frrokun:

— Kur u plagose, xha Frrok?

— U plagosa në vitin 1916 në përpjekje me italianët. Plumbi më kapi keq. Shokët u tmerruan kur më panë, por s'kishin ç'të më bënin. Ma lidhën dorën dhe vazhduam luftën. Tërë kohën ndieja dhimbje. Plumbi më kishte shkatërruar një pjesë të kockës dhe krahu më rrinte varur në një pjesë të lëkurës dhe muskulit. Deri atëherë kisha punuar druvar dhe krahët i kisha të fortë. E shikoja dorën që më varej dhe më kujtoheshin degët e thata kur pastronim pyllin. I njihja drurët dhe kisha parë kushedi sa degë të thyera që vareshin pas lëkurës, e cila i ushqente e i ushqente, ndërsa trangu lëshonte lëngje dhe mbushte plagët. Doja të ndodhte edhe me mua e njëjta gjë, sepse kisha lindur dhe isha rritur bashkë me drurët. Doktorin më tha ta prisja dorën. Përse? Se do të më merrte tërë trupin. Nuk pranova. Me një dorë sëpata nuk i pret trungjet e trasha. Më thanë se forcën e dorës së prerë do të ma merrte dora e shëndoshë. Qesha. Në pyll ne i prisnim degët e tepërta që druri të rritej i shëndetshëm dhe i

bukur, por unë isha njeri dhe njeriu asgjë nuk ka të tepërt. Apo e kam gabim? Jo? Ashtu mendoja dhe unë. Tërë ditën dhe sidomos natën nuk më hiqeshin nga mendja pyjet. Fëshfërinin sikur frynte vazhdimisht erë. Nuk ngopesha së dëgjuari. Pastaj vija në vete nga dhimbja. E duroja. Doktorin ngulte këmbë të ma priste pa vonesë. Kujtoja pyjet dhe nuk pranoja. Pse, mos do të kishte gjithmonë luftë? Ajo do të mbaronte një ditë. Pyjet nuk më donin me një dorë. Ditën e shtatë plaga m'u qelbëzua keq. Atëherë dhashë e mora me vetë dhe e kuptova se dora po më vdiste. E shikoja si vdiste dhe më sëmbonte në zemër. Ç'të bëja? Le të vdesë si një dru pylli. Nuk kishte lezet të ankohesha. Pemët nuk ankohen ndonjëherë.

Ditën e tetë po kalonim nëpër Karmë. Njeriu i parë që më pa dorën ishte një malësor, të cilit i kërkova ujë për të pirë. Edhe ai u habit si e mbaja në atë gjendje dorën. Ama unë kisha ditë që nuk dëgjoja ç'më thoshin njerëzit, po ç'më çuçuriste pylli. Thuaj pastaj që njeriu nuk është i çuditshëm. Edhe malësorit ia preva keq. Më mirë të vdes, sesa të jetoj sakat. Atëherë malësori më tha se do të më çonte te një heqim. Po të mos më bënte dhe ai derman, nuk kishte burrë nëne që të më shëronte. Shkova. Heqimi, sa ma pa plagën, mblodhi buzët. Më tha të rrija tek ai tri javë. Si ushtar, ma hoqën fillin dhe më lanë. Bile, ngaqë flisja ndonjëherë natën në gjumë me drurët, menduan se lajthitë fare. Heqimi ma mjekonte plagën me ilaçet e veta. Jo. Nuk e mësova dot se me çfarë i përgatiste. Të them të drejtën, edhe nuk e pyeta. Pas tri javësh urdhëroi të birin të vriste qenin. I biri e vrau. Heqimi mori nga këmba e prapme pjesën më të trashë, aq sa më ishte thyer mua nga plumbi. Dhe ma vuri kockën e qenit. Më tha se isha i ri dhe koci do të zinte. E mjekova edhe dy muaj rresht, pastaj u largova. Pas dhjetë muajsh fillova ta lëviz dhe pas dy vjetësh ta përdor për punë. Po të mos kisha dëgjuar pyllin, s'ot o do të isha sakat, o do të kisha vdekur. Se, kije nga unë këtë, toka dhe pylli asnjëherë nuk ta duan të keqen dhe asnjëherë

nuk të mësojnë për të keq. Ja, kështu ishte tërë kjo mesele. Hë, vjet më thirrën në Shkodër dhe pastaj nga Shkodra më nisën në Tiranë. Më panë krahun me ato veglat që keni ju. Më dhanë dhe nja dy letra që t'i kem. Posi! O Halit, sillja pak doktorit t'i shohë, — i thirri të birit.

Haliti solli letrat që i kërkoi i ati. Laboja i mori dhe lexoi:

Konstatim nga kontrolli që i është bërë të sëmurit në Spitalin Nr. 2 Klinik të Tiranës nga mjekët Stavri Vodica dhe Aleksandër Pepo:

Krahu i djathtë është 3-4 cm më i shkurtër, ka forcë muskulare të mesme. Në radiografi shihet një kockë 8-10 cm, e implatuar lateralisht humerit në formë pak harkore, si dhe rigjenerim i kockës së frakturuar të humerit, ku janë bashkuar dy fragmentet e thyera.

Shënim: Të njëjtin konstatim kishte edhe mjeku i Spitalit Civil, Shkodër, Paulin Ndoja, i cili e dërgoi pacientin në spitalin tonë për të vërtetuar sa më saktë këtë transplatim kockor të bërë nga një mjek popullor në Karmë.

14.

Treni kaloi stacionin e Vorës dhe po i afrohej Maminasit. Laboja shikonte peisazhin e zhveshur të kodrave dhe i kujtohej koha kur ishte student dhe e bënte shpesh atë rrugë. Kodrave ua njëhte edhe ndryshimin më të vogël. Duke parë ato, ai sillte ndër mend se si i rritej përditë dashuria për profesionin. Ndërsa tani kjo dashuri nuk ishte diçka e thjeshtë. Ashtu si nuk ishte diçka e thjeshtë dashuria e Frrok Spatës për pyllin. Ajo ishte dashuria për të qenë i shëndetshëm, si vetë natyra.

Labos i vinte keq që po i mbaronte udhëtimi. Ai qëndroi dy ditë në Lezhë dhe i dha dorën e fundit studimit dhe të dhënave. I kishte mbetur pa u takuar edhe mjeku popullor nga Durrësi, Rremë Leshteni.

Rrema banonte në Shijak. Laboja u nis për në Shijak me autobusin që nisej nga Shkozeti. Kur shkoi në shtëpinë e Rremës, nuk e gjeti. I thanë se Rremën e kishin thirrur që në mëngjes në Rashbull. Po nuk do të vonohej. Dhe, me të vërtetë, Rrema nuk u vonua. Ai ishte një plak i qetë. Edhe pyetjen e Labos, se kë kishte mjekuar të parin, e priti i qetë.

— Cilin kam mjekuar të parin fare? Të gjithë ma bëjnë këtë pyetje, sikur kanë frikë se mos e harroj. Ja, edhe ti, pa u çlodhur mirë, se ke bërë tërë atë udhë, do që të mësosh se kë kam shëruar të parin fare. Pse, kaq rëndësi paska ky i pari? Po pastaj edhe unë e vras mendjen dhe them se, po të mos ishte ky, i pari, ndofta nuk do t'i shëroja dot njerëzit. Nuk e kam harruar. Jo se do të vinit ju një ditë dhe do të më pyesnit, por se s'kam si ta harroj. E, kështu që thua ti, të parin fare kam shëruar delen time. Kishim gjithsej pesë dele. Na mbanin gjallë. Një ditë delja më e mirë theu këmbën. Veç ta dëgjoje si blegërinte. Të këpuste shpirtin. M'i mbërtheu sytë dhe nuk m'i shqiste. Dhe bee, beee! E mora me të mirë, e përkëdhela në kokë, i fola, i dhashë dhe bukën që më jepte nëna për tërë ditën, por ku i pushonin së shkretës dhimbjet! Bee, beee! Nuk e ulte dot këmbën e thyer. Rrinte me tre këmbët dhe fap, më shiko mua, fap, shiko shoqet e saj, sikur u lutej t'i bënin çare. Po ngrysej, ja si tani, veçse atëherë nuk ishte dimër, por kishte hyrë behari. Një të ardhur dhe qingji i vogël, dhe të dy nisën të blegërijnë aq fort, sa nuk dëgjohej gjë tjetër në atë livadh, përveç blegërimës së tyre. U ula në gjunjë dhe i kontrollova këmbën; Tëk, e pashë ku i ishte thyer. E pashë një herë, e pashë dy herë dhe në daç, më beso, në daç, mos më beso, por si e kam ndier veten atëherë, nuk më ka ndodhur më. Aty për aty vendosa t'ia lidh. Pashë rreth e rrotull dhe më shkuan sytë të shëlgjet që po shpërthenin gjeth. Një të hovur përpjetë dhe një të nxjerrë një lëkurë të gjatë nga shëlgju. Lëkura ishte e njomë dhe lëshonte lëng. Ia mbështolla këmbën e thyer deles me lëkurën e shëlgut dhe e hodha në kurriz. Qingji më ndiq-

te nga pas dhe nuk pushonte së blegëriri. Kushedi si mendonte, i shkreti. E kisha një frikë se mos im atë, sa ta shihte ashtu me këmbë të thyer, e therte. Por jo. Edhe ai u mërzit dhe vetëm tha se ishalla na shërohej. Këmbën ia lashë të lidhur një javë a më shumë, kush e mban mend tani. Kur ia hoqa, delja ecte për bukuri. Ia kontrollova me kujdes dhe pashë se kockat ishin ngjitur. Sikur e kam para syve. Si isha ashtu ulur, kur ndiej që delja po më lëpinte flokët, tamam si të ishte njeri. Mos qesh. Po, për herë të parë mua më ka përkëdhelur ja, ajo dele.

Do ti, që pas kësaj m'u hap nami në fshat — se kush ma hapi, nuk e di — dhe, sa i thyhej ndonjë bagëtie këmba, e sillnin tek unë. Pastaj shërova dhe njeriun e parë dhe, sa të më punojnë duart, do të shëroj kush të trokasë në derën e shtëpisë sime.

Allçinë? Allçinë nuk e kam përdorur asnjëherë. Se nuk e lë lëkurën të marrë frymë. Merr dot frymë ti, po të zunë hundët? Jo. Ashtu edhe lëkura. Edhe gjaku nuk lëviz si duhet, muskuli dobësohet, ose si i thoni ju me shkollë, aatt... he, atrofizohet. Mirë e thashë? Ke parë ti që këto fjalë nuk më hyjnë dot në tru. Posi, edhe lëkura e shelgut kishte një të keqe, se thahej dhe e lironte plagën. Atëherë e zëvendësova me karton. Edhe sot e kësaj dite me karton punoj.

15.

Në stacionin e Shkozetit nuk kishte asnjë pasagjer pothuajse atë mëngjes. Laboja mori biletën nga biletashitësja, së cilës akoma nuk i kishte dalë mirë gjumi, dhe doli në platformën e vogël. Nuk e dinte përse i pëlqenin aq shumë stacionet e vogla të trenave, sidomos drita e tyre e ngrohtë netëve të dimrit. Përgjegjësi i stacionit ngrinte fenerin, e tundte disa herë lart e poshtë, sikur i uronte natën e mirë lokomotivës, dhe qëndronte atje derisa treni të tretej në errësirën e natës. Ai shkon-

te në sallë dhe linte ndezur vetëm një dritë të zbehtë, të verdhë.

Deti përtej rrugës nacionale ishte ca i trazuar. Die-lli donte gati dhe dy orë që të lindte. Laboja ishte çuar herët që të kapte trenin e parë. Duke pritur, iu kujtua Rremë Lesheni që flinte përnatë me shqetësimin e trokitjes së njerëzve në derën e shtëpisë.

Në bufenë e stacionit fishkëlleu sirena e ekspresit. Laboja shkoi të pinte një kafe. Në bufe, mbështetur pas tavolinave të larta, pinin kafe me konjak dy punëtorë të hekurudhës. Ata po bisedonin për ndeshjen e futbollit. Aty Laboja u kujtua se dita e djeshme kishte qenë e diel. «Siç duket paska fituar skuadra e tyre», — mendoi Laboja kur pa fytyrat e kënaqura të dy punëtorëve. Kishte dhjetë ditë që udhëtonte dhe biseda e punëtorëve se pse iu duk e largët. Askush nuk do ta besonte se ai kishte mbërritur në stacionin e vogël të Shkozetit nga krahina e Gurit të Mirë, duke bërë pjesën më të madhe më këmbë. Më e pabesueshme kjo do të ishte për të dy punëtorët e hekurudhës.

— Si e do kafen?, — e pyeti bufetierja.

— Me shumë.

Dy punëtorët kthyen kokën dhe i hodhën Labos një vështrim të tillë sikur ai po pinte kafe për herë të parë. Labos i erdhi rëndë dhe u pendua që e porositi kafen me shumë. «Çunak, — qortoi veten, — mbete përherë çunak!».

Xhamat e mëdhenj të bufesë zunë avull. Jashtë po frynte një erë e ftohtë dhe e lagësht. Kodrat përballë dremisnin. Era e kafes ia hoqi edhe mjegullat e fundit të gjumit nga truri i lodhur. Punëtorët e hekurudhës paguan dhe dolën. Përtej avullit të xhamave të bufesë u shfaq turiri i lokomotivës. Laboja piu kafen e mbetur dhe doli.

Vagonat gati ishin bosh. «Vagonat bosh të dimrit», — mendoi Laboja. Atë mëngjes e ndiente veten të lehtë dhe në humor. Në të hyrë të Tiranës iu kujtua Vera, por kujtimi i saj iu tret shpejt nga shqetësimi i materialeve të mbledhura.

Zuri vend në hotel «Peza» dhe shkoi drejt e në Spitalin Nr. 1. U takua me pedagogun e vet dhe, duke u skuqur, i dha të dhënat e mbledhura dhe mendimet e veta mbi to. Pedagogu mori dosjen në dorë dhe pa numrin e faqeve. Tundi kokën i kënaqur dhe i tha Labos t'i shkonte në shtëpi.

— Kam marrë shtëpi të re pranë Bankës. E para ishte larg qendrës. Shkalla e parë, apartamenti katër. Le që, po pyete, ta tregojnë vetë menjëherë.

Laboja ishte çmësuar me shqetësime të tilla, si largësia e apartamentit nga qendra, numri i shkallës dhe sesi i dukej kur pedagogu i fliste aq i kënaqur. Vështron-te i hutuar dhe nuk dinte ç'të thoshte.

— Kështu, sot do të takohemi dhe bisedojmë. Mundësisht, eja pas orës gjashtë, se xheku marr një sy gjumë. Andej besoj se ke boll kohë. Këtej u këputëm.

— Jo, — tha Laboja, — nuk mbaj mend që kur s'kam fjetur për drekë. Fshatrat janë larg qendrës së lokalitetit dhe dimri është i ashpër.

— Edhe këtu na mbyti shiu, — u ankua pedagogu. — Ke zënë hotel?

— Po.

— Kot. Të kishe ardhur nga unë.

— Falemnderit, po ç't'ju ngushtoj kot.

— Jo, jo, tani jam mirë me dhoma.

Pedagogu nuk e fshihte kënaqësinë, bile Labos iu duk sikur ai e zgjaste muhabetin për të treguar sa mirë ishte rregulluar.

— Atëherë po vij në orën gjashtë, — tha Laboja me një farë nervi.

— Në rregull, — tha pedagogu dhe u largua për në sallën e mjekëve.

Laboja e ndjeu mungesën e Verës sapo ngeli vetëm dhe pa dosjen. I tha «mirupafshim» portierit plak dhe i erdhi keq që portieri e kishte harruar. Para spitalit ndaloi autobusi urban. Ai nxitoi dhe hipi. Nuk ambientej dot me jetën e kryeqytetit pas tërë atij udhëtimi. Drekën e hëngri shumë shpejt dhe shkoi në hotel të

merrte një sy gjumë. Gjumi e zuri sapo vuri kokën në jastëk.

Në orën gjashtë fiks ishte para derës, ku në një pllakë të vogël, të nikeluar ndritshëm, sikur dikush sapo e kishte fshirë, ishte shkruar emri «Dr. Stefan Kora». I ra ziles. Derën ia hapí një grua e re, simpátike, e veshur bukur dhe me shije. Sidomos trikoja e punuar pak si shtrënguar tregonte linjat elegante të trupit të saj.

— Është doktori, ju lutem?, — pyeti Laboja me një farë ngathtësie, që as vetë nuk e kuptonte nga i vinte.

— Mòs jeni ai studenti nga..., — dhe gruaja bëri një lëvizje të tillë me dorë, sikur emri i krahinës të fluturonte diku rrotull kokës së saj e ajo nuk po e kapte dot. Sytë i kishte të kaltër dhe në çiltërsinë e tyre kishte diçka fëmijnore. Gruaja nuk po e gjente dot emrin e krahinës dhe Laboja kënaqej kur shikonte se si mundohej ajo ta gjente patjetër. Ai e dinte se gruaja nuk kishte për ta gjetur, prandaj vendosi t'i jepte fund torturës së ëmbël të syve që nuk po e gjenin se ku fluturoi emri i krahinës.

— Guri i Mirë, — tha Laboja.

— Po, po. E kam bërë në gjeografi, por e paskam harruar. Mbetëm dhe te dera. Ju lutem, hyni brenda.

Ajo eci para dhe e futi në dhomën e pritjes. Ishte një dhomë e mobiluar hijshtëm dhe në tërë atë sistemim nuk gjeje një gjë që nuk ishte në vendin e vet. Dora që i kishte rregulluar dukej që ishte e ngeshme dhe me sensin e harmonisë. Megjithatë Labos iu duk sikur rregullimi i kishte ngrënë asaj më shumë kohë, sesa duhej. Në mes të dhomës ishte një tavolinë xhami, me një akuarium në mes.

— Uluni, uluni, Stefani tani vjen. Sa vuri kokën në jastëk, e thirrën, — tha gruaja me naivitet dhe se pse u skuq kur hasi vështrimin e Labos.

Laboja nuk dinte ku të ulëj.

— Uluni, uluni ku të doni. Mòs kini fare druajtje. Jo, miku nuk rri te dera. Ja, urdhëroni uluni këtu.

Laboja u ul në kolltukun e mesit. Gruaja u ul për-

ballë tij. Nuk dinin ç'të flisnin. Laboja ndiqte me bisht të syrit gruan. Ajo po shikonte se ç'përshtypje po i linte atij dhoma. Kjo e turbulloi.

«Mos duhet t'i lëvdoj dhomën», — tha Laboja me vete, por hoqi dorë menjëherë nga ky mendim. Nuk ishte mësuar me lëvdata të tilla dhe jeta që po bënte e largonte akoma më tepër nga kjo. Edhe gruaja, që u tregua aq e mirëpritur, heshtte, sikur donte të shtonte hutimin e tij. Laboja vendosi të mos thoshte asnjë fjalë.

— Bën dimër andej nga ju?, — pyeti gruaja.

— Andej tani është kulmi i dimrit, — tha Laboja.

— Mimosat gjithmonë të ngatërrojnë, — tha gruaja.

— Apo ne u besojmë atyre, se duam që të vijë pranvera?

— Nuk e di, — qeshi Laboja, — veçse nuk kam parë dru më naiv se mimoza.

Edhe gruaja e pedagogut vuri buzën në gaz.

— Kur më tha Stefani se do të vinit ju, m'u kujtua vetja nxënëse me përparëse të zezë. Atëherë habitesha me emrin e krahinës. Guri i Mirë! Im atë më thoshte se, që të veje në atë krahinë, duhej të kaloje shumë gryka të thella dhe rruga ishte e thepisur e tërë kthesa. Dhe unë e pyesja, sigurisht me naivitet, se, gjersa ishte aq thellë dhe aq larg, ç'kishin dashur njerëzit që kishin shkuar për të jetuar atje. Babai qeshte dhe më thoshte se do ta kuptoja kur të rritesha. Të them të drejtën, akoma nuk e kam kuptuar. Apo kam mbetur e vogël dhe nuk jam rritur?

Megjithëse ajo u përpoq që pyetjes së saj t'i jepte formën e shakasë, Labos iu duk sikur ajo e bëri atë pyetje me një farë dhimbjeje. Ai u përpoq t'i hiqte gruas çdo dyshim se ai e kuptoi dhimbjen e saj dhe tha:

— Edhe unë u habita në fillim dhe akoma nuk e kam kuptuar mirë, megjithëse po mbush katër vjet atje. Siç duket, kjo është e vështirë.

— Përse i kanë vënë këtë emër krahinës?

— Është e vështirë të shpjegohet me një fjalë.

— Mos lidhet me ndonjë legjendë?, — pyeti gruaja.

— Jo, — tha Laboja. — Nuk lidhet me ndonjë legjendë, por me jetën.

— Më jetën?! Nuk ju duket pak abstrakte se pse çdo gjë lidhet me jetën?

— Por ja që emri i krahinës së Gurit të Mirë lidhet me jetën më shumë se çdo toponim tjetër.

Gruaja ra në mendime. Nuk kaluan as disa sekonda, kur ajo u çua si e trembur.

— Më falni, — tha ajo, — harrova t'ju qeras.

Hapi bufenë e bibliotekës prej arre dhe nxori një shishe të bukur tërë etiketa.

— Mos kushedi profesorit i ka dalë shumë punë? Vij dhe nesër, — tha Laboja.

— Stefani më porositi njëqind herë të mos ju lë të largoheni. Ai sikur ka ardhur.

Gjëja që e bezdiste më tepër Labon ishte kur njerëzit përpiqeshin t'i tregonin me çdo kusht se për të po bënin diçka jashtë së zakonshmes.

Gruaja shtiu në gotë një pije ngjyrë vishnje dhe të trashë. Laboja mori gotën dhe u habit kur pa gruan që po rrinte më këmbë dhe po priste gjersa ai të pinte pijen.

— Mirë se ju gjeta, — uroi Laboja, por ky urim se pse iu duk gjysmak dhe kundër natyrës së tij vazhdoi: — Edhe me një djalë! Apo keni?

— S'kemi mbushur akoma tre vjet martuar...

Laboja sa e vuri në buzë gotën e sa shijoi shijen pak të hidhur të pijes dhe u mat ta linte, kur gruaja i tha me një farë qortimi:

— Pijeni të gjithë, e kam bërë vetë.

Laboja mendoi se tani ishte fare mirë rasti ta mburte të zonjën e shtëpisë, por përsëri ngriti krye kokëfortësia e tij. Heshti. Kjo gjë e mërziti gruan, e cila ishte mësuar të priste lavdërime pas pirjes së gotës. Labos iu duk një kënaqësi e vogël kjo gjë, megjithëse dyshoi se mos po sillej ashpër më shumë sesa duhej. Ra zilha.

— Erdhi, — tha gruaja e lehtësuar. — E njoh nga dora. Më falni.

— Ju lutem.

Laboja mbeti vetëm. Sytë i shkuan në volumet e

trasha të librave mjekësorë. Stefan Kora sa futi kokën në dhomën e pritjes dhe tha:

— Mos u mërzit edhe dy minuta.

Burrë e grua hynë në dhomën ngjitur. Labos iu duk sikur pak më parë në atë dhomë kishte bërë dialogun me pa kuptim. Dhe papritur i tërhoqi vëmendjen peshku në akuarium. Ishte një peshk i shëndetshëm, të cilit po i vënitej ngjyra. Bile nga barku e deri afër kurrizit luspat ishin zbardhur, sikur të kishte kaluar një sëmundje lëkure. Ai vërtitej tërë dembellëk nëpër akuariumin e rrumbullakët, pastaj hapte gojën e gogësinte dhe binte në një qetësi meditative. Të zotët e shtëpisë i kishin futur një degë asparagu, një gur poroz dhe një gjarpër të derdhur në xham shumëngjyrësh. Peshku doli mbi sipërfaqen e ujit dhe mbylli qepallat si diafragma aparat fotografik. Si fotografoi për të mijtën herë objektet e dhomës, tundi bishtin dhe u zhyt aq thellë, sa preku fundin e akuariumit. I erdhi një herë rrotull gurit poroz duke e vështruar me vëmendje, sikur po e shihte për herë të parë. Mos vallë peshku i gjorë mendoi se preku fundin e detit? Ai ishte i kënaqur. Pa tjetër që guri ishte mbretëria e nënujit. Sa mund i desh të zhytej deri aty! Dhe peshku bënte xhiro rreth gurit, që shërbente si miniaturë e fundit të detit. Si studioi nga të katër anët, iu avit me kujdes gjarprit të përdredhur. Lëboja vuri re se të zotët e shtëpisë e kishin lidhur me pe gjarprin. Ai lëvizi nga valëzimi i ujit. Peshku u tremb. Ç'kafshë të pasjellshme jetokan në këtë botë! Por peshku ishte kureshtar dhe i guximshëm. Mori zemër dhe iu afrua përsëri gjarprit. Gjarpri ishte indiferent në derdhjen e tij. Peshku afroi hundën dhe i mbajti erë. Labos i erdhi për të qeshur. Peshku u largua nga gjarpri fodull e i pakënaqur. Atë çast i tërhoqi vëmendjen asparagu. Dega notonte mbi ujë. Peshku u zhyt të gjente ku arrinin rrënjët e bimës. Dhe u diziluzionua. Asparagu nuk arrinte dot as deri në mes të akuariumit. Peshku mendoi të largohej nga ai det ku asgjë nuk ishte interesante. Dhe ai i ra përsëri mbarë e prapë akuariumit dhe përsëri gjeti të njëjtat objekte.

Veçse këtë herë ai i gjeti ato në një det të shqetësuar. Peshku nuk e dinte se tërë atë stuhie krijoi vetë. Ishte i kënaqur dhe i lodhur. Duhej të pushonte. Kishte përshkuar një det të vështirë, të shqetësuar, plot dallgë, shkëmbinj, bimë dhe kafshë të atrofizuara dhe të fosilizuara. Mbi sipërfaqen e akuariumit binte drita e ëmbël e abazhurit, si drita e hënës. Peshku gëlltiti një thërrime diskote.

— Siç duket, peshqit, të pëlqekan shumë, — tha Stefani duke hyrë në dhomë.

Ai i ra më thoin e gishtit tregues akuariumit që të rembte peshkun. Por peshku nuk e prishi terezinë. Një zërit nuk e dinin se ai sapo kishte përshkuar një det të vështirë, plot dallgë. Tani ai po çlodhej.

— Njeriu nuk bën dot pa natyrën, — tha prapë Stefan Kora.

— Ashtu është, — tha Laboja.

— Vetëm ti mos u anko, — tha Stefani. — Apo edhe ti mban peshk në akuarium? Se je nga Bregu. Dhe kush të pa një herë dhe nuk e bëre rob, o deti im i fëmijnisë! Ke mall, besoj.

— Kam. Po s'ma ha mendja që të ma nxjerrë një peshk i mbajtur në akuarium, — tha Laboja gjysmë me shaka, gjysmëseriozisht mos fyhej i zoti i shtëpisë.

Në dhomë hyri përsëri e shoqja e Stefanit.

— E qerase Labon?

— Si nuk e qerasa? T'ju shtie edhe nga një?

— Patjetër, edhe pyet.

Përdet e trasha dhe tyli i hollë, i bukur, linin të hynte nga jashtë një dritë e mugët neoni. Dëgjohej zhurma e autobuzave urbanë të linjës Kinostudio-Kombinat. Gjallëria poetike e Tiranës kur bie mbrëmja...

— I lexova ato që më dhe në mëngjes. Kishte gjëra interesante.

— Doja t'i lexoja dhe unë, po Stefani harroi të më linte çelësin e sirtarit, — ndërhyri dhe e shoqja. — Isha kurioze, sepse kam një përfytyrim të turbullt mbi mjekësinë popullore.

— Mos u mërzit, gjërat më interesante t'i tregoj unë, — e qetësoi i shoqi.

— Ndryshe është kur i lexon vetë dhe ndryshe kur t'i thonë të tjerët.

— Sa kohë të është dashur për t'i mbledhur?, — iu drejtua befas Stefani Labos.

— Mbi tre vjet.

Mimika e Stefan Korës shprehu habi.

— Interessant si është njeriu! Do të bëjë si do të bëjë, por një farë mënyre për të kaluar kohën do ta gjejë se s'bën, — tha ai si i zhytur në mendime, por, kur pa se Laboja u prek, shtoi duke buzëqeshur: — Keni bërë një punë të bukur. Megjithëse nuk e di sa do t'i shërbejnë të dhënat tuaja mjekësisë. Veçse ato mund të shërbejnë për historikun e saj. Ju si thoni? Në këtë fushë ne jemi pak si prapa.

— Nuk e di. Kur fillova të mbledh të dhënat, nuk u nisa aspak, si të thuash, për të shkruar kapitullin e parë të historisë së mjekësisë. Unë doja të hyja me tonë të fshehtë e ekzistencës së jetës në krahinën e Gurrit të Mirë. Jeta në këtë krahinë nuk ka qenë e lehtë.

— Vend i egër, — tha e shoqja e Stefan Korës.

— Shumë i egër, — u përgjigj Laboja. — Por jeta mbeti dhe aty jetë. Kur jeta qëndron e pamposhtur, ajo ka një bukuri të veçantë. Apo e kam gabim?, — tha Laboja me një ton sfidues.

Burrë e grua nuk folën.

— Kjo mjekësi është e lashtë, u ka rezistuar shekujve dhe, po t'i nënshtrohet eksperimentimit klinik, do t'i rezistojë patjetër edhe atij. Kjo më shtyu që t'i futem akoma më me zell.

— Për veten time, unë preferoj substancat kimike, — tha Stefani. — Në mos gabohem, kjo është dhe tendenca e terapisë moderne.

— Edhe për këtë kam menduar gjatë kësaj kohe. Kam vënë re se substancat e natyrës sintetike, në krahasim me ato bimore, janë toksike, në këtë apo atë shkallë, për funksionet fiziologjike të makroorganizmit.

— Aspak, Labo, aspak. Bile ky mendim më duket dhe frenues.

— Përse?

— Sepse mund t'i kushtohej më tepër kohë sesa duhej dhe do të shkaktonte shkëputjen e mjekësisë nga shkencat e tjera moderne.

— Më falni, por...

— Të lutem. Ky nuk është vetëm mendimi im, por i... — Dhe Stefan Kora bëri me kokë nga librat e trashë të bibliotekës.

— Këtë doja të thosha dhe unë. Në mos gabohem, biologjia është një nga këto shkencat çelës.

— Po.

— Në farmakopetë e vendeve të ndryshme rekomandojnë për mjekimin e anoreksisë sanzën, gentianën e përdorur nga ilirët. Po në farmakopenë botërore ka mbi dhjetë bimë me emrin e Gentit, mbretit të ilirëve.

— Më bëhet qejfi që i ke hyrë me kaq seriozitet kësaj pune. Por nuk të duket se ky zell për t'iu referuar literaturës, vetëm për ato që justifikojnë mendimin tënd, tregon për një farë dyshimi që mund të të ketë lindur edhe ty?

— Jo, — tha Laboja, — t'i referohesh së kaluarës për një pohim, do të thotë se do që ky pohim të jetë sa më shkencor.

— Pa harruar se ka gjëra që i përkasin vetëm së kaluarës e për kohën tonë ruajnë vetëm vlera etnografike.

— Nuk ju kuptoj.

— Ju keni mbledhur foshnjërinë e mjekësisë. Këtu është dhe vlera e tyre.

Laboja nuk foli. E shoqja e Stefan Korës u çua të bënte kafet.

— Mos e humb kështu, or burrë, — tha me shaka Stefan Kora. — Hajt, gëzuar!

— Jo, — tha Laboja, që nuk e kishte dëgjuar mirë ç'tha pak më parë Stefan Kora, — ato nuk janë aq të thjeshta. Gjithmonë kam qenë i bindur se në këto re-

ceta të thjeshta është jeta në luftë me asgjësimin. Prandaj dhe vlera e tyre do të jetë e përhershme, si dashuria e njeriut për të qëndruar pranë truallit ku lindi.

— Mos harro se në kohë të ndryshme ka mjete të ndryshme.

— Dashuria për tokën nuk ndryshon as formën dhe as mjetet. Ky është dhe çelësi për të zbërthyer gjuhën e thjeshtë të këtyre të dhënave. Ato lindën pikërisht nga kjo dashuri.

— Të lutem, na mbush edhe nga një gotë para se të pimë kafën, — i tha Stefan Kora së shoqes, që hyri në dhomë me tabakanë e kafes në dorë.

Gruaja mbushi përsëri gotat, por jo me kënaqësinë e parë.

«Ndofta i vjen keq për pijen që e ka pregatitur me aq kujdes për të qerasur mysafirët vetëm me një gotë», — mendoi Laboja dhe u mërzit.

— Përse je kaq këmbëngulës, Labo? Mos të vjen keq se të kanë humbur tre vjet, të cilët mund...

— Jo, — tha Laboja, — asnjëherë nuk i kam menduar të humbur.

— Ndofta, tani e keni të vështirë ta kuptoni këtë.

— Ndofta. Megjithatë ata kanë një të vërtetë të madhe brenda, pa të cilën nuk bëhesh dot mjek.

— Cilën?

— Një mjek popullor kishte si moto të punës së vet: «Kërkoje çdo gjë pranë dheut ku jeton». Këtë ia kishte thënë i ati të atit; i gjyshi të gjyshit; stërgjyshi...

— Si puna e plakut pas plakës, — qeshi Stefan Kora. Përpjekja e Stefan Korës për ta kthyer bisedën në shaka kur ajo futej në diskutim, po e nxehte përherë e më shumë Labon.

— Si puna e mesazheve që brezat i lënë njëri-tjetrit, — tha Laboja me një nerv që të dy bashkëshortët s'kishte si të mos e vinin re.

! Pas kësaj biseda u shua. Në tavan ranë lulet e perdeve të projektuara nga dritat e një veture që kaloi

me shpejtësi. Peshku dremiste në akuarium. Stefan Kora u shtriq padashur.

— Kur nuk fle mirë pasdite, e ndiej veten debël, — tha ai.

E shoqja mblodhi gotat e pijes dhe filxhanët e kafes.

— Përse nuk i futesh studimit të ndonjë sëmundjeje karakteristike për atë krahinë?, — pyeti Stefan Kora me një kujdes gati atëror, — Do të ishte një kontribut me vlerë.

— Deri tani nuk kam konstatuar ndonjë sëmundje të tillë, — tha Laboja.

— Nuk ka mundësi. Por, i dhënë pas mjekësisë popullore, nuk e ke vënë re. Mos u shqetëso, je në fillim të karrierës. Do të të ndihmoja me gjithë qejf.

— Hëpërhë nuk kam ndër mend t'i futem një pune të tillë. Unë vetëm sa e kam filluar studimin e mjekësisë popullore, — tha Laboja prerë.

— Si të duash, — tha Stefan Kora dhe e vështroi në sy sikur i vinte keq për të.

Laboja e ndjeu se ata nuk kishin më ç'ti thoshin njëri-tjetrit. Donte të çohet menjëherë, por qëndroi dhe pak që të mos ia merrnin si fyerje. Ora po shkonte nëntë. Stefan Kora u ngrit nga kolltuku dhe eci nëpër dhomë të çmpehej. Iu afrua peshkut dhe e trembi përsëri, duke i rënë xhamit të akuariumit me thoin e gishtit tregues. Peshku filloi të bënte stuhi.

— Ia ndërrove sot ujin?, — pyeti Stefani të shoqen.

— Po.

— Prandaj është kaq i freskët.

— Do të më falni mua, — tha Laboja dhe u çua.

— Rri të hamë darkë.

— Ju falem nderit, po kam lënë takim me një shok kursi.

— Kur qenka kështu, nuk po të vonojmë. Ti, Vjollca, nuk mund ta marrësh me mend sa të bukura dhe të dashura janë këto takime.

E shoqja uli kokën dhe një farë trishtimi u end në sytë e saj. Laboja mori dosjen, u përshëndet dhe, kur

i dha dorën së shoqes së Stefan Korës, vuri re se trishimi i saj u shtua akoma më tepër. Para se të zbriste shkallët, ai se pse ktheu përsëri kokën dhe sytë i shkuan padashur te peshku që kishte rënë përsëri në qetësi dhe dremiste i kënaqur në akuarium nën dritën hënore të abazhurit.

16.

Laboja mendoi të shkonte drejt e në hotel por, për çudi, megjithëse ishte dimër, ajo natë kishte diçka nga pranvera. Ai zbriti drejt korpusit kryesor të Universitetit dhe i pëlqeu të mos nxitonte. Ishte i vetmi njeri që shëtiste në bulevardin më të madh të Republikës mënge. Pishat e buta, përthyenin dritën e llambave neon dhe dukeshin sikur ishin të mbuluara nga bryma. Një mjegull e lehtë e bënte më të largët dhe më real Monumentin e Skënderbeut. «Ai qëndroi i pamposhtur një çerek shekulli», — iu kujtua Labos mësimi i historisë. Mjegulla binte mbi pelerinën e ushtarit të përjetshëm, ndërsa kali bëhej gati të hidhte çapin e tij të rëndë mbi tokën e ngrirë të dimrit. Për herë të parë Laboja dalloi në derdhjen e bronzit gatishmërinë për të sakrifikuar. Heroin dhe kalin ndërgjegjja e popullit i kishin kthyer në simbole. Dhe simbolet nuk kanë moshë. Dhe iu kujtua gjethedelli mbi varrin e mjekut të panjohur në rrënojat e kalasë. Edhe ai ishte një simbol.

Kur po hynte në hotel, iu kujtua Vera. Kishte gati mbi dhjetë ditë që ajo i kujtohej vetëtimthi si një vegim. Pastaj tretej. Laboja nuk dinte si ta shpjegonte këtë gjë. Njëherë mendoi se largësia ishte një provë, por pastaj u nxeh me veten, duke thënë se ai nuk ishte larguar për të provuar ndjenjat e tij për Verën.

Sportelisti e pa i ngrysur, si i vështrojnë zakonisht klientët që kthehen vonë. Laboja u ngjit në dhomë dhe la ndezur dritën e abazhurit të komosë. U shtri me idenë se do të mendonte vetëm për Verën. Kur u zgjua, ishte

si i hutuar dhe nuk dinte se përse kishte menduar më shumë gjatë asaj nate.

Që në mëngjes shkoi në Institutin e Mjekësisë Popullore, dorëzoi aty materialet dhe studimin e vet dhe nxitoi të arrinte trenin. Po atë ditë me një makinë të rastit shkoi deri në Fushën e Kalit. Më tej dëborë kishte bllokuar rrugën. Rrugën deri në lokalitet e bëri në këmbë bashkë me katër malësorë. Mbërritën në mesnatë.

Në spital ndriçonte vetëm drita e jashtme.

— Ti, Labo, je?, — pyeti Lulash Kashi, roja i spitalit.

— Unë, Lulash, unë.

Ata i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe Lulashi nuk po ia ndante sytë. Laboja nuk po kuptonte gjë dhe nuk dinte ç'të thoshte.

— Qenke dobësuar pak, doktor, — tha Lulashi.

Laboja shkoi dorën mbi fytyrë dhe qeshi.

— Ju këtej si jeni?

— Mirë.

— Shokët flenë?

— Flenë.

— Ç'kemi ndonjë të re këtej?

— Asgjë. Ti si i le nga shtëpia?

— Nuk isha në shtëpi.

— Pse, ku ishe?

Laboja nuk dinte si t'i përgjigjej. Në atë çast ajo ishte pyetja më e thjeshtë, por së cilës nuk mund t'i përgjigjeshe me dy fjalë. Fshati flinte. Lumi poshtë këmbëve të tyre bënte zhurmën e tij të zakonshme, të njohur dhe të dashur. Laboja e kuptoi se larg atë e kishte marrë malli edhe për lumin, edhe për dëborën, edhe për dritën e zbehtë të spitalit. Po ky ishte një mall i heshtur dhe i fshehtë. Ai ishte një mall i vërtetë. Vetëm malli i vërtetë e shkakton atë ndjenjë gëzimi të veçantë kur të duket sikur po kthehesh pas një kohe të gjatë në vendin e dashur, ndonëse ke munguar vetëm disa ditë. Lulash Kashi priste përgjigje. Dhe

përsëri e pyeti Labon se ku kishte munguar aq gjatë. Dhe Laboja i tha:

— Ta them nesër, se sonte jam i lodhur dhe më flihet.

— Mirë, — tha Lulash Kashi. — Vetëm ndonjë hall mos kesh pasur.

— Nuk kam pasur, jo, — tha Laboja me buzën në gaz. — Natën e mirë!

— Natën e mirë!, — tha Lulash Kashi, megjithëse e brente dyshimi.

Ai mendonte se doktori duhej të kishte pasur ndonjë hall të madh. Vetëm hallet e mëdha e dobësojnë ashtu njeriun.

17.

Jeta në krahinën e Gurit të Mirë rridhte e qetë. Natën frynte erë dhe qëmtonte dëborë. Malësorët thoshin se ai ishte dimër i bukur dhe i rrallë. Ditën e tretë si u kthye nga Tirana, Laboja zuri dy trofta të mëdha. Ata u mblodhën në shtëpinë e Arifit, infermierit më të vjetër të spitalit, dhe ndenjën aty deri vonë. Lulash Kashi erdhi në qejf dhe nuk donte që ta mbyllnin aq shpejt. Për hir të tij qëndruan edhe një orë. Kur po ktheheshin për në spital, Laboja u habit kur u ndodh vetëm për vetëm me Verën. Edhe ajo nuk dinte si ta shpjegonte këtë. U hutuan dhe ecën pa folur. Mbi fshat binte një dëborë flokëmadhe, e ngeshme, dembele. Vera ngriti kokën dhe dalloi një flok të madh, që po zbriste nën dritën e rrugës tërë naze. Ajo hapi gojën dhe e kapi. Kjo lodër filloi t'i pëlqente. Diku i rrëshqiti këmba. Laboja i dha dorën për ta ngritur. Vera, ashtu ulur siç qe, i kapi dorën dhe e vështroi në sy. Ajo qëndroi për një çast mbi dëborë dhe Laboja shikonte se si dëborë zinte vend mbi flokët e saj. Kur ajo u çua, ata nuk i shkëputën duart. Ecën drejt spitalit të zënë për dorë dhe krejt të zbardhur.

— Dale të të shkund dëborën, — tha Vera.
Por Laboja nuk e la. E mbështeti pas gjoksit dhe e shtrëngoi fort. Ajo u ngjesh ngadalë dhe Labos iu duk sikur Vera po qante. Por ai nuk guxonte ta shihte në sy. Dhe, për çudi, atë natë gjithçka ishte aq e lehtë, aq e qetë dhe aq e bukur. Dëborë binte e binte me flokët e mëdhenj e dembelë, ndërsa fshati flinte nën zhurmën e lumit. Dhe çdo gjë ishte sa e vjetër, aq dhe e re. Dhe atyre të dyve u dukej se kishin kohë që e dashuronin njëri-tjetrin.

Instituti i Mjekësisë Popullore i dërgoi Labos një letër ku e përgëzonte për punën e nisur dhe shprehte bindjen se ai do të ishte një bashkëpunëtor i rregullt. Materiali i mbledhur prej tij dhe studimi shoqërues do të botohej në dy numrat e ardhshëm të buletinit shkencor. Së bashku me letrën i kishin dërguar dhe një ftesë për sesionin shkencor që do të mbahej në fund të muajit mars. Ai do të referonte mbi kirurgjinë e luftës në krahinën e Gurit të Mirë. Laboja filloi të përgatitej për referatin e tij, por ndodhi që ai të mos merrte pjesë në atë sesion.

Më njëzet e pesë mars mbeturina e një orteku zuri katër malësorë. Tërë lokaliteti u ngrit më këmbë. I gjetën gati të ngrirë. Ndaj të ngrysur i sollën në spital. Laboja qëndroi pa gjumë tërë natën. Kryetari i këshillit i tha të kërkonin helikopterin për t'i çuar në Tiranë, por Laboja nuk pranoi. Ai nguli këmbë se do t'i shëronte vetë. Por kryetari i tha se do të lajmëronte spitalin e qytetit. Laboja ia priti se ai mund të lajmëronte kë të donte, por të sëmurët do t'i mjekonte vetë. Dikush u shpreh se Laboja po tregohej shumë mendjemadh dhe po merrte më qafë katër burra. Laboja bëri sikur nuk dëgjoi gjë dhe u largua për në spital. Kalorësit ishin keq. Laboja filloi mjekimin e tyre dhe atë ditë vetëm nga dreka vuri pak bukë në gojë. Të sëmurët dhanë shenjën e parë të përmirësimit. Atë e kapi vetëm Laboja. Ai shkoi të merrte një sy gjumë. Po bënte gati dyzet orë pa u qetësuar. Sa e kishte zënë gjumi, e zgjuan. I thanë se kishte ardhur një mjek nga

qyteti për malësorët. Ai kishte vizituar të sëmurët dhe kishte urdhëruar të zgjonin doktorin. Ata u takuan dhe dolën të bisedonin në oborr. Mjeku nga qyteti ishte më i madh në moshë se Laboja.

— Sikur t'i marr, — tha ai. — Dhe ti je i qetë.

— Jo, — tha Laboja. — Këtu kam gjithçka që u duhet pacientëve për t'u shëruar.

— Mos po merr përsipër diçka jashtë mundësive të tua?, — tha mjeku nga qyteti me një ton dashamirës.

— Jo, — tha prapë Laboja.

— Mos më keqkupto. Mendohu, unë pres.

Ata ecnin nëpër oborr dhe shikonin se si hapat e tyre mbeteshin mbi dëborë. Moti po bëhej më i ftohtë, se po errej.

— Jam menduar, — tha Laboja. — Asnjëherë nuk i kam pasur qejf aventurat.

— Nuk të kuptoj, — tha mjeku. — Ti tani ke aq përvojë sa të dish se profesioni ynë është privuar nga pendimi.

Laboja vuri buzën në gaz apo mendoi se vuri buzën në gaz.

— E di, — tha ai.

— Kur thashë t'i marr në qytet, nuk doja të të fyeja.

— E di, — tha Laboja, — por jam i bindur se ata do të shërohen fare mirë këtu.

— Në këtë bindje mos ka ndikuar jeta jote këtu?

— Patjetër, — tha Laboja.

Mjeku nga qyteti i hodhi krahun. Drejt majave të Alpeve po ngjitej nata.

— Kur isha i vogël, vija gati çdo verë këtu, me babanë, — tha mjeku nga qyteti. — Këtë verë do të marr djalin dhe do të vij patjetër, le të dojë gruaja për në plazh.

— Dua të të tregoj diçka, — tha Laboja.

— Mirë, — tha mjeku, — por më parë më pihet një kafe.

Shkuan në klub. U liruan menjëherë një tavolinë. Mjeku nga qyteti qeshi nën buzë dhe e kuptoi se Labon

e hutonin kujdesjet e tepruara. Por mjeku nuk vuri re ndonjë gjë të tepërt në sjelljet e malësorëve. Tek atë gjithçka ishte aq e natyrshme. Por prapë ai pyeti Labon:

— Siç duket, të respektojnë shumë.

— Jo, — tha Laboja, — si çdo njeri.

— Malësorët e kanë të hollë nuhatjen për të dalluar njeriun e mirë. Këtë ua ka mësuar jeta, dhe unë e njoh mirë.

Zefi u solli kafet, të shoqëruara me nga një gotë raki. Ai i la ato mbi tavolinë dhe u largua pa folur. Laboja me mjekun nga qyteti kthyen kokën për të parë se nga kush i kishin, por malësorët që ishin ulur në tavolinat pranë bisedonin të qetë. Ata trokitën gotat, duke i uruar njëri-tjetrit për njohjen, dhe Laboja filloi t'i tregonte për studimin e vet dhe mbi të dhënat që kishte mbledhur. Ai tregonte dhe përpiqej të kapte edhe reagimin më të vogël të kolegut. Tjetri e dëgjonte me vëmendje. Në klub hynte ndonjë malësor i vonuar dhe, pasi përshëndeste me zë të lartë, ulej në karrigen që i afronin. Jashtë ndërrimi i muzgut me natën ishte bërë shpejt e shpejt pa u kuptuar, si ndodh zakonisht në Alpe. Kjo ishte më e theksuar sidomos tani në dimër. Laboja heshti dhe priste si do të përgjigjej mjeku nga qyteti. Tjetri vështronte nga banaku, ku Zefi me të shoqen po bënin llogarinë e ditës, dhe nuk po fliste. Rrotullonte në dorë filxhanin bosh të kafes dhe papritur e pyeti:

— Si ke ndër mend t'i mjekosh?

— Me të dyja. Edhe me të dhënat e mjekësisë popullore, edhe me ato që kemi mësuar në shkollë. Sipas rastit.

— Nuk di ç'të të them. Për vete jam më se i bindur se do të dalësh mirë. Ndofta këtë bindje e kam ngaqë më pëlqen.

Ai e tha këtë aq sinqerisht, sa Laboja u prek.

— Rri sonte nga unë, — tha Laboja.

— Nuk mundem, — tha mjeku nga qyteti. Ai vë-

shtroi orën dhe shtoi: — Edhe kaq dhe ndenja shumë.

— Tani është natë. Nisu nesër që në mëngjes.

— Nuk mundem. Në Fushën e Kalit më presin.

Kur dolën jashtë, frynte një erë e ftohtë, e padukshme.

— Era paska rënë, — tha mjeku.

— Kot ngul këmbë për t'u nisur, — tha Laboja.

— Po të mos më prisnin, do të qëndroja edhe pa më thënë ti.

— Ata do ta marrin me mend.

— Por edhe mund të shqetësohen. Udhë, dimër, natë... Pastaj nuk jam vetëm. Jam me dy malësorë nga Fushëkali, me gjithë mushka. Ja, ua dëgjon zilet? Edhe ato janë bërë merak.

Nën dritën elektrike mushkat e lidhura përtypnin tërshërë në trastat e varura në qafë. Ata u afruan deri aty pa folur. Nga qoshja e shtëpisë përballë dolën menjëherë dy malësorët. Laboja u dha dorën.

— Mos të bëmë vonë, doktor, — tha njëri prej tyre.

— Jo, edhe ne sapo erdhëm. Epo atëherë, mirupafshim!

— Ata nuk do t'i marrim me vete?, — pyeti njëri prej shoqëruesve.

— Jo, — tha mjeku nga qyteti dhe, si hodhi sytë nga Laboja, shtoi: — Do t'i shërojë ky këtu.

Malësorët nuk folën dhe filluan t'u zgjidhnin kapistrat mushkave dhe t'u hiqnin trastat, duke u rënë lehtë, me përkëdheli, në fytyrë.

— Për çdo të papritur, të lutem të më lajmërosh menjëherë. — tha mjeku nga qyteti duke u ndarë nga Laboja.

— Mos ki merak.

Mjeku nga qyteti u largua disa hapa, pastaj u kthye menjëherë, sikur kishte harruar pa thënë diçka të rëndësishme, tundi dorën dhe tha:

— Natën e mirë!

— Nesër do të të marr në telefon që në mëngjes,
— tha Laboja.

— Mos ia ki merakun doktorit, or dashamir, se e kemi vetë në kujdes, — tha shoqëruesi më i moshuar.

Zuri të qëmtonte dëborë. Era sillte zhurmën e pishave të pyllit. Zilet e mushkave sa vinin dhe largoheshin. Laboja shkundi dëborën nga flokët. Vetëm kur zhurma e zileve humbi nën dëborën e butë që binte, ai u nis për në spital. Edhe ajo natë do të kalonte pa gjumë, por Laboja ndiente një qetësi të ëmbël në tërëqenien e tij.

100 Toka e Guri të Mës (Guri)
101 Me shkrim
102 Kur të kisheshin me një
103 Mbrojtja e një vete
104 Këmbët e vëllave të dam
105 Një qarin
106 Një Selva në Tërnang
107 Shprehja
108 I gabërkund
109 Dësh e trëll të luftës
110 Dhor, dhor im
111 Ujë dërr
112 Një dërr

— Këtu do të marrë në telon që në mënyrë
— Janë Labeja.
— Kështu ia di tërëkëmbë doktorit në bashkëpunim, se e
kurrë vëra në këmbë, — the shprehur me i mosmarrë.
Në të gjithë këto, për sille këmbë e qe-
shave të pafit. Një e moshkave në vinn dhe jarghe-
shin. Labeja shkollë këmbë nga flokët. Vetëm kur
shumë e shive këmbë nën këmbë e pult që dinte.
Në u nis për në të kalonte qe
stamë por Labeja bënte një dëgjë të këmbë në këmbë
përdien e tij.

PASQYRË E LËNDËS

	Faqe
Nisemi, djema!	3
Unë, djali yt	29
Dhori, burri im	40
Ditën e tretë të luftimit	52
I papërkuluri	60
Stazhieri	73
Nga Selca në Tamarë	85
Net prilli	93
Fëmijët e viteve të para	109
Mposhtja e një nate	118
Kur të kthehesha me leje	128
Me shërbim	139
Toka e Gurit të Mirë (novelë)	159

Tirazhi: 10.000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1977